

EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE
ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

Viti LV nr. 138 / 2025

Boton: KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME E KOSOVËS

EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE

ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

www.edukataislame.net

e-mail: edukataislame@yahoo.com

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182

Tel & fax: 038 / 224-024

Redaksia:

Ramadan Shkodra - kryeredaktor,

Dr. Ajni Sinani - redaktor

Dr. Sadik Mehmeti - redaktor

Dr. Sedat Islami - redaktor

Mr. Besnik Jaha - redaktor

Redaktor gjuhësor:

Besnik Jaha

Redaktor teknik & ballina:

Nuhi Simnica

Shtypi:

"Printing press" - Prishtinë

Tirazhi: 300

EDUKATA ISLAME

REVISTË TREMUJORE

ISLAME - SHKENCORE - KULTURORE

Viti LV nr. 138 / 2025

Prishtinë
2025

I. EDITORIAL

30-VJET NGA GJENOCIDI SERB NË SREBRENICË

Srebrenica - plagë që ende lëngon

Tridhjetë vjet më parë, në korrik të vitit 1995, në zemër të Evropës ndodhi një nga krimet më të errëta të historisë moderne: gjenocidi në Srebrenicë. Më shumë se tetë mijë burra dhe djem myslimanë boshnjakë u ndanë me dhunë nga nënat, gratë dhe motrat e tyre, për t'u ekzekutuar mizorisht vetëm pse ishin myslimanë, vetëm pse ishin boshnjakë. Gratë u dhunuan, fëmijët u lanë jetimë, të moshuarit u dëbuan, dhe e gjithë struktura shoqërore e qytetit u shkatërrua. Dhe, kjo masakër ndodhi në një vend që kishte statusin e “zonës së mbrojtur” nga Kombet e Bashkuara. Ishte një siguri e tradhtuar, një besim i shkelur, një përgjegjësi ndërkombëtare e lënë në baltë. Ky akt gjenocidal u krye me një qëllim të qartë: shfarosjen e një populli për shkak të përkatësisë së tij etnike dhe fetare. Ideologjia që e ushqeui këtë krim nuk lindi rastësisht, por u ndërtua për vite të tëra në akademi, në kisha dhe në qarqe të caktuara intelektuale e artistike, të cilat e bekuan dhunën si projekt kombëtar. Srebrenica ishte kulmi i kësaj ideologjie shfarosëse, por jo fundi i saj, sepse e njëjta makineri do të përsëritej edhe në Kosovë, pak vite më vonë, me masakra, spastrim etnik, djegie, shkatërrim, dëbim masiv të shqiptarëve...

Tridhjetë vjet pas kësaj tragjedie në Srebrenicë, miratimi i Rezolutës së Kombeve të Bashkuara, e cila e njeh zyrtarisht gjenocidin serb mbi popullatën boshnjake, ka një domethënie historike. Nuk është vetëm një akt juridik, por, mbi të gjitha, moral. Është një fitore e së vërtetës mbi mohimin, një hap i vonuar, por i domosdoshëm në betejën kundër relativizimit dhe heshtjes. Serbia zyrtare, ajo që e shkaktoi këtë tragjedi, fatkeqësisht, ende nuk ka marrë përgjegjësinë për këtë krim. Në vend të pendesës kemi parë mohimin, në vend të ndjesës relativizimin, në vend të drejtësisë heshtjen. Ky qëndrim nuk i shërben paqes, nuk i shërben as së ardhmes, por e ushqen kulturën e pandëshkueshmërisë dhe e mban gjallë ideologjinë e gjenocidit. Për këtë arsye, Rezoluta e OKB-së nuk është vetëm një doku-

ment ndërkombëtar, por një akt kujtese kolektive dhe një thirrje për të mos lejuar që mohimi të bëhet pjesë e narratives historike. Ajo është një kujtesë se e vërteta është parakusht për drejtësi, dhe se pa drejtësi nuk mund të ketë as paqe të qëndrueshme.

Ndërgjegje që nuk hesht

Në këtë frymë, edhe Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka marrë mbi vete obligimin moral dhe fetar që mos të lejojë që Srebrenica të harrohet. Këtë vit në Prishtinë, më 8 korrik, u organizua promovimi i librit të imam Mevludin Hrnjiq, “Dëshmitari i Srebrenicës”. Ky libër nuk është thjesht një botim, por një dëshmi jetësore, një rrëfim i një të mbijetuarit që flet jo vetëm për tmerret e përjetuara, por edhe për forcën e njeriut përballë errësirës absolute. Rrëfimi i tij është i dhimbshëm, por i domosdoshëm, sepse është një zë që e thyen heshtjen, që e mposht mohimin dhe që na detyron të ballafaqohemi me realitetin e hidhur. Botimi i këtij libri në gjuhën shqipe është një homazh për viktimat, por edhe një mësim për ne shqiptarët, të cilët kemi kaluar tragjedi të ngjashme nga e njëjta makineri shtetërore gjenocidale. Është një kujtesë se kujtimi nuk është luks, por domosdoshmëri, se drejtësia nuk është kërkesë e viktimave, por parakusht i njerëzimit.

Më 11 korrik 2025, në Potoçari të Srebrenicës, në përvjetorin e 30-të të gjenocidit dhe njëkohësisht në përvjetorin e parë të miratimit të Rezolutës së OKB-së, u mbledhën qindra personalitete nga bota demokratike, për t’i nderuar viktimat dhe për t’u solidarizuar me të mbijetuarit. Në mesin e tyre ishte edhe një delegacion i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, i kryesuar prej Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili ishte i shoqëruar prej kryeimamit Vedat ef. Sahiti dhe drejtorit për Kulturë e Botime pranë BIK-ut, z. Ramadan Shkodrës. Pjesëmarrja jonë, me ftesë të Reisul-Ulemasë së Bosnjës, Husein ef. Kavazoviq, ishte shprehje e qartë e përkushtimit tonë për të qëndruar në krah të popullit boshnjak, jo vetëm në fjalë, por edhe në vepra.

Srebrenica është më shumë se një ngjarje tragjike e së kaluarës. Ajo është plagë që ende lëngon, amaneti i nënave që ende presin drejtësi, zëri i të mbijetuarve që na kujton se nuk ka paqe pa të vërtetë dhe as pajtim pa

drejtësi. Tridhjetë vjet më pas, shteti serb, sikurse u tha, ende nuk ka kërkuar falje, por, përkundrazi, gjenocidi shpesh relativizohet, madje edhe glorifikohet nga qarqe politike e kulturore. Ky qëndrim është fyese për viktimat dhe rrezik për të ardhmen, sepse mohimi nuk është thjesht mungesë ndjeshmërie, por vazhdim i krimit me mjete të tjera. Përballë kësaj, detyra jonë është që mos të lejojmë që harresa ta mbulojë të vërtetën. Kujtesa nuk është akt hakmarrjeje, por akt drejtësie dhe ndërgjegjeje, është mësim për brezat e ardhshëm dhe garanci që tragjeditë e tilla mos të përsëriten.

Duke e kujtuar Srebrenicën, ne si besimtarë nuk kërkojmë hakmarrje. Islami nuk na thërret në urrejtje, por në drejtësi, mëshirë dhe pajtim mbi bazën e së vërtetës. Ky kujtim është një detyrim moral e shpirtëror, një mësim se paqja ndërtohet mbi pranimin e së vërtetës dhe mbi ndëshkimin e së keqes. Kurani Famëlartë na kujton: ***“O ju njerëz! Ne ju kemi krijuar prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë popuj e fise që të njiheni mes vete. Më i nderuari tek Allahu është ai që është më i devotshëm.”*** (*Huxhurat*, 13). Ky është thelbi i besimit tonë: njohja, respekti dhe devotshmëria, jo urrejtja dhe përjashtimi. Dhe, kjo është rruga që duhet të na udhëheqë, që kujtesa e Srebrenicës mos të shndërrohet në burim hakmarrjeje, por në udhërrëfyes për drejtësi e paqe.

Srebrenica është edhe kujtesa jonë

Srebrenica është një mesazh për mbarë njerëzimin, sepse na mëson se urrejtja ideologjike dhe mohimi i së vërtetës janë pararendës të tragjedive. Për ne shqiptarët ky mesazh është edhe më i dhimbshëm, sepse pak vite pas Srebrenicës, vetë Kosova u bë skenë e krimeve të ngjashme të ushtruar nga e njëjta makineri shtetërore. Prandaj, kujtesa e Srebrenicës është edhe kujtesa jonë, një thirrje që mos të lejojmë që e kaluara të fshihet, që drejtësia të vonohet pa fund, që mohimi të triumfojë mbi të vërtetën.

Tridhjetë vjet nga gjenocidi, Srebrenica ende mbetet plagë e hapur, ndërgjegje që nuk hesht dhe thirrje që nuk shuhet. Ajo na mëson se harresa është hapi i parë drejt përsëritjes, se drejtësia është kusht për paqe, se kujtesa është amanet për brezat. Prandaj, sot më shumë se kurrë, duhet të kujtojmë, të flasim dhe të dëshmojmë. Sepse vetëm duke e kujtuar me

ndershmëri dhe duke e kërkuar drejtësinë me këmbëngulje, mund të shpresojmë se bota do të jetë vend më i drejtë dhe më i sigurt për të gjithë.

Përmes këtij përkujtimi, *ne kontribuojmë në misionin tonë si njerëz dhe si besimtarë* - në misionin me të cilin na ka ngarkuar *Krijuesi i gjithësisë*: që të jemi *dëshmitarë të së vërtetës, bartës të drejtësisë dhe përhapës të paqes. Besimi nuk duhet të na ndajë, por të na afrojë. Ai nuk duhet të na çojë drejt Srebrenicës së vitit 1995, por drejt fisnikërisë, urrejtjes dhe njohjes së ndërsjellë.*

Ky është thelbi i besimit tonë: *njohja, respekti dhe devotshmëria*, jo urrejtja dhe përjashtimi.

Duke e kujtuar Srebrenicën, ne forcojmë paqen, ndërtojmë ura mirëbesimi dhe themelojmë bashkëjetesë të qëndrueshme dhe respekt të ndërsjellë – *por kjo është e mundur vetëm kur përgjegjësia morale pranohet me sinqeritet. Vetëm atëherë kujtesa bëhet udhëzim për të ardhmen, dhimbja kthehet në forcë, dhe drejtësia bëhet realitet.*

Në kuadër të përpjekjeve për të kontribuar në ruajtjen e kujtesës kolektive mbi gjenocidin e kryer në Srebrenicë, revista **Edukata Islame** këtij numri ia ka kushtuar një rubrikë të posaçme përvjetorit të 30-të të këtij krimi. Në këtë rubrikë përfshihen kumtesat dhe kontributet e paraqitura në aktivitetin e mbajtur në Prishtinë, të organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, me rastin e këtij përvjetori. Ky aktivitet, i cili në përmbajtje kishte karakter promovues dhe përkujtimor, bashkoi përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, udhëheqës të Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe personalitete nga fusha akademike, kulturore e fetare të vendit. Botimi i këtyre kontributeve nga revista **Edukata Islame** synon të shërbejë si dëshmi historike dhe si mjet i ndërgjegjësimit shoqëror, duke theksuar rëndësinë e kujtesës për të parandaluar përsëritjen e akteve të ngjashme në të ardhmen.

E lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm t'i mëshirojë viktimat e Srebrenicës, t'u japë forcë të mbijetuarve dhe ta udhëzojë mbarë njerëzimin drejt paqes, drejtësisë dhe së vërtetës!

Ramadan Shkodra

II. ISLAMISTIKË

Mr. Driton ARIFI

HARRESA SI PENGESË E ZOTËSISË LIGJORE NË TË DREJTËN ISLAME

Abstrakt

Njeriu, megjithëse është krijesa me konstruktin më të përkryer në gjithë këtë ekzistencë, dhe megjithëse është i pajisur me mendje e arsye, ai mbetet një krijesë harrestare. Ai mëson shumë gjëra gjatë jetës, rikujton shumë, por njëkohësisht harron edhe jo pak të tjera. Këtë fakt na e riktheu në vëmendje Krijuesi i Urtë, kur tha: ***“Dhe Ne patëm bërë një besëlidhje me Ademin më parë, por ai e harroi, dhe Ne nuk gjetëm tek ai vendosmëri.”*** (Taha, 115). Njeriu i parë, Ademi, a.s., qenka kapluar nga harresa. Kjo është një fakt dhe konstatim kuranor. Natyrisht, as bijtë e tij, deri në fund të kohës, nuk mund t’i shpëtojnë këtij tipari, i cili në fund të fundit është krejt njerëzor.

Meqë harresa është një gjendje e jashtëvullnetshme për njeriun, dhe ai në parim nuk zgjedh se çfarë do të harrojë dhe çfarë do të kujtojë, Zoti Fuqiplotë e ka marrë të mirëqenë këtë situatë, duke shkarkuar njeriun nga përgjegjësia para Tij në rast se ai bën disa veprime nga harresa ose lë të tjera për të njëjtën arsye.

Kjo trajtesë shkencore ka për qëllim të shqyrtojë në mënyrë analitike materien relevante shkencore islame lidhur me harresën dhe efektin e saj juridik në jetën e njeriut. Duke u cilësuar në gjuhën juridike islame si pengesë e zotësisë ligjore të njeriut, harresa mbetet një nga fenomenet që mund të bëjë që krijesa e ndërgjegjshme të shkarkohet nga llogaridhënia para Zotit në Ditën e Gjyki-

mit, megjithëse kjo nuk i zhbën detyrimet që rëndojnë mbi supet e tij dhe përgjegjësinë që ka ai ndaj njerëzve në jetën e kësaj bote.

Fjalët çelës: kompetencë, zotësi, pengesë juridike, detyrim juridik...

Hyrje

Harresa është një nga proceset më të zakonshme dhe njëkohësisht më intriguese për studiuesit e fushave të ndryshme që lidhen me qenien njerëzore. Ajo prek çdo individ në mënyrë të përditshme, duke ndikuar jo vetëm në funksionimin e kujtesës, por edhe në vendimmarrje, madje edhe në veprime e joveprime, të cilat, për më tepër, përbëjnë ngarkesa hyjnore nga Zoti i tij.

Ky punim ka për qëllim të paraqesë një pasqyrë të qartë dhe të argumentuar mbi harresën nga këndvështrimi juridik islam dhe efektet që ajo ka në uljen e shkallës së përgjegjësisë së njeriut. Secili studiues juridik duhet të vërejë se në të drejtën islame, harresa trajtohet me kujdes të veçantë, duke u konsideruar si një nga gjendjet që mund të ndikojnë në vlefshmërinë e një veprimi ose në përjashtimin e tij nga përgjegjësia dhe llogaridhënia. Argumente të shumta nga Kurani, Suneti dhe fjalët e dijetarëve dëshmojnë për faktin se feja islame njeh natyrën harrestare të njeriut dhe e trajton atë me mëshirë dhe drejtësi. Ajo është një gjendje që e përjashton individin nga disa përgjegjësi, si në rastet e prishjes së agjërit, betimeve apo marrëveshjeve kontraktuale, nëse mungon qëllimi për shkelje të normës. Për shkak të peshës së kësaj çështjeje dhe gjerësisë së implikimeve që ka në shumë kapituj të së drejtës islame, kjo trajtesë synon të ofrojë një pasqyrë solide dhe të ngjizur mbi fenomenin e harresës nga këndvështrimi i jurisprudencës islame.

Fillimisht, trajtohen përkufizimet, më pas pasqyrohet ndikimi i harresës në detyrimet fetare dhe përgjegjësinë juridike sipas Islamit, e në fund, sigurisht, jepen edhe konkluzionet e një shoshitjeje shkencore islame mbi këtë tematikë.

Kuptimi i zotësisë ligjore në jurisprudencën islame

(*El Ehlije* - الأَهْلِيَّة)

Duke qenë krijesa e vetme e bekuar nga Krijuesi me mendje dhe ndërgjegje, njeriu mbetet gjithnjë subjekt i përgjegjësisë për veprimet e tij gjatë jetës në këtë botë. Detyrat me të cilat ai është i ngarkuar nuk tejkalojnë kurrë mundësitë, aftësitë dhe kapacitetet e tij vepruese ose jovepruese. Ngarkesa konform mundësisë është një postulat i pathyeshëm, i nxjerrë nga shumë citate kuranore dhe hadithe profetike. Zoti i Plotfuqishëm, në Librin e Tij fisnik, tha: **“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej mundësive të veta, e atij (njeriut) i takon ajo që e fitoi, dhe atij i bie ajo (e keqe) që e meritoi...”**. *El Bekare*, 286.

Zotësia ose aftësia e njeriut për veprim, duke qenë në parim dhunti nga ana e Zotit tonë, tërheq pas vetes detyrime sheriatike, për çka njeriu mbahet edhe përgjegjës në të dy botët.

Zotësia ligjore (*El Ehlije* - الأَهْلِيَّة), ose kompetenca juridike, siç njihet në literaturën e Bazave të së Drejtës Islame, është një koncept që ka domethënien e vet eksplicite. Ajo definohej si në vazhdim: Kompetencë që ka njeriu për të qenë subjekt i detyrimeve, qoftë për t'i pranuar ose edhe për t'i dhënë ato për të tjerët.¹ Pra, zotësia është aftësia që zotëron njeriu për të vepruar në të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në jetën e tij në këtë botë. Si e tillë, ajo ka lidhje të ngushtë dhe varësi nga kapacitetet dhe mundësitë e tij fizike e mendore.

Megjithatë, në rrethana jashtë vullnetit të tij, kjo zotësi juridike ndeshet me faktorë pengues që i pamundësojnë njeriut të ngarkuar kryerjen e detyrimeve fetare dhe përgjigjen ndaj kërkesave hyjnore.

Për shumë interpretues të Kuranit, zotësia ligjore mund të konsiderohet edhe si sinonim i emanetit, me të cilin njeriu u ngarkua nga Zoti i tij. Kësaj ngarkese, ose emaneti, i jepet theks i veçantë në ajetin e 72-të të Kapitullit El Ahzab, ku Allahu thotë: **“Ne ua ofruam përgjegjësinë (amanetin) qiejve, Tokës dhe maleve, mirëpo ato nuk pruan ta marrin përsi-**

¹ Muhamed Revas Kalahxhij, *Mu'xhem Lugatu El Fukaha*, (Bejrut: Daru En Nefais, 1996), 76.

për dhe refuzuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e këtij amaneti)."
El Ahzab, 72.

Mund të ndodhë që njeriu të pranojë një emanet me bindjen se do ta realizojë atë siç duhet, por gjatë realizimit të tij të dalë përpara ndonjë pengesë që e bën të pamundur përmbushjen e atij amaneti. Pra, njeriu nuk ka garanci absolute për kohën apo mundësinë e realizimit të një emaneti që ka marrë përsipër, edhe pse në momentin e pranimit ishte i bindur se do ta shpiente në vend.²

Shkollarët e diciplinës së Usuli Fikhut e kategorizojnë zotësinë në dy kategori:

- zotësi për të pasur të drejta dhe për të përmbushur detyrime, dhe;
 - zotësi për të vepruar.
- Zotësia për të pasur të drejta dhe për të përmbushur detyrime.**
 Çdo qenie njerëzore ka zotësi juridike, dhe këtë cilësi e posedon vetëm për faktin se është qenie humane. Ai ka të drejta dhe detyrime, pavarësisht nëse është i moshuar apo i ri, i aftë mendërisht apo jo, mashkull apo femër. Kjo zotësi varet nga mosha dhe gjendja mendore e njeriut; ajo mund të jetë e plotë ose e pjesshme.
- Zotësia për të vepruar.** Zotësia është ajo aftësi që ka njeriu për të vepruar i lirë në çështje të ndryshme që merren në konsideratë nga Sheriati. Kjo aftësi përkthehet në "përgjegjshmërinë" e njeriut. Andaj, aftësia mendore është shkaku themelor i kësaj zotësie. Nëse personi është plotësisht i aftë mendërisht, ai ka zotësi të plotë për të vepruar; nëse është pjesërisht i aftë mendërisht, zotësia e tij është e pjesshme; ndërsa nëse është tërësisht i paaftë mendërisht, nuk zotëron aspak zotësi për të vepruar.³

² Muhamed Mutevel Esh Sharavij, *Tefsir Esh Sharavij* (Kairo, Ahbar El Jeum, 1991), 20/12212.

³ Rushit Musallari, *Bazat e së Drejtës Islame* (Usul fikh), (Tiranë, Ardhmëria, 2025), 521.

Kufizuesit ose zhvleftësuesit e zotësisë juridike në Islam

Zotësia juridike, duke qenë kompetenca e njeriut për të pranuar detyrime ose për të kryer disa veprime në Islam, natyrisht që herë pas here, për arsye të caktuara, mund të kufizohet ose edhe të mos ekzistojë fare. Dijetarët e fushës së Usulit këto kufizime i kanë quajtur “pengues të zotësisë ligjore” (عوارض الأهلية).

Penguesit e zotësisë mund të jenë rastësorë dhe të përkohshëm, por edhe të përhershëm dhe konstantë. Ata që nuk varen aspak nga vullneti i njeriut, pra që janë jashtë kontrollit të tij, janë quajtur në literaturën përkatëse “pengues qiellorë”, për të treguar se në këto raste njeriu, asnjë krijesë tjetër mbi tokë, nuk ka dorë në ndryshimin e tyre.

Këta pengues të jashtëvullnetshëm përfshijnë: miturinë; çmendurinë; marrëzinë; harresën; hutinë; gjumin; gjendjen e të fiktit; skllavërinë; sëmundjen; menstruacionet dhe lehoninë.⁴

Duke qenë se secili prej këtyre penguesve mund të trajtohet si një temë në vete dhe gjerësia e shqyrtimit të tyre nuk mund të përmbyllet në një trajtesë të shkurtër, ky punim synon të hedhë dritë vetëm mbi njërin prej tyre, pra merr për objekt harresën dhe efektin e saj në aspektin detyrimor në Islam.

Harresa si nocion psikologjik dhe juridik islam

Harresa (النسيان) është një dukuri natyrore, e pandashme nga natyra njerëzore, dhe trajtohet me kujdes të veçantë, sidomos në kontekstin e përgjegjësisë ligjore dhe veprimtarisë fetare. Implikimet e saj në normat juridike islame janë të pashmangshme. Usulisti i mirënjohur hanefi, El Bezdevijj, e ka përkufizuar harresën si moskujtesën e njeriut për ato gjëra që më parë i kishte ditur me domosdoshmëri, por jo për shkak të ndonjë të mete fizike.⁵

⁴ Muhmed Err Rrumij, *Fusul El Bedai' fi Usul Esh Sherai'* (Bejrut, Daru El Kutub El Ilmijje, 2006), 1/322.

⁵ Dr. Husejn Xheburij, *Avarid El Ehlijje Inde Ulema El Usul* (Arabi Saudite, Mahed El Buhuth El Ilmijje vet Turath El Islamij, pa vit botimi), 209.

Në natyrën njerëzore, harresa mbase është një proces i nevojshëm për ruajtjen e ekuilibrit mendor. Njeriu harron gjëra të panevojshme për të lëshuar vend në memorien e tij për ato që janë të nevojshme e ndoshta të domosdoshme. Ai harron mërzinë dhe pikëllimin për të hapur hapësirë për harenë dhe gëzimin. Prandaj, edhe në aspektin psikologjik *“harresa nuk është gjithmonë një dështim i kujtesës; ajo shpesh është një proces aktiv që ndihmon trurin të menaxhojë informacionin e tepërt dhe të fokusohet në atë që është më e rëndësishme për funksionimin e përditshëm.”*⁶ Pra, edhe harresa disi është një lloj bekimi hyjnor, natyrisht në raste e situata të caktuara, dhe ndërprerja e vetëdijshme e një kujtimi të padëshiruar ndërlidhet me kontrollin e vetëdijes që ndikon në ruajtjen e së kaluarës sonë.

Në kohën moderne, koncepti i harresës nuk trajtohet më thjesht si një veçori natyrore e njeriut, por edhe si rezultat i faktorëve të ndërlikuar neurobiologjikë, psikologjikë dhe socialë. Sipas neuroshkencës bashkëkohore, harresa është një proces aktiv që ndihmon në riorganizimin e memories për të përballuar mbingarkesën e informacionit dhe për të ruajtur stabilitetin psikologjik të individit.

Studimet në neuropsikologji tregojnë se faktorë të tillë si stresi kronik, lodhja mendore, çrregullimet e vëmendjes dhe trauma emocionale mund të ndikojnë fuqishëm në kujtesën afatshkurtër dhe në aftësinë e vendimmarrjes.⁷

Efekti juridik i harresës në jetën e besimtarit

Allahu i Lartë, duke qenë Krijues i njeriut dhe i çdo krijese tjetër pa dallim, ka treguar një lloj miratimini hyjnor për harresën, si një gjë e natyrshme për krijesën njeri, për çka në Kuran ka thënë:

“Zoti ynë, mos na ndëshko nëse harrojmë ose gabojmë...!” Bekare, 286. Këtu, përveç miratimit hyjnor për këtë natyrë njerëzore, gjejmë edhe

⁶ Alan D. Baddeley, *Human Memory: Theory and Practice* (Hove, East Sussex, 1997), 176.

⁷ <https://www.cell.com/action/showPdf?pii=S1364-6613%2814%2900074-6>.

udhëzimin prej Zotit tonë, që t'i lutemi Atij për mosngarkesë e për falje, nëse ne bëjmë diçka nga harresa ose mosdija.

Gjithashtu, siç transmeton Ibën Abbasi, r.a., se e ka dëgjuar Muhamedin, s.a.v.s., duke thënë:

*“Allahu vërtet ka hequr mëkatit nga umeti im, nëse ata kanë vepruar gabimisht, nga harresa, apo nëse kanë qenë të detyruar.”*⁸ Megjithatë, ngritja e mëkatit dha heqja e fajit nuk nënkupton se veprimet që vijnë gabimisht dhe nga harresa nuk kanë asfarë efekti, dhe se nga të njëjtat njeriu shkarkohet pastaj në tërësi.

Ngase, nëse njeriu ka falur namazin duke harruar të marrë abdesin paraprakisht, ai sigurisht se me veprimin e tij nuk ka bërë mëkat sipas këtij hadithi, as nuk ka faj para Allahut Ditën e Gjykimit. Mirëpo, sapo ta kujtojë se nuk ka pasur abdes, duhet të marrë abdes dhe të ngrihet e të falet përsëri, sepse nga detyrimi i faljes së namazit (duke i plotësuar të gjitha kushtet e tij) nuk është liruar. Pra, harresa nuk konsiderohet shkak për të hequr në tërësi përgjegjësinë detyrimore të njeriut, meqë racionaliteti dhe mendja e shëndoshë e atij që ka harruar janë të pranishme, mirëpor ajo, thjesht, bëhet shkak për ta shkarkuar njeriun nga llogaridhënia në botën tjetër. Ndërsa, kërkesa për të kryer veprimin për të cilin njeriu ka harruar mbetet në fuqi dhe nuk zhvleftësohet, përjashtuar rastet kur Ligjvënësi i Urtë ka dhënë leje për përjashtim.⁹

Duhet marrë parasysh nga ky shtjellim se detyrimet e njeriut në këtë botë ndahen në dy kategori kryesore në jurisprudencën islame: ato që klasifikohen si të drejta të Allahut dhe ato që klasifikohen si të drejta të njerëzve.

⁸ Ibën Maxheh në Sunenin e tij (2045), Taberani në Muxhem El Evsut (8273), Ibën Hibban në Sahih (7219). Hadithi cilësohet si i saktë, nëpërmjet rrugëve të transmetimit.

⁹ Abdullah El Anezij, *Tejsir Ilm Usuli Fikh* (Bejrut, Mussasetu Rejjan, 1997), 97.

Harresa dhe efekti i saj në të drejtat (obligimet tona) ndaj Allahut

Krijuesi ynë në Librin e Tij fisnik, pos shumë emrave të Tij të bukur, Vetën e Ka cilësuar edhe si të Gjithmëshirshmin, Mëshirëplotin. Mëshira e Tij ndaj njerëzve është e dukshme në çdo ligj dhe normë juridike islame. Ai ka treguar bujari e durim ndaj robërve të Vet në shumë situata që lidhen me detyrimet që ata kanë ndaj Tij. Kur bëhet fjalë për të drejtat e Allahut, vërejmë se, nëse ekzistojnë motive e arsye të fuqishme, Zoti ynë e pranon edhe pamundësinë tonë për t'i përmbushur ato detyrime. Në këtë kuadër, edhe harresa trajtohet si një lehtësim i tillë.

Megjithatë, është relevante të theksohet një princip, se as në raport me të drejtat e Allahut nuk merret në konsideratë harresa që vjen si pasojë e neglizhimit total të njeriut, ose kur nuk ka motiv të fortë që e shtyn personin të harrojë, si dhe as në ato situata kur ekzistojnë shkaqet përkujtuese për njeriun.

Kështu, nëse një person harron dhe ha në namaz, ai nuk mund të justifikohet me harresën, prandaj edhe namazi i tij prishet. Ose harron, nëse flet në namaz, i tilli e prish namazin e tij. As nuk justifikohet në asnjë mënyrë personi që ka hyrë në *itikaf*, ose atij që është me rroba të *ihramit*, që gjatë ritualeve të haxhit kryen marrëdhënie intime me bashkëshorten e tij, ngase *itikafi* dhe petku i *ihramit* janë gjendje aq të dallueshme dhe aq të pazakonta për njeriun, ashtu që harresa në to llogaritet e pajustificueshme logjikisht, e sigurisht pastaj edhe sheriatikisht.

Harresa merret në konsideratë kur ndodh për shkaqe që lidhen me shëndetin e njeriut ose për shkak të daljes nga rutina e zakonshme e përditshme. Për shembull: nëse një person harron dhe ha gjatë agjërit, kjo harresë është e toleruar dhe agjërimi i tij mbetet i vlefshëm. Po ashtu, nëse harron dhe nuk përmend emrin e Allahut (së paku sipas juristëve hanefitë dhe shumë të tjerëve) gjatë therjes së një kafshe, kjo harresë merret në konsideratë, pasi vetë akti i therjes mund të ndikojë emocionalisht tek njeriu, duke e tronditur dhe bërë që ai të harrojë për një çast..¹⁰

¹⁰ Dr. Husejn Xheburij, *Avarid El Ehlijje Inde Ulema El Usul* (Arabi Saudite, Mahed El Buhuth El Ilmijje vet Turath El Islamij, pa vit botimi), 211-213.

Për mosprishjen e agjërimit kur njeriu ka ngrënë ose pirë diçka nga harresa, kemi një tekst të drejtpërdrejtë nga i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të), të transmetuar nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të), ku ai thotë: *“Kush harron se është agjërueshëm, dhe ha ose pi, le ta vazhdojë agjërimin e tij, sepse atë e ka ushqyer dhe e ka freskuar (me ujë) Allahu”*.¹¹

Pra, në situatën konkrete, mëshira e Zotit ndaj agjëruesit është tejet e evidente. Meqë motivi për të harruar faktin se ai është agjërues ekziston (sepse njeriu rëndom ndien nevojën për ushqim dhe jo gjithmonë i kujtohet se nuk duhet të hajë ose pse është agjërues), prandaj Zoti ynë ka hequr fajin, si edhe detyrimin apo ngarkesën për të bërë kompensimin e asaj dite që është prishur nga harresa.

Ndërkaq, në situatën kur njeriu gjatë therjes së kafshës harron ta përmendë emrin e Allahut (të bëjë **bismillah**), megjithë faktin që këtë gjë e kërkon ajeti kuranor në formë decidive duke thënë: **“Dhe mos hani nga ajo që (para therjes së saj) nuk është përmendur emri i Allahut, ajo (ngrënie) vërtet është mëkat...”**. *El Enam. 121*. Këtu juristët hanefinj, mirëpo jo vetëm ata, e kanë justifikuar harresën dhe e kanë lejuar të konsumohet mish i asaj kafshe, therësi i së cilës nuk e ka përmendur emrin e Allahut para therjes së saj. Arsyeimi logjik i këtij qëndrimi qëndron në faktin se njeriu, në atë moment, përballet me një pamje të pakëndshme dhe ndien dhimbje, veçanërisht ata që janë më të ndjeshëm emocionalisht, duke e paramenduar se po i shkakton një “dëm” kafshës teksa po e ther. Për rrjedhojë, në një situatë të tillë, ai mund ta harrojë përmendjen e emrit të Allahut.¹² Ky madje nuk është vetëm mendimi i Imam Ebu Hanifes, por njësoj sikurse ai mendonin edhe Imam Maliku, Imam Ahmedi, Is’hak Ibn Ebi Rahavejhi, Sufjan Eth Theurij dhe të tjerë.

Edhe në namaz, nëse ndonjëri gjatë uljes së parë të një namazi katër rekatesh jep selam nga harresa, duke menduar se është ulja e fundit për

¹¹ Hadithin është evidentuar në koleksionet e sakta të hadithit. Buhariu në Sahihun e tij (6669), Muslimi në Sahihun e tij (1155).

¹² El Kemal Ibën Humam, *Et Takrir ve Et Tahbir ala Kitab Et Tahrir* (Kairo, Daru El Kutub El Ilmijje, 2010), 2/177.

të, e më pas kujton se ajo ishte ulja e parë, namazi i tij nuk priset, sipas hanefitëve. Arsyeja është se ato lutje që këndohen në uljen e parë (et-tehijjati dhe shehadeti) janë të njëjtat që këndohen edhe në uljen e fundit, ndonëse në të fundit ka edhe diçka më shumë për t'u kënduar. Kështu, ngatërrimi që ai bëri kishte si burim harresën dhe, për shkak të ngjashmërisë mes uljes së parë dhe të fundit, gabimi i tij mbetet i justifikueshëm, prandaj ai nuk e prish namazin. Kjo çështje, përndryshe, është bërë analogji me mosprishjen e agjërit nëse dikush ha ose pi nga harresa¹³. Në të gjithë shembujt e lartcekur, vërejmë një harresë të justifikueshme, prandaj edhe zotësia ligjore e personit të ngarkuar mbetet e cunguar.

Ndërkaq, dijetarët islamë, veçanërisht ata hanefitë, kanë theksuar faktin se edhe në kapitullin e adhurimeve, nëse harresa vjen si rezultat i neglizhencës ose braktisjes së kujdesit të duhur, ajo nuk është e justifikuar. Në këtë kontekst, Imam Ebu Jusufi, Zoti e pastë mëshiruar (nxënësi i Imam Ebu Hanifes r.a.), thekson shembullin kur dikush udhëton dhe harron të marrë ujë me vete. I tilli, kur t'i vijë koha e namazit (nëse aty afër nuk gjen ujë), duhet ta marrë tejemumin dhe të falet. Mirëpo, kurdo që të gjejë ujë, duhet të marrë abdes dhe ta përsërisë namazin e falur më herët vetëm me tejemum.¹⁴ Është kështu, sepse udhëtimi i tij pa marrë me vete ujin llogaritet si neglizhencë e pajustificueshme dhe si harresë që ka si burim braktisjen e kujdesit të kërkuar. Njeriu në shkretëtirë, apo edhe në udhëtime të tjera, zakonisht duhet të ketë ujë me vete. Në këtë rast nuk ka vend për harresë. Andaj, nuk bie detyrimi për faljen përsëri të atij namazi që gjatë udhëtimit e ka falur vetëm me tejemum.

¹³ Husamuddin Es Signakij, *El Kafi Sherh Usul El Bezdevij* (Rijad, Mektebetu Err Rrushd, 2001), 5/2217.

¹⁴ Alauddin El Buhari, *Keshf El Esrar An Usul El Bezdevij* (Stanboll, Sheriketu Es Sahafe, 1871), 4/276.

Efekti i harresës në realizimin e të drejtave të njerëzve

Nocioni “*të drejtat e njerëzve*”, natyrisht se ka një domethënie eksplicite në të Drejtën Islame. Sipas Imam Zerkeshiut, “*të drejtat e njerëzve (ḥuqūq al-‘ibād) janë ato të drejta që u përkasin njerëzve në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin, si të drejtat mbi pasurinë, trupin, nderin etj. Këto janë të drejta që kërkohen nga njerëzit dhe për të cilat njeriu jep llogari si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.*”¹⁵ Pra, të drejtat e njeriut janë ato interesa personale të individit, që si term, për dallim nga ai parapraku, pra, “*të Drejtat e Allahut*”, që me të synojë diçka që është interes i përgjithshëm i shoqërisë, e jo një njeriu apo individ në veçanti, tanik a kontekst tjetër.

Në fushën e të drejtave të njerëzve, qofshin ato fizike, morale apo materiale, harresa nuk ka asnjë efekt juridik dhe as nuk pranohet si arsye justifikuese për atë që, për shembull, nga harresa nuk ka paguar ndonjë borxh ndaj dikujt ose ka shkaktuar dëmtim në çfarëdo forme ndaj tjetrit.¹⁶ I tillë, edhe pse justifikohet dhe deklaron se ka harruar, kjo nuk e shkakton nga detyrimi për të bërë atë pagesë ose për t’ia përmbushur obligimet që ka ndaj tjetrit. Po kështu qëndron puna edhe në fushën e të Drejtës Martesore. Nëse një person i thotë gruas së tij: “Ti je e shkurorëzuar nëse unë hyj ndonjëherë në këtë shtëpi”, atëherë, nëse ai harron kushtin e shkurorëzimit dhe hyn në atë shtëpi, gruaja e tij automatikisht bëhet e shkurorëzuar prej tij. Pra, justifikimi eventual i tij me harresë nuk i sjell asnjë dobi dhe mbetet pa efekt juridik.

Shembuj të tjerë në këtë vijë ka mjaft, mirëpo qëllimi shkencor është vetëm ilustrimi i temës, jo trajtimi i zgjeruar i të gjitha rasteve dhe i implikimeve të harresës.

¹⁵ Bedruddin Ez Zerkeshij, *El Menthur Fil Kavaid El Usulijje* (Kuvajt, Vizaretu El Evkaf, 1982), 2/ 366.

¹⁶ Dr. Husejn Xheburij, *Avarid El Ehlijje Inde Ulema El Usul* (Arabi Saudite, Mahed El Buhuth El Ilmijje vet Turath El Islamij, pa vit botimi), 217.

Përmbyllje

Trajtimi i tematikës së harresës dhe efektit të saj në cungimin e zotësisë ligjore, si dhe në lehtësimin e barrës juridike të njeriut, është një çështje që në thelb i përket fushës së Bazave të Jurisprudencës Islame (Usuli Fikhut), megjithëse, domosdoshmërisht, si e tillë, ajo ka edhe ndërthurje me lëmin e Fikhut. Anën teorike e shtrin në shtratin e shkencës së Usulit, ndërsa pjesën aplikative e vendos në shtratin e shkencës së Fikhut. Duke qenë e kësaj kategorie, kjo tematikë, përveç dobisë që sjell me shpërfaqjen e lehtësimeve të dhëna nga Ligjvënësi i Urtë, fsheh në vet-vete edhe peshën e saj në studimet e zgjeruara islame.

Në fund të këtij punimi modest mund të nxjerrim disa konstatime, të cilat njëkohësisht përfaqësojnë edhe rezultatet e pritshme nga një trajtesë e tillë. Këto rezultate i përvijojmë si vijon:

- Harresa – është një dukuri natyrore që përshkon qenien njerëzore; prandaj edhe në optikën juridike islame nuk shihet thjesht si një mangësi e kujtesës, por si një faktor që kërkon drejtësi, baraspeshë dhe mëshirë.
- Veprimet ose mosveprimet që vijnë si rezultat i harresës, në të drejtën islame, hasin një mirëkuptim të gjerë, veçanërisht në raport me të drejtat e Allahut, ku mëshira Hyjnore mbizotëron mbi detyrimet ndaj njeriut. A nuk tha i Dërguari i Allahut (paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të): *“Allahu nuk ndëshkon umetin tim për gabimet e bëra nga harresa, pakujdesia-gabimisht dhe nga detyrimi”*?
- Ndërsa në raport me të drejtat e njerëzve, harresa nuk e përjashton domosdo përgjegjësinë e personit që ka vepruar gabimisht ose ka lënë diçka të domosdoshme.
- Dëmi i shkaktuar, edhe pa qëllim, kërkon riparim, dhe kjo është pasqyrim i drejtësisë tokësore; prandaj jurisprudenca islame nuk lejon që harresa të përdoret si justifikim për të cenuar të drejtën e tjetrit.

Krejt në fund, harresa shfaqet si një provë mes mëshirës dhe drejtësisë: mëshirë në të drejtën e Zotit dhe drejtësi në të drejtën e krijesës. Njëra kërkon falje, tjetra kërkon kompensim. Por të dyja kërkojnë ndërgjegje dhe përgjegjësi: që njeriu të kujdeset për fjalën dhe veprën e tij, sepse e drejta islame e pranon njeriun si të gabueshëm, por jo si të papërgjegjshëm.

Literatura e përdorur:

- Abdullah El Anezij, *Tejsir Ilm Usuli Fikh* (Bejrut, Mussesetu Rejjan, 1997).
- Alan D. Baddeley, *Human Memory: Theory and Practice* (Hove, East Sussex, 1997).
- Alauddin El Buhari, *Keshf El Esrar An Usul El Bezdevij* (Stanboll, Sheriketu Es Sahafe, 1871).
- Bedruddin Ez Zerkeshij, *El Menthur Fil Kavaid El Usulijje* (Kuvajt, Vizaretu El Evkaf, 1982).
- Dr.Husejn Xheburi, *Avarid El Ehlijje Inde Ulema El Usul* (Arabi Saudite, Mahed El Buhuth El Ilmijje vet Turath El Islamij, pa vit botimi), 209.
- El Buhari, Sahih El Buhari.
- El Kemal Ibn Humam, *Et Takrir ve Et Tahbir ala Kitab Et Tahrir* (Kairo, Daru El Kutub El Ilmijje, 2010).
- Husamuddin Es Signakij, *El Kafi Sherh Usul El Bezdevij* (Rijad, Mektebetu Err Rrushd, 2001).
- Ibn Hibban, Sahih Ibn Hibban.
- Ibn Maxheh, Sunen Ibn Maxhe
- Muhamed MutevEl lii Esh Sharavij, *Tefsir Esh Sharavij* (Kairo, Ah'bar El Jeum, 1991).
- Muhamed Revas Kalahxhij, *Mu'xhem Lugatu El Fukaha*, (Bejrut: Daru En Nefais, 1996).
- Muhmed Err Rrumij, *Fusul El Bedai' fi Usul Esh Sherai'* (Bejrut, Daru El Kutub El Ilmijje, 2006).
- Muslim, Sahih Muslim.
- Rushit Musallari, *Bazat e së Drejtës Islame* (Usul fikh), (Tiranë, Ardhmëria, 2025).
- Taberani, El Mu'xhem El Evsut.
- <https://www.cell.com/action/shoëPdf?pii=S1364-6613%2814%2900074-6>.

Mr. Driton ARIFI

FORGETFULNESS AS AN OBSTACLE TO LEGAL CAPACITY IN ISLAMIC LAW

Abstract

Man, despite being the most perfect creation in the entire universe, and despite being endowed with mind and reason, remains a forgetful being. He learns many things during life, recalls much, but at the same time forgets not a few others. This fact was brought back to our attention by the Wise Creator when He said: *“And We had already taken a covenant with Adam before, but he forgot; and We found not in him determination.”* (Taha, 115). The first man, Adam, pbuh, was overcome by forgetfulness. This is a Qur’anic fact and observation. Naturally, neither his descendants, until the end of time, can escape this trait, which is, after all, entirely human.

Since forgetfulness is an involuntary state for man, and he in principle does not choose what to forget and what to remember, the Almighty has acknowledged this situation, discharging man from responsibility before Him in cases where he commits certain acts out of forgetfulness or neglects others for the same reason.

This scientific paper aims to analytically examine relevant Islamic scholarly materials concerning forgetfulness and its legal effect on human life. Being considered in Islamic legal terminology as an obstacle to a person’s legal capacity, forgetfulness remains one of the phenomena that may absolve conscious creatures from accountability before God on the Day of Judgment, although it does not annul the obligations that rest upon his shoulders nor the responsibilities he holds toward other people in this worldly life.

Keywords: *competence, capacity, legal obstacle, legal obligation.*

Dr. Sedat ISLAMI

PEJGAMBERI ISA, A.S., SIPAS KURANIT, SUNETIT DHE KËSHILLAVE TË PËRCJELLA PREJ TIJ

Abstrakt

Isai, a.s., është njëri ndër peygamberët e përzgjedhur të Zotit. Mënyra e pazakontë e lindjes së tij dhe përfundimi i misionit janë shpesh keqinterpretuar, duke përfunduar në koncepte ekstreme që nuk kanë asnjë lidhje me të vërtetën. Ky punim ka në fokus trajtesën Kuranore dhe peygamberike përkitazi me jetën dhe misionin e Isait, a.s., duke ofruar në mënyrë të përmbledhur dhe tematike rrjedhën e jetës së tij, që nga lindja e deri te vdekja e tij në fund të kohës.

Rëndësia e punimit qëndron në ofrimin e materialit si një udhëzues i rëndësishëm rreth çështjeve që lidhen me këtë peygamber të dalluar, të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta në aspektin akaidologjik. Punimi është i ndarë në disa pjesë, të cilat tematikisht plotësojnë njëra-tjetrën. Të gjeturat e tij konfirmojnë qasjen e pastër fetare dhe racionale të Kuranit dhe Syneetit në trajtimin e çështjeve diskutabile përkitazi me Isain, a.s., ndërsa këshillat e tij shërbejnë si prova dhe dëshmi shtesë për këtë qasje.

Rekomandimi kryesor i punimit është që besimtarët çështjet që kanë impakt të drejtpërdrejt akaidologjik t'i marrin vetëm nga Kurani dhe hadithet e sakta.

Fjalët çelës: *Isai, a.s., peygamber, Kurani, lindja, misioni, mrekulli, vdekja, fundi i kohës.*

HYRJE

Besimi në pejgamberë është një nga gjashtë kushtet esenciale të besimit. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿آمَنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْ رُسُلِهِ ۚ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۚ غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ﴾ ٢٨٥

“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur prej Zotit të tij, e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij...” (Kurani: El Bekare: 285)

Pejgamberi, a.s., siç qëndron në hadithin e Xhibrilit, kur është pyetur për Imanin, ka thënë: *“Ta besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në çdo gjë që na ndodh, e mirë apo e keqe, është e caktuar nga Allahu...”*

Përveçqë duhet të besohet në këto shtylla të besimit si tërësi, duhet të besohet edhe në detajet e tyre. E këtë nuk mund ta arrish pa iu referuar teksteve fetare nga Kurani dhe Syneti, të cilat i trajtojnë këto detaje.

Pikërisht me këto detaje merret ky punim. Ai ka në fokus njërën prej shtyllave të besimit - besimin në pejgamberë, dhe më konkretisht, besimin në Pejgamberin Isa, a.s. Punimi trajton detaje nga jeta dhe misioni i tij, duke i argumentuar me ajete kuranore dhe hadithe profetike. Synimi i tij është të ofrojë përgjigje për çështje themelore, si: lindja e Isait, a.s., misioni i tij, mrekullitë, përfundimi i misionit dhe, po ashtu, fundi i tij në raport me këtë botë – vdekja.

Ky punim merr rëndësi sepse e paraqet temën nga perspektiva kuranore dhe pejgamberike, duke u mbështetur edhe në thëniet dhe këshillat që Isai, a.s., ka dhënë dhe që janë të regjistruara në veprat e dijetarëve myslimanë.

Punimi është i strukturuar në tre kapituj kryesorë dhe mbështetet kryesisht në metodologjinë deskriptive. Rezultatet e tij konfirmojnë trajtimin origjinal dhe të pastër të Kuranit dhe Synetit për figurën e Isait, a.s. Rekomandimi kryesor që del nga ky studim është thirrja për rikthim tek

Kurani dhe Syneti, veçanërisht për çështjet e ndjeshme që lidhen me besimin.

1. PARALAJMËRIMET PËR LINDJEN E ISAIT, a.s.

1.1. Paralajmërimi i hershëm

Në Kuranin fisnik, gjegjësisht në interpretimet e ajeteve kuranore, gjejmë detaje se si paralajmërimi për lindjen e Isait, a.s., është bërë qysh herët, atëherë kur ka lindur vetë nëna e tij. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِذْ قَالَتِ امْرَأَتُ عِمْرَانَ رَبِّ إِنِّي نَذَرْتُ لَكَ مَا فِي بَطْنِي مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ مِنِّي ۖ إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ۝٣٥﴾ فَلَمَّا وَضَعَتْهَا قَالَتْ رَبِّ إِنِّي وَضَعْتُهَا أُنْثَىٰ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعْتَ وَلَيْسَ الذَّكَرُ كَالْأُنْثَىٰ ۖ وَإِنِّي سَمَّيْتُهَا مَرْيَمَ وَإِنِّي أُعِيذُهَا بِكَ وَذَرَيْتَهَا مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ ۝٣٦﴾

“Kujto kur gruaja e Imranit tha: “Zoti im, unë Ty ta kam kushtuar atë që është në barkun tim, që të të shërbejë vetëm Ty, prandaj pranoje prej meje! Se Ti, me të vërtetë, dëgjon dhe di çdo gjë.”. E, kur ajo lindi, tha: “Zoti im! Unë linda femër - Allahu e di më mirë se çfarë lindi ajo...” (Ali Imran: 35-36)

Ky paralajmërim fshihet në pjesën e ajetit: وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعْتَ - *...Allahu e di më mirë se çfarë lindi ajo...*

Prindërit e Merjemes ishin zotuar se fëmijën e tyre, ende të palindur, do ta përkushtonin për shërbim në tempull ose faltore. Ata prisnin që fëmija të ishte mashkull, sepse këtë detyrë e kryenin zakonisht meshkujt; femrat nuk shërbenin në faltore. Mirëpo, kur lindi Merjemja, gjërat morën drejtim tjetër. Si do të shërbente një femër në faltore?! Pikërisht këtu shfaqet një paralajmërim i hershëm për pejgamberin Isa, a.s. Ky paralajmërim kuptohet përmes një mënyre tjetër të leximit të pjesës së ajetit të sipërpërmendur. Në vend të “وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعْتَ” - *...Allahu e di më mirë se çfarë lindi ajo...*, Abdullah bin Abbasi, r.a., e ka lexuar:

“وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعْتَ” - ...*Allahu e di se çfarë ke lindur ti...*”, pra, e di se çfarë fëmije ke lindur, çfarë nami do të ketë; sepse, edhe pse grua, fama e saj do të jetë e madhe, dhe ajo do të jetë nëna e një njeriu të madh...¹

1.2. Paralajmërimi i Merjemes

Lindja e Isait, a.s., paralajmërohet tekstualisht dhe në mënyrë të drejt-përdrejtë, në kumtimin e lajmit hyjnor që engjëjt ia bëjnë Merjemes. Në Kuran qëndron:

﴿إِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ يُبَشِّرُكِ بِكَلِمَةٍ مِّنْهُ اسْمُهُ الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ وَجِيهًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمِنَ الْمُقَرَّبِينَ﴾ ﴿٤٥﴾

“(Kujto) Kur engjëjt thanë: “O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë për një (djalë që do të lindë me një) Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën, dhe njëri prej të afërmve të Allahut.” (Ali Imran: 45)

Pra, Merjemes iu dha myzhdeja se ajo do të bëhej nëna e një fëmije të madh, një fëmije me pozitë, të nderuar si në dynja, ashtu edhe në ahiret; një fëmije që do të ishte pejgamber.

Me këtë myzhde fillon një epokë e re në jetën e Merjemes, një jetë aspak e lehtë. Edhe në ajetet e përmendura vërehet brenga e saj: si do të bëhej nënë, kur ajo nuk ishte e martuar?

¹ Shih: Muhamed bin Ahmed El Kurtubiu, *El Xhamiu li-ahkami El Kur'an*, red. Ahmed Berduni dhe Ibrahim Atfish, (Kajro: Dar El kutub El misrije, ed. 2, 1964), 4/67-68.

2. PREJARDHJA FAMILJARE E ISAIT, A.S.

Isai, a.s., është i biri i Merjemes, vajzës së Imranit. Në Kuran na është bërë me dije se Imrani ka qenë njeri i dalluar, dhe se familja e tij kanë qenë me emër e nam.

﴿إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ﴾ ﴿٣٣﴾

“Allahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit (e kohës së tyre).” (Ali Imran: 33)

Ibën Kethiri² përmend se familja e Imranit nënkupton familjen e babait të Merjemes.

Imrani nuk është babai i Musait, a.s., sikurse Merjemja nuk është motra e Harunit, a.s. Përkitazi me këtë të fundit, janë krijuar paqartësi për shkak të përmendjes së Harunit si vëlla i Merjemes:

﴿فَأْتَتْ بِهِ قَوْمَهَا تَحْمِلُهُ ۖ قَالُوا يَا مَرْيَمُ لَقَدْ جِئْتِ شَيْئًا فَرِيًّا﴾ ﴿٢٧﴾ يَا أُخْتُ هَارُونَ مَا كَانَ أَبُوكِ امْرَأَ سَوْءٍ وَمَا كَانَتْ أُمُّكِ بَغِيًّا ﴿٢٨﴾

“Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, e as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.” (Merjem: 27-28)

Ibën Kethiri e sheh këtë lidhje ndërmjet Merjemes dhe Harunit, a.s., vetëm në aspektin e adhurimit: “Oj e ngjashmja me Harunin në adhurim...” Disa, siç shënon Ibën Kethiri më tej, e shohin Merjemen si pjesëtare nga linja e Harunit, vëllait të Musait, a.s. Është thënë edhe ndryshe: se është thirrur kështu për shkak të një burri fetar të njohur në mesin e tyre për adhurim. Ndërkaq, të tjerë kanë menduar se kjo thirrje i është bërë sipas njëfarë Haruni që paskësh qenë i njohur për pandershmëri në kohën e tyre. Pra, ata e kanë akuzuar Merjemen se, meqë solli fëmijë pa qenë e martuar, ishte e pandershme sikur ky Harun.³

² Ismail bin Omer bin Kethir, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, red. Sami bin Muhamed Selameh, (Rijad: Dar Tajjibe, ed. 3, 1999), 2/33.

³ Po aty, 5/226-227.

Abdurrahman bin Nasir Es Sadi thotë se ajeti, sipërfaqësisht, lë për të kuptuar se ajo ka pasur një vëlla nga babai dhe nëna, e i cili është quajtur Harun, dhe se nuk ka pasur lidhje me Harunin, vëllanë e Musait, a.s., ndërmjet të cilëve, Merjemes dhe tyre, ka disa shekuj.⁴

Siç kuptohet nga ajeti dhe siç e kanë shënuar në komentimin e tij Ibën Kethiri dhe Sadi, familja e Merjemes – babai dhe nëna e saj – kanë qenë njerëz të dalluar për devotshmërinë dhe ndershmërinë e tyre.

3. SHTATZËNIA E MERJEMES: FRIKA, SFIDAT DHE NGUSHËLLIMI HYJNOR

3.1. Frika për nderin dhe sfida nga të qenët shtatzënë pa burrë

Merjemja ishte vajzë e edukuar dhe rridhte nga një familje e ndershme. Nuk kishte pasur kurrë kontakte me meshkuj. Për këtë arsye, kur engjëlli i doli përpara, ajo u trondit së pari nga frika, sepse, duke mos e ditur kush ishte, mendonte se ndokush po përpiqej ta çnderojë. Së dyti, u shqetësua kur mësoi se si do të kishte fëmijë, kur nuk ishte e martuar.

﴿قَالَتْ أَنَّى يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمْسَسْنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكْ بِغَيًّا﴾

“Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur, dhe as nuk jam e pacipë?!” (Merjem: 20)

Pra, shihet qartë se ajo ishte një grua e ndershme, që i druhej kontaktit me meshkujt e huaj dhe shqetësohej për mënyrën se si do të lindte, pa qenë e martuar. Veçimi apo izolimi i Merjemes nga familja, siç shënon Sadi, ishte bërë pikërisht për arsye adhurimi.⁵ Kjo dëshmon edhe më tej pastërtinë dhe ndershmërinë e saj.

⁴ Abdurrahman bin Nasir Es Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman fi tefsiri kelami El Mennan*, red. Abdurrahman bin Mual-la Luvejhak, (Bejrut: Muessesetu Err Risale, 2000), f. 492.

⁵ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 491.

3.2. Forcimi hyjnor për këtë sfidë

3.2.1. Aludimi në vlerën e saj

Sadi, duke interpretuar ajetin:

﴿وَاذْكُرْ فِي الْكِتَابِ مَرْيَمَ﴾

“Dhe trego (o Muhamed) në Libër për Merjemen...” (Merjem: 16), thotë se përmendja e saj në Kuran, në librin që lexohet në Lindje e Perëndim, përmendja dhe lëvdimi për të mirë, si shpërblim për punën e mirë dhe angazhimin e përsosur të saj, është vlera më e madhe e saj.⁶

3.2.2. Përzgjedhja dhe vlerësimi hyjnor për të

- Është përzgjedhur

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَإِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاكِ وَطَهَّرَكِ وَاصْطَفَاكِ عَلَى نِسَاءِ

الْعَالَمِينَ ٤٢﴾

“(Kujto) Kur engjëjt thanë: “O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës.”

(Ali Imran: 42)

Shejh Sadi, në komentimin e këtij ajeti, ka thënë: “Allahu i Madhëruar sinjalizon vlerën dhe pozitën e lartë që ka Merjemja, duke treguar se engjëjt i janë drejtuar asaj me fjalët se është përzgjedhur nga Zoti dhe është pastruar nga të metat e mangësitë. Përzgjedhja e parë tregon për vlerat dhe virtytet e saj, ndërsa përzgjedhja e dytë është një vlerësim që i bëhet grave të botës, qoftë të kohës së saj, qoftë një vlerësim absolut deri në Ditën e Kiametit...”⁷

⁶ Po aty.

⁷ Po aty, f. 130.

- Është përgëzuar

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ يُبَشِّرُكِ بِكَلِمَةٍ مِنْهُ اسْمُهُ الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ وَجِيهًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمِنَ الْمُقَرَّبِينَ﴾ ٤٥

“(Kujto) Kur engjëjt thanë: “O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë për një (djalë që do të lindë me një) Fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën, dhe njëri prej të afërmeve të Allahut.”. (Ali Imran: 45)

Përgëzimi bëhet për të mirë; të mirët përgëzohen. Dhe, është përgëzuar për një fëmijë të ndershëm, të cilin Allahu do ta bëjë pejgamber.

- Është vlerësuar e ndershme

Allahu i Madhëruar na flet për ndershmërinë e saj, dhe se Ai e ka konsideruar të këtillë.

﴿وَالَّتِي أَحْصَنَتْ فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهَا مِنْ رُوحِنَا وَجَعَلْنَاهَا وَابْنَهَا آيَةً لِلْعَالَمِينَ﴾

“(Kujtoje) Atë që e ruajti virgjërinë e saj! Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë, dhe e bëmë atë dhe birin e saj mrekulli për gjithë njerëzit.” (Enbija: 91)

Shejh Sadi konsideron se vlerësimi që i është bërë Merjemes në këtë ajet për ndershmërinë e saj nuk lidhet vetëm me heqjen dorë nga harami, por edhe nga hallalli; ajo nuk ishte martuar që t’i përkushtohej adhurimit të Zotit.⁸

3.3. Shtatzënia

Në Kuran na tregohet se mrekulli në shtatzëninë e Merjemes ka qenë vetëm frymëzimi i saj, dhe se i tërë procesi tjetër ka qenë plotësisht i natyrshëm. Pra, shtatzënia e saj ka zgjatur sa zgjat rëndom te gratë. Ibën Kethiri, madje, thotë se ky është mendimi i shumicës së dijetarëve – i xhumhurit.⁹

⁸ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 530.

⁹ Ibën Kethiri, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, vep. cit., 5/222.

Allahu i Madhëruar na tregon në Kuran se si ka ardhur deri te shtatzënia e Merjemes. Ajo fillimisht është përgëzuar, e më pas është frymëzuar me fëmijë; pra, ka mbetur me barrë. (Ali Imran: 45; Merjem: 16-21; Enbija: 91).

4. ISAI, A.S., NGA LINDJA E DERI NË PEJGAMBERI

4.1. Përshkrimi i lindjes së Isait, a.s.

Kurani fisnik na e përshkuan lindjen e Isait, a.s., dhe mënyrën se si ai iu prezantua izraelitëve.

﴿فَحَمَلَتْهُ فَانْتَبَدَتْ بِهِ مَكَانًا قَصِيًّا﴾ ﴿٢٢﴾ ﴿فَاجَاءَهَا الْمَخَاضُ إِلَى جِذْعِ النَّخْلَةِ قَالَتْ يَا لَيْتَنِي مِتُّ قَبْلَ هَذَا وَكُنْتُ نَسِيًّا مَّنْسِيًّا﴾ ﴿٢٣﴾ ﴿فَنَادَاهَا مِنْ تَحْتِهَا أَلَا تَحْزَنِي قَدْ جَعَلَ رَبُّكِ تَحْتَكِ سَرِيًّا﴾ ﴿٢٤﴾ ﴿وَهَزِي إِلَيْكِ جِذْعَ النَّخْلَةِ تُسَاقِطُ عَلَيْكَ رَطْبًا جَنِيًّا﴾ ﴿٢٥﴾ ﴿فَكُلِي وَاشْرَبِي وَقَرِّي عَيْنًا ۖ فَإِمَّا تَرِينَ مِنَ الْبَشَرِ أَحَدًا فَقُولِي إِنِّي نَذَرْتُ لِلرَّحْمَنِ صَوْمًا فَلَنْ أُكَلِّمَ الْيَوْمَ إِنْسِيًّا﴾ ﴿٢٦﴾ ﴿فَأَتَتْ بِهِ قَوْمَهَا تَحْمِلُهُ ۖ قَالُوا يَا مَرْيَمُ لَقَدْ جِئْتِ شَيْئًا فَرِيًّا﴾ ﴿٢٧﴾ ﴿يَا أُخْتَ هَارُونَ مَا كَانَ أَبُوكَ امْرَأَ سَوْءٍ وَمَا كَانَتْ أُمُّكَ بَغِيًّا﴾ ﴿٢٨﴾ ﴿فَأَشَارَتْ إِلَيْهِ ۖ قَالُوا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ فِي الْمَهْدِ صَبِيًّا﴾ ﴿٢٩﴾ ﴿قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ آتَانِيَ الْكِتَابَ وَجَعَلَنِي نَبِيًّا﴾ ﴿٣٠﴾ ﴿وَجَعَلَنِي مُبَارَكًا أَيْنَ مَا كُنْتُ وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ مَا دُمْتُ حَيًّا﴾ ﴿٣١﴾ ﴿وَبَرًّا بِوَالِدَتِي وَلَمْ يَجْعَلْنِي جَبَّارًا شَقِيًّا﴾ ﴿٣٢﴾ ﴿وَالسَّلَامُ عَلَيَّ يَوْمَ وُلِدْتُ وَيَوْمَ أَمُوتُ وَيَوْمَ أُبْعَثُ حَيًّا﴾ ﴿٣٣﴾ ﴿ذَلِكَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ ۖ قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ يَمْتَرُونَ﴾ ﴿٣٤﴾

“Ajo mbeti me barrë dhe u tërhoq me të në një vend të largët. Dhe mbijet e lindjes e detyruan që të shkonte te trungu i një hurme. Ajo tha: “Ah, sikur të kisha vdekur para kësaj ngjarjeje dhe të isha harruar krejt!”. Një zë e thirri nga poshtë: “Mos u pikëllo, se Zoti yt të ka bërë një burim uji poshtë teje! Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta! Ha, pi dhe qetësohu. Nëse vëren

ndonjë njeri, i thuaj: “Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.”. Dhe ajo u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: “O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.”. Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?”. Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Inxhilin), më ka bërë pejgamber dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë, dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja dhe shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallem!”. Ky është Isai, i biri i Merjemes. Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë.” (Merjem: 22-34)

Dhimbjet fizike tregojnë për lindjen e natyrshme të fëmijës nga ana e Merjemes. Mirëpo, ajo nuk kishte vetëm dhimbje fizike. Tani ishte koha të shfaqej para izraelitëve me fëmijën e saj, diçka që kishte frikë se do ta prisnin keq. Dhe ashtu edhe ndodhi. E akuzuan në moral. Mirëpo, ajo heshti dhe e la fëmijën që të fliste. Isai, a.s., foli dhe tregoi se ishte mrekulli e Zotit, se ishte pejgamber, se do të predikonte adhurimin në një Zot, se ishte i mirësjellshëm me nënën etj. Arsyeja pse ajo nuk ka folur, por ka folur djali i saj, siç thotë Shejh Sadi,¹⁰ është që fjalët e tij të jenë shfajësimi më i madh i saj.

Edhe pse foli dhe mbrojti nënën e tij, madje fjalët e tij ishin një mrekulli, prapë ata e refuzuan. Në fakt, ata që e pranuan ishin shumë pak, ndërsa shumica e refuzuan dhe e akuzuan për pandershmëri.

Ajo që ia vlen të përmendim këtu është se Isai, a.s., vetëm këtu ka folur, përndryshe, më pas ka vazhduar jetën si fëmijët normal, si dhe ka folur atëherë kur flasin edhe fëmijët zakonisht.¹¹

¹⁰ Sadi, Tejsiru El Kerimi Err Rrahman, vep. cit., f. 530.

¹¹ Ibën Ebi Shejbe, *El Musannef*, red. shkenc. Sa’d bin Nasir bin Abdulaziz, (Rijad: Dar kunuz Ishbilija, 2015), 19/225.

4.2. Koha e lindjes së Isait, a.s.

Në Kuran përmendet se kur Merjemes i ishte afruar koha e lindjes së Isait, a.s., Allahu i Madhëruar i kishte thënë:

﴿وَهَزِي إِلَيْكَ بِجُذْعِ النَّخْلَةِ تُسَاقِطُ عَلَيْكَ رُطْبًا جَنِيًّا ۝٢٥﴾

“Shkunde trungun e palmës, që të bien mbi ty hurma të freskëta!”

(Merjem: 25)

Hurmat e freskëta kanë shkaktuar debate rreth kohës së lindjes së Isait, nëse ajo ka qenë në dhjetor apo jo. Nëse ajeti lexohet sipërfaqësisht, rezulton se lindja ka ndodhur në qershor, jo në dhjetor, megjithatë nuk përjashtohet mundësia që hurmat e freskëta gjatë dimrit të kenë qenë një mrekulli e veçantë.

Njohja e këtij informacioni, përderisa nuk ka argument të qartë që e provon ose e mohon, mbetet në kuadër të asaj që pa tekst nuk mund të mësohet. Fakti që feja nuk e ka përmendur me saktësi këtë detaj tregon se nuk është një informacion me rëndësi thelbësore.¹²

4.3. Emri Mesih?

Në disa vende në Kuran dhe në hadithe përmendet emri Mesih. Po, cili është kuptimi i tij?

Ka mendime të shumta rreth kuptimit të emrit Mesih. Ibën Mendhuri, në Lisan El Arab¹³ thotë se është quajtur me këtë emër për shkak të sinqeritetit dhe korrektësisë së tij. Është thënë se ai shëtiste nëpër tokë dhe nuk qëndronte në një vend të caktuar për të banuar. Gjithashtu, ekziston një mendim sipas të cilit ai ka lindur i lustruar, i lëmuar dhe i lyer me vaj.

¹² Shih fetvatë: “زمن ولادة عيسى عليه السلام”, të publikuar në:

<https://www.islamweb.net/> më 22 nëntor 2007; “وقت ولادة المسيح عليه السلام” të publikuar në: <https://www.islamweb.net/> më 14 janar 2014;

“متى وُلِدَ عيسى بن مريم ؟ وهل في القرآن إشارة إلى أنه وُلِدَ في الصيف ؟” të publikuar në: <https://islamqa.info/> më 26 shkurt 2009.

¹³ Muhamed bin Mukerrem bin Ali Ibën El Mendhur, *Lisan El arab*, (Bejrut: Dar Sadir, ed. 3, 1414 h.), 2/595.

Dexhalli, mallkimi i Allahut qoftë mbi të, është quajtur mesih për shkak se i mungon një sy dhe ka fytyrë të lëmuar.

4.4. A është lindja e mundshme pa baba?

Po, sepse Allahu i Madhëruar, qysh nga momentet e përgëzimit, i ka treguar se kjo çështje është e mundshme, për shkak të mundësisë së pakufizuar të Tij:

﴿قَالَتْ رَبِّ أُنَّى يَكُونُ لِي وَلَدٌ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ ۚ قَالَ كَذَلِكَ اللَّهُ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۚ إِذَا قَضَىٰ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ﴾ ﴿٤٧﴾

“Ajo tha: “Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur askush?!” - “Kështu – tha (engjëlli) - Allahu krijon ç’të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: “Bëhu!”, dhe ajo bëhet.” (Ali Imran: 47)

﴿قَالَتْ أُنَّى يَكُونُ لِي غُلَامٌ وَلَمْ يَمَسِّنِي بَشَرٌ وَلَمْ أَكُ بَغِيًّا﴾ ﴿٢٠﴾ ﴿قَالَ كَذَلِكَ قَالَ رَبُّكَ هُوَ عَلَيَّ هَيِّنٌ ۖ وَلَنَجْعَلَنَّ آيَةً لِلنَّاسِ وَرَحْمَةً مِنَّا ۚ وَكَانَ أَمْرًا مَّقْضِيًّا﴾ ﴿٢١﴾

“Ajo tha: “Si mund të kem unë djalë, kur asnjë mashkull nuk më ka prekur dhe nuk jam as e pacipë?!”. Iu përgjigj: “Kështu është! Zoti yt ka thënë: “Kjo për Mua është e lehtë. Ne do ta bëjmë atë shenjë për njerëzit dhe mëshirë nga ana Jonë.”. Dhe kjo është punë e kryer.” (Merjem: 20-21)

Shejh Sadi,¹⁴ duke komentuar këto dy ajete, shpjegon fuqinë e jashtëzakonshme të Allahut dhe mundësinë e pakufizuar të Tij për të bërë çdo gjë. Këtë mundësi për të bërë gjëra të jashtëzakonshme ua dëfton robërve për t’i bërë që, para se të lidhen me shkaqe, të lidhen me Shkaktarin. Kështu, kush e njeh Allahun e Madhëruar, e di se krijimi i Isait, a.s., nuk paraqet asfarë dyshimi.

¹⁴ Shih: Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 131; 491!

4.5. Pse Allahu i Madhëruar nuk ka nevojë për fëmijë?

T’i përshkruash Allahut fëmijë është mëkat shumë i madh.

﴿وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا﴾ ﴿٨٨﴾ لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا ﴿٨٩﴾ تَكَادُ السَّمَاوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِنْهُ وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًّا ﴿٩٠﴾ أَنْ دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا ﴿٩١﴾ وَمَا يَنْبَغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ يَتَّخِذَ وَلَدًا ﴿٩٢﴾

“Ata thonë: “I Gjithëmëshirshmi ka një bir.”. Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme! Qiejt gati sa nuk copëtohen nga kjo, Toka gati sa s’çahet, dhe malet sa s’rrëzohen të thërrmuar, ngaqë ata ia mveshin një bir të Gjithëmëshirshmit. Kurrë nuk i shkon (Madhërisë së) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir.” (Merjem: 88-92)

Shejh Sadi¹⁵ ka thënë se, arsyeja pse Zoti nuk ka fëmijë është se nuk përkon me Të, sepse të pasurit fëmijë nënkupton mangësinë dhe nevojën, ndërsa Allahu është i pastër prej tyre.

4.6. Konfirmimi i aspektit njerëzor tek Isai, a.s.

Kurani famëmadh ka konfirmuar njerëzoren e Isait, a.s., nga aspekte të ndryshme.

- Konfirmimi se ai është thjesht njeri dhe pejgamber.¹⁶
- Konfirmimi i njerëzores nëpërmjet tipareve njerëzore, ngrënia ushqim, si shembull konkret.¹⁷ Edhe mësimi prej të tjerëve është tipar njerëzor. Isai, a.s., është mësuar nga ana e Zotit të Madhëruar; përndryshe, po të ishte Zoti, nuk do të mësohej nga askush.¹⁸
- Shpjegimi i mundësisë së Allahut të Madhëruar. Kur folëm për përgëzimin e Merjemes me djalë, mësuam se frikës së saj për mundësinë e lindjes së fëmijës pa burrë Zoti iu përgjigj nëpër-

¹⁵ Po aty, f. 501.

¹⁶ Shih: Zuhruf, 59; Maide, 75!

¹⁷ Shih: Maide, 75!

¹⁸ Shih: Maide: 110!

mjet mundësisë së Tij të pakrahasueshme për të bërë çdo gjë. Këtë e ka shpjeguar edhe në raste të tjera.¹⁹

- Argumenti i parë logjik: një shembull edhe më sfidues dhe më madhështor se ai i Isait, a.s.

﴿إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ خَلَقَهُ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ﴾

“Rasti i Isait për Allahun është si rasti i Ademit që e krijoi nga balta, e pastaj i tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë.” (Ali Imran, 59)

Shejh Sadi²⁰ ka një shpjegim shumë të bukur, ku thuhet: “Kjo që kanë pretenduar të krishterët nuk përbën as dyshim, e lëre më provë. Krijimi (në përgjithësi dhe krijimi i Isait, a.s., pa baba, në veçanti) është dëshmi se i vetmi që krijon është Allahu dhe ky fakt më shumë tregon se askush nuk meriton të adhurohet përkrah Zotit, sesa që tregon se Isai, a.s., ka qenë zot. Kjo për arsye se shembulli i Ademit, të cilin Zoti e krijoi prej dheut, pa baba dhe pa nënë, është edhe më madhështor. E nëse ky shembull nuk i jep Ademit, a.s., attribute hyjnore, atëherë Isait, a.s., edhe më pak.”.

- Argumenti i dytë logjik: mundësia e ndëshkimit dhe e zhdukjes së Isait, a.s.:

﴿لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ قُلْ فَمَنْ يَمْلِكُ مِنَ اللَّهِ شَيْئًا إِنْ أَرَادَ أَنْ يُهْلِكَ الْمَسِيحَ ابْنَ مَرْيَمَ وَأُمَّهُ وَفِي الْأَرْضِ جَمِيعًا وَلِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾

“Pa dyshim se janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është Meshihu, i biri i Merjemes.”! Thuaj: “Kush mund ta pengojë Allahun, nëse Ai dëshiron ta zhdukë Mesihun, të birin e Merjemes dhe nënën e tij, si dhe gjithçka që gjendet në Tokë?!”. Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve, i Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre.

¹⁹ Shih: Nahël, 40; Jasin: 82.

²⁰ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 133.

Ai krijon çfarë të dojë, dhe është i Plotfuqishëm për çdo gjë. (Maide: 17)

Në koment të këtij ajeti, Shejh Sadi²¹ ka thënë: “Pse Isai nuk është zot, e tregon fakti se, përderisa nuk ka fuqinë ta mbrojë veten nga fundi, shkatërrimi ose vdekja, ai nuk mund të jetë zot. Zoti i Plotfuqishëm ua demantoi thëniet e të krishterëve me prova logjike.”.

➤ Deklarimi i vetë Isait, a.s.

Allahu i Madhëruar na e përshkuan se ndër fjalët e para që tha Isai, a.s., ishin edhe:

﴿وَالسَّلَامُ عَلَيَّ يَوْمَ وُلِدْتُ وَيَوْمَ أَمُوتُ وَيَوْمَ أُبْعَثُ حَيًّا ۝٣٣﴾

“Le të jetë paqja dhe shpëtimi mbi mua, në ditën që kam lindur, në ditën që do të vdes dhe në ditën që do të ringjallet!” (Merjem, 33)

Lindja dhe vdekja janë tipare njerëzore, jo hyjnore.

4.7. Fjala dhe shpirti a janë dëshmi të hyjnore të Isait, a.s.?

Keqinterpretimi i ajeteve kuranore ka bërë që disa, të cilët nuk e njohin mirë fenë, të mendojnë gabimisht se, kinse, Kurani e konfirmon trinitetin dhe se Isai, a.s., është hyjnor. Si ka ndodhur kjo? Në këtë përfundim të gabuar ata kanë arritur duke lexuar ajetet:

﴿إِنَّمَا الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ رَسُولُ اللَّهِ وَكَلِمَتُهُ أَلْقَاهَا إِلَى مَرْيَمَ وَرُوحٌ مِنْهُ﴾

“...Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjalë e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt prej Tij...” (Nisa: 171)

﴿وَالَّتِي أَحْصَنَتْ فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهَا مِنْ رُوحِنَا﴾

“(Kujtoje) Atë që ruajti virgjërinë e saj! Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë...” (Enbija: 91)

²¹ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 226.

﴿وَمَرْيَمَ ابْنَتَ عِمْرَانَ الَّتِي أَحْصَنَتْ فَرْجَهَا فَنَفَخْنَا فِيهِ مِنْ رُوحِنَا﴾

“Edhe Merjemen, të bijën e Imranit, e cila e ruajti virgjërinë e saj; Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë (shpirtin e Isait, a.s.)...” (Tahrim: 12)

Çfarë nënkuptojnë termat fjalë dhe shpirt?²²

Sa i përket termit *fjalë*, kjo nënkupton mundësinë e Allahut për të bërë çdo gjë duke mjaftuar ta shprehë fjalën: “*Bëhu!*”, - dhe ajo që është synuar bëhet.

﴿إِنَّمَا قَوْلُنَا لِشَيْءٍ إِذَا أَرَدْنَاهُ أَنْ نَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ﴾

“Nëse dëshirojmë të bëhet diçka, mjafton që të themi: “*Bëhu!*”, - dhe ajo bëhet.” (Nahël: 40)

Sa i përket termit *shpirt* prej Allahut, për qëllim është shpirti i krijuar nga ana e Allahut, dhe që është frymëzuar, siç ndodh me të gjitha krijesat. Për Ademin, a.s., sa për ilustrim, Allahu i Madhëruar thotë:

﴿إِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي خَالِقٌ بَشَرًا مِنْ طِينٍ * فَإِذَا سَوَّيْتُهُ وَنَفَخْتُ فِيهِ مِنْ رُوحِي فَقَعُوا لَهُ سَاجِدِينَ﴾

“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një njeri nga balta. Kur t’i jap trajtë dhe t’i fryj prej shpirtit Tim, përuljuni në sexhde atij!” (Sad: 71-72)

Për bijtë e Ademit, a.s., njerëzimin mbarë, pra, Allahu i Madhëruar thotë:

﴿الَّذِي أَحْسَنَ كُلَّ شَيْءٍ خَلَقَهُ وَبَدَأَ خَلْقَ الْإِنْسَانِ مِنْ طِينٍ * ثُمَّ جَعَلَ نَسْلَهُ مِنْ سُلَالَةٍ مِنْ مَاءٍ مَهِينٍ * ثُمَّ سَوَّاهُ وَنَفَخَ فِيهِ مِنْ رُوحِهِ وَجَعَلَ لَكُمُ السَّمْعَ وَالْأَبْصَارَ وَالْأَفْئِدَةَ قَلِيلًا مَّا تَشْكُرُونَ﴾

Ai, i Cili përsosi çdo gjë që krijoi. Ai e filloi krijimin e njeriut prej baltës. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur, së cilës më pas i dha trajtë dhe i fryu shpirtin

²² Ibën Kethiri, *Tefsiru El Kur’ani El adhim*, vep. cit., 2/478-479.

e krijuar prej Tij. Ai ju dha dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës.” (Sexhde: 7-9)

5. PEJGAMBERIA E ISAIT, A.S., DHE MREKULLITË E TIJ

5.1. Koha e dërgimit dhe lidhshmëria misionare e Isait me Musain, a.s.

Në Kuranin fisnik na bëhet me dije se Isai, a.s., ka ardhur si vazhdimësi e misionit të Musait, a.s.:

﴿وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَلَأَحِلَّ لَكُم بَعْضَ الَّذِي حُرِّمَ عَلَيْكُمْ ۖ وَجِئْتُكُم بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ۝٥٠﴾

“Dhe (kam ardhur te ju) për t’jua vërtetuar Tëvratin, që është para meje, dhe që t’jua lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Jua kam sjellë një provë prej Zotit tuaj, prandaj kini frikë Allahun dhe bindmuni!” (Ali Imran: 50)²³

Në këto ajete konfirmohet roli vazhdues i Isait, a.s., në raport me Tëvratin. Shejh Sadiu, duke komentuar këto ajete, ka thënë: “...që t’ju lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara...”, - kjo tregon se Inxhili nuk i ka abroguar shumicën e normave të Tëvratit, përkundrazi, i ka plotësuar dhe i konfirmuar ato.²⁴

Dijetarët kanë përmendur se ndërmjet Isait dhe Musait, a.s., ka më shumë se një mijë vjet; disa thonë 1500 vjet, e të tjerë thonë se janë rreth 1700 vjet.²⁵ Ndërmjet tyre dihet saktësisht se kanë qenë pejgamberët Davudi, Sulejmani, Zekerijai etj., paqja qoftë mbi ta!

²³ Shih edhe: Maide, 46; Saf, 6!

²⁴ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 131.

²⁵ Shih: Kurtubiu, *El xhamiu li-ahkami El Kur’an*, vep. cit., 6/121!

5.2. Mosha e Isait, a.s., kur u dërgua pejgamber

Ne më parë përmendëm se Isai, a.s., ka folur në djep vetëm njëherë, kur e ka shfajësuar nënën e tij dhe ka treguar se është pejgamber. Disa mendojnë se Isai, a.s., është dërguar si pejgamber në moshën tridhjetëvjeçare, ndërsa të tjerë thonë, duke u bazuar edhe në deklarinimin e tij se është pejgamber, se është dërguar që nga fëmijëria.

Edhe kjo çështje nuk është prej atyre që, nëse e di, ndikon në forcimin e besimit tënd, ose, nëse nuk e di, ndikon në dobësimin e tij²⁶.

5.3. Libri dhe përmbajtja e misionit të tij

Isai, a.s., është pejgamber që në Kuran përmendet se ka pasur libër të caktuar, ose njërin nga katër librat, pra, Inxhilin. Të krishterët është dashur ta organizojnë jetën sipas tij. Ai ka qenë libër udhëzues. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَقَفَّيْنَا عَلَىٰ آثَارِهِم بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ ۖ وَآتَيْنَاهُ الْإِنْجِيلَ فِيهِ هُدًى وَنُورٌ وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَهُدًى وَمَوْعِظَةً لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٦﴾ وَلَيَحْكُمَنَّ أَهْلُ الْإِنْجِيلِ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فِيهِ ۖ وَمَن لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٤٧﴾﴾

“Pas atyre pejgamberëve Ne e dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Tevratit që kishte ardhur para tij. Dhe ia dhamë atij Inxhilin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Tevrat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut. Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit ashtu siç ka shpallur Allahu në të! Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është keqbërës i vërtetë.” (Maide: 46-47)

²⁶ Shih fetvanë: “سن عيسى عليه السلام عندما بعث” e publikuar në <https://www.islamweb.net/> më 28 janar 2019!

Ibën Kethiri,²⁷ duke komentuar atë se Inxhili ka qenë udhërrëfim dhe këshillë, ka thënë: “E kemi bërë Inxhilin udhëzim me të cilin udhëzohet, dhe këshillë e frenues nga kryerja e haramëve dhe e mëkateve.”.

Në këtë libër ai ua ka lejuar disa gjëra që më parë kanë qenë të ndaluara (Ali Imran: 50).

Kjo sa i përket përmbytjes së librit në përgjithësi, ndërsa sa i përket misionit, fjala kyçe ka qenë besimi i pastër – Tevhidi. Isai, a.s., sikurse pejgamberët e tjerë, ka thirrur në besimin në një Zot. Këtë e ka bërë që nga momenti i parë kur ka folur dhe e ka vazhduar derisa ka qenë gjallë.

﴿فَأَشَارَتْ إِلَيْهِ قَالُوا كَيْفَ نُكَلِّمُ مَنْ كَانَ فِي الْمَهْدِ صَبِيًّا﴾ ﴿٢٩﴾ قَالَ إِنِّي عَبْدُ اللَّهِ آتَانِيَ الْكِتَابَ وَجَعَلَنِي نَبِيًّا ﴿٣٠﴾ وَجَعَلَنِي مُبَارَكًا أَيْنَ مَا كُنْتُ وَأَوْصَانِي بِالصَّلَاةِ وَالزَّكَاةِ مَا دُمْتُ حَيًّا ﴿٣١﴾ وَبَرًّا بِوَالِدِيَّ وَلَمْ يَجْعَلْنِي جَبَّارًا شَقِيًّا ﴿٣٢﴾

“Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: “Si t’i flasim ne fëmijës që është në djep?”. Ai (Isai në djep) tha: “Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin (Inxhilin) dhe më ka bërë pejgamber. Dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë. Dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime, dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm.” (Merjem: 292-32)

Siç mund ta vërejmë, pika që karakterizojnë misionin e tij janë:

- Besimi në një Zot;
- Namazi;
- Zekati;
- Mirësjellja me nënën ose morali.

Këtë ka vazhduar ta predikojë edhe kur është dërguar.

﴿إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ﴾

“Me të vërtetë Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë! Kjo është rruga e drejtë!” (Ali Imran: 51)

²⁷ Ibën Kethiri, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, vep. cit., 3/126.

﴿وَقَالَ الْمَسِيحُ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ اعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾

“...O bijtë e Izraelit, adhurojeni Allahun, që është Zoti im dhe Zoti juaj! Sigurisht se, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë Xhenetin, dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës.” (Maide: 72)

Muhamed Ebu Zehre i ka bërë një përmbledhje misionit të Isait, a.s.: “Misioni i Isait, paqja qoftë mbi të!, ishte se nuk ka ndërmjetës mes Krijuesit dhe krijesave, mes adhuresit dhe të Adhuruarit. Priftërinjtë dhe rabinët nuk kanë të drejtën e ndërmjetësimit ndërmjet njerëzve dhe Zotit; përkundrazi, çdo pasues i tij lidhet personalisht me Zotin, pa pasur nevojë për ndërmjetësimin e priftit apo të klerit. Askush, pa varësisht pozitës që ka në fe, nuk mund të jetë ndërmjetës ndërmjet Zotit dhe robërve të Tij...”²⁸.

5.4. A ka pretenduar Isai, a.s., se është Zoti, ose djalë i Zotit?!

Kurani ka mohuar që Isai, a.s., të ketë pretenduar hyjnizim për veten apo për nënën e tij. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَإِذْ قَالَ اللَّهُ يَا عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ أَأَنْتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ اتَّخِذُونِي وَأُمِّي إِلهَيْنِ مِنْ دُونِ اللَّهِ ۖ قَالَ سُبْحَانَكَ مَا يَكُونُ لِي أَنْ أَقُولَ مَا لَيْسَ لِي بِحَقِّ ۖ إِنْ كُنْتُ قُلْتُهُ فَقَدْ عَلِمْتَهُ ۖ تَعَلَّمَ مَا فِي نَفْسِي وَلَا أَعْلَمُ مَا فِي نَفْسِكَ ۚ إِنَّكَ أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ ﴿١١٦﴾ مَا قُلْتُ لَهُمْ إِلَّا مَا أَمَرْتَنِي بِهِ أَنْ اعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبَّكُمْ ۖ وَكُنْتُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا مَّا دُمْتُ فِيهِمْ ۚ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِي كُنْتُ أَنْتَ الرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ ۚ وَأَنْتَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ شَهِيدٌ ﴿١١٧﴾﴾

“Pastaj Allahu do të thotë (në Ditën e Gjykimit): “O Isa, i biri i Merjemes, ti ishe ai që u the njerëzve: “Adhuromëni mua dhe në-

²⁸ Shih: Muhamed Ebu Zehre, *Muhadaratun fi En Nasaranijeh*, (Kajro: Dar El fikër El arabij, ed. 3, 1966), f. 12-13!

nën time si zota krahas Allahut!”?! Isai do të thotë: “Qofsh i Lartë dhe i Lavdëruar! Mua nuk më takon të them diçka për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, po unë nuk e di çfarë ka në Veten Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: “Adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!”. Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe, qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe Mbikëqyrësi i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë.” (Maide: 116-117)

Mundësinë që Isai, a.s., të predikojë diçka të këtillë Kurani e ka mohuar nga aspekte të ndryshme:

I. Marrja e besës nga ana e pejgamberëve, se nuk do të kumtojnë asgjë në kundërshtim me atë që i shpallet. Allahu i Madhëruar thotë:

﴿وَإِذْ أَخَذْنَا مِنَ النَّبِيِّينَ مِيثَاقَهُمْ وَمِنْكَ وَمِنْ نُوحٍ وَإِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ ابْنِ مَرْيَمَ وَأَخَذْنَا مِنْهُمْ مِيثَاقًا غَلِيظًا﴾

“Ne lidhëm besën me ty (o Muhamed), siç bëmë me pejgamberët e tjerë: me Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isin - të birin e Merjes. Ne lidhëm me ata një besë solemne.” (Ahzabë: 7)

Në koment të këtij ajeti, Shejh Sadi²⁹ ka thënë”Allahu i Madhëruar na bën të ditur se Ai ka marrë besën nga të gjithë pejgamberët në përgjithësi dhe nga Ululazmi në veçanti, një besë të fuqishme dhe të siguruar, që ata do ta përcjellin fenë e Tij dhe do të luftojnë në rrugën e Tij. Këtë rrugë të dëshmimit të besnikërisë e kanë përshkuar të gjithë pejgamberët, duke kulmuar me pejgamberin e fundit, Muhamedin, paqja e Zotit qoftë mbi të gjithë!”.

²⁹ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 659.

II. Njëpërmjet vetëdeklarimit të Isait, a.s.

Allahu i Madhëruar na mëson se Isai, a.s., predikonte sikurse tregon ajeti:

﴿إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ ۚ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ﴾ ٥١

“Me të vërtetë Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë! Kjo është rruga e drejtë!” (Ali Imran: 51)³⁰

Allahu i Madhëruar ka mohuar në Kuran që Isai, a.s., këtë ta ketë thënë diçka që Ai nuk e do. Përkundrazi, kjo është fjalë kufri, e cila është shpikur e sajuar prej të tjerëve.

﴿لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْمَسِيحُ ابْنُ مَرْيَمَ ۚ وَقَالَ الْمَسِيحُ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ اعْبُدُوا اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ ۚ إِنَّهُ مَن يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَاهُ النَّارُ ۚ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ﴾ ٧٢ ﴿لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ ثَلَاثُ ثَلَاثَةٍ ۚ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا إِلَهٌ وَاحِدٌ ۚ وَإِن لَّمْ يَنْتَهُوا عَمَّا يَقُولُونَ لَيَمَسَّنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾ ٧٣

“Pa dyshim se janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është Mesihu, i biri i Merjemes!”, - sepse vetë Mesihu ka thënë: “O bijtë e Izraelit, adhurojeni Allahun, që është Zoti im dhe Zoti juaj! Sigurisht se atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë Xhenetin, dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës. Pa dyshim se janë jobesimtarë ata që thonë: “Allahu është njëri prej Trinisë!”. Nuk ka, përveçse një Zot të Vetëm e të vërtetë! Nëse nuk heqin dorë nga ato që thonë, patjetër që jobesimtarët nga mesi i tyre do t’i godasë një dënim i dhembshëm!” (Maide: 72-73)³¹

Janë gjykuar kështu, sepse nuk janë mësimet e Isait, a.s., ato që i thërrasin njerëzit në hyjnizim të tij, përkundrazi.³²

³⁰ Shih edhe Merjem, 30!

³¹ Shih edhe Nisa, 171; Maide, 17!

³² Shih: Tevbe: 30-31!

III. Dëshmia kuranore për Isain, a.s.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿لَنْ يَسْتَنْكِفَ الْمَسِيحُ أَنْ يَكُونَ عَبْدًا لِلَّهِ﴾

“Mesihu nuk do ta përbuzte kurrë që të ishte rob i Allahut...”

(Nisa: 172)

Siç përmend Shejh Sadi,³³ Isai, a.s., kurrë nuk ka hequr dorë nga adhurimi i Zotit, përkundrazi.

IV. Urdhri i Zotit që ne, myslimanët, ta besojmë si njeri dhe si pejgamber

Ne besojmë se Isai, a.s., është pejgamber i Zotit, se ka pasur libër, dhe ne nuk bëjmë dallim ndërmjet tij dhe asnjë pejgamberi tjetër.

﴿قُولُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنْزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنْزِلَ إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ وَمَا أُوتِيَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَا أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِنْ رَبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ﴾ ١٣٦

“Thoni: “Ne besojmë në Allahun, në atë që na është shpallur neve (Kuranin), në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe Esbatëve (12 bijve të Jakubit), në atë që i është dhënë Musait e Isait dhe në atë që u është dhënë pejgamberëve prej Zotit të tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre, dhe vetëm Allahut i përulemi.” (Bekare: 136)³⁴

³³ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 216.

³⁴ Shih edhe Al Imran, 84!

5.5. Mrekullitë

Pejgamberët në misionet e tyre janë përkrahur me mrekulli, ashtu që njerëzit t'u besojnë më lehtë. Edhe Isait, paqja qoftë mbi të, i janë dhënë mrekulli.

﴿وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِي إِسْرَائِيلَ أَنِّي قَدْ جِئْتُكُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ ۚ أَنِّي أَخْلُقُ لَكُمْ مِنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ فَأَنْفُخُ فِيهِ فَيَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِ اللَّهِ ۚ وَأُبْرِئُ الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ وَأُحْيِي الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِ اللَّهِ ۚ وَأُنَبِّئُكُم بِمَا تَأْكُلُونَ وَمَا تَدْخُرُونَ فِي بُيُوتِكُمْ ۚ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَآيَةً لَّكُمْ إِن كُنتُمْ مُّؤْمِنِينَ ﴿٤٩﴾ وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيِّ مِنَ التَّوْرَةِ وَلَا حِلَّ لَكُمْ بَعْضَ الَّذِي حُرِّمَ عَلَيْكُمْ ۚ وَجِئْتُكُمْ بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ۖ﴾ ﴿٥٠﴾ إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ ۚ هَٰذَا صِرَاطٌ مُّسْتَقِيمٌ ﴿٥١﴾﴾

“Dhe do ta caktojë atë të Dërguar te bijtë e Izraelit (të cilëve do t’u thotë): “Ju kam sjellë prova prej Zotit tuaj (që vërtetojnë pejgamberinë time): bëj për ju diçka nga balta në formë shpendi, fryj në të dhe, me urdhrin e Allahut, ajo bëhet shpend i gjallë; i shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrosurit, dhe i ngjall të vdekurit, me lejen e Allahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja. Sigurisht që te të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Dhe (kam ardhur te ju) për t’jua vërtetuar Tevratin, që ishte para meje, dhe që t’jua lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë prej Zotit tuaj, prandaj kini frikë Allahun dhe bindmuni! Me të vërtetë Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë! Kjo është rruga e drejtë!” (Ali Imran: 49-51)

﴿إِذْ قَالَ اللَّهُ يَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ اذْكُرْ نِعْمَتِي عَلَيْكَ وَعَلَىٰ وَالِدَتِكَ إِذْ أَيَّدْتُكَ بِرُوحِ الْقُدُسِ تُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهْلًا ۖ وَإِذْ عَلَّمْتُكَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ ۖ وَإِذْ تَخْلُقُ مِنَ الطِّينِ كَهَيْئَةِ الطَّيْرِ بِإِذْنِي فَتَنفُخُ فِيهَا فَتَكُونُ طَيْرًا بِإِذْنِي ۖ وَتُبْرِئُ الْأَكْمَهَ وَالْأَبْرَصَ بِإِذْنِي ۖ وَإِذْ تُخْرِجُ الْمَوْتَىٰ بِإِذْنِي ۖ وَإِذْ كَفَفْتُ بَنِي إِسْرَائِيلَ عَنْكَ إِذْ جِئْتَهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَقَالَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْهُمْ إِن هَٰذَا إِلَّا

سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿١١٠﴾ وَإِذْ أُوحِيتْ إِلَى الْخَوَارِجِ أَنْ آمِنُوا بِي وَبِرَسُولِي قَالُوا آمَنَّا
وَأَشْهَدُ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿١١١﴾ إِذْ قَالَ الْخَوَارِجُ يَا عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ هَلْ
يَسْتَطِيعُ رَبُّكَ أَنْ يُنْزِلَ عَلَيْنَا مَائِدَةً مِنَ السَّمَاءِ ۖ قَالَ اتَّقُوا اللَّهَ إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ
﴿١١٢﴾ قَالُوا نُرِيدُ أَنْ نَأْكُلَ مِنْهَا وَتَطْمَئِنَّ قُلُوبُنَا وَنَعْلَمَ أَنْ قَدْ صَدَقْتَنَا
وَنَكُونَ عَلَيْهَا مِنَ الشَّاهِدِينَ ﴿١١٣﴾ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا أَنْزِلْ
عَلَيْنَا مَائِدَةً مِنَ السَّمَاءِ تَكُونُ لَنَا عِيدًا لِأَوَّلِنَا وَآخِرِنَا وَآيَةً مِنْكَ ۖ وَارْزُقْنَا وَأَنْتَ
خَيْرُ الرَّاظِقِينَ ﴿١١٤﴾ قَالَ اللَّهُ إِنِّي مُنَزِّلُهَا عَلَيْكُمْ ۖ فَمَنْ يَكْفُرْ بَعْدُ مِنْكُمْ فَاِنِّي
أُعَذِّبُهُ عَذَابًا لَا أُعَذِّبُهُ أَحَدًا مِنَ الْعَالَمِينَ ﴿١١٥﴾

“Allahu do të thotë: “O Isa, i biri Merjemes, kujtoje mirësinë Time ndaj teje dhe nënës sate: se si të forcova ty me Shpirtin e Shenjtë (Xhebrailin), kështu që ti u predikojë njerëzve kur ishte foshnjë në djep dhe i rritur; se si ta mësova Librin dhe Urtësinë, Tëvratin dhe Inxhilin; se si, me vullnetin Tim, krijojë një figurë shpendi nga balta, pastaj fryjë në të, dhe ajo bëhej zog me vullnetin Tim; se si me vullnetin Tim i shërojë të lindurit të verbër dhe të lebrosurit; se si me vullnetin Tim i ngjalljë të vdekurit; se si i pengova sulmet e izraelitëve kundër teje, atëherë kur u asolle atyre provat e qarta, e mohuesit në radhët e tyre thanë: “Kjo është vetëm magji e kulluar.”; dhe se si, kur i urdhërova dishepujt: “Besomëni Mua dhe të Dërguarit Tim!”, - ata u përgjigjën: “Ne besojmë, prandaj dëshmo se Ty të jemi dorëzuar!”! Kujto kur dishepujt thanë: “O Isa, i biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na e zbresë një sofër nga qielli?”. Ai tha: “Kini frikë Allahun, nëse jeni besimtarë të vërtetë! Ne dëshirojmë të hamë nga ajo – thanë ata – me qëllim që të na qetësohen zemrat dhe ta dimë se na e ke thënë të vërtetën, dhe për atë të jemi dëshmitarë. “O Allah, o Zoti ynë!”, – tha Isai, i biri i Merjemes – “Zbritna një sofër nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë, dhe të jetë mrekulli prej Teje, dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i Mirë!”. Allahu u përgjigj: “Unë do t’jua zbres

sofrën. Mirëpo, cilido prej jush që nuk beson pas kësaj, do ta dënojmë ashtu siç nuk e kam dënuar askënd në botë!” (Maide: 110-115)

Cila ka qenë rëndësia e këtyre mrekullive?

- “Që të jenë sfiduese të llojit të asaj që ka ekzistuar në popullin e tyre, sepse pejgamberët janë dërguar zakonisht me mrekulli që sfidonin njohuritë e popujve të tyre në fusha të caktuara. Në kohën e Isait, paqja qoftë mbi të!, kishte mjekë të aftë, të cilët i sfidoi me mrekulli që njeriu nuk mund t’i arrijë, sado dije të ketë, dhe...”;
 - Që t’i shtyjnë njerëzit drejt besimit, sepse pas prezantimit të këtyre mrekullive ai ka kërkuar që ta adhurojnë Allahun dhe t’i binden Atij:

﴿وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ التَّوْرَةِ وَلَأَحِلَّ لَكُم بَعْضَ الَّذِي حُرِّمَ عَلَيْكُمْ ۚ وَجِئْتُكُم بِآيَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ فَاتَّقُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا ۝٥٠﴾ إِنَّ اللَّهَ رَبِّي وَرَبُّكُمْ فَاعْبُدُوهُ ۚ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ ﴿٥١﴾

“Dhe (kam ardhur te ju) për t’jua vërtetuar Teveratin, që ishte para meje, dhe që t’jua lejoj disa gjëra që i keni pasur të ndaluara. Ju kam sjellë një provë prej Zotit tuaj, prandaj kini frikë Allahun dhe bindmuni! Me të vërtetë Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë! Kjo është rruga e drejtë!” (Ali Imran: 50-51)

5.6. Havarijunët – mbështetësit dhe ndjekësit e Isait, a.s.

Ashtu sikur edhe çdo pejgamber tjetër, edhe Isai, a.s., ka pasur pasues dhe ndjekës. Kurani na i ka ofruar disa të dhëna rreth tyre.

1) Ata e kanë besuar Allahun dhe të dërguarin e Tij

﴿وَإِذْ أَوْحَيْتُ إِلَى الْحَوَارِيِّينَ أَنْ آمِنُوا بِي وَبِرَسُولِي قَالُوا آمَنَّا وَاشْهَدْ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ﴾

“Dhe se si kur ua shpalla dishepujve: “Besomëni Mua dhe të Dërguarit Tim!” - ata u përgjigjën: “Ne besojmë, prandaj dëshmo se Ty të jemi dorëzuar!” (Maide: 111)

Shejh Sadi³⁵ ka thënë se shpallja e përmendur në këtë ajet nënkupton inspirimin dhe frymëzimin, hapjen e gjokseve të tyre për ta pasuar Isain, a.s. Po kështu, nënkupton shpalljen nëpërmjet gjuhës së tij (Isait, a.s.): “I kam urdhëruar, përmes shpalljes që të kam bërë ty, që të më besojnë Mua dhe pejgamberit Tim.”.

Këta pasues, - shpjegon Shejh Sadi, - Zoti i Madhëruar i ka përmendur në kontekstin e mirësisë së Tij ndaj Isait, a.s.”. Ata e kanë dëshmuar besimin e tyre kur të tjerët e kanë mohuar Isain, a.s., dhe kanë tentuar ta vrasin atë.

﴿فَلَمَّا أَحَسَّ عِيسَى مِنْهُمُ الْكُفْرَ قَالَ مَنْ أَنْصَارِي إِلَى اللَّهِ قَالَ الْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ أَنْصَارُ اللَّهِ آمَنَّا بِاللَّهِ وَأَشْهَدُ بِأَنَّكَ مُسْلِمُونَ * رَبَّنَا آمَنَّا بِمَا أَنْزَلْتَ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ﴾

“Kur Isai vuri re mosbesimin e tyre, tha: “Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e Allahut?”. Nxënësit (e tij) u përgjigjën: “Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) Allahut. Ne e besojmë Allahun, e ti (Isa) dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij)! Zoti ynë! Ne besojmë atë që na e ke shpallur, dhe e pasojmë të Dërguarin! Na shkruaj, pra, bashkë me dëshmitarët!” (Ali Imran: 52-53)

2) Havarijunët janë, megjithatë, njerëz

Havarijunët nuk janë pejgamberë dhe, rrjedhimisht, nuk janë as të mbrojtur nga mëkatet. Ata, siç mësuam në pjesën e mrekullive, i kërkuan Zotit t’ua zbresë një sofër nga qielli (Maide: 112), kërkesë që Isai, a.s., e kundërshtoi si sjellje, sepse është ligj i Zotit që, nëse kërkohen gjëra të tilla dhe më pas vazhdohet me mohim, Ai t’i ndëshkojë ashpër.

³⁵ Sadi, *Tejsiru El Kerimi Err Rrahman*, vep. cit., f. 248.

5.6. Përgëzimi për ardhjen e Pejgamberit Muhamed s.a.v.s.

﴿وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِنْ بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدٌ فَلَمَّا جَاءَهُمْ بِالْبَيِّنَاتِ قَالُوا هَذَا سِحْرٌ مُبِينٌ﴾³⁶

“Kujto kur Isai, i biri i Merjemes, tha: “O bijtë e Izraelit, unë jam i dërguar i Allahut te ju, për t’jua vërtetuar Tevratin e shpallur para meje dhe për t’jua sjell lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje!”. Mirëpo, kur ai u solli atyre shenja të qarta, ata thanë: “Kjo është magji e hapur.” (Saf, 6)

Isai, a.s., ka qenë si pejgamberët e mëparshëm: e ka vërtetuar pejgamberin para tij dhe ka paralajmëruar për ardhjen e pejgamberit pas tij. Ti-paret e pejgamberit Muhamed s.a.v.s., të përshkruara në Inxhil, ishin të njohura për të krishterët dhe, edhe atëherë kur ata, bashkë me hebrenjtë, i panë qartë në personalitetin e Muhamedit s.a.v.s. i kanë mohuar.³⁶

Ja një dëshmi e mohimit të qëllimshëm dhe armiqësor.

Nëna e besimtarëve, Safije bint Hujej bin Ahtab, rrëfen se ajo ishte fëmija më i dashur për babanë dhe xhaxhanë e saj. Ditën kur pejgamberi Muhamed s.a.v.s. erdhi në Medinë, ata shkuan për ta parë. Në shtëpi ishin kthyer të lodhur, dikur kur dielli veçse po perëndonte. Dola t’i prisja, por, edhe pse më donin shumë, nuk më folën. Pra, ishin shumë të zemëruar. Pastaj, vazhdon Safija, Xhaxhai e pyeti babanë tim në lidhje me pejgamberin Muhamed s.a.v.s.: “A ishte ai?”. “Po, betohem në Zot se po”, - iu përgjigj babai. “Çfarë do të bësh? A do ta pranosh?” – e pyeti. “Jo, do ta urrej përjetësisht!”, - iu përgjigj ai.³⁷

³⁶ Shih: Bekare, 146; A’rafë, 157!

³⁷ Shih: Abdul Halik Hasen Esh Sherif, *El kuds, El jehud, ve Ed Dexhal*, (Kajro: botim privat, 2000), f. 8-21!

6. POLEMIKAT RRETH FUNDIT TË ISAIT, A.S.

6.1. Mohimi i vrasjes apo i kryqëzimit të Isait, a.s.

A u vra Isai, a.s.?

A e kryqëzuan?

Çfarë ndodhi me të?

Kurani ka mohuar në mënyrë kategorike se ata e kanë vranë Isain, a.s. Madje, këtë e llogarit si akuzë të rëndë dhe mëkat të madh.

﴿وَبُكَرِهِمْ وَقَوْلِهِمْ عَلَىٰ مَرْيَمَ بُهْتَانًا عَظِيمًا﴾ ﴿١٥٦﴾ وَقَوْلِهِمْ إِنَّا قَتَلْنَا الْمَسِيحَ عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ رَسُولَ اللَّهِ وَمَا قَتَلُوهُ وَمَا صَلَبُوهُ وَلَكِنْ شُبِّهَ لَهُمْ ۚ وَإِنَّ الَّذِينَ اخْتَلَفُوا فِيهِ لَفِي شَكٍّ مِّنْهُ ۚ مَا لَهُمْ بِهِ مِنْ عِلْمٍ إِلَّا اتِّبَاعَ الظَّنِّ ۚ وَمَا قَتَلُوهُ يَقِينًا ﴿١٥٧﴾ بَلْ رَفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿١٥٨﴾

“(I mallkuam ata) Për shkak të mosbesimit të tyre (ndaj Isait, a.s.), për shkak të shpifjeve të mëdha që thanë kundër Merjemes. Dhe për fjalët e tyre: “Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut.”. Mirëpo ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vranë. Mirëpo, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm.” (Nisa: 156-158)

Pra, Isai, a.s., nuk është mbytur, dhe aq më pak të jetë gozhduar e kryqëzuar; atë e ngriti Zoti në qiell.

﴿إِذْ قَالَ اللَّهُ يَا عِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ ارْفُضْ إِلَيْنِي مِثْقَالَ ذَرَّةٍ ۖ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا﴾

“(Kujtoje, o Muhamed) Kur Allahu tha: “O Isa! Unë do të të marr, do të të ngre pranë Meje dhe do të të shpëtoj ty nga ata që nuk besojnë...” (Ali Imran: 55)

Ibën Kethiri³⁸ shpjegon se urrejtja dhe armiqësia e hebrenjve ndaj Isait, a.s., ka ekzistuar që në fillim. Edhe pse kishin parë mrekullitë e tij dhe ishin të bindur për pejgamberësinë e tij, zgjodhën ta mohojnë. Dhe jo vetëm kaq, por e keqtrajtonin aq shumë, sa që ai, bashkë me nënën e vet, Merjemen - paqja qoftë mbi të dy! - nuk mund të qëndronin dot në një vend me ta. Hebrenjtë kishin nxitur mbretin idhujtar të Damaskut që ta përndiqte Isain, a.s., nën pretekstin e predikimit të tij të gabuar. Ai kishte urdhëruar guvernatorin e Kudsit që ta kryqëzonte këtë njeri (Isain, a.s.) dhe t'i vendoste në kokë një kurorë me gjemba.

Kur Isai, a.s., u rrethua prej tyre, derisa ishte në prani të shokëve të vet, tha: “Kush prej jush pranon të jetë shoqëruesi im në Xhenet, me kusht që pamja ime t'i hidhet atij?”. Pranoi një djalosh i ri. Atëherë Isai, a.s., u ngrit në qiell dhe ata që ishin aty e panë, ndërsa djaloshi që mori pamjen e tij u kryqëzua dhe u mbyt.

Hebrenjtë u gëzuan nga ky lajm, ndërsa një pjesë e të krishterëve e pranuan si të vërtetë për shkak të injorancës që kishin. Përrjashtim bënë vetëm ata që ishin në shtëpi me të; të tjerët besuan se ai u kryqëzua.

Para se të kalojmë tutje, na mbetet të trajtojmë edhe një shprehje që mund të kuptohet gabimisht, sikur bën fjalë për vdekjen. Fjala është për shprehjen *muteveffike*: “مُتَوَفِّيكَ” – do të të bëj të vdesësh”.

Dijetarët mendojnë se kjo shprehje nuk përcakton kohën, as nuk nënkupton që vdekja ka ndodhur në të kaluarën. As pjesëza lidhëse “vav” (وَ) në shprehjen tjetër “rafiuke” (وَرَأَيْكَ) nuk tregon veprim të ngjitur. Pra, Isai, a.s., nuk ka vdekur që të ngjitet më pas në qiell. Kjo konfirmohet edhe me argumente të sakta, të cilat dëshmojnë se Isai, a.s., është në qiell, nuk ka vdekur dhe do të zbresë në kohën e fundit.

Disa kanë thënë me shprehje *muteveffike* është se për qëllim gjumi, siç qëndron në Kuran (në suren En'amë: 60). Edhe në hadithe gjumi është quajtur vdekje. Në Sahihun e Buhariut qëndron se pejgamberi Muhamed s.a.v.s. në mëngjes lutej:

³⁸ Ibën Kethiri, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, vep. cit., 2/448.

الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي أَحْيَانَا بَعْدَ مَا أَمَاتَنَا وَإِلَيْهِ النُّشُورُ

“Falënderimi i qoftë Allahu që na ringjalli, pasi ishim të vdekur, dhe tek Ai është ringjallja!”³⁹

Disa thonë se Isai, a.s., është ngritur në qiell duke qenë në gjumë. Të tjerë vdekjen e kanë interpretuar se do të ndodhë pas zbritjes nga qielli. Disa shprehjen *muteveffike* e kanë interpretuar me *kabd*.⁴⁰ kapje, mbajtje, marrje, e që kuptimi del: të kam kapur dhe ngritur tek Unë.

6.2. Pasojat ideologjike të bindjes për vrasjen e Isait, a.s.

Allahu i Madhëruar thotë:

﴿ذَلِكَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ ۖ قَوْلَ الْحَقِّ الَّذِي فِيهِ يَمْتَرُونَ﴾

“Ky është Isai, i biri i Merjemes. Kjo është fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë.” (Merjem: 34)

﴿فَاخْتَلَفَ الْأَحْزَابُ مِنْ بَيْنِهِمْ فَوَيْلٌ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ مَّشْهَدِ يَوْمٍ عَظِيمٍ﴾

“E, megjithatë, sektet u përçanë në lidhje me atë. Mjerë ata që nuk besojnë për takimin e një dite të madhe (Ditës së Kiametit)!” (Merjem: 37)

Me shprehjen “sekte” janë për qëllim hebrenjtë dhe të krishterët. Hebrenjtë jo vetëm që nuk e pranuan pejgamberësinë e Isait, por edhe e akuzuan si magjistat dhe si fëmijë (i paligjshëm) i një zdrukthëtari me emrin Jusuf. Ndërsa të krishterët u ndanë në tri grupe:

- 1) Disa thanë se në mesin tonë ka qenë rob i dërguari i Allahut, të cilin Allahu e ngriti në qiell. Ky grup, ndonëse i vogël, janë pasuesit e vërtetë të tij;
- 2) Një grup tjetër thanë se ai ishte Zoti, dhe;
- 3) Grupi i tretë thanë se ishte i biri i Zotit.⁴¹

³⁹ Buhariu, 6324.

⁴⁰ Shih: Muhamed bin Xherir Taberiu, *Tefsir Et Taberij*, red. Abdullah bin Abdulmuhsin Turki, (Kajro: Dar Hixhr, 2001), 5/447-448; Ibën Kethiri, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, vep. cit., 2/47; Kurtubi, *Tefsir El Kurtubi*, vep. cit., 4/99-100!

⁴¹ Ibën Kethiri, *Tefsiru El Kur'ani El adhim*, vep. cit., 2/47.

6.3. Rikthimi i Isait, a.s.

Dijetarët myslimanë janë të mendimit se Kiameti nuk do të ndodhë para se Isai, a.s., të kthehet. Kthimin e tij e shpjegojmë në mënyrë të detajuar në pjesën vijuese, tek hadithet.

Në Kuran aludohet për zbritjen e Isait, a.s. Disa nga këto aludime i gjejmë në ajetin e 46-të të kaptinës Ali Imran:

﴿وَيُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهْلًا وَمِنَ الصَّالِحِينَ ٤٦﴾

“Ai do t’u flasë njerëzve qysh i vogël, në djep, e edhe si njeri i rritur, dhe do të jetë prej më të mirëve.” (Ali Imran: 46)

Me shprehjen “i rritur - كَهْلًا” disa e kanë kuptuar rikthimin.⁴²

Në rikthim aludohet edhe kur për Isain, a.s., flitet si shenjë e Kiametit.

﴿وَإِنَّهُ لَعِلْمٌ لِّلسَّاعَةِ فَلَا تَمْتَرُنَّ بِهَا وَاتَّبِعُون هَٰذَا صِرَاطٌ مُّسْتَقِيمٌ﴾

“Në të vërtetë Isai është shenjë e Orës (së Kiametit), në ardhjen e të cilës mos dyshoni kurrësi. Pra, ndiqmëni mua, se kjo është rruga e drejtë!” (Zuhruf: 61)⁴³

Në këtë pjesë duam të diskutojmë edhe për një çështje me rëndësi që ndodh kur të kthehet Isai, a.s., e të cilën e ka përmendur edhe Kurani.

﴿وَإِن مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ إِلَّا لَيُؤْمِنَنَّ بِهِ قَبْلَ مَوْتِهِ ۖ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكُونُ عَلَيْهِمْ

شَهِيدًا ۝ ١٥٩﴾

“Të gjithë ithtarët e Librit do t’i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe, në Ditën e Kiametit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre.” (Nisa: 159)

Pjesa në ajet: “قَبْلَ مَوْتِهِ” -para se ai të vdesë”, respektivisht përemri, i ka bërë dijetarët të diskutojnë se për kë bëhet fjalë, për të krishterët apo

⁴² Shih: El Husejn bin Mes'ud El Begavij, *Mealim Et Tenzil fi tefsiri El Kur'an*, red. Muhamed Abdullah Nemr, Uthman Xhumuah Dumejrije dhe Sulejman Muslim Harash, (Dar Tajjibe, ed. 4, 1997), 2/46!

⁴³ Shih: Sadi, *Tefsir Es Sadi*, vep cit., f. 768!

për Isain, a.s. Shejh Sadi⁴⁴ ka thënë: “Nëse bëhet fjalë për të krishterët, atëherë kjo ndodh kur ata të vdesin, por besimi nuk iu pranohet sepse është tepër vonë. Ndërsa nëse i referohet Isait, a.s., atëherë kjo do të ndodhë kur ai të kthehet dhe ata ta mësojnë të vërtetën. Kjo nënkupton se ata do ta besojnë si Isain, ashtu edhe Muhamedin, paqja qoftë mbi ta. Në Ditën e Llogarisë, ai do të dëshmojë nëse veprat e tyre kanë qenë ose jo në përputhje me fenë e Zotit.”.

-vazhdon-

⁴⁴ Po aty, f. 213.

Dr. Sedat ISLAMI

PROPHET JESUS, PEACE BE UPON HIM, ACCORDING TO THE QUR'AN, THE SUNNAH, AND HIS COUNSEL

Abstract

Jesus is one of the prophets chosen by God. The unusual manner of his birth and the conclusion of his mission have often been misinterpreted, resulting in extreme concepts that bear no relation to the truth. This paper focuses on the way the life and mission of Jesus are presented in the Qur'an, offering a summarized and thematic overview of his life, from his birth until his death at the end of time.

The importance of this paper lies in presenting material which can be used as an important guide regarding issues related to this distinguished prophet, which have direct consequences in the field of creed ('aqīdah). The paper is divided into several parts, which thematically complement each other. Its findings confirm the pure religious and rational approach of the Qur'an and the Sunnah in addressing disputable matters regarding Jesus, while his counsels serve as additional evidence and testimony for this approach.

The main recommendation of the paper is that believers should take matters with direct doctrinal impact only from the Qur'an and authentic hadiths.

Keywords: *Jesus, prophet, Qur'an, birth, mission, miracles, death, end of time.*

Asist. Prof. Dr. Rexhep SUMA

STILISTIKA E KURANIT NË PARAQITJEN E HISTORIVE, TË RRËFIMEVE DHE TË TË VËRTETAVE

Abstrakt

Kurani përdor metoda të ndryshme dhe të dallueshme për t'i paraqitur të vërtetat dhe mesazhet hyjnore. Këto metoda nuk janë vetëm edukative, por gjithashtu synojnë të ndikojnë shpirtërisht dhe mendërisht te lexuesi ose dëgjuesi. Një nga mënyrat më të bukura që Allahu ka urdhëruar të përdoren në thirrjen e njerëzve dhe në ligjërimin predikues, është tregimi i historive dhe të vërtetave, si dhe dhënia e shembujve. Historitë me vlerë dhe shembujt e qartë tërheqin vëmendjen, lënë mbresa në shpirt dhe ndihmojnë në të kuptuarit. Tregimet (*el kisas*) janë një formë e fuqishme dhe efektive e thirrjes islame (*da've*). Duke shqyrtuar qëllimet e rrëfimit në Kuran, del në pah vërtetimi i Njëshmërisë së Krijuesit, Njëshmërisë së fesë, Njëshmërisë së pejgamberëve, Njëshmërisë së metodave të *da'ves* (thirrjes islame) dhe Njëshmërisë së pasojave që do të përjetojnë përgënjeshtruesit. Stilistika kuranore ka një rëndësi të veçantë në interpretimin e Librit të Zotit, pasi një komentues nuk mund të kuptojë semantikën strukturale dhe gjuhësore të tij pa e njohur thellësisht domethënien e fjalëve dhe strukturave. Stilistika e Kuranit në paraqitjen e historive, të rrëfimeve dhe të vërtetësive është unike dhe komplekse. Ajo kombinon narracionin, poezinë dhe prozën në një mënyrë që ngjall reflektim dhe emocion tek lexuesi. Kurani përdor një gjuhë të pasur dhe të fuqi-

shme, të mbushur me metafora, analogji dhe simbole, për të përcjellë mesazhet e tij.

Fjalët çelës: *Stilistika e Kuranit, rrëfim, strukturë, histori, edukim.*

HJRJE

Rrëfimi në Kuran nuk është një vepër artistike e pavarur, as në tematikë, as në mënyrën e shprehjes, as në interpretimin e ngjarjeve të tij, siç është rasti me rrëfimin e lirë artistik, i cili synon të realizojë vetëm aspektin artistik. Rrëfimi është njëra prej metodave të shumta të Kuranit, e cila synon të arrijë qëllimin e saj themelor. Kurani, para së gjithash, është libër i misionit fetar, ndërsa rrëfimi është njëra prej metodave të tij për proklamimin e këtij misioni (thirrjeje) dhe për vendosjen e tij. Kjo është kështu, sepse studimi i stilistikës është thelbi i metodës analitike për të kuptuar tekstet dhe për të nxjerrë ligjet prej tyre.¹

Studiuesi dhe dijetari i njohur i botës islame, Muhamed Ebu Zehre, në librin e tij **“Ed-davetu ile’l-islami”**, ndër të tjera, duke theksuar nevojën e rrëfimit nga jeta e Muhamedit, a.s., shpjegon se rasti i tij është identik me rastin e skenave të Kiametit, pikturave të mjerimit (ndëshkimit) dhe lumturisë (kënaqësisë), si dhe me rastin e fakteve që pasqyrojnë ringjalljen dhe fuqinë e Allahut. Ai është identik edhe me çështjet e sheriatit, të cilat i detajon me shembujt që sjell, por edhe me të gjitha tematikat që shqyrton. Rrëfimi kuranor, sa i përket tematikës, mënyrës së shtrirjes dhe interpretimit të ngjarjeve të tij, i është nënshtruar në mënyrë direkte qëllimeve fetare. Megjithatë, ky nënshtrim i plotë ndaj qëllimit fetar dhe realizimi i tij përmes këtij qëllimi nuk e pengon në mënyrë të plotë shfaqjen e tipareve artistike gjatë paraqitjes së tij, veçanërisht veçorinë më të madhe të Kuranit në shprehje dhe ilustrim. Ne kemi vërejtur më parë se shprehja kuranore sintetizon qëllimin fetar me atë artistik kur ekspozon diçka nga pikturat dhe skenat. Madje, kemi vërejtur se ajo bukurinë artistike e shndërron në një mjet synues për ndikim intuitiv.²

¹ Mustafa Xhumejde, *Es Salibu El Atfi fi El Kurani El Kerimi*, Esherike El Misrije li En Neshër, Kajro, 1999, v. 1, f. 2.

² Sejid Kutub, *Et Tasviru’l Fennij fi El Kuran*, Daru Esh Shuruk, Bejrut, 1995, f. 143.

Stili i rrëfimit apo i tregimit në Kuran mbetet qenësor

Stili i rrëfimit ose tregimit në Kuran është thelbësor për transmetimin e mësimave morale, historive të pejgamberëve dhe ngjarjeve historike që përmbajnë udhëzime për besimtarët. Kurani përmban shumë rrëfime që synojnë të japin mesazhe të rëndësishme dhe të nxjerrin mësimet jetësore. Disa nga rolet kryesore të rrëfimit/të tregimit në Kuran janë:

1. *Mësimet morale*: Përmes rrëfimeve të historive, Kurani i ofron besimtarëve mësimet të rëndësishme morale. Për shembull, rrëfimi i historisë së Ademit dhe Haves na mëson mbi detyrimet dhe pasojat e mosbindjes ndaj urdhrave të Zotit.
2. *Udhëzime për besimtarët*: Rrëfimet në Kuran ofrojnë udhëzime dhe mësimet për të jetuar në mënyrë të drejtë dhe për të përmbushur detyrat fetare. Për shembull, rrëfimi mbi historinë e Ibrahimit dhe provat që ai përballoi na mëson për besnikërinë dhe besimin në rrethanat më të vështira.
3. *Inspirim dhe përcjellje*: Rrëfimet në Kuran shërbejnë si burim frymëzimi për besimtarët, duke i inkurajuar ata të përpiqen për virtyte dhe të shmangin mëkatet. Në këtë kontekst, rrëfimi mbi historinë e Musait dhe betejat kundër zullumeve na mëson për guximin dhe vendosmërinë për të mbrojtur të vërtetat e drejtësisë.
4. *Kujdes për të shkuarën dhe për të ardhmen*: Kurani rrëfen ngjarje dhe histori të mëdha, të cilat i kujtojnë besimtarëve mësimet e të kaluarës dhe i përgatitin për të ardhmen. Për shembull, rrëfimi i historisë së Nuhut dhe arkës së tij na mëson për rëndësinë e besimit dhe vullnetit të Zotit për të shpëtuar ata që janë besimtarë.

Pra, tregimi në Kuran shërben si një mjet për të edukuar, për të udhëzuar dhe për të frymëzuar besimtarët, duke i përgatitur ata për të jetuar në harmoni me mësimet dhe udhëzimet e Islamit. Çdo tregim apo rrëfim, i çfarëdo zhanri qoftë, duhet të bazohet në elemente të caktuara që formojnë strukturën e tij, dhe në elemente të caktuara që drejtojnë ndërtimin e tij, në mënyrë që të jetë i drejtë në masën e kritikës letrare për t'u quajtur tregim. Në aspektin tonë duhet nënvizuar se tregimi kuranor nuk përjashtohet nga ky rregull; pasi, në përgjithësi, përcaktohet nga tri elemente kryesore, të cilat janë: forma, përmbajtja, koha dhe vendi, si dhe emrat e

emërtimet. Ne do të flasim për secilin prej këtyre elementeve në mënyrë të shkurtër.

Elementi formë dhe përmbajtje: Tregimet kuranore risjellin ngjarjet historike nga thellësitë e kohës dhe i mbledhin ato nga të gjitha anët e tokës, për t'i paraqitur përsëri në jetën e re, në kontekstin e këshillës dhe mësimi. Me fjalë të tjera, ato risjellin ngjarjet historike në një formë të re dhe i bëjnë ato të gjalla, pasi ishin të vdekura - të gjitha këto me një stil tërheqës dhe përmbajtje të shkëlqyer.

Elementi kohë: Sa i përket elementit të kohës, çdo tregim në Kuran ka kohën e vet specifike. Elementi i kohës në tregimin kuranor është absolut dhe i lirë nga çdo kufizim, përveç kufizimit në të kaluarën; pra, kjo kohë nuk ka kufij që e përcaktojnë, por është një ngjarje që ka ndodhur dhe ka përfunduar. E njëjta gjë vlen edhe për elementin e vendit. Tregimet kuranore nuk i kushtojnë rëndësi vendit dhe nuk e përmendin atë, përveç në rastet kur vendi ka një rëndësi të veçantë që ndikon në zhvillimin e ngjarjes, thekson karakteristikat e saj, ose sjell dëshmi për këshillën dhe mësimin - si në tregimin e Isra-së, ku Kurani përmend vendin e ngjarjeve për arsyet e mësipërme. Nëse vendi nuk ka ndonjë rëndësi nga këto aspekte, atëherë Kurani nuk e përmend vendin dhe nuk e konsideron të rëndësishëm, si në tregimin e banorëve të shpellës dhe tregime të ngjashme. Nga një aspekt tjetër, natyra njerëzore anon dhe e pëlqen tregimin. Ajo paraqet një ilustrim nga aspekti social, i cili i paraqitet individëve, ku prezantohet lëvizja, morali, mendimet dhe orientimet e tyre, si dhe ambienti kohor e natyror që i rrethon personazhet. Njerëzit, natyrisht, kanë dëshirë të dëgjojnë një tregim të tillë. Këto mund të jenë mjete ndër më të mirat që ne mund t'i paraqesim dhe prezantojmë për mësimet tona fetare (imami), përmes një procesi të gjallë që i lëviz shpirtat drejt prezantimit të fakteve.³ Në këtë aspekt, tregimet kuranore janë tregimet më të mira me të cilat është ndërtuar sistemi i moralit dhe me të cilat është forcuar shtylla e civilizimit islam, e që e bëri më të plotë dhe më të besueshme në mesin e kulturave.

³ Al Bahi Al Khouli, *Tedhkiretu Ed Duat*, Daru El Beshir li Eth Thekafeti ve El Ulum, Tanta, 1999, f. 45.

كُلَّا نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ ۚ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ
وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ

“Të gjitha këto që t’i rrëfyem ty nga lajmet e pejgamberëve janë që të ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to ka ardhur e vërteta e këshilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” (Hud, 120).

Element i emrave dhe i emërtimeve: Nëse Kurani përmend emrat e personave në tregimet e tij, ai i referohet personaliteteve historike të njohura, si përmendja e emrave të pejgamberëve, si dhe disa emra që kanë sfiduar thirrjen hyjnore, si Faraoni, Karuni, Hamani dhe të tjerë. Gjithashtu, ka personazhe për të cilët Kurani nuk përmend emrin dhe nuk zbulon funksionin e tyre shoqëror në jetë, por përmend vetëm disa prej cilësive të tyre psikologjike ose shpirtërore, si shoku i Musait (Hidri), besimtari nga populli i Faraonit dhe shoku i Sulejmanit. Kurani mund të paraqesë disa emra pa asnjë cilësi të veçantë, si “një burrë” apo “një fshat”, ku këto emra janë të papërcaktuar dhe nuk kërkojnë identifikim, sepse nuk luajnë një rol të veçantë në ngjarjen e treguar me cilësi që i dallojnë, por janë shembuj të përgjithshëm të gjinisë së tyre. Kjo do të thotë se është e kotë të kërkojë të njohësh emrat e tyre ose të përcaktosh cilësitë e tyre. Në përgjithësi, Allahu i Lartë, duke na treguar tregimet kuranore, na sjell disa të vërteta universale që vazhdojnë deri në Ditën e Gjykimit; sepse, kur shikojmë elementet që përdor Kurani, i shohim ato të pandikuar nga një kohë, vend apo person i caktuar. Kjo është ajo që pritet nga një libër universal. Ngjarjet që përmend Kurani përsëriten gjatë kohës nën forma të ndryshme, por me të njëjtën thelb.⁴

Historitë në Kuran janë treguar në mënyra të ndryshme dhe me shprehje të larmishme; ndonjëherë një histori e vetme zgjat një sure të tërë ose pjesën më të madhe të saj; ndonjëherë, historia përmbledhet në katër ose pesë rreshta dhe kryen qëllimin e saj. Shiko, për shembull, se si historia e Jusufit zgjat një sure të tërë dhe si lexuesi e përsërit leximin e saj pa u mërzitur. Madje, ai e dëshiron ta lexojë, për të ndjekur ngjarjet e saj, edhe pse e ka lexuar kushedi sa herë dhe e njeh përmendësh. Shiko historinë e

⁴ El Kisas fi El Kuran, <https://www.islamweb.net> (03.02.2023).

Musait, sa herë është përmendur në Kuran dhe çdo herë tregohet në një mënyrë tërheqëse, në momente që ngjallin emocione dhe përfitime të reja. Nganjëherë, ajo është e gjatë, si në suret Taha dhe El Kasas; ndonjëherë e mesme, si në suret El Araf dhe Esh Shuara; dhe ndonjëherë tjetër e shkurtër, si në suret El Muminun dhe En Naziat - e gjithë kjo larmi është për qëllime të posaçme, për mësim mbresëlënës... etj.

Metodat kuranore kanë një rëndësi të veçantë në interpretimin e Librit të Zotit, sepse kuptimi i thellë i tij nuk mund të arrihet pa njohjen e kuptimeve të fjalëve dhe strukturave gjuhësore. Mësimi stilistik në këtë kuadër është themelor dhe i fortë.⁵ Për këtë arsye, studiuesit e shkencave kurano-re kanë miratuar kapituj që trajtojnë qasjen analitike në kuptimin e teksteve dhe nxjerrjen e vendimeve prej tyre. Sidomos në veprat e tyre, ata kanë folur për metodat e Kuranit, rëndësinë e tij, diversitetin dhe sekretet e thella që ai përmban. Mund të thuhet se stili i Kuranit është metoda unike që e karakterizon në hartimin e fjalës dhe në zgjedhjen e fjalëve të tij.⁶ Ja redaktimi i tekstit tënd, i saktë, pa e shkurtuar, dhe me rrjedhshmëri të mirë gjuhësore. Edhe pse Kurani u shpall në gjuhën e arabëve dhe ndoqi të njëjtat rregulla të tyre në hartimin e fjalëve të tij, ai është më i paimitueshmi prej tyre për shkak të stilit të tij artistik dhe metodës së mrekullueshme të folurit. Edhe në gurra pejgamberike hasim tregime historish me një stil të lehtë, të kuptueshëm, me një ligjërim të shkurtër, përveç rasteve të rralla kur ato janë të gjata. Kjo bëhet vetëm e vetëm që ato të kuptohen sa më mirë dhe të mbahen mend. Duke qenë se është e vështirë të bëhet një studim i tërësishëm rreth këtyre historive, do të mjaftohem duke përmendur vetëm tri prej tyre: E para është historia e atyre tre njerëzve që ngelën të mbyllur në shpellë.⁷ Nëse e shikon me vëmendje, do të gjesh dobi të shumta dhe qëllime të mëdha. E dyta, është historia e engjëllit që shkoi te qerosi, lebrozi dhe i verbri. Kjo është një ngja-

⁵ Mustafa Xhumejde, *Es Salibu El Atfi fi El Kurani El Kerim*, Esh Sherike El Misrije El Amilije li En Neshr, botimi parë, Kajro 1999, f. 2.

⁶ Ali El Xharim & Mutafo Emin, *El Belaga El Vadiha ve Delilu El Vadiha*, Daru El Mearif, Kajro.2008, f. 12.

⁷ Buhariu, 2215.

rje që kërkon të meditosh për dobitë dhe qëllimet që mbart. E treta, është historia e atij njeriu që vrau nëntëdhjetë e nëntë vetë dhe më pas ua shtoi edhe të njëqindtin, me një njeri që adhuronte me përkushtim Zotin. Më pas një njeri i ditur e udhëzoi se si të pendohej, dhe u pendua... Ajo është një histori madhështore dhe me vlera të shumta. Kush dëshiron të mësojë më shumë, le të kthehet te librat ku është trajtuar dhe ku ka komentuar.⁸

Kushtet që duhet t'i plotësojnë shembujt dhe etika që duhet ta përmbajnë, si dhe shembuj nga Kurani dhe Suneti

Shembulli duhet të jetë aktual e të kapet nga shumica e njerëzve dhe jo imagjinar apo diçka që nuk janë në gjendje ta perceptojnë. Të paraqitet me një stil të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshëm për njerëzit. Të ketë një pikësynim të madh dhe një qëllim të qartë.⁹

Kurani përdor një numër termash që janë të lidhur ngushtë me arsyen/intelektin dhe të menduarit. Mes këtyre termave janë **tefekkur**, “të menduarit”, **kalb**, “zemër”, **fu’ad**, “zemër e brendshme”, dhe **lubb**, fjalë për fjalë “farë”, me kuptimin “zemër esenciale”, dhe çdonjëri përkon me një aspekt të ndryshëm të aktit të perceptimit, të mendimit dhe të reflektimit. Gjithashtu ka edhe terma të tjerë, të cilët gjenden brenda së njëjtës sferë semantike të *akl*-it: *ilm*, “dije”, *fehm*, “të kuptuar”, *fikh*, “perceptim/njohje”, *idrak*, “kuptim”, *shu’ur*, “vetëdije”, *burhan*, “demonstrim”, *huxhxhet*, “dëshmi”, *bejjine*, “dëshmi e qartë”, *sultan*, “dëshmi e pa-diskutueshme”, *furkan*, “dallim”, *tedebbur*, “meditim”, *nutk*, “fjalim/meditim”, *hukm*, “grykim”, *hikmet*, “urtësi”, dhe *dhikr*, “përkujtim/lutje”. Përdorimi kuranor i këtyre termave, shtjellimi i plotë i të cilëve kërkon një studim me vete, vë bazën e një konteksti të të menduarit të integruar, në të cilin ndeshja jonë me realitetin zbulon aspekte të ndryshme të realitetit gjithëpërfshirës të ekzistencës. Çfarë është më e rëndësishme, ai

⁸ Buhariu, 3470.

⁹ Adnan Alaraur, *Menhexh Ed Da'vefidev'iel vaki elmuasir*, Khaizetu-l- Naif bin Abdulaziz Al Saud El Alemije li Es Suneti En Nebevijje, ve Dirasat El Islamiye El Muasire, Riad, 2005, f. 216.

çon në një mënyrë të të menduari që bashkon vëzhgimin empirik, analizën racionale, gjykimin moral dhe fisnikërimin shpirtëror. Ky fjalor i pasur vë në dukje plotësinë e të perceptuarit dhe të të menduarit. Në kontrast me dallimet kategorike midis perceptimit ndijor dhe analizës konceptuale, ndeshja jonë natyrore apo e “rendit të parë” me gjërat ndodh si një përvojë e njësishe. Ato kanë një ndikim të madh në transmetimin e mësimave fetare dhe morale, duke prekur zemrat dhe mendjet e njerëzve. Tregimet kuranore janë histori të rëndësishme që gjenden në Kuran dhe shërbejnë për të mësuar dhe udhëzuar besimtarët në parimet dhe mësimet islame. Këto tregime janë të mbushura me mësimet morale, shpirtërore dhe praktike, dhe ofrojnë shembuj të gjallë të besimit dhe sjelljes së duhur. Ato e sqarojnë mirë qëllimin, e tregojnë realitetin dhe e demonstrojnë vërtetësinë e pikësnyimit. Për këtë edhe Allahu, xh.sh., ka përmendur shumë të tilla në Librin e Tij, madje i ka nxitur edhe njerëzit që t’i tregojnë historitë. Po kështu ka vepruar edhe i Dërguari i Zotit në misionin që ka pasur. Allahu thotë:

نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ وَإِنْ كُنْتَ مِنْ قَبْلِهِ لَمِنَ الْغَافِلِينَ

“Ne me të shpallur të këtij Kurani po ta rrëfejmë ty (Muhamed) me të bukurin rrëfim, edhe para tij ishe nga të paimformuarit”. (Jusuf, 3).

فَاقْصُصِ الْقَصَصَ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“...Ti rrëfe tregimet (umetit tënd) në mënyrë që ata të mendojnë. (El Arafë, 176).

وَلَا يَأْتُونَكَ بِمَثَلٍ إِلَّا جِئْنَاكَ بِالْحَقِّ وَأَحْسَنَ تَفْسِيرٍ

“Dhe ata nuk të sjellin ndonjë shembull ty, e që Ne të mos ta tregojmë të vërtetën, duke të ofruar shpjegim të qartë e të plotë”. (El Furkan, 33).

Po ashtu i Larti në një ajet tjetër e ka lajmëruar për ngjarjet e kaluara që kanë ndodhur; pra, për disa e ka informuar Kurani, e për disa jo.

كَذَلِكَ نَقُصُّ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ مَا قَدْ سَبَقَ ۚ وَقَدْ آتَيْنَاكَ مِنْ لَدُنَّا ذِكْرًا مَنْ
أَعْرَضَ عَنْهُ فَإِنَّهُ يَحْمِلُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وِزْرًا خَالِدِينَ فِيهِ ۖ وَسَاءَ لَهُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ حِمْلًا

“Po kështu, Ne të rrëfejmë ty për disa nga ndodhitë që kanë kaluar më herët, dhe nga ana jonë ta dhamë ty shpalljen plot rikujtime. Kush ia kthen shpinën kësaj (shpalljes - Kuranit), ai do të bartë në Ditën e Kiametit barrën më të rëndë. Nën atë do të qëndrojnë përgjithmonë. Sa barrë e keqe është për ta në Ditën e Kiametit!”. (Ta-ha, 101).

Pra, ai që ia kthen shpinën mësimëve kuranore dhe pason libra tjerë ai do të hyj në këtë paraljmërim. Ashtu sic transmetohet edhe në hadithi që transmetohet në musnedin e Tirmidhiut që Aliu, r.a. ka thënë: “*Dhe kush kërkon udhëzim në diçka tjetër përveç tij (Kuranit), Allahu e humb atë*”.¹⁰ Historitë dhe shembujt i japin të shprehurit shije, i dhurojnë ngrohtësi dhe afërsi; ai bëhet i pranueshëm dhe të largon lodhjen e mërzinë. Për këtë, rrallë do të mund të gjesh sure të gjata në Kuran apo edhe në ndonjë të shkurtër, që të mos ketë histori në të. Ka sure të plota apo edhe të tjera të pjesshme që trajtojnë që nga fillimi deri në fund një ngjarje të vetme apo ngjarje të ndryshme, siç janë për shembull surja *Hud, Jusuf, El Kasas, El Enbija...* etj. Po kështu edhe Tradita Pejgamberike nuk qëndron mbrapa në këtë drejtim. Në tregimin e historive dhe dhënien e shembujve, ajo është një det me plot perla të tilla dhe një lumë me ujë të ëmbël, disa prej të cilave do t’i përmendim. Tregimet janë një formë e fuqishme dhe efektive e thirrjes islame (*da’ve*). Ato kanë një ndikim të madh në transmetimin e mësimëve fetare dhe morale, duke prekur zemrat dhe mendjet e njerëzve. Në vazhden e studimit po ashtu me rëndësi është të ceket se një ndër karakteristikat e burimit të tregimeve të myslimanët – Kurani – është elementi i maturisë apo harmonisë ndërmjet asaj që është hyjnore dhe njerëzore, shpirtërore dhe materiale, individuale dhe kolektive etj. Kurani u kushton vëmendje të duhur të gjitha fakteve jetësore dhe të gjitha nevojave të njeriut, dhe vepron me to në atë mënyrë që t’i ndihmojë njeriut

¹⁰ Imam Hafidh imadudin Ebu’l Fida Ismail bin Kethir, Ed Dimeshki, *Kisasa’l kuran*, bot. i V, Darut’ibati ven’nesnari el islamije, Mensure, 1997, f. 294.

t'i kuptojë qëllimet bujare të qenies së tij. Për këtë qasje të maturisë, Kurani i quan myslimanët *popull mesatar*.

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ وَيَكُونَ الرَّسُولُ عَلَيْكُمْ شَهِيدًا

“Disa ashtu (sikur u udhëzuam në fenë islame) Ne ju bëmë një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i Dërguari dëshmitar ndaj jush...” (El Bekare, 143).

Me këtë “mesatari” ata dallohen si njerëzit më të mirë dhe më të zhvilluar të njerëzimit, sepse urdhërojnë të drejtën, luftojnë kundër të keqes dhe i besojnë Zotit. Tregimet kuranore janë histori të rëndësishme që gjenden në Kuran dhe shërbejnë për të mësuar e udhëzuar besimtarët në parimet dhe mësimet islame. Këto tregime janë të mbushura me mësimet morale, shpirtërore e praktike, dhe ofrojnë shembuj të gjallë të besimit dhe sjelljes së drejtë. Në Islam, tregimet përdoren për të mësuar dhe për të frymëzuar, duke ofruar shembuj nga jeta reale që mund të ndiqen e të shërbejnë si modele. Tregimet janë një mjet i fuqishëm për thirrjen islame, sepse krijojnë lidhje emocionale dhe ofrojnë shembuj praktikë të mësimëve dhe vlerave islame. Duke përdorur tregime nga Kurani, hadithet, historia islame dhe përvojat personale, thirrësit mund ta komunikojnë mesazhin e Islamit në mënyrë të kuptueshme dhe të prekshme për të gjithë.

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةً لِأُولِي الْأَلْبَابِ ۚ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ

“Në tregimet e tyre (të të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësimet e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kurani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111)

Kurani është libri i komunikimit të Islamit (da've) dhe kushtetuta e tij; ai duhet të vazhdojë gjithmonë të jetë burimi kryesor për thirrjen islame

dhe për thirrësit në çdo kohë.¹¹ Po ashtu, tregimi kuranor frymëzon predikuesin dhe e mbush me energji devotshmërie, trimërie e durimi; i sqaron atij parimet e thirrjes islame dhe format që kanë përdorur pejgamberët; gjithashtu ia qartëson natyrën e njerëzve dhe orientimet e tyre. Në çdo tregim kuranor synohet pasqyrimi i realitetit dhe i ngjarjeve nga jeta e tyre. Tregimet kuranore, po ashtu, mbeten forma të predikimit të Daves, krahas atyre të ligjërimit, përgëzimit dhe frikësimit në misionin e thirrjes islame.¹² Po ashtu, jo vetëm nga bota njerëzore, por edhe nga ajo shtazore, Kurani ka rrëfyer ngjarje të cilat janë të regjistruara në të dhe që sot paraqesin sfida për shkencën dhe dijen njerëzore: si kanë mundur pejgamberët të komunikojnë me kafshët dhe shpezët? Madje, libra të tërë janë shkruar për tregimet e kafshëve, si p.sh. ai i autorit Ahmed Behxhet. Sa e mahnitshme është të ulesh e të flasësh me një pupëz, ta urdhërosh atë dhe ta shohësh duke treguar bindjen e saj; të bësh një diskutim me të dhe ta dëgjosh; të buzëqeshësh nga fjalët e një milingone teksa paralajmëron pjesën tjetër të milingonave për njeriun. Kjo aftësi të trullos mendjen dhe zemrën nga habia. Sidoqoftë, edhe pse Sulejmani dhe Davudi, a.s., kanë vdekur, arti do të zgjasë deri sa të ketë jetë mbi sipërfaqen e tokës. Arti mund të jetë gjuha me të cilën përshkruajmë jetën e atyre kafshëve që ishin në shoqërinë dhe shërbimin e pejgamberëve.¹³

¹¹ Ahmed Galvesh, *Ed Da'vetu el islamije usuluha ve vesailuha*, Daru'l kitab el misri, Kajro, 1978, f. 328.

¹² Muhamed Jusuf, *Ed Da'veetu el islamijeti el vesailu ve'l esalibu*, Metabiu'l ferdhedk, Riad, bot. 1, 1987, f. 87.

¹³ Ahmet Behxhet, *Tregimet e kafshëve në Kuran*, përktheu Enes Koshi, Dituria islame, BIK, Prishtinë, 2024, f. 12.

Kushtet që duhet të plotësojë historia: shembuj për këtë nga Kurani dhe tradita pejgamberike

Pa dyshim se, si historitë, ashtu edhe shembujt duhet t'i plotësojnë disa kushte dhe kritere. Këtu do t'i përmendim më të rëndësishmet.

Historia duhet të jetë e vërtetë, shprehëse, me kuptime gjurmëlënëse dhe që pasqyron qartazi gjallërinë e saj.

- Të mos jetë aq e shkurtër sa të mbetet e mangët në pasqyrimin e qëllimit, por as aq e gjatë sa të bëhet e mërzitshme.
- Historitë nuk duhet të dominojnë ligjërimin e thirrësit, duke lënë mënjane plotësisht apo pjesërisht ajetet dhe hadithet. Thirrësi nuk duhet të shndërrohet në një tregimtar që nuk mendon përveçse për historitë.
- Të përmbajë elemente dije-formuese, stimulim drejt qëllimit dhe dobi të qarta. Ai që i lexon me vëmendje historitë në Kuranin famëlartë, i sheh të trupëzuara qartë këto gjëra, si për shembull:

Jusufi u tha vëllezërve të tij:

قَالُوا إِنَّكَ لَأَنْتَ يُوسُفُ ۖ قَالَ أَنَا يُوسُفُ وَهَذَا أَخِي ۖ قَدْ مَنَّ اللَّهُ عَلَيْنَا ۖ إِنَّهُ مَن يَتَّقِ وَيَصْبِرْ فَإِنَّ اللَّهَ لَا يُضِيعُ أَجْرَ الْمُحْسِنِينَ

Ata thanë: “A ti je vetë Jusufi?” Ai tha: “Unë jam Jusufi, e ky është vëllai im, Allahu na dhuroi shpëtim, pse ai që ruhet dhe bën durim, s’ka dyshim se Allahu nuk e humb shpërblimin e punëmirëve”. (Jusuf, 90).

Apo, kur iu drejtua atyre me të cilët ishte në burg:

يَا صَاحِبِي السِّجْنِ أَرَبَابٌ مُّتَفَرِّقُونَ خَيْرٌ أَمِ اللَّهُ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ مَا تَعْبُدُونَ مِن دُونِهِ إِلَّا أَسْمَاءٌ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَآبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِن سُلْطَانٍ ۚ إِنِ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ ۚ أَمَرَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ ۚ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm, apo Allahu, i Vetmi Ngadhënjimtar?” Ata që adhuroni, përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që i pagëzuat ju dhe prindërit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta, vendimi

(në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, përveç Allahut, e Ai urdhëroi mos të adhuroni tjetër, por vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, mrëpo shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Jusuf, 39-40).

Apo edhe ajeti tjetër që argumenton një gjë të tillë:

إِنِ الْحُكْمُ إِلَّا لِلَّهِ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَعَلَيْهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُتَوَكِّلُونَ

“...Vendimi nuk është i tjetërkujt, vetëm i Allahut; vetëm Atij i jam mbështetur, dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që besuan.” (Jusuf, 67).

Përse përsëriten tregimet kuranore?

Përsëritja në tregimet kuranore është një fenomen i qartë, që bie në sy dhe ngjall shumë pyetje e hulumtime. Në përgjithësi, përsëritja në këto tregime nuk është bërë kot, pa ndonjë qëllim, por ka ardhur për arsye të caktuara e të qëllimshme. Ibën Xhema’a, në librin e tij **El Muktenas fi fevaïd tekâr el kasas**, përmend disa përfitime nga përsëritja e tregimeve: Ndër këto përfitime është edhe fakti se në çdo rast ka një shtesë diçkaje që nuk është përmendur në tregimin e mëparshëm, ose një zëvendësim të një fjale me një tjetër për një qëllim të caktuar; kjo është zakoni i oratorëve. Zerkeshiu e ka detajuar këtë pikë duke thënë: *“Një tregim... edhe nëse duket se nuk ndryshon nga tjetri, mund të gjendet në fjalët e tij një shtesë dhe mungesë, renditje dhe vonesë, dhe këto janë rastet e kuptimit sipas atyre fjalëve, pasi çdo njëra duhet të ndryshojë nga tjetra për një kuptim të shtuar, që nuk mund të zbulohet përveçse nga ajo vetë.”* Kjo do të thotë që çdoherë që paraqitet tregimi, zbulohet një aspekt i tij, ose paraqitet një imazh, apo plotësohet një ngjarje.

Një tjetër përfitim është se paraqitja e të njëjtës fjali në shumë stile dhe forma të ndryshme nuk e zbeh elokuencën. Imam Bakilani e shpreh këtë përfitim në librin e tij *Ixhaz el-Kuran* duke thënë: *“Rikthimi i të njëjtit tregim me fjalë të ndryshme, që sjellin të njëjtin kuptim, është një gjë e vështirë ku shfaqet elokuenca dhe retorika.”* Me këtë, ai dëshiron të thotë se paraqitja e të njëjtës temë me stile të ndryshme, pa ndryshuar karakteristikat e saj dhe pa dobësuar stilin e saj të paraqitjes, është e vështirë dhe mund të realizohet vetëm nga ata që kanë aftësi të veçanta retorike

dhe elokumente. Ai gjithashtu thotë në këtë kontekst: *“Shumë nga tregimet janë përsëritur në vende të ndryshme, me renditje të ndryshme, dhe me këtë i është bërë e qartë arabëve për paaftësinë e tyre për të sjellë diçka të ngjashme, qoftë ajo e re apo e përsëritur.”*

Me këtë ai dëshiron të theksojë se një nga format e sfidës që arabët nuk mundën ta përballonin në lidhje me Kuranin ishte paraqitja e tregimeve kuranore në mënyra të ndryshme, të gjata dhe të shkurtra, duke zgjeruar kështu fushën e sfidës për ta, por përfundoi vetëm me paaftësi. Ibën Faris ka saktësuar këtë pohim në lidhje me arsyen e përsëritjes së tregimeve kuranore. Një tjetër përfitim është gjithashtu fakti se shpirtrat janë të prirur për të dashur ndryshimin dhe larminë, dhe ndiejnë mërzë nga ajo që përsëritet dhe ripërsëritet në të njëjtën formë dhe mënyrë. Kuranit ka marrë parasysh këtë aspekt të natyrës njerëzore dhe ka diversifikuar stilin e paraqitjes së këtyre tregimeve, në mënyrë që shpirtrat të mos ndiejnë mërzë nga përsëritja dhe të mos lodhen prej saj. Profesori Muhamed Kutb thotë: *“Fenomeni i vërtetë nuk është përsëritja, por larmia. Nuk ka dy tekste të njëjta në të gjithë Kuranin; ekziston vetëm ngjashmëri pa qenë identike. Është një ngjashmëri si ajo që ekziston midis vëllezërve dhe motrave dhe të afërmeve, por në asnjë mënyrë nuk është përsëritje. Është si frutat e Xhenetit: ‘Sa herë që u jepet një fryt prej tij, ata thonë: ‘Kjo është ajo që na është dhënë më parë’, por u jepet atyre ngjashëm.’ Kur e shijojnë frutin për herë të parë, ata thonë: ‘Kjo është ajo që na është dhënë më parë.’ Megjithatë, kur e shijojnë, kuptojnë se është ndryshe, e ngjashme, por jo identike. Kjo larmi në vetvete është një bukuri, përtej thjeshtë çlirimit të shpirtit nga monotonia.”¹⁴*

Ai në vazhdim thekson se përsëritja është një stil retorik i lartë dhe një formë e bukur e të folurit retorik. Vlerësimi i përsëritjes si pozitiv apo negativ varet nga vetë folësi; nëse ai e përdor atë me mjeshtëri, është e mirë, por nëse dështon në përdorimin e saj, bëhet e pashije. Po ashtu, ajo është përdorur nga arabët edhe para zbritjes së Kuranit. Nuk duhet të kërkojmë falje për përsëritjen në Kuran, pasi përsëritja në Kuran nuk është

¹⁴ Muhamed Kutb, *Dirasat kuranije*, botim i dytë, Darushuruk, Bejrut, 1980, f. 255.

diçka për t'u kritikuar, sepse është paraqitur në formën më të lartë dhe më të bukur, pasi është zbritur në një gjuhë arabe të qartë.

Përsëritja mund të jetë e lavdërueshme ose e kritikueshme. Përsëritja në Kuran ekziston, por është në formën e saj më të mirë dhe në shprehjen më të lartë, sa që është bërë një nga aspektet e mrekullisë së tij, prandaj dijetarët janë unanimë se nuk ka përsëritje të kritikueshme në Kuran. Për-pjekjet e dijetarëve të moderuar vazhdojnë në sqarimin e çështjes së përsëritjes, duke treguar se dyshimi mbi “përsëritjen” është i lashtë sa prishja e shijes arabe, dhe është një çështje që përsëritet nga armiqtë – nga zilia - herë pas here. Në këtë aspekt, ka përfitime të mëdha nga ana fetare: ajo forcon konceptet e drejta; dhe nga ana letrare: ajo pasuron shprehjet kur-anore dhe u jep atyre madhështi dhe bukuri. Edukimi, që është një nga qëllimet më të rëndësishme të Kuranit, kërkon përsëritje dhe ripërsëritje, dhe ata që merren me procesin e edukimit në çdo nivel e kuptojnë rëndësinë e përsëritjes. Kurani ka përdorur përsëritjen në mënyrë të tillë që lexuesi të ndiejë se është origjinal dhe i ri në të gjitha temat e tij, pa përsëritje. Sikurse, përsëritja në Kuran përfshin të gjitha format dhe qëllimet e përsëritjes që janë identifikuar nga gjuhëtarët dhe retorikët.¹⁵

Ndërsa studiuesi tjetër i Kuranit, Muhamed Mabel, ndan mendimin se ka disa qëllime dhe mësimet të fshehura në përsëritjen e disa historive dhe ngjarjeve në Kuranin e Shenjtë. Kjo përsëritje shërben për të zbuluar madhësitinë dhe bukurinë e fjalës së tij në mënyrë të shkëlqyer dhe në një stil që mahnit mendjet. Përmendja e një historie të njëjtë në më shumë se një vend dhe në kontekste të ndryshme ndihmon lexuesin të zbulojë shumë mësimet dhe kuptime të reja, të cilat rinovojnë vullnetin dhe frymën për të lexuar ajetet e Kuranit.¹⁶ Shpërndarja e mesazhit të Islamit dhe përcjellja e tij tek numri më i madh i adhuruesve është arsyeja pse Kurani i Shenjtë u shpall në fragmente të shpërndara dhe në stile të ndryshme: herë si pasqyrim i frikës dhe kërcënimit për njerëzit, për atë që u ndodhi popujve të tjerë kur refuzuan të ndjekin të vërtetën dhe e luftuan atë; e

¹⁵ Muhamed Kutb, Ibid.f. 56.

¹⁶ Muhamed Mabel, *Nefehat fi ulumi'l kuran*, botim i dytë, Daru'selam, Kajro, 2005, f. 108.

herë si ndihmë dhe inkurajim për ata që arritën të ndjekin rrugën e vërtetësisë dhe të mirësisë. Islami nuk iu kufizua vetëm umetit të Muhamedit (paqja qoftë mbi të), por iu shpall të gjithë njerëzve.¹⁷ Mëshira dhe vendosmëria e peygamberit Muhamed, a.s., në mbajtjen e mesazhit të Islamit theksohet në Kuran fisnik, ku Zoti i Lartë thotë në lidhje me këtë temë:

وَكَلَّا نَقْصُ عَلَيْكَ مِنْ أَنْبَاءِ الرُّسُلِ مَا نُثَبِّتُ بِهِ فُؤَادَكَ وَجَاءَكَ فِي هَذِهِ الْحَقُّ
وَمَوْعِظَةٌ وَذِكْرَى لِلْمُؤْمِنِينَ

“Të gjitha këto që t’i rrëfyem ty nga lajmet e peygamberëve, janë që të ta forcojnë zemrën tënde, dhe në to ka ardhur e vërteta e kështilla, si dhe përkujtime për besimtarët.” (Hud, 120).

Historitë kuranore tregojnë se çfarë ballafaqimesh kishin peygamberët e mëparshëm të Allahut me popujt e tyre, pasojat për ata që iu kundërvunë atyre, si edhe mbështetjen dhe fitoren që Allahu u dha dërguarve të Tij dhe atyre që i mbështetën e besuan në ta nga mesi i adhuresve. Këto histori gjithashtu përcjellin një mesazh për ata që largohen nga feja e Allahut dhe ligji i Tij, duke i paralajmëruar të mos ndjekin rrugën e tyre.¹⁸ Përcaktohet në mënyrë të saktë dhe të vërtetë për të nxjerrë mësim dhe për të siguruar zemrën e Peygamberit, a.s., siç u përmend më parë. Prandaj, asnjë histori e plotë e peygamberëve nuk përmendet në ndonjë vend tjetër të Kuranit, përveç historisë së Jusufit, a.s., në suren që mban emrin e tij.¹⁹ Sa për ilustrim, në vazhdim po e përmendim stilin e ligjërrimit të Kuranit për parimin e këshillimit.

¹⁷ Sulejman Tufej, El intisarar el islamiye fi keshfi shibhi’nesraniye, botim i parë, Mektebetu ubejkan, Riad, 2000, v. 2, f. 592.

¹⁸ Abduladhim al-Mut’ani, Karakteristikat e shprehjes kuranore dhe veçoritë e saj retorike, botim i parë, Mektebetu Vehbe, Egjipt, 1992, v. 1, f. 333.

¹⁹ Muhamed Shaaravi, Tefsiru’sharavi, Metabi ahbaru’l jevm, Egjipt, 1997, v. 11, f. 6833.

Këshillimi si formë e tregimeve kuranore

Kultura e këshillimit nënkupton gjithashtu promovimin e gjerë të praktikës këshilluese në të gjitha fushat e shoqërisë, në mënyrë që njerëzit të përjetojnë procesin këshillues, të trajnohen në të dhe të kuptojnë përfitimet që sjell. Në fund të fundit, këshillimi nuk është ekskluzivisht për krerët e shteteve dhe liderët e tjerë, as nuk është vetëm për qëllimin e zgjedhjes së kalifit ose trajtimit të situatave të luftës apo çështjeve politike. Përkundrazi, kjo është një mënyrë jetese, një mënyrë e të menduarit, e planifikimit dhe një model që lidhet me të tjerët. Askush nuk mund t'ia dalë pa këshillim, qoftë nëse shqetësimi i tij është i madh apo i vogël, apo nëse dija e tij është e madhe apo e kufizuar. Nëse ka pasur ndonjëherë një njeri që mund t'ia dilte pa këshillim, do të kishte qenë më i miri i gjithë njerëzimit, i Dërguari i Zotit. Megjithatë, ishte po ky i Dërguar i Zotit që u këshillua me të tjerët për shqetësimet kryesore dhe për ato të vogla, për çështjet publike dhe ato private, për materialen dhe shpirtëroren. Këshillimi lartëson individin në një nivel të ri, në menaxhimin e punëve të tij, duke bërë të mundur që ai t'i shërbejë interesave të tij dhe të tjerëve në masën maksimale, për të minimizuar dëmin ndaj vetes dhe të tjerëve, për të pastruar veten dhe për të zhvilluar intelektin e tij. Këshillimi siguron një mjet për të udhëzuar dhe korrigjuar marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave, midis prindërve dhe fëmijëve. Si i tillë, ai përforcon marrëdhëniet intime përmes dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, duke na ndihmuar të shmangim vendimet e njëanshme, së bashku me ankthet dhe pakënaqësitë që mund të shkaktojnë. Në mënyrë të ngjashme, ai na kursen llojin e kuptimit të shtrembëruar, që e kthen mbikëqyrjen e burrave për gratë në thjesht autoritarizëm, pa thënë detyrim, duke e lejuar atë të bëhet kujdestari i këshillimit, mirëkuptimit të ndërsjellë, pëlqimit dhe bashkëpunimit të përbashkët. Nëse lloji i këshillimit të urdhëruar nga Kurani dhe i modeluar në jetën e Pejgamberit është i zbatueshëm për jetën e individëve, bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, atëherë ai është edhe më i zbatueshëm për interesat publike dhe çështjet me interes të përbashkët. Një nga arenat publike që duhet të marrë rolin udhëheqës në

përhapjen e kulturës dhe praktikës së këshillimit është ajo e organizimit komunal ndaj jomyslimanëve.²⁰

Disa mund të neglizhojnë çështje të rëndësishme, prandaj historitë shfaqen në më shumë vende dhe sure, duke theksuar disa çështje të cilat duhet të kthehet vëmendja dhe të priorizohen. Kjo do të thotë që myslimanët janë të prirë t'i dëgjojnë ato, t'i lexojnë dhe t'i përsërisin ato. Allahu i Madhëruar thotë:

وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنَ الْأَنْبَاءِ مَا فِيهِ مُزْدَجَرٌ حِكْمَةٌ بِالْغَلَّةِ ۖ فَمَا تُغْنِ التُّذْرُ

“Atyre u patën ardhur aso lajmesh (të popujve të lashtë), ku ka mjaft qortime, (për ata që kuptojnë). Urtësi e përsosur (është Kurani)! Po sa bëjnë dobi qortimet! (Junus, 4-5).

Prandaj, çdo përmendje në Kuran ka disa mësimet të rëndësishme për jetën e myslimanëve. Transmetimi i kuptimeve me shprehje më të saktë dhe përshkrime të ndryshme të të njëjtës histori është thelbi i efektit që del nga përsëritjet.

Ndërtimet stilistike unike kuranore

Ndërtimet unike kuranore që nuk përsëriten, janë me shumicë dhe mund të identifikojmë me lehtësi një numër syresh, në secilën faqe të Kuranit. Për t'u siguruar se përfundimet tona janë objektive dhe gjithëpërfshirëse, jo subjektive dhe përzgjedhëse, do të sjellim si shembull faqen e parë të plotë të Kuranit, që përfshin ajetet 6-16 të sures El Bekare. Ky shembull i vogël mjafton për të bërë të qartë, se sa të shumta dhe të larmishme janë këto ndërtimet e shprehjeve. Vetëm në këtë faqe gjejmë 23 ndërtimet unike, secila me një strukturë të veçantë, që e dallon dhe veçon, jo vetëm prej ndërtimit të poezisë e prozës arabe, të haditheve pejgamberike, por edhe nga ato që ndeshen në të njëjtën faqe të Kuranit. Do të shohim se, përveç ndikimeve kuranore në gjuhën arabe në tërësi dhe tërheqjes që ajo ushtron mbi shkrimtarët arabë gjatë shekujve, për shkak të stilit elegant e të përpunuar, pjesa më e madhe e këtyre ndërtimeve dhe

²⁰ Ahmed Rajsuni, *The Qur'anic Principle of Consultation*, The International Institute of Islamic Thought, Herndon, USA, 2012, f. 201-211.

shprehjeve kanë mbetur unike vetëm për Kuranin. Për pasojë, janë të dallueshme nga çdo lloj shprehjeje gjuhësore njerëzore. Një dukuri të tillë të ngjashme nuk e gjejmë në asnjë gjuhë letrare tjetër në botë, përgjatë shekujve. Veçantia që manifestohet në nivelet e modeleve kuranore dhe të fjalëve të veçanta, njëherazi në marrëdhënien mes fjalëve, ndërtimeve dhe shprehjeve, shërben për të krijuar një gjuhë të dallueshme, që edhe një lexues i zakonshëm nuk do ta ngatërronte me stilet njerëzore. Nuk janë vetëm termat e veçanta kuranore që na bëjnë të mundur të gjejmë dallimet mes shprehjeve kuranore dhe shprehjeve të thjeshta njerëzore. As strukturat mbi të cilat ndërtohet gjuha kuranore, apo ritmi i tyre; as figurat e reja letrare kuranore që aq shumë na mahnitin; as mesazhet e tij të mbushura me frymëzim hyjnor, me urtësi, solemnitet, forcë tërheqëse, me jokohësinë e tyre dhe me aftësinë për t'u ngritur mbi çdo mesazh njerëzor. As ligjërimi i dallueshëm qiellor që është kaq plotësisht zotërues, i sigurt, mjeshtëror, i mbushur me dije, bindës dhe ekzaltues mbi çdo shpirt të dobët njerëzor. Cilësia dalluese e tekstit kuranor shkon përtej gjithë kësaj, me mënyrën se si të gjitha këto bëhen bashkë, nëpër njësitë dhe modelet gjuhësore që, edhe po t'i bashkosh me mijëra shprehje e fraza gjuhësore, sërish mund të dallohen qartësisht dhe pagabueshëm, se janë kuranore.²¹

Karakteristikat e tregimeve të Kuranit

Tregimet e Kuranit karakterizohen nga disa aspekte të ndryshme nga tregimet e tjera, dhe më poshtë i përmendim disa prej tyre:

- a. Tregojnë elokuencën e Kuranit dhe përshkrimin e saktë e të detajuar të ngjarjeve.
- b. Shprehin gjendjen përfundimtare të popujve të mëparshëm, qoftë në udhëzimin apo ndëshkimin e tyre.

Stili i tregimit në Kuranin e shenjtë e realizon këtë, siç thotë Allahu i Lartë:

²¹ Besam Saih, *The Miraculous Language of the Qur'an: Evidence of Divine Origin*, The International Institute of Islamic Thought, Herndon, 2015, f. 49-50,

لَقَدْ كَانَ فِي قَصَصِهِمْ عِبْرَةٌ لِأُولِي الْأَلْبَابِ ۚ مَا كَانَ حَدِيثًا يُفْتَرَىٰ وَلَكِن تَصْدِيقَ
الَّذِي بَيْنَ يَدَيْهِ وَتَفْصِيلَ كُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ

“Ne tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësimet e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kurani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj që ishte më parë (librave të shenjta) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson.” (Jusuf, 111).

Këto tregime nuk janë përmendur në Kuran për argëtim, tregim apo vetëm për t’i njohur ngjarjet e mëparshme.

- Tregimet kuranore përmbajnë të gjitha elementet e ndërtimit të një tregimi, dhe ngjarjet e tyre janë reale, larg nga teprimi, gënjeshttrat dhe le gjendat. Allahu i Lartë i përshkruan ato si të vërteta. Ai, xh.sh., thotë:

إِنَّ هَذَا هُوَ الْقَصَصُ الْحَقُّ وَمَا مِنْ إِلَهٍ إِلَّا اللَّهُ وَإِنَّ اللَّهَ هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

“S’ka dyshim se ky është lajm i vërtetë. Nuk ka asnjë të adhuruar tjetër përveç Allahut. Allahu është Ai, i Plotfuqishmi, i Vetëdituri!” (Ali Imran, 62).

Përveç kësaj, temat e tregimeve janë të qëllimshme dhe të qarta, ashtu që ndikojnë te myslimani nga shumë aspekte, si dhe nxisin mendimin e tij për të kërkuar dhe mësuar më shumë. Allahu, xh.sh., thotë:

فَاقْصُصِ الْقَصَصَ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“... Ti rrëfeji tregimet (umetit tënd) në mënyrë që ata të mendojnë!” (El Arafë, 176).

Reflektimi mbi kuptimet e tregimit dhe rezultatet e tij ka një ndikim të fuqishëm në shpirt e zemër; prandaj, pas këtij reflektimi, myslimani synon të përmbahet besnik ndaj besimit të tij dhe të përpiqet të kryejë vepra të mira.²²

- Përmendja e tregimeve të Kuranit është bërë në formë të shkurtër, për t’u përdorur si dëshmi dhe argument; ato nuk janë përmendur në shumë

²² Ebu’l Mexhd Sejjid Navfal, *Esalibu’daveti ilall’Ilah fi’lkurani’l kerimi*, Revista e Universitetit Islamik, nr.52, f. 108.

vende në mënyrë të plotë, për të qenë në harmoni me idenë e përgjithshme të sures.²³

- Tregimet e Kuranit dallohen për stilin e tyre tërheqës, i cili tërheq lexuesin për të vazhduar leximin, për të njohur detajet, për t'u ndikuar nga ngjarjet dhe për të ndërvepruar me qëllimin kryesor të tyre. Ky ndikim synon të realizojë një qëllim që Allahu i Lartë ka dashur; prandaj, përmendet një pjesë specifike e tregimit që të mbetet në mendjen dhe shpirtin e lexuesit të Kuranit, duke shmangur fokusimin në elemente të tepërta dhe të parëndësishme që mund të shpërqendrojnë vëmendjen e lexuesit nga kuptimi i qëllimit të synuar.²⁴
- Tregimet e Kuranit trajtojnë disa aspekte, ndër më të rëndësishmit qëndron aspekti fetar, duke thelluar konceptet dhe urdhrat islame që Allahu ka synuar për të gjithë besimtarët, të cilët i zbatojnë ato me plot bindje dhe pajtueshmëri.²⁵

Përfundim

Stili kuranor është një stil i mrekullueshëm dhe i veçantë, që dallon nga të gjitha stilet e tjera arabe, dhe nuk do të gjendet kurrë në kohët e ardhshme një stil që mund t'i afrohet apo krahasohet me të. Kurani përmban sekrete të ndryshme estetike në stilin e tregimeve të tij. Mrekullitë e Kuranit konfirmohen përmes stileve të tij kuranore, dhe historia e Sulejmanit, a.s., në Kuran ka zbuluar vlerat edukative, të pandashme nga qëllimi edukativ, fetar dhe letrar. Kurani përmban mrekulli nga ana e elokuencës. Historitë dhe rrëfimet në Kuran nuk janë vetëm tregime të thjeshta, por mësimet morale dhe shpirtërore që synojnë të udhëzojnë dhe të frymëzojnë besimtarët. Stili i tij është i gjallë, shpesh duke përdorur dia-

²³ Nurudin Itri, *Ulumu'l kurani'l kerim*, bot. i parë, Metabius'sabah, Damask, 1993, f. 247.

²⁴ Muhamed Nebhan, *El med'hal ila ulumi'l kurani'l kerim*, bot. i parë, Dar alemi'l kuran, Haleb, 2005, f. 255.

²⁵ Abduselam Ragib, *Vedhifetu's sureti'l fennije fi El Kuran*, bot. i parë, Haleb, 2001, f. 260.

logë dramatikë dhe përshkrime të detajuara për të theksuar mesazhet. Stilistika e Kuranit në paraqitjen e historive, rrëfimeve dhe të vërtetave është e veçantë dhe komplekse. Ajo kombinon narracionin, poezinë dhe prozën në një mënyrë të tillë që ngjall reflektim dhe emocion tek lexuesi. Kurani përdor një gjuhë të pasur dhe të fuqishme, të mbushur me metafora, analogji dhe simbole për të përcjellë mesazhet e tij. Në përgjithësi, stilistika e Kuranit është një ndërthurje e mrekullueshme e artit dhe shpalljes hyjnore, e cila vazhdon të ndikojë dhe të udhëzojë miliona njerëz në të gjithë botën. Mrekullia e Kuranit shfaqet në stilin dhe strukturën e tij. Thelbi i stilit gjuhësor në Kuran rrjedh nga lidhja e ngushtë midis fjalës dhe kuptimit.

Asst. Prof. Dr. Rexhep SUMA

THE STYLISTICS OF THE QUR'AN IN PRESENTING HISTORIES, STORIES, AND TRUTHS

Abstract

The Qur'an employs various distinctive methods to present divine truths and messages. These methods are not only educational but also aim to spiritually and intellectually influence the reader or listener. One of the most beautiful ways that Allah has commanded to be used in calling people and in religious preaching is the telling of stories and truths, as well as the giving of examples. Important histories and clear examples attract attention, leave an impression on the soul and aid understanding. Stories (*al-qasas*) are a powerful and effective form of *da'wah*.

By examining the purpose of narration in the Qur'an, what stands out is the affirmation of the Oneness of the Creator, the Oneness of religion, the Oneness of the prophets, the Oneness of the methods of *da'wah*, and the Oneness of the consequences that deniers will face. The stylistics of the Qur'an holds particular importance in the interpretation of God's Book, as a commentator cannot grasp its structural and linguistic semantics without deeply understanding the meaning of its words and structures. The stylistics of the Qur'an in presenting histories, stories, and truths is unique and complex. It combines narration, poetry, and prose in a way that evokes reflection and emotion in the reader. The Qur'an employs rich and powerful language, filled with metaphors, analogies, and symbols, to convey its messages.

Keywords: *Stylistics of the Qur'an, story, structure, history, education.*

III. KULTURË / TRASHËGIMI

Dr. Ferid PIKU

ABEDIN PASHË DINO, SI KOMENTUES I KURANIT FAMËLARTË SIPAS MËNYRËS SË TEFSIRIT SHOQËROR

Abstrakt

Abedin Pasha nga Preveza, me origjinë shqiptare, ka qenë një burrë shteti i rëndësishëm gjatë periudhës së Sulltan Abdylhamidit II. Përveç detyrave të tij politike dhe administrative, ai ka shkruar shumë vepra fetare dhe letrare. Në punimet e tij të shkruara, bazuar në përvojat personale, duket qartë se është marrë edhe me çështjet fetare dhe gjendjen e shoqërisë myslimane të asaj kohe.

Ndër këto vepra, veçanërisht bie në sy “Meâli-i İslâmiyye”, në të cilën disa ajete të zgjedhura kuranore janë komentuar nga një këndvështrim sociologjik. Në këtë vepër, Abedin Pasha fillimisht jep përkthimin e disa ajeteve të zgjedhura nga sure të ndryshme, dhe më pas i komenton ato në një mënyrë që mund të konsiderohet si një nga shembujt e parë të qasjes së tefsirit shoqëror.

Përveçse ishte një burrë shteti që kuptonte mirë problemet aktuale të shoqërisë, Abedin Pasha kërkonte zgjidhje për këto probleme në dritën e ajeteve kuranore. Prandaj, qëllimi i këtij studimi është të zbulojë identitetin e këtij personaliteti si komentues i Kuranit dhe të përcaktojë nëse Abedin Pasha mund të konsiderohet si një ndër pararendësit e qasjes së tefsirit sociologjik.

Për këtë qëllim janë shqyrtuar dhe analizuar problemet që ai trajton në veprën “Meâli-i İslâmiyye” dhe zgjidhjet që ofron. Duke marrë parasysh shpjegimet që i ka dhënë ajeteve dhe propozimet që ka paraqitur, mund të kuptohet se Abedin Pasha ka qenë një

nga autorët e parë që demonstroi qasjen e tefsirit shoqëror në kup-
timin e ajeteve.

Fjalët çelës: komentues osmanë, tefsir shoqëror, komentet e she-
kullit XIX, *Meâli-i İslâmiyye*.

HYRJE

Shekulli XIX ishte një periudhë e ndjeshme dhe e vështirë për myslimanët, veçanërisht për Perandorinë Osmane. Nga njëra anë, pushteti politik dhe forca ushtarake e osmanëve ishin dobësuar, ndërsa nga ana tjetër, shoqëria kishte pësuar rënie në aspektin shoqëror, fetar, shkencor, intelektual dhe moral. Në këtë periudhë, shumë dijetarë dhe mendimtarë shkruan vepra që synonin të jepnin përgjigje se si myslimanët duhet të përballeshin me këtë gjendje dhe si mund të dilnin prej saj.

Një nga figurat e rëndësishme që kërkonte zgjidhje për këto probleme ishte Abedin Pasha, i njohur jo vetëm si burrë shteti, por edhe për thellësinë e tij në shkencat islame dhe mendimin intelektual. Ndër veprat e tij, libri me titull *Meâli-i İslâmiyye* zë një vend të veçantë për nga informacioni, përvojat dhe propozimet që ofron në lidhje me problemet shoqërore.

Pavarësisht nga detyrat zyrtare në administratën shtetërore, lidhjet e Abedin Pashës me botën akademike dhe përpjekjet e tij të palodhura për të shkruar vepra dëshmojnë për interesin dhe pasionin e tij për dijen. Edukimi i tij i thellë dhe identiteti i kombinuar si dijetar dhe administrator shtetëror përbëjnë një bazë të fortë për studimin e tij. Falë funksioneve që mbante, Abedin Pasha kishte mundësinë të vëzhgonte nga afër problemet shoqërore dhe, si rrjedhojë, të propozonte zgjidhje efektive rreth tyre në dritën e Kuranit dhe Islamit.

Në veprën *Meâli-i İslâmiyye*, ai ka përzgjedhur ajete nga sure të ndryshme, të cilave u ka dhënë përkthimin në turqisht dhe më pas u ka shtuar komentimin e tyre. Në këtë komentim, ai ka trajtuar çështje të tilla si: korrupsioni, ryshfeti, neglizhenca në përmbushjen e detyrave dhe probleme të tjera themelore shoqërore, duke përdorur një stil të qartë për masat dhe një gjuhë mjeshtërore. Po ashtu, ka diskutuar edhe debate aktuale të asaj kohe, si p.sh.: konceptet e durimit dhe të xhihadit në jetën e përditshme;

arsyet pse të huajt kishin përparuar e pse myslimanët kishin mbetur pas; zbulimet e fundit të shkencës bashkëkohore dhe raportin e tyre me Islam-in dhe ajetet kuranore etj. Në komentet e tij, ai ka përdorur shembuj praktikë nga jeta e përditshme e individit dhe shoqërisë, duke u shtuar kështu një vlerë shpjegimeve të tij

1. Jeta dhe veprat e Abedin Pashës

Abedin Pasha ishte një prej figurave të rëndësishme të administratës osmane gjatë periudhës së Sulltan Abdylhamidit II. Ai shërbeu si vali (guvernator) në provinca të rëndësishme, si Sivas, Selanik, Adana dhe Ankara. Njihet gjithashtu me emrin Abidin Dino.

Ai ka lindur më 5 mars 1843 (5 Rebiulevvel 1259 sipas kalendarit hixhri) në qytetin Prevezë, që sot ndodhet në kufijtë e Greqisë. Babai i tij, Zenelabedin Efendiu, ishte me origjinë nga shqiptarët e Çamërisë, me prejardhje nga Filati dhe i vendosur në Prevezë, ndërsa nëna e tij, Saliha Hanëmi, vinte nga fisi Çapar i Margëllicit.

Abedin Pasha mori një arsimim shumë të mirë në vendlindjen e tij. Fillimisht mori mësim nga një hoxhë privat, më pas studioi në shkollën “Kaleiçi Mektebi” në Prevezë, pastaj në një nga medresetë lokale dhe në fund në kolegjin grek “Zosimea” në Janinë. Ai gjithashtu mori leksione letërsie nga Osman Efendiu i Prevezës. Gjatë arsimimit të tij mësoi gjuhët arabe, perse, greke dhe frënge, si dhe studioi lëndë, si: matematika, gjeografia dhe kozmografia¹.

Në vitin 1863 (1279 H), shkoi në Stamboll dhe filloi karrierën në shërbim të shtetit si rojë personale e Sulltan Abdylazizit. Më pas mbajti poste si ndihmës i mytesarifit të Prevezës dhe të Nartës, kajmekam në qendër dhe në fund edhe si mytesarif po atje. Në vijim shërbeu si kryetar i Gjykatës së Apelit në Izmir, kryetar i Komisionit Juridik, mytesarif në Tekirdag dhe Varna, komisioner i Bursës së Stambollit dhe më pas me radhë shërbeu si vali (guvernator) në Dijarbakër, dy herë në Sivas, Selanik,

¹ Sicill-i Osmanî Zeylî, haz. Mehmed Zeki Pakalın (Ankara: Türk Tarih Kurumu, 2008), 1/161.

Adana, Ankara dhe më së fundi për një kohë të gjatë shërbeu po ashtu si vali i vilajetit të Ishujve të Mesdheut (Cezâyir-i Bahr-i Sefid).

Gjatë kohës që ishte dhe komisioner i Bursës së Stambollit, pas luftës osmano-ruse (1877-1878), Abedin Pasha u dërgua në vilajetin e Janinës nga Sulltan Abdylhamidi për të ruajtur zonat e banuara nga shqiptarët². Në vitin 1880, ai mbajti për tre muaj edhe postin e ministrit të Punëve të Jashtme. Me urdhër të Sulltanit, hartoi një draft për një rregullore mbi zgjedhjet me dy shkallë për kandidatët në parlamentin osman³.

Falë performancës së tij të suksesshme në të gjitha këto poste, ai fitoi respektin e shtetit dhe të popullit. Ai njihej si një njeri besnik i Sulltan Abdylhamidit, të cilin e lavdëronte me fjalë, si: “Halifi dhe sulltani i myslimanëve”, “Mësuesi i botës islame”, “Mjeshtri i madh i politikës”, “Bamirësi modest dhe njeriu i vlerave të larta” etj. Megjithatë, nga një letër e shkruar prej tij kur ishte vali i Ishujve të Mesdheut, ai shprehet i mërzhitur që ishte rikthyer nga posti i ministrit të Jashtëm në atë të valiut, gjë të cilën e kishte parë si një ulje në gradë.⁴

Abedin Pasha vdiq më 9 maj 1906 (15 Rebiulevvel 1324 h.) nga një sulm në zemër, ndërsa ishte në krye të një komisioni për Jemenin. Varri i tij⁵ ndodhet në varrezat e xhamisë “Fatih” në Stamboll, ngjitur me tyrben

² Abedin Pasha, pas luftërave ruso-osmane, kishte mbledhur familjet e mëdha shqiptare dhe kishte luftuar bashkë me to për mbrojtjen e Janinës. Edhe pse më të paktë në numër, ato kishin mundur të ruanin qytetin nga rënia. Shih Dervish Hima, *Musavver-i Arnavut*, (İstanbul: Matbaa-i Şems, 1327/1911), f. 8.

³ İskender Pala, “Abidin Paşa”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, (İstanbul: 1988), 1/310.

⁴ Hayri Orhun vd., *Meşhur Valiler* (Ankara: İçişleri Bakanlığı Merkez Valiler Bürosu, 1969), 31.

⁵ Mbi varrin e tij shkruhet: “Ky është varri i ndritur i Abedin Pashë Dinos, pinjoll i familjes së madhe shqiptare të Dinove. Një nga ministrat e mëdhenj të Sulltanatit të Lartë Osman. Allahu është i Përjetshëm. Abedin Pasha, një nga të urtët e mëdhenj të umetit islam, një nga ministrat e vjetër të Perandorisë së Lavdishme, shpjeguesi i *Kasîde* i *Bürde* dhe *Mesnevî* i *Mevlâna*, autori i *Meâlî* i *İslâmiyye* dhe *Saâdet* i *Dünyâ*, një poet me një zgjuarsë të rrallë, ish-ministër i Punëve të Jashtme. Shpirti i tij i pastër qoftë në Parajsë, së bashku me Zotërinë e njerëzimit,

e Gazi Osman Pashës – një fakt që tregon nderimin e madh që kishte shteti për të.

Përveçse një administrator i aftë, Abedin Pasha kishte një prirje të dukshme ndaj sufizmit. Ai ishte ndjekës i Mevlanasë dhe kishte lidhje me shehun Nuredin Efendiu të teqesë Halveti⁶ në Merkez Efendi në Stamboll.

Pavarësisht nga angazhimet shtetërore, ai nuk e shkëputi kurrë lidhjen me dijen dhe dijetarët e, si rrjedhojë, la pas vepra të vlefshme e të larmi-shme që pasqyrojnë personalitetin e tij administrativ, letrar, shkencor dhe sufist.

Ndër veprat e tij më të rëndësishme përmendim:

- “Shpjegimi i Mesneviut”
- “Përkthimi dhe komentimi i Kaside-i Bürde”
- “Saadet-i Dünya” (Lumturia e kësaj bote)
- “Meâlî-i İslamiyye”
- “Mbrotja e botës islame”

2. Vepra *Meâlî-i İslamiyye* në kontekstin e shkencës së tefsirit

“*Meâlî-i İslamiyye*” është një nga veprat më të rëndësishme të Abedin Pashës, e cila dëshmon njohuritë e tij në shkencat islame. Libri u botua në Stamboll, në vitin 1900 (1318 h.), dhe ka 356 faqe. Në këtë vepër autori ka përzgjedhur 171 ajete, nga 53 sure të ndryshme të Kuranit, të cilat i ka përkthyer në turqisht, dhe më pas edhe i ka komentuar.

shtrati i tij qoftë në dallgët e mëshirës dhe varri i tij qoftë përjetësisht rezidencë e faljes hyjnore. Ai i përket popullit shqiptar dhe fisnik të Çamërisë. Babai i tij vjen nga fisi Dino, ndërsa nëna e tij nga fisi Çapar. O vizitor i këtij njeriu zemërbutë, këtij ministri që la vepra, lutu me shpirt e me zemër që ai të gjejë qetësinë e plotë e të kulluar dhe kujtoje atë me të mira dhe me mëshirë. Shpirti i tij u prehtë në paqe. Viti i lindjes 1259/1843; viti i vdekjes 1324/1906”.

⁶ Në disa libra, përkatësia në tarikatin “Halveti” e shehut të tij Nuredin Efendiu gabimisht është lexuar si “Alevi” duke u aluduar kështu gabimisht se edhe Abedin Pasha dhe dinastia e tij ishte e sektit Alevi. Shih Niko Stylos, Preveziani Abedin Pasha Dino-Poezitet e tij greqisht dhe Dinat (Dinot) (Mulheim: Botimet “Pa Ku-finj” A. D. R, 2013), 37.

Suret dhe ajetet e përzgjedhura janë si më poshtë:

Bekare 2/115; 195; 216; 249; 268-269; 286, **Ali Imran** 3/142; 145-146; 159; 169; 200, **Nisa** 4/79; 110; 114; 135, **Maide** 5/15-16; 32; 54, **Enam** 6/11-12; 15- 17; 59; 93; 102-103; 116, **Araf** 7/30-31; 198-199, **Enfal** 8/17; 40; 45-46, **Tevbe** 9/20-22; 51; 104, **Junus** 10/25-26; 56-57; 106, **Hud** 11/114, **Jusuf** 12/87, **Rad** 13/28-29, **Ibrahim** 14/7; 24-27; 31, **Hixhr** 15/14-15, **Nahël** 16/90; 119; 125-128, **Isra** 17/11; 23-24; 85, **Kehf** 18/119, **Merjem** 19/95, **Haxh** 22/77, **Muminun** 23/51; 117-118, **Nur** 24/22; 35, **Furkan** 25/70, **Shuara** 26/213-220, **Kasas** 28/77; 83; 88, **Ankebut** 29/45; 69, **Rum** 30/20-24, **Llukman** 31/17-19; 22; 34, **Sexhde** 32/17; 30-31; 34-35, **Ahzab** 33/27; 56; 72, **Sebe** 34/2; **Fatir** 35/10, **Jasin** 36/77-79, **Zumer** 39/9-10; 18; 22; 33-37; 53; 61-63, **Shura** 42/28; 36-40, **Zuhruf** 43/36-37, **Ahkaf** 46/13- 15, **Muhamed** 47/21, **Huxhurat** 49/12, **Kaf** 50/16, **Dharijat** 51/55, **Rrahman** 55/26, **Hadid** 57/22-23, **Mumtehine** 60/13, **Saf** 61/1-4; 10-13, **Muzemil** 73/8-10, **Naziat** 79/40-41, **Fexhr** 89/27-30.

Në veprën e tij gjithashtu ka bërë komentin e plotë të sureve më të shkurtra, siç janë **Fatiha**, **Duha**, **Inshirah**, **Kadr**, **Asr**, **Keuther**, **Nasr**, **Ihlas**, **Felek** dhe **Nas**.

Autori fillimisht jep emrin e sures, numrin e ajetit dhe tekstin në arabisht⁷. Pastaj, nën titujt “Përkthim” ose “Kuptimi i nderuar”, paraqet përkthimin turqisht. Në vazhdim, nën titujt “Urtësia” ose “Komentimi”, jep interpretimin. Në fund, me titullin “Përmbledhje”, jep thelbin e komentimit. Në disa vende, ai nis me frazën “Mund të lindë pyetja...” dhe më pas jep përgjigje të detajuara ndaj dyshimeve apo keqkuptimeve që mund të lindin në lidhje me atë pikë.

Vepra është shkruar me një stil të thjeshtë dhe të kuptueshëm, me qëllim që të lexohej nga masat e gjera. Për ta bërë më të qartë mesazhin, ai jep shembuj të shumtë nga jeta e përditshme.

Abedin Pasha nuk përmend drejtpërdrejt emrat e komentuesve apo të burimeve më të mëhershme të Kuranit, por në mënyrë të përgjithshme

⁷ Duke filluar nga ajeti i 87-të i sures *Jusuf*, e deri në fund të veprës, autori shkruan vetëm fillimin e ajeteve që komenton.

përdor shprehjen “sipas disa komentuesve”. Ai përfshin shpesh vargje nga “*Mesneviu*” i Mevlanasë, vepër të cilën e lavdëron shumë dhe po ashtu bën referenca edhe nga komentimi që vetë ai ka shkruar për “*Mesneviun*”. Gjithashtu, autori përdor shumë hadithe për të sqaruar ajetet.

Përveç çështjeve shoqërore, Abedin Pasha u kushton vëmendje të veçantë çështjeve si besimit në kader (përcaktimit hyjnor), besimit në të padukshmen, rëndësisë së adhurimeve, natyrës së shpirtit, shpalljes së vërtetë dhe asaj të rreme, politeizmit etj. Ai nuk heziton të futet herë pas here edhe në diskutime që kanë të bëjnë me filozofinë dhe shkencat natyrore bashkëkohore.

3. Disa mendime të Abedin Pashës nga perspektiva e tefsirit me karakter shoqëror

Kurani, përveçse flet për ngjarjet që u ndodhën kombeve të mëherëshëm, përmend edhe ngjarje shoqërore që ndodhën në kohën e shpalljes. Këto ngjarje përshkruhen me një stil të veçantë kuranor dhe theksojnë ligjet e pandryshueshme të Zotit mbi shoqëritë. Qëllimi është që njerëzit t’i kuptojnë këto ligje hyjnore, të marrin mësim nga ato dhe të zgjidhin problemet e tyre në përputhje me to.

Gjatë historisë, komentuesit e Kuranit janë përpjekur t’i lidhin ajetet me realitetet e kohës së tyre dhe t’i shpjegojnë ato, në mënyrë që të japin zgjidhje për problemet shoqërore të asaj kohe. Por, kthimi i kësaj qasjeje në një metodë të qëndrueshme ndodhi në fund të shekullit XIX⁸, veçanërisht me figurat si Muhamed Abduh (v. 1905) dhe nxënësit e tij si Muhammed Reshid Rida (v. 1935) dhe Mustafa El Meragi (v. 1945).

Veçoria kryesore e kësaj qasjeje është kërkimi i zgjidhjeve për problemet e kohës në dritën e ajeteve të Kuranit. Kjo erdhi si reagim ndaj krizës së thellë në të cilën ndodhej bota islame në përballje me Perëndimin – në aspektin ushtarak, politik, ekonomik dhe kulturor. Sipas këtyre

⁸ Muhammed Huseyin Edh Dhehebî, *Et Tefsir ve El Mufessirûn* (Kajro: Mektebetu-l Vehbe, botimi i tetë, 2003), 2/401-404.

mendimtarëve, problemi nuk qëndronte në vetë Islamin, por si pasojë e natyrshme e largimit të myslimanëve nga thelbi i tij.

Edhe në fund të Perandorisë Osmane pati shumë dijetarë e autorë që u ndikuan nga ky stil dhe botuan vepra me frymë të ngjashme në gazeta dhe revista. Për shembull, Mehmet Akif Ersoj përktheu dhe botoi artikujt e revistës *El Urvetul Vuthkâ* në revistën *Sırat-ı Müstakim/Sebilürreşad*, duke ia atribuar ato Muhamed Abduhusë⁹.

Sipas mendimit tonë, edhe Abedin Pasha – i cili jetoi në të njëjtën kohë – kishte për qëllim që Kurani të kuptohej në mënyrë bashkëkohore dhe të shihej si libër udhëzimi. Prandaj, ai shmangu detajet e thella gjuhësore, kelmaste apo juridike, dhe komentoi ajetet përmes problemeve që preknin drejtpërdrejt shoqërinë. Ai ishte një figurë me përvojë në administratë, me një edukim sufist dhe me njohuri si në shkencat fetare ashtu edhe në ato moderne, gjë që i mundësonte të analizonte problemet nga kënde të ndryshme.

Në veprën “*Meâlî-i İslamiyye*” kjo shumanshmëri tërheq vëmendjen dhe është menjëherë e dukshme. Megjithatë, prioriteti dhe fokusi i tij kryesor mbetet përmirësimi i kuptimit fetar dhe korrigjimi i qasjes së myslimanëve ndaj jetës.

3.1. Përmirësimi i kuptimit fetar

Abedin Pasha mendonte se arsyeja pse myslimanët kishin mbetur prapa nuk ishte vetë Islami, por përkundrazi, ishte mënyra e gabuar si e kishin kuptuar ata fenë dhe veprimet që burojnë nga ky kuptim i shtrembëruar. Kjo kishte sjellë te myslimanët një gjendje pasiviteti dhe dëshpërimi. Për të dalë nga kjo gjendje, sipas tij, ishte e nevojshme të ringjallej shpresa, duke u kthyer te Zoti dhe duke reformuar konceptet e tyre rreth fesë dhe jetës.

⁹ Mehmet Suat Mertoğlu, “Kur'an'ın Güncel Olaylarla İlişkilendirilmesi, Sırat-ı Müstakim/Sebilürreşad Mecmuası Çerçevesinde Osmanlı Son Döneminde Sosyo-Politik Tefsir Yaklaşımı”, Osmanlı Toplumunda Kur'an Kültürü ve Tefsir Çalışmaları -II-, İlim Yayma Vakfı-Kur'an ve Tefsir Akademisi, 399-428.

Abedin Pasha theksonte se kuptimi i shëndoshë i fesë duhet të mbështetet mbi bazat e saj të vërteta. Prandaj, ai ndalet me kujdes te konceptet thelbësore, siç janë: durimi, xhiahadi, drejtësia, bamirësia, përmirësimi i vetes, pendimi dhe kërkimi i faljes, dija, kursimi dhe shpërdorimi, shpresa, përpjekja, përvullësia dhe të folurit me mirësi.

Këto koncepte kanë një lidhje të ngushtë me jetën shoqërore. Për këtë arsye, Abedin Pasha i trajtonte këto koncepte fetare duke i lidhur ngushtë me dobitë e tyre si për individin dhe për shoqërinë, duke u përpjekur të tregojë gjithashtu se si duhet të reflektohen në jetën e përditshme.

Për shembull, kur flet për dobitë e adhurimeve, ai i vlerëson ato si në aspektin personal, ashtu edhe në atë shoqëror:

*“Adhurimet ndaj Zotit janë dy llojesh: të parat si shehadeti, namazi, agjërimi dhe haxhi janë personale; të dytat si p.sh.: dhënia e zekatit dhe sadakasë, xhiahadi për fenë dhe shtetin, ndihma e të tjerëve në mënyrë të lejuar dhe të përshtatshme, veprimet e tjera që burojnë nga sjellje të larta dhe të mira. Këto të dytat realizojnë qëllimin e adhurimit dhe nënshtrimit të plotë dhe janë akte që përmirësojnë njeriun dhe shoqërinë”.*¹⁰

Një nga temat ku ai ndalet me shumë kujdes është dhënia e pasurisë në rrugë të Zotit (infaku). Kur komenton ajetin: *“dhe jepni nga ajo që ju kemi dhënë...”*, ai vëren se dhënia e kontributit financiar ka tri aspekte të dobishme: për individin, për shoqërinë dhe për shtetin. Ai e lidh *infakun* me parime, si: zbutja e nevojave, përmirësimi i vendit, rritja e lumturisë dhe forcimi i dashurisë mes njerëzve.

Abedin Pasha, gjithashtu, teksa ndalet në ajetin 31 të sures Ibrahim (*Dhe ata shpenzojnë nga ajo që ju kemi dhënë, fshehurazi dhe haptazi...*) thekson se forma e dhënies së sadakasë nuk duhet kufizuar vetëm në para, e cila është një formë e dukshme pasi në një mënyrë është një detyrim financiar. Sipas tij, ka edhe sadaka të fshehta, si p.sh. përçimi i dijes, dhënia e këshillave, fjalët e mençura etj., të cilat janë po aq të vlefshme. Ai shprehet: *“Sadakaja e hapur është përmes parasë dhe sendeve materiale; ndërsa sadakaja e fshehtë bëhet nëpërmjet dijes, fjalës, mendjes, këshillës dhe mbështetjes për jetën”.*¹¹

¹⁰ Abidin Paşa, *Meali i Islamiyye*, f. 178.

¹¹ Po aty, f. 16.

Kjo qasje e tij jep një dimension të ri të kuptimit të zekatit dhe ndihmës. Ndonëse në aspektin juridik nuk mund të zbatohet kështu, në aspektin etik dhe shoqëror ajo tregon thellësinë e vlerave që ai synon të mbjellë në shoqëri. Kjo, sepse njerëzit nuk kanë vetëm nevoja financiare, por shpeshherë kanë nevojë që dikush t'i ndajë me ta ato vlera.

Po ashtu, Abedin Pasha e kundërshton ashpër aktin e mburrjes me sadaka dhe ofendimin e atyre që janë të nevojshëm dhe kur flet për ajetin 262 të sures *Bekare*¹², i kritikon hapur këto sjellje: *“Të prishësh sadakanë me mburrje dhe fyerje është p.sh. t'i detyrosh të varfrit të presin me orë të tëra nën diell, në shi a në të ftohtë ose t'i ofendosh ata e t'i bësh të ndihen keq në momentin e dhurimit. Është e vërtetë se i varfri ka nevojë për të pasurin, por edhe i pasuri ka nevojë për të varfrin, sepse varfëria është pasqyra e pasurisë. Ashtu sikur njeriu nuk mund të shohë dot veten dhe bukurinë e tij pa praninë e një pasqyre, po ashtu, pa praninë e të varfërve i pasuri nuk mund ta kuptojë dot njerëzillëkun dhe mirësitë që i janë dhuruar.”*

Sipas tij, sadakaja është mjet për të plotësuar nevojat e të varfrit, por nga ana tjetër, për të pasurin ajo është një provë e njerëzisë së tij.

Në përfundim, vëmendja që i kushton infakut dhe sadakasë tregon se ai ka vërejtur mangësi në këtë fushë në shoqëri dhe nga ana tjetër është përpjekur që të japë zgjidhje duke zgjeruar kuptimin etik dhe shpirtëror të këtyre koncepteve.

Qasja e Abedin Pashës ndaj durimit dhe xhihadit

Një tjetër koncept që Abedin Pasha e trajton me theks të veçantë është durimi (sabri) dhe xhihadi. Sipas tij, durimi nuk është thjesht pranimi pasiv i fatit ose kënaqja pasive me atë që është caktuar nga Zoti. Përkundrazi, durimi përfshin edhe përpjekjen aktive të individit për të larguar fatkeqësinë dhe vështirësinë që i ka rënë. Durimi, sipas Abedin Pashës, nuk duhet të shfaqet vetëm në adhurimet ndaj Zotit, por ai duhet reflektu-

¹² “Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje...”

ar edhe në përmbushjen e detyrave njerëzore dhe shoqërore. Gjatë komentimit të ajetit: **“A mendoni se do të hyni në Xhenet, pa i provuar Allahu ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar?”** (*Ali Imran 3:142*), ai i drejtohet shoqërisë osmane, të lodhur nga sfidat politike dhe shoqërore, duke u dhënë shpresë dhe duke i nxitur të mos dorëzohen para vështirësive, por të punojnë me vendosmëri për t’i tejkaluar ato. Në mënyrë të veçantë, ai nënvizon rëndësinë e durimit gjatë luftës dhe përballjeve me armiqtë, duke theksuar që vetëm përmes qëndrueshmërisë dhe përkushtimit mund të arrihet fitorja.

Xhiahadi në tri nivele

Abedin Pasha ka trajtuar në mënyrë të gjerë dhe të thellë edhe konceptin e xhihadi. Ai përfshin në veprën e tij komentime të shumë ajeteve që lidhen me këtë temë dhe përpiket të sqarojë se xhihadi nuk është i kufizuar vetëm në fushën e betejës ushtarake. Për të korrigjuar këtë perceptim të kufizuar në lidhje me konceptin në fjalë, ai bën pyetjen: **“Çfarë është xhihadi i vërtetë?”**. Dhe përgjigjet: *“Xhihadi i vërtetë është që të luftosh armiqtë e fesë dhe të shtetit sipas mënyrave të ligjshme, të bësh përpjekje për adhurim të rregullt para Zotit e të përmbushësh drejt dhe me besnikëri detyrat që të janë ngarkuar para shoqërisë, të luftosh kundër egos që të urdhëron për keq dhe kundër djallit të mallkuar, duke rezistuar ndaj tij si në nivel të brendshëm ashtu edhe të jashtëm.”*¹³

Ky përkufizim i trefishtë për xhihadin, në fakt, përputhet me hadithin e famshëm të Profetit Muhamed (a.s.): *“U kthyem nga xhihadi i vogël, për te xhihadi i madh”*¹⁴ – që nënkupton luftën me vetveten.

Përtej qasjes klasike, Abedin Pasha jep edhe një kuptim bashkëkohor të xhihadi. Duke komentuar ajetin 249 të sures *Bekare*¹⁵, ai e lidh kuptimin e ajetit me përvojën e tij si udhëheqës në luftërat ruso-osmane dhe në

¹³ Meali i Islamiyye, f. 83.

¹⁴ Transmeton Bejhaki në “Kitabu’z-Zuhd’il Kebir”.

¹⁵ “...Sa herë, me ndihmën e Allahut, një ushtri e vogël ka ngadhënjyer mbi një ushtri të madhe! Allahu është me të durueshmit”.

përpyjekjet për të mbrojtur trojet shqiptare në Janinë. Ai shkruan: *“Feja dhe shteti, populli dhe kombi ruhen dhe mbahen në këmbë nga luftëtarët trimë. Ata sjellin mundësitë e mira dhe lumturinë e atij vendi. Historia ka treguar se një popull që nuk ka guxim dhe forcë, sado i pasur apo i zgjuar të jetë, në fund do të jetë i dënuar me humbje dhe mjerim”*.

Në të njëjtën mënyrë, autori, pasi flet për kuptimin e drejtë dhe kush-tet e “mbështetjes te Zoti” (tevekkul), flet përsëri për konceptin dhe rëndësinë e përpjekjes me këta rreshta: *“Nëse besimtarët duan të arrijnë dëshirat që kanë te Zoti, duhet të përpiqen shumë, në të gjitha situatat dhe deri në fund të jetës së tyre, por brenda kufirit të mundësive që kanë dhe gjithmonë në mënyrë të ligjshme. Të presësh lumturi dhe rehati pa lodhje dhe pa përpjekje nuk është gjë tjetër përveçse injorancë dhe marrëzi”*.

Abedin Pasha, kur merr të flasë për ajetin: *“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin”*,¹⁶ tërheq vëmendjen në rëndësinë e këtyre urdhëresave dhe ndalesave, si për individin dhe për bashkësinë. Sipas tij, nëse njeriu dhe shoqëria do të vepronin thjesht në përputhje me këtë ajet kuranor, ata do të arrinin lumturinë e dy botëve dhe do të ishin “me flatra” në mejdanin e vlerave. Në vazhdim ai jep shpjegimet e tij për “drejtësinë”, “mirësinë” dhe “ndihmën e të afërmeve”.

“Drejtësia është që parësisht të mos bëhet padrejtësi, që çdokujt t’i jepet haku që i takon, por edhe që t’i ruhet haku që i takon. **Mirësia** (Ih-san) është kryerja me hak e adhurimeve, pajisja me moralet dhe vlerat e larta dhe kryerja me amanet e detyrave njerëzore. Ndërsa **përkujdesja dhe ndihma ndaj të afërmeve** realizohet duke i ndihmuar ata në përputhje me drejtësinë dhe gjithashtu duke u dhënë lëmoshë. Por, përderisa njerëzit janë njësoj në krijimin e tyre dhe konsiderohen si vëllezër me njëritjetrit, atëherë çdo njeri që është i nevojshëm, qoftë apo jo mysliman, përfshihet në këtë ajet”.¹⁷

¹⁶ Sure Nahël, ajeti 90.

¹⁷ Meali i Islamiyye, f. 147-148.

Duket qartë se nëpërmjet këtyre fjalëve, duke ditur mirë se shteti osman ishte një shtet multifetar dhe multikulturor, ai synon që nëpërmjet ajeteve kuranore të ruajë dhe të mbështesë paqen sociale dhe rëndësinë e madhe që ka ajo.

3.2. Qasja e Abedin Pashës ndaj problemeve të kohës së tij

Abedin Pasha, në veprën “*Meâlî-i Islâmiyye*”, u kushton një pjesë të madhe çështjeve të besimit dhe akides (doktrinës). Nga ajo që kuptohet në analizë, si pasojë e detyrave që mbante dhe udhëtimeve të shumta në provinca të ndryshme, duket se kishte vërejtur probleme serioze në aspektin shpirtëror të myslimanëve. Kjo është arsyeja pse ai zgjodhi për komentim shumë ajete që lidhen me besimin dhe forcimin shpirtëror të njeriut.

3.2.1. Kush është një udhëheqës i vërtetë shpirtëror (murshid-i kâmil)?

Për të ndërtuar një jetë fetare të shëndoshë, është e domosdoshme që të ketë njerëz shembullorë, të cilët e udhëheqin shoqërinë me sjelljen dhe diturinë e tyre. Abedin Pasha e shpjegon këtë domosdoshmëri duke dhënë një krahasim:

“Ashtu siç një ushtri nuk mund të luftojë pa komandant, ashtu edhe njerëzit nuk mund të përparojnë shpirtërisht pa udhëheqës të vërtetë shpirtërorë”.

Por, kush është një murshid (udhërrëfyes i vërtetë)?

Ai nuk mund të përcaktohet thjesht nga veshja, thjesht nga forma se si duket apo nga fakti që vetë ai e pohon një gjë të tillë. Sipas Abedin Pashës, cilësitë që duhet të ketë janë: “*Aftësi intelektuale dhe mençuri, sjellje të larta morale, besim i plotë dhe përkushtim ndaj adhurimeve të detyrueshme. Këto cilësi duhet të jenë të verifikuara nga njerëz të drejtë dhe të devotshëm të vendit ku ai është rritur dhe vendit ku jeton*”.¹⁸ Në këtë mënyrë, udhëheqësi shpirtëror duhet të jetë shembull në të gjitha dimen-

¹⁸ *Meali i Islamiyye*, f. 44.

sionet e jetës. Kjo qasje, tek e cila tërheq vëmendjen autori, është një element që ruan vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij edhe në ditët tona.

3.2.2. Lufta kundër korrupsionit dhe ryshfetit

Sipas Abedin Pashës, përmbushja e detyrave fetare dhe islame nuk përmbillet vetëm me adhurime, por kërkon gjithashtu përmbushje të ndershme të çdo detyre në shërbim të popullit. Nga problemet më të mëdha të kohës, të cilat bien ndesh me ndershmërinë dhe përgjegjësinë, dhe të cilat, me sa duket, ai i ka hasur shpesh dhe i vë në dukje, janë: korrupsioni dhe ryshfeti.

Abedin Pasha e ndërlidh këtë me interpretimin e ajeteve, si: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë”** (*Fatiha 1:5*), duke thënë se për një nëpunës “rruga e drejtë” është:

“Mos të fitojë para në mënyrë të paligjshme, mos t’i bëjë padrejtësi askujt, të mbrojë të drejtat e njerëzve me mundësitë që i jep posti!”. Ai thekson se, për të arritur rezultate të mira në detyrë, një njeri duhet të përpiqet me fjalë dhe me vepra ose, siç thotë ai vetë: “Të kryejë siç duhet adhurimet hyjnore dhe detyrimet njerëzore që i janë besuar”.

Në një tjetër vepër të tij, në komentin e Mesneviut, ai e përshkruan ryshfetin kështu: “Për një gjykatës dhe zyrtar, perdja më e trashë dhe më e ndyrë për nderin është ajo që quhet ryshfet”.

Pra, Abedin Pasha e shpjegon konceptin kuranor të “rrugës së drejtë” jo në mënyrë abstrakte, por në mënyrë konkrete, duke u nisur nga probleme konkrete dhe duke e lidhur atë me realitetin e padrejtësive shoqërore.

Duhet theksuar që ky shpjegim i tij nuk është një përkthim i drejtpërdrejtë i shprehjes *sirat-ı müstakim* (Rruga e drejtë). Megjithatë, ai dëshiron të tërheqë vëmendjen e të na thotë se një gabim i bërë nuk mund të përputhet me *sirat-ı müstakim*-in dhe të na shpjegojë gjithashtu se udhëzimi i njeriut drejt Allahut (drejt *sirat-ı müstakim*-it) mund të ndodhë vetëm kur personi heq dorë nga veprimet që bien ndesh me këtë rrugë.

3.2.3. Prapambetja e botës islame

Në kohën e Abedin Pashës, bota islame, dhe sidomos Perandoria Osmane, po kalonte një krizë të vështirë dhe po përjetonte rënie në shumë aspekte. Tokat osmane po humbnin njëra pas tjetrës dhe shpresa tek e ardhmja po zbehej ditë pas dite. Për këtë arsye, duke qenë edhe i vetëdijshëm se shoqëria islame mund të dilte nga kjo gjendje ku kishte rënë, ai e kthen vazhdimisht vëmendjen te çështje, si:

- pendimi dhe kërkimi i faljes,
- kuptimi i xhihadit të vërtetë,
- durimi dhe qëndrueshmëria,
- përmbushja e detyrave fetare dhe atyre njerëzore.

Herë pas here ai nënvizon se rrugëdalja, krahas lutjeve dhe adhurimeve, duhet kërkuar edhe te puna dhe përpjekja e fortë.

Në komentimin e ajeteve, si: *“Na udhëzo në rrugën e drejtë”*, ai thekson se lutja, adhurimi dhe përmendja e Zotit nuk duhet të mbeten veprime të thjeshta pasive dhe gojore, por duhet të përkthehen në veprime konkrete në jetën e përditshme.

Ai jep një shembull konkret për t'i sqaruar këto koncepte: *“Lutjet që njeriu ia bën Zotit janë edhe me gojë, por edhe me vepra. Nuk ka dyshim se lutjet gojore dhe adhurimet kanë dobitë e tyre të padiskutueshme, por nuk duhet të harrojmë se lutja dhe adhurimi i vërtetë bëhen me punë dhe me vepra. P.sh., nëse u jepen dy personave nga pesë dynym tokë dhe njëri prej tyre atë sipërfaqe e mbjell dhe e punon sipas ligjeve të Zotit dhe të mendjes, ndërsa tjetri nuk e punon tokën e tij, por vetëm lutet për begati dhe bollëk, është e qartë se Zoti do t'ia pranojë lutjet dhe do t'i japë rezultat atij që punoi e jo atij që u mjaftua me lutje gojore”*.

Po ashtu, ai thekson se shpëtimi nuk do të vijë thjesht nga lutjet me gojë: *“O Zot! Shkatërroji armiqtë kudo që janë!”*, - por do të vijë duke marrë masat e nevojshme, duke shkuar si trim në mejdan e duke u përballur me dushmanin e fesë e të atdheut, edhe sikur i vetmuar”.

Vlen të theksohet se Abedin Pasha, në mënyrë që fjalët e tij të mos keqkuptohen e atyre të mos u jepet kuptim tjetër, shton e thotë: *“Por, njeriu asnjëherë nuk duhet të shkëputet nga namazi, përmendja e Zotit dhe*

adhurimet e obliguara. Atë që largohet prej tyre, shejtani i mallkuar do ta çojë drejt shkatërrimit dhe turpërimit”.

Ai e sheh përmirësimin e individit dhe të shoqërisë paralelisht nëpërmjet përpjekjes shpirtërore dhe asaj materiale. Kur e komenton ajetin e 145-të të sures Ali Imran: *“E kush kërkon shpërblimin e kësaj bote, atij do t’i japim prej atij shpërblimi, e kush kërkon shpërblimin e botës tjetër, atij do t’i japim prej atij shpërblimi”*, shpjegon se, përderisa është i Drejtë, Zoti i jep njeriut në bazë të përpjekjes që ai bën. Evropianët, duke qenë të prirë ndaj kënaqësive të kësaj bote, janë munduar në këtë drejtim dhe kanë sjellë shpikje dhe zhvillime të reja. Këto shpikje të tyre janë vetëm rezultat i përpjekjeve të tyre.

Abedin Pasha e sjell fjalën te pyetja nëse prapambetja e myslimanëve ka të bëjë me Kuranin dhe Islamin dhe jep këto sqarime lidhur me temën: *“Nëse ka një person që merret me bujqësi dhe i jep hakun punës në arë dhe një tjetër që vetëm merret me lutje me fjalë, por nuk punon tokën, nuk ka dyshim se Allahu do t’i japë prodhim atij që punon tokën. Arsyeja pse myslimanët kanë mbetur pas në çështjet e kësaj bote nuk buron nga Islami, ashtu siç përparimi i evropianëve nuk vjen si pasojë e krishterimit”.*

Ai pastaj sjell si shembull historinë e myslimanëve të Andaluzisë (Spanjë) për të dëshmuar se Islami nuk e pengon përparimin, përkundrazi e nxit atë: *“Nëse feja jonë do ta pengonte lumturinë e lejuar dhe begatinë e kësaj bote, myslimanët që jetuan për shekuj në Spanjë nuk do të kishin përparuar, ndërsa të krishterët nuk do të kishin mbetur pas”.*

3.3. Aspektet administrative dhe politike në komentet e Abedin Pashës

Siç u theksua më herët, Abedin Pasha ishte një burrë shteti shumë i suksesshëm. Kjo prani e tij në qeverisje reflektohet jo vetëm në punët që ai ka kryer, por edhe në veprën e tij *“Meâlî-i Îslâmiyye”*, ku ai shfaq qartësisht një qasje administrative dhe politike në interpretimin e disa ajeteve.

Mëshira në dy nivele: e dukshme dhe e fshehtë

Duke komentuar ajetin: “*Mëshiruesi Mëshirëbërësi*” (Fatiha 1:2) dhe ajetin tjetër: “*Falë mëshirës së Allahut, ti u solle butë ndaj tyre*” (Ali Imran 3:159), ai e ndan mëshirën në dy kategori:

1. Mëshira e dukshme:

Kjo është ndjeshmëria dhe sjellja e butë që u shfaqet njerëzve, kafshëve dhe gjallesave gjatë kohëve të vështira dhe jashtë tyre. Kjo përfshin fjalë dhe veprime të mëshirshme të dukshme.

2. Mëshira e fshehtë:

Kjo konsiston në zbatimin e drejtësisë dhe politikës së drejtë. Për shembull, kur autoritetet ndëshkojnë dikë përmes burgimit ose masave të tjera ligjore, kjo nga jashtë mund të duket si ashpërsi, por në të vërtetë, njerëzit e mendjes e dinë mirë se edhe kjo është një formë mëshire, sepse ndihmon në edukimin e individit dhe parandalon dëme më të mëdha shoqërore.

Ai thekson se kjo mënyrë veprimi është në të mirë të gjithë njerëzimit, sepse ndëshkimi i së keqes shërben si shembull dhe mësim për të tjerët. Kështu pra, edhe ndëshkimi i drejtë në thelb është një akt mëshire.

Sipas këtyre shpjegimeve të Abedin Pashës, ndjenja e mëshirës ndaj individit nuk duhet ta dobësojë njeriun në zbatimin e dënimeve, përndryshe shoqëria do të pësojë dëm edhe më të madh; ndërsa në zbatimin e dënimeve gjendet dobi si për individin, ashtu edhe për shoqërinë.

Rëndësia e konsultimit (meshvereti)

Në komentimin e ajetit: “*Dhe konsultohu me ta në punë...*” (Ali Imran 3:159), që u referohet ngjarjeve në lidhje me betejën e Uhudit, Abedin Pasha flet për “konsultimin” dhe thekson:

“Edhe nëse një person ose një grup ka bërë ndonjë gabim të paqëllimshëm në të kaluarën, nuk është e drejtë t’i përjashtosh ata nga procesi i konsultimit për shkak të atij gabimi e kjo as në fenë Islame e as në politikë”.

Ai shpjegon se konsultimi është thelbësor, sidomos në çështjet politike dhe shtetërore. Rëndësinë e konsulencës e shpjegon në këtë formë:

“Një person i mençur është si një qiri që ndriçon një dhomë, por nëse në atë dhomë vendosim disa qirinj të tjerë, drita bëhet më e plotë. Kështu është edhe me mendimet e shumta; ato i japin qartësi vendimmarrjes. Megjithatë, konsultimi me njerëz të paditur, hipokritë apo tradhtarë, marrja e çdo mendimi pa e verifikuar atë më parë nuk do të sjellë dobi. Pra, është e rëndësishme cilësia e atyre që përfshihen në proces”.

Lidhja midis pendimit dhe politikës

Në komentimin e ajetit: **“A nuk e dinë ata se Allahu e pranon pendimin e robërve të vet?”** (Tevbe 9: 104), Abedin Pasha thekson rëndësinë e pendimit dhe pranimit të gabimit, jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në jetën shoqërore dhe politike.

Ai thotë:

“Në politikë dhe madje edhe në jetën familjare, pranimi i pendimit të singertë është urtësi. Nëse një person, që më parë ka vepruar gabim, vjen me pendim të singertë dhe u kërkon falje autoriteteve ose prindërve, kjo duhet të pranohet me mençuri dhe me dashamirësi”.

Por, edhe këtu ai paralajmëron, duke thënë:

“Nëse pendimi bëhet vetëm për të shmangur ndëshkimin ose për ndonjë mashtrim tjetër, ai nuk ka vlerë reale dhe do të zbulohet shpejt”.

Sipas këtyre shembujve, del e qartë se Abedin Pasha, përmes komenteve të tij, ka lidhur ajete të Kuranit me realitetet e jetës politike, administrative dhe shoqërore të kohës së tij. Ai jo vetëm që ka përdorur urtësinë e Kuranit për të dhënë zgjidhje për problemet morale dhe fetare, por ka sjellë edhe perspektiva shumë të vlefshme për qeverisjen dhe drejtësinë.

Përfundim

Abedin Pasha ishte një ndër figurat më të rëndësishme shtetërore gjatë periudhës së Sulltan Abdylhamidit II dhe ka shërbyer si vali në qytete të ndryshme të Perandorisë Osmane. Sulltani e mbajti atë për një kohë të gjatë në pozita të rëndësishme dhe e vlerësoi lart punën e tij, por përveçse një administrator i zoti, Abedin Pasha spikati edhe në fushën e dijes.

Duke analizuar temat e trajtuara në veprën “*Meâlî-i İslâmiyye*”, kuptohet se ai kishte jo vetëm një interes të veçantë për shkencën e tefsirit, por dha edhe një kontribut të çmuar në të. Ashtu si në shumë vepra dhe traktate të shkruara në fund të periudhës osmane, qëllimi kryesor i tij ishte të trajtonte problemet fetare dhe shoqërore me të cilat përballeshin myslimanët dhe të jepte zgjidhje në dritën e Kuranit.

Për këtë arsye, “*Meâlî-i İslâmiyye*” mund të konsiderohet si një studim serioz, i cili jo vetëm që analizon çështjet shoqërore, por edhe ofron rekomandime konkrete për zgjidhjen e tyre.

Në këtë vepër gjenden gjithashtu analiza mbi besimin dhe doktrinën islame. Abedin Pasha përpiqet t’i përfshijë problemet aktuale brenda korvizës së këtyre vlerave themelore. Ai nuk heq dorë asnjëherë nga vlerat e larta të Islamit dhe përpiqet që ato të kuptohen dhe zbatohen në mënyrë të drejtë dhe bashkëkohore. Gjithashtu, ai përpiqet të ruajë një ekuilibër mes fesë dhe jetës praktike, duke përfshirë shembuj konkretë nga jeta.

Në komentimin e tij vërehet se në përgjithësi ai u ndal te:

- kuptimi i drejtë i adhurimeve personale dhe kolektive,
- çfarë është durimi dhe xihadi i vërtetë,
- si zbatohet drejtësia dhe mëshira në shoqëri,
- nevoja për të braktisur sëmundjet morale dhe sjelljet e dëmshme,
- mënyra se si Kurani mund të shërbejë si udhërrëfyes për zgjidhjen e problemeve të përditshme.

Gjatë komentimit të ajeteve, Abedin Pasha qëndron besnik ndaj tekstit kuranor, qoftë në aspektin gjuhësor apo kuptimor. Ai gjithashtu arrin të shkruajë përkthimin dhe interpretimin me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për lexuesin.

Përmbledhje

Abedin Pasha, përmes veprës **Meâlî-i İslâmiyye**, nuk shfaqet vetëm si një komentues bashkëkohor i Kuranit, por edhe si një udhëheqës shpirtëror, administrator i aftë dhe intelektual me diapazon të gjerë. Me këtë vepër, ai bëhet një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të qasjes shoqërore në komentimin e Kuranit në fundin e Perandorisë Osmane.

Kjo vepër përbën një model të pasur dhe shumëdimensional të tefsirit social dhe meriton më shumë vëmendje nga studiuesit e kësaj fushe.

Literatura:

- Abidin, Paşa. *Meali-i İslamiyye*, İstanbul: Ma'lumât Kütüphanesi-Tahir Bey Matbaası, 1318.
- Abidin, Paşa. *Terceme ve Şerhi Kaside-i Bürde*, İstanbul: Mahmud Bey Matbaası, 1324/1906.
- Abidin, Paşa. *Terceme ve Şerh-i Mesnevi-i Şerîf*, İstanbul: Mahmud Bey Matbaası, 1324/1906.
- Beyhaki, *Kitabü'z-Zühdü'l-Kebîr*, nşr. Amir Haydar, Beyrüt: Darü'l-Cinân, 1987.
- Çelik, İsa. *Abidin Paşa (1259/1843-1324/1906)'nın Mesnevi Şerhi ve Tasavvufi Düşünceleri*, Atatürk Üniversitesi, Sosyal Bilimleri Enstitüsü, Doktora Tezi, 2001.
- Hima, Derviş. *Musavver-i Arnavut*, İstanbul: Matbaa-i Şems, 1327/1911.
- Mertoğlu, Mehmet Suat. “Kur'an'ın Güncel Olaylarla İlişkilendirilmesi, Sırat-ı Müstakim/Sebilürreşad Mecmuası Çerçevesinde Osmanlı Son Döneminde Sosyo-Politik Tefsir Yaklaşımı”, Osmanlı Toplumunda Kur'an Kültürü ve Tefsir Çalışmaları -II-, İlim Yayma Vakfı-Kuran ve Tefsir Akademisi, 2013, 2/399-428.
- Orhun, Hayri, Belek, Mehmet, Kasaroğlu, Celal, *Meşhur Valiler*, Ankara: İçişleri Bakanlığı Merkez Valiler Bürosu, 1969.
- Pakalın, Mehmed Zeki. *Sicill-i Osmanî Zeylî*, Ankara: Türk Tarih Kurumu, 2008.
- Pala, İskender. “Abidin Paşa”, Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi, İstanbul: TDV Yayınları, 1988.
- Stylos, Niko. *Preveziani Abedin Pasha Dino-Poezitë e Tij Greqisht dhe Dinat (Dinot)*, Mulheim A. D. R: Botimet “Pa Kufinj”, 2013.
- Şimşek, M. Sait. *Günümüz Tefsir Problemleri*, İstanbul: Kitap Dünyası Yayınları, 12.baskı, 2014.
- Zehebî, Muhammed Hüseyin. *et-Tefsir ve'l-Müfessirûn*, Kahire: Mektebetü'l-Vehbe, 8. baskı, 2003.

Dr. Ferid Piku

ABEDIN PASHA DINO AS A COMMENTATOR OF THE GLORIOUS QUR'AN THROUGH THE METHOD OF SOCIAL TAFSIR

Abstract

Abedin Pasha from Preveza, who was of Albanian origin, was an important statesman during the period of Sultan Abdul Hamid II. In addition to his political and administrative duties, he authored many religious and literary works. In his writings, based on personal experiences, it is evident that he also dealt with religious matters and the state of the Muslim society of that time.

Among these works, one that particularly stands out is *Meâli-i İslâmiyye*, in which selected Qur'anic verses are commented on from a sociological perspective. In this work, Abedin Pasha first provides the translations of selected ayats from different surahs, and then comments on them in a way that may be considered one of the earliest examples of the social tafsir approach.

Apart from being a statesman who well understood the contemporary problems of society, Abedin Pasha sought solutions to these problems in the light of Qur'anic ayats. Therefore, the purpose of this study is to shed light on this figure as a commentator of the Qur'an and to determine whether Abedin Pasha can be regarded as one of the forerunners of the sociological tafsir approach.

For this purpose, the issues he addresses in *Meâli-i İslâmiyye* and the solutions he offers are examined and analyzed. Considering his interpretation of the ayats and the proposals he presents, it can be understood that Abedin Pasha was one of the first authors to use the social tafsir approach in interpreting the meaning of ayats.

Keywords: Ottoman commentators, social tafsir, 19th-century commentaries, *Meâli-i İslâmiyye*.

Semra VASIJA-TËRHOLLI

SUZI ÇELEBIU-PRIZRENASI DHE VAKËFET E TIJ

Abstrakt

Në këtë punim bëhet fjalë për njërin prej dijetarëve, poetëve dhe historianëve më të hershëm të Prizrenit gjatë periudhës osmane, Suzi Çelebiun, i cili konsiderohet një nga personalitetet më me ndikim të kohës së tij. Ai shquhet për poemën e tij Gazavatname-i Mihaloglu, ku përshkruhet pushtimi i Ballkanit nga Perandoria Osmane në shekullin XV dhe betejat e lavdia e komandantit ushtarak Ali bej Mihalolli, duke u renditur ndër veprat më të shquara të letërsisë osmane të atij shekulli. Kjo vepër, përveç vlerës historike, paraqet edhe një model të shkrimit epik me elemente të theksuara artistike dhe gjuhësore, duke pasqyruar shijen letrare të kohës.

Në punim, me theks të veçantë, trajtohen vakëfet që ka lënë ky bamiresh i shquar në Prizren dhe vakëfnamja e tij e legalizuar në vitin 1513, e cila dëshmon për kontributin e tij në zhvillimin shoqëror dhe kulturor të

Fjalët çelës: Suzi Çelebiu, Prizreni, periudha osmane, vakëfi, vakëfname.

1. JETËSHKRIMI I SUZI ÇELEBI PRIZRENASIT

Për periudhën e pushtimit osman, si dhe përhapjen e Islamit në Prizren, nuk kemi dokumente të publikuara, dhe përderisa nuk publikohen defterët kadastralë nga arkivat e Stambollit, nuk mund të jepet ndonjë informatë e saktë përkitazi me këtë periudhë. Ajo që dimë është se osmanët, me të arritur në Prizren, e ndërtuan një xhami provizore (namazgjah), kursen kishën e Shën Premtes (Bogorodica Ljevishka) e shndërruan në xhami. Së këndejmi, edhe Prizreni, me gjasë, u pushtua nga ana e osmanëve edhe para vitit 1455¹, por dihet se ai përfundimisht ra nën administrimin osman në vitin 1459.² Dokumenti i parë, dhe që është më afër kësaj date, është pikërisht Vakëfnameja e Suziut, e cila daton në vitin 1513. Mirëpo, Suziu nuk ishte i pari që kishte kontribuar në Prizren në atë kohë, ngase në vakëfnamenë e tij, si dëshmitarë, përmenden dy imamë, tre myezinë, tre haxhinj, vëllai i tij, poeti Nehariu, si dhe ndihmës të imamëve dhe myezinëve. Megjithatë, mund të themi se Suziu është i pari që shkroi një dokument të rëndësishëm për njohjen e asaj periudhe në këtë rajon.³

Ajo që dihet me siguri është fakti se, me ardhjen e osmanëve në Prizren dhe përhapjen e Islamit, ky qytet e shpejtoi zhvillimin e tij në çdo aspekt, si në atë shoqëror ashtu edhe në atë kulturor e fetar. Në këtë periudhë, nevojat e përgjithshme shoqërore dhe rajonale filluan të merreshin parasysh, duke u themeluar mësonjëtoje, qendra të ndryshme tregtare e shëndetësore, si dhe duke u ndërtuar rrugë, ura, xhami etj.⁴

¹ Hasan Kaleshi, “Prizreni qendër kulturore gjatë periudhës turke”, Hikmet- Revistë shkencore, nr. 10, Prishtinë, 2015, f. 10.

² Prof. Dr. Esat Haskuka, *Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve*, Shtypshkronja “Kosova”, Prizren, 2003, f. 116.

³ Hasan Kaleshi, po aty, f. 10.

⁴ Nexhat Ibrahim, *Suzi Prizrenasi*, Prizren, 1990, f. 5.

1.1. Jeta

Suzi Çelebiu është një nga personalitetet më të rëndësishme të historisë sonë dhe asaj osmane. Ndër studiuesit që janë marrë me figurën e tij janë orientalisti austriak Joseph Hammer Purgstall, gjermani Franz Babinger dhe orientalisti kroat Aleksej Olesnicki, i cili jep informata më të hollësishme për Suziun. Kjo për shkak se, në vitin 1930, ai vizitoi Prizrenin, lexoi epitafin mbi varrin e Suziut dhe studioi Vakëfnamenë e tij, e cila asokohe ishte nën mbikëqyrjen e imamit të kohës, Hafëz Kemalit.⁵ Ndërsa, ndër shqiptarët që kanë shkruar për Suziun është orientalisti Hasan Kaleshi. Gjithashtu, Suziun dhe vëllain e tij, Nehariun, i cili ishte gjithashtu poet, i përmend edhe Shemsedin Sami Frashëri në enciklopedinë e tij të njohur **Kamus al-Âlam**.⁶

Suziun e përmendin gjithashtu edhe biografi Ashik Çelebiu, në librin e tij *“Meşâ’irü’ş-Şuarâ”* si dhe Latifi-u, në librin e tij *“Tezkiretü’ş-Şuarâ”*.⁷

Ashik Çelebiu e përmend Nehariun si vëlla të Suziut, si edhe një tjetër me emrin Remzi Çelebi. Gjithashtu, kur shkruan për Nehariun, ai tregon se ky kishte një vëlla më të madh me emrin Sa’ji.⁸

Ndërsa Latifiu, që ishte bashkëkohanik i Suziut, kur flet për këtë të fundit, thotë: *“...Nakşbendi ٲarıkatına sâlik olmış ve Suzi-i Nakşbendi dimekle şöhet bulmuş...”*⁹ (U bë pjesëtar i tarikatit Nakshibendi, dhe më pastaj u bë i njohur me emrin Suzi Nakshibendiu).

⁵ Agâh Sırrı Levend, *Gazavat-nameler ve Mihaloğlu Ali bey’in gazavat-namesi*, Türk tarih kurumu, Ankara, 2000, f. 199.

⁶ Sami Frashëri, *Personalitetet shqiptare në Kâmus Al-a’lâm*, Logos-A, Shkup, 2002, f. 144, 177.

⁷ Tezkirelerde Suzi, Prizrenli Suzi’nin 500.yili (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000, f. 84-85.

⁸ Altay Suroy Recepoglu, *”Suzi’nin kardesleri”*, Prizrenli Suzi’nin 500.yili (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000, f. 43.

⁹ Agâh Sırrı Levend, *Gazavat-nameler ve Mihaloğlu Ali bey’in gazavat-namesi*, Türk tarih kurumu, Ankara, 2000, f. 197.

Emri i vërtetë i Suziut është Muhamed, emri i babait të tij Mahmud, ndërsa emri i gjyshit Abdullah. Siç duket, Suzi është pseudonimi i tij letërrar, që në persisht ka kuptimin “përvëlues”, “i flaktë”, “ai që digjet për hir të Zotit”, dhe me këtë emër ai përmendet edhe në vakëfnamenë e tij. Ndërsa sa i përket nofkës Çelebi, dihet se në shekujt XI-XVI kështu quheshin ata që ishin dashamirë të letërsisë dhe të poezisë¹⁰, megjithëse, Hasan Kaleshi thotë se kjo nofkë e Suziut është e vonshme, ngaqë i pari që e përdori këtë nofkë është Sa’ji, e pastaj e përcollën edhe Babingeri, Olesnicki e edhe Levendi. Kjo, sipas H. Kaleshit, sepse në vakëfnamenë e Suziut janë të regjistruar pesë persona me nofkën Çelebi dhe, po të ishte kjo nofkë edhe e Suziut, sigurisht që do të ishte shënuar edhe për të. Megjithatë, në vend të saj, ai në vakëfname përmendet si Mevlana Suzi.¹¹

Në epitafin e Suziut, emri i tij është shkruar si “Suzi Zerrini”, ndërsa banorët e Prizrenit e përmendin më shpesh si “Sozi” ose “Sozi Baba”.

Për jetën e Suzi Çelebiut nuk dihet shumë, pasi veprat historike-letërrare turke nuk japin ndonjë shënim për të, e as në veprën e tij nuk gjendet ndonjë informacion i tillë. Vendi i lindjes së tij nuk është i njohur saktësisht, por nga vakëfnameja kuptohet se një pjesë të madhe të jetës e ka kaluar në Prizren.

Në lidhje me prejardhjen e tij ekzistojnë kontradikta të ndryshme. Burimet që trajtojnë jetën e Suziut, kur flasin për nacionalitetin e tij, shpesh tregojnë prirje fanatike. Nëse autori që ka shqyrtuar jetën e Suziut ka qenë me prejardhje sllave, atëherë është përpjekur me çdo kusht të sjellë argumente se Suziu ishte sllav. Një shembull i tillë është Olesnicki, i cili mendimin e tij se Suziu ishte sllav, ose më saktë serb, e mbështet në faktin se “të islamizuarit (myslimanët) e rinj, për të shmangur emrat e mëparshëm me prejardhje joislame, merrnin emrin Abdullah (rob i Zotit), ku marrja e një emri të tillë në fillim ka qenë e shpeshtë... dhe ka qenë e lidhur me myslimanët e rinj serbë apo sllavë.”¹²

¹⁰ Osi, Dr. Maliq, *Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor*, Shoqata numizmatike shqiptare Demastion, Prizren, 2001, f. 67-68.

¹¹ Hasan Kaleshi, po aty, f. 23.

¹² Nexhat Ibrahim, *Suzi Prizrenasi*, Prizren, 1990, f. 9.

Ndërsa, nëse autori ka qenë turk, ai është përpjekur të sjellë argumente se Suziu kishte qenë turk, duke u bazuar në faktin se ai shkroi në gjuhën turke (osmane). Në anën tjetër, kur autori që shkroi për Suziun është shqiptar, ai është munduar të vërtetojë se Suziu, pa asnjë dyshim, ishte me nacionalitet shqiptar.

Duke pasur parasysh mungesën e materialeve të shumta për saktësimin e kësaj çështjeje, nuk mund të themi me siguri se ai ka qenë serb, turk apo shqiptar. Dhe meqë nuk ekzistojnë dokumente të qarta dhe burime të sakta që do ta ndriçonin këtë çështje, qartësimi i këtyre hipotezave mbetet i varur nga zbulimi i dokumenteve të ardhshme.

Suzi Prizrenasi ka punuar në xhaminë e tij si imam dhe në mektebin e tij si mualim (mësues), objekte që i kishte ndërtuar vetë. Njëkohësisht ka shërbyer edhe si kadi. Më pas ka qenë sekretar i përgjithshëm i Ali bej Mihalogllut, me të cilin ka marrë pjesë në beteja, dhe pas vdekjes së tij vazhdoi të punonte si sekretar i Mehmet beut, djalit të Ali beut.

Siç duket, shkollimin e tij nuk e ka kryer vetëm në Prizren, pasi në atë kohë Prizreni sapo ishte pushtuar. Për këtë arsye, ai mund të jetë shkolluar në Edrene ose në Stamboll dhe, pas përfundimit të shkollimit, u kthye në Prizren, ku vazhdoi jetën e tij.¹³

Ai përmendet në histori për ndërtimin e shumë objekteve, si: xhaminë, bibliotekën dhe mektebin me objektet përcjellëse, të cilat formonin një kompleks fetaro-kulturor. Suziu ka ndërtuar gjithashtu edhe urën mbi lumin e Prizrenit, përballë xhamisë së tij. E gjithë kjo lagje sot njihet si Lagjja e Suzi Çelebiut. Ekzistojnë edhe gojëdhëna që thonë se ai ka ndërtuar një kanal uji me gjatësi 5-7 km.

Ndër veprat e rëndësishme që ka lënë është poema e tij me titull **Gazâvatnâme-i Ali Bey Mihaloglu** ("Libri i pushtimeve të Ali bej Mihalogllut"), e cila ka një rëndësi të veçantë në poezinë turke si edhe në historinë osmane.

¹³ Aleksije Olesnicki, "XV-XVI yuzyl sair ve tarihci Prizrenli Suzi Çelebi'nin ozgecmis'i", Zagreb, 1934, Prizrenli Suzi'nin 500. yili (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000, f. 96.

Ai gjithashtu ka shkruar edhe poezi didaktike-satirike, si dhe në poezive të Nexhatiut u ka shkruar *nazire*, të cilat janë poezi si imitim i poezive të tjera, duke pasur formën dhe rimimin e njëjtë.¹⁴

Kemi shumë legjenda lidhur me jetën e Suziut, të cilat nuk dihet nëse janë të sakta apo jo. Njëra prej tyre tregon se, kur ai u kthye nga Stambolli pasi kishte kryer shkollimin, gjatë rrugës në Tetovë u bë dëshmitar i një kadiu që merrte ryshfet. Kur e pa këtë, Suziu i shkroi sulltanit një letër në vargje, ku denonconte tiraninë e këtij kadiu. Ky gjest i Suziut i pëlqeu sulltanit, prandaj me “temlik-nâmenë” e viteve 1512-1520 ia dhuroi atij të dhjetën e të ardhurave të fshatit Grazhdanik. Nga vakëfnameja shihet se kjo dhuratë iu bë atij dhe se ai e kishte lënë si vakëf për nevojat e xhamisë dhe të mektebit të tij.¹⁵

Suzi Prizreni ka qenë njohës i mirë i gjuhës turke, arabe dhe persiane. Për të thuhet se ka vdekur si shehid, por kjo, me sa duket, nuk është e vërtetë, sepse po të kishte rënë dëshmor, do të ishte varrosur në vendin ku kishte rënë, i cili përmendet si Nasheci. Ndërkohë dihet se ai është i varrosur në oborrin e xhamisë së tij. Për më tepër, dokumentet e asaj periudhe nuk shënojnë ndonjë betejë në atë vend gjatë viteve 1524-1525, dhe as në epitafin e tij nuk ka ndonjë aludim se ai ka vdekur si shehid.¹⁶ Sidoqoftë, Suziu vdiq në Prizren në vitin 931 hixhri (1524-1525), në kohën e sulltan Bajazitit. Varri i tij gjendet në oborrin e xhamisë së tij, pranë varrit të vëllait të tij, Nehariut, dhe që të dy janë të rrethuar me katër mure, të cilat nuk kanë kulm mbi to. Në epitafin e Suziut shkruhet:

المتوفى المرحوم المغفور - I ndjeri, i mëshiruari, i faluri

سوزى زرينى - Suzi Zerrini

في تاريخ سنة - Vdiq në vitin

تسعمئة و احدى و ثلاثين - Nëntëqind e tridhjetë e një

رحمة واسعة¹⁷ - Pastë mëshirë të gjerë

¹⁴ Hasan Kaleshi, “Prizreni qendër kulturore gjatë periudhës turke”, Hikmet- Revishtë shkencore, nr.10, Prishtinë, 2015, f. 25.

¹⁵ Po aty, f. 21.

¹⁶ Nexhat Ibrahim, *Suzi Prizrenasi*, Grafo-art d.o.o. Sarajevo, Prizren, 1990, f. 13.

¹⁷ Mr.Hamit Altıparmak, “Mevlana Suzi Zerrini camii haziresinde mezartaş kitabeleri”, Suzi Çelebi/Araştırma İnceleme, Bay yayınları, Prizren, 1998, f. 217.



Foto e mbishkrimit të varrit të Suzi Çelebiut

1.2. Vepra “Gazâvatnâme-i ‘Ali-beg Mihalo lu” e Suziut

Vepra e vetme e shkruar e Suziut sot gjendet në katër kopje të shpërndara në vende të ndryshme: njëra është kopja e Berlinit me 1795 bejte (ose 1688 bejte sipas H. Kaleshit), kopja e Zagrebit me 216 bejte (ose 217 bejte sipas H. Kaleshit), e cila është gjetur në vitin 1929 nga Akademia Jugosllave në Zagreb, kopja e Ali Emirit, si dhe kopja që gjendet tek Agâh Sırrı Levendi.¹⁸

Franz Babingeri, gjatë analizës së dorëshkrimit që kishte në duar, thotë se ky dorëshkrim është pronë e Akademisë Jugosllave dhe mban emrin

¹⁸ Agâh Sırrı Levend, *Gazavat-nameler ve Mihaloğlu Ali bey'in gazavat-namesi*, Türk tarih kurumu, Ankara, 2000, f. 205.

“Tevarich al-Osman”, që tregon se përmban diçka nga historia osmane. Burimet tregojnë se ky dorëshkrim ka prejardhje nga Prizreni. Vjetërsia e kësaj vepre kuptohet nga turqishtja e vjetër e shkruar. Babingeri gjithashtu thotë se ekziston mundësia që kjo vepër të ketë qenë në duart e francezëve për një kohë të gjatë dhe se ajo ka arritur në Gjermani përmes kompanisë Bernard Quaritch nga Londra.¹⁹

Hulumtimin më të thelluar të veprës së Suziut e ka bërë letrari Agâh Sırrı Levendi, i cili në vitin 1956 realizoi edhe botimin e saj me gjithsej 1795 bejte. Ai krahasoi kopjet e gjetura deri më tani të veprës dhe u bëri atyre analizë kuptimore dhe gramatikore.

Vepra “Gazâvatnâme-i ‘Ali-beg Mihaloğlu” është shkruar në metrin poetik mesnevi, ku rimon vargu i parë me të dytin.²⁰

Suziu, kur fillon të shkruajë për dashurinë romantike të Ali beut me Merjemen, e përmend Isa Beun, i cili bie dëshmor në vitin 884 h./1479 m. Sipas kësaj të dhëne, mund të konkludojmë se Suziu e ka filluar shkri-min e veprës pas këtij viti.²¹

Vepra e Suziut është origjinale në shumë aspekte. Ai nuk filloi ta shkruante veprën rastësisht, pa ndonjë qëllim të caktuar, por kishte për qëllim që t’i përshkruante *akinxhinjtë*²² e Ali Beut. Një aspekt tjetër të

¹⁹ Franz Babinger, “*Suzi’nin el yazmalari*”, Prizrenli Suzi’nin 500.yili (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000, f. 67.

²⁰ Hasan Kaleshi, “*Prizreni qendër kulturore gjatë periudhës turke*”, Hikmet- Revistë shkencore, nr.10, Prishtinë, 2015, f. 25.

²¹ Agâh Sırrı Levend, po aty, f. 200.

²² Akinxhinjtë kanë qenë pjesë e ushtrisë osmane, detyra e të cilëve ishte të shkonin në vendet që synoheshin për pushtim dhe, përmes robërve që zinin, të merrnin informacionet e duhura për ato vende. Këta akinxhinj ndodheshin në një largësi prej rreth 4-5 ditësh nga ushtria kryesore, ku hulumtonin rrethinën dhe bënëin përgatitjet e nevojshme për ushtrinë, si hapjen e rrugëve për kalimin e saj, parandalimin e kurtheve të mundshme nga armiku dhe, nëse kishte nevojë, ndërtimin e urave për kalimin e trupave. Kjo pjesë e ushtrisë e ka marrë emrin “akıncı” për shkak të lëvizjes së tyre shumë të shpejtë në territoret armike, duke i frikësuar ata pa masë. (Shih: Mr. Bedrettin Koro, “Osmanlı İmparatorluğunda Akıncılar ve Mihaloğlu

originalitetit të Suziut studiuesit e shohin te mënyra poetike e përshkrimit të ngjarjeve historike. Në realitet, shumica e autorëve që shkruanin vepra të këtij lloji i paraqisnin ngjarjet në formë dokumentare dhe me një gjuhë të thjeshtë. Ndërsa Suziu nuk e bën këtë gjë, por ngjarjen historike e rrëfen me një gjuhë poetike, gjë që e bën atë tejet original dhe të pashoq.²³

Veprat e quajtura “*Gazâvatnâme*”, në të shumtën e rasteve kanë për qëllim informimin e popullit me betejat e kohës, si dhe nuk kanë ndonjë gjuhë arti të thellë, por janë të thjeshta²⁴; ndërsa, Suziu është origjinal në këtë aspekt, ngase ai i përshkruan ngjarjet e kohës me një gjuhë artistike.

Fjala “*gazâvatnâme*” rrjedh nga fjala e gjuhës arabe “*gaza/gazve*”, që do të thotë “*betejë*”, “*luftë*”, si dhe nga fjala perse “*nâme*” që do të thotë “*libër*”. Veprat letrare që përshkruanin kësolloj betejash, në letërsinë arabe janë të njohura me emrin “*megaza*”, kurse me përhapjen e akinxhinjve, përgjatë shekujve XV-XVI, këto u bënë pjesë edhe të letërsisë osmane, duke e marrë emrin “*gazâvatnâme*”. Në letërsinë turke kemi edhe emra të ngjashëm veprash që i ngjajnë njëra-tjetrës, por që dallojnë në disa aspekte, si **zafernâme** dhe **fetihnâme**. Ndryshe nga këto, në **gazâvatnâme** nuk kemi të bëjmë me çlirimin e ndonjë vendi apo me një fitore të caktuar.²⁵

Zakonisht këto vepra, duke qenë përshkrim i jetës së ndonjërit prej sulltanëve, e marrin emrin e tij, sikurse, për shembull: “*Gazavat-ı Hayreddin Paşa*”, “*Gazavat-ı Yusuf Paşa*”²⁶; prandaj, edhe kjo poemë e Suziut është emërtuar në bazë të personazhit kryesor të poemës, pra, Ali Beut.

Ali Beu, të cilit i është kushtuar ky libër, është pasardhës i familjes Mihalogllu, e cila kishte qenë pjesë e akinxhinjve që nga koha e Osman

Gazi Ali Bey”, **Prizrenli Suzi’nin 500. yılı (Bildiriler, bilgiler, belgeler)**, Kosovo Türk Yazarlar Derneği, Prizren, 2000, f. 39!)

²³ Po aty, f. 208.

²⁴ Okt. Kürşat Şamil Şahin, “*Gazavatnamelerde edebi savaş tasvirleri*”, f. 235.

<http://dergipark.ulakbim.gov.tr/tubar/article/viewFile/5000123193/5000117090>.

²⁵ Po aty, f. 236.

²⁶ Po aty, f. 237.

Gaziut. Paraardhësi i Ali Beut, Kyse Mihali, pasi pranoi Islamin, u bë person i afërt i Osman Gaziut, hyri në shërbimin e tij dhe mori pjesë në shumë beteja. Kjo familje, me pasardhësit e saj, ka qenë gjithmonë pjesë e akinxhinjve, duke dhënë kontribut të madh dhe duke marrë pjesë në shumë beteja.²⁷

Për shkak të frikës që populli kishte ndaj Ali Beut, shpeshherë është përhapur lajmi se ai kishte vdekur. Për këtë arsye ekzistojnë shumë kontradikta lidhur me datën e saktë të vdekjes së tij, si dhe për faktin nëse ai u vra në ndonjë luftë apo jo. Komandantët austriakë, duke parë frikën që populli ndiente vetëm duke dëgjuar emrin e Ali Beut, disa herë kanë deklaruar se e kishin zënë dhe e kishin vrarë, vetëm për ta qetësuar popullin.²⁸ Mirëpo, dihet se Ali Beu, për shkak të shtyrjes së moshës, nuk kishte më mundësi të merrte pjesë me akinxhinjtë dhe u vendos në Plevne, ku edhe vdiq rreth viteve 909-913 h. / 1503-1507 m., përtej moshës 100-vjeçare. Ai u varros në tyrben e xhamisë që kishte ndërtuar vetë. Pas Ali Beut, edhe pasardhësit e tij vazhduan të merrnin pjesë në formacionet e akinxhinjve; kështu, pesë djemtë e tij: Hasani, Ahmeti, Mehmeti, Hëziri dhe Kara Mustafai, ranë shehid nëpër beteja të ndryshme.²⁹

Autori Sehi e regjistron numrin e bejteve të veprës së Suziut me shifrën 15.000, të cilën e përcjellin edhe shumë autorë të tjerë të biografisë së tij. Në librin e tij *Heşt-Bihişt* për Suziun ai shkruan: *Mihaloğlu 'Ali Beğ itdigi gazâları nazmidûp onbeş bin beyit miķdârı yazup kitâp it-mişdür* ("Akinxhinjtë e Mihaloglu Ali Beut i ka shkruar në pesëmbëdhjetë mijë vargje, të cilat i mbledhi në një libër"). Mirëpo, duke qenë se nuk janë gjetur të gjitha bejtet e shkruara prej tij, dalin mendime të ndryshme mbi atë se çfarë ndodhi me pjesën tjetër të bejteve të pagjetura ose nëse këto bejte kanë ekzistuar vërtet apo jo. Agâh Sırrı Levendi thotë se *Gazâvatnâme*-ja mund të jetë vetëm kjo që kemi në dorë dhe nuk ka diçka më tepër, ndërsa Sehi këtë informatë mund ta ketë dëgjuar nga të tjerët

²⁷ Agâh Sırrı Levend, *Gazavat-nameler ve Mihaloğlu Ali bey'in gazavat-namesi*, Turk tarih kurumu, Ankara, 2000, f. 184.

²⁸ Mr.Bedrettin Koro, po aty, f. 39.

²⁹ Agâh Sırrı Levend, po aty, f. 195.

dhe pastaj e ka regjistruar. Një tjetër mundësi është se ndoshta Suziu e kishte planifikuar që vepra e tij të ishte më e gjatë, duke përmbledhur edhe gjëra të tjera, por nuk arriti ta përfundojë. Ndërsa një mundësi tjetër është se vepra me të vërtetë ka pasur 15.000 bejte, por deri më sot janë gjetur vetëm kopjet e përmendura më lart, ndërsa për pjesën tjetër nuk dihet asgjë.³⁰

Ngaqë vepra është poetike, nuk mund të thuhet se ajo i përshkruan me saktësi absolute të gjitha realitetet historike të kohës. Prandaj, ky aspekt mbetet për t'u verifikuar edhe përmes hulumtimit të veprave të tjera që përshkruajnë të njëjtën periudhë historike.

Një nga ngjarjet që ka nxjerrë pas vetes shumë legjenda është mënyra se si është takuar Osman Gaziu me paraardhësin e Ali Beut, Kyse Mihalin. Në bejtin e 296-të dhe në bejtet në vijim, Suziu përshkruan mënyrën se si janë takuar Osman Gaziu dhe Kyse Mihali, ku thotë se Osman Gaziu i kishte shkruar letër Kyse Mihalit që t'i vinte në ndihmë. Kyse Mihali niset dhe, në tendën ku pushon, e sheh në ëndërr pejgamberin Muhamed, a.s., i cili e thërret pranë vetes dhe i thotë që të shkojë te Osman Gaziu dhe aty ta pranojë Islamin. Kyse Mihali, pas ëndrrës, vepron ashtu siç i ishte thënë: para Osman Gaziut e pranon Islamin dhe pas kësaj ngjarjeje këta të dy bëhen miq të ngushtë. Më pas, Osman Gaziu e vendos Kyse Mihalin në krye të ushtrisë³¹, ku Suziu, në bejtin e 419-të, thotë kështu:

Şeh ol günden Mihâlî yâr idindi (*Prej asaj dite Shehu (Osman gaziu)*
u bë me Mihalin mik

Çeriye baş diküp ser-dâr idindi³² *e bëri komandant dhe e vendosi në*
krye të ushtrisë)

Hasan Kaleshi bën përkthimin e bejtit të 1096-të, dhe të disa bejteve të tjera në vazhdim, ku Suziu ka përshkruar Mihajil Szylagynë, i cili ishte zënë rob nga ana e osmanëve:

³⁰ Po aty, f. 205.

³¹ Po aty, f. 218

³² Po aty, f. 260.

Şaşın haddünden aşma kim zamâne *Ruaju, mos i kalo kufijtë e tu,*
se fati
Gülünç eyler senı halk-ı cihâna *Të bën qesharak përpara njerëzve*
të botës
Şaşın gerden-firâz olma qarındaş *Vëlla bëhu i matur, mos e ngre*
lart kokën,
Felek cellâddür her gün keser baş *Qielli është gjakosur, çdo ditë*
shkurton nga një qafë
Var ayak başma güstâhâne zinhâr *Ec, por me kujdes, mos i zgjat*
shumë hapat,
Ki her adım yer üzre biñ tuzak var *Se në çdo hap ka mijëra pengesa*
e po ngatërroresh!
Siper gibi göğüs germe cihâna *Mos ia hap botës kraharorin si*
mburojë
K'olursiñ tirine çerhuñ nişâne *Se do t'bëhesh nishan i shigjetave*
qiellore,
Qalur şanma saña bu taht-gâhı *Princ, mos mendo se përgjithmonë*
të mbetet kulltuku
Ki devrân kapdı Husrevden külahı³³ *Sepse Husrevit (mbret persian -*
*H. K.) fati kurorën i zhduku!*³⁴

Pas përkshkrimit të akinxhinjve dhe betejave deri në bejtin i 1160-të, Suziu vazhdon të shkruajë për dashurinë e Ali Beut me Merjemen, e cila ishte kroate dhe vajza e një princi të Vllahisë. Këtë ngjarje ai e ka dëgjuar nga të tjerët, pasi mendohet se ai hyri në shërbim të Ali Beut rreth viteve 885-896 h. / 1480-1490 m., ndërkohë që në këtë periudhë Ali Beu tashmë ishte i martuar.³⁵

³³ Ağah Sırrı Lgcevend, *Gazavat-namesler ve Mihaloğlu Ali bey'in gazavat-namesi*, Turk tarih kurumu, Ankara, 2000, f. 309.

³⁴ Hasan Kalesh, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame*, Logos-A, Shkup, 2013, f. 24-25.

³⁵ Hasan Kaleshi, po aty, f. 200.

Për faktin se ai nuk i ka shkruar vetëm ngjarjet që i ka përjetuar, por edhe ato që i ka dëgjuar prej të tjerëve, dëshmon edhe bejti i 210-të, ku thotë:

Ne gördün ne işitdünse beyan it, *(Tregoja botës gjithë atë që e ke parë e dëgjuar*

Cihana gün gibi anı iyan it.³⁶ *Duke e shfaqur atë të pastër si dita)*

Suziu tregon se, në atë kohë, nëpër muret e kishës vendoseshin pikturat e komandantëve dhe trimave të shumtë osmanë të asaj kohe, si të Mal-koç Ahmed Bej Evrenosit, Ymer Bejogllit, si dhe të Ali Beut. Merjemja, e cila kishte ardhur në kishë së bashku me shoqen e saj, Banu, e sheh pikturën e Ali Beut dhe dashurohet në të. Këtë ngjarje Suziu e përshkruan nga bejti i 1341-të e në vijim, ku edhe përfundon vepra me këtë ngjarje.³⁷

Bu kişverde belürse bir dilâver *(Kur paraqitej në këtë vend ndonjë trim*

Olurdi ol kelisâda musavver *Pikturohej ai aty në kishë*

‘Ali Beğ naşsını çün gördi ol cân *Kur e pa pikturën e Ali beut ky shpirt*

Kelisâ naqşı gibi kaldı hayrân³⁸ *Mbeti e mahnitur sikur piktura e ki)*

³⁶ Agâh Sırrı Levend, po aty, f. 244.

³⁷ Aleksije Olesnicki, “XV-XVI yuzyıl sair ve tarihçi Prizrenli Suzi Çelebi’nin özgeçmiş”i, Zagreb, 1934, Prizrenli Suzi’nin 500.yılı (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000, f. 96.

³⁸ Agâh Sırrı Levend, po aty, f. 326, 328.

2. VAKËFET E SUZI ÇELEBI PRIZRENASIT

Edhe pse fjala *vakëf* nuk përmendet në Kuran, kemi shumë këshilla kuranore dhe pejgamberike që nxisin për ndihmesë të njëri-tjetrit. Vakëfi, si institucion i lejuar dhe me një pozitë të veçantë në jetën e myslimanëve, ashtu si zekati, sadakaja dhe kurbani, ka për qëllim shërbimin shoqëror dhe ndihmesën ekonomike.³⁹ Vakëfi, si institucion, ka qenë praktikë e vetë Muhamedit a.s. dhe e shokëve të tij, e cila më pas u kthye në traditë të myslimanëve përgjatë shekujve dhe u vazhdua edhe nga osmanët.⁴⁰

Si pjesë e Perandorisë Osmane dhe si praktikues i traditës së vakëfeve në Prizren, ka qenë edhe Suzi Zerrini, i cili ka lënë vakëfe të shumta. Ai ndërtoi një xhami, një mekteb (shkollë) pranë xhamisë, një urë guri mbi Lumbardhin e Prizrenit përballë xhamisë së tij, si dhe një kanal të gjatë prej 7 kilometrash, nga Lumbardhi deri në Grazhdanik, për ujitjen e tokave të tij në këtë zonë.⁴¹ Me gjithë gojëdhënat në Prizren, që flasin për ndërtimin e këtij kanali me iniciator vetë Suziun, siç shihet, ai e ka bërë vetëm rindërtimin, ngase ky kanal ka ekzistuar edhe më herët,⁴² kurse pas rinovimit kalonte përmes lumit të Prizrenit, afër xhamisë së Mehmet Pashës, si dhe nëpër rrethinën e tij, Tabakhanen.⁴³ Suziu ndërtoi gjithashtu edhe një krua, ujin e të cilit e solli nga “Bunarllëku”, dhe që konsiderohet të jetë ujësjellësi më i vjetër në Prizren, me një gjatësi prej 2 kilometrash.⁴⁴

Vakëfet e tij Suziu i legalizon në vitin 1513, e të cilat i përmend edhe në vakëfnamenë e tij.

³⁹ Prof. Dr. Ziya Kazıcı, *İslam medeniyeti ve müesseseleri tarihi*, İFAV, İstanbul, 2006, f. 278.

⁴⁰ Prof. Dr. Mehmed Maksudoğlu, *Historia osmane dhe institucionet*, ALSAR, Tiranë, 2013, f. 672.

⁴¹ Abib Ahmeti, *Theranda-Prizreni ndër shekuj*, Orient, Prizren, 1996, f. 74.

⁴² Hasan Kaleshi, “Prizreni qendër kulturore gjatë periudhës turke”, Hikmet- Revishtë shkencore, nr.10, Prishtinë, 2015, f. 22.

⁴³ Prof. Dr. Esat Haskuka, *Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve*, Shtypshkronja “Kosova”, Prizren, 2003, f. 205.

⁴⁴ Po aty, f. 201.

Ja përkthimi i vakëfnames së tij në gjuhën shqipe:

“E kam marrë origjinalin e vakëfnames prej Osman Efendiut, djalit të

Hëzër Efendiut

E kam mbrojtur origjinalin e vakëfnamesë me të gjitha kushtet e saja

Unë Osmani, djali i Sylejmanit

Kadiu i Pyrzerrinit dhe i Suhrikës

Falënderimi i takon Allahut, i Cili e krijoi Ademin nga asgjëja dhe e solli Isain në këtë botë pa mashkull; i dha dritë Diellit e Hënës; nxjerr zjarrin nga lisi dhe ujin nga guri; e bëri këtë botë vendkalim dhe Xhenetin shpërblim për atë që falënderon, ndërsa zjarrin e bëri dënim për atë që mohon. Ai është i Cili vendosi dhe caktoi, pastaj krijoi të blertën (Xhenetin) dhe të kuqen (Xhehenemin), e më pas e shpalli fjalën e Tij triumfuese atëherë kur ai (Musai, paqja qoftë mbi të!) kërkoi ujë për popullin e tij dhe fitore, e iu tha: **“Bjeri gurit me shkopin tënd”**⁴⁵, dhe i mëshoi, dhe me urdhrin e Tij uji shpërtheu.

E nderoi të Dashurin e Tij të pastër (Muhamedin, a.s.), duke ia falur të gjitha mëkatet e kaluara dhe të ardhshme, dhe i dha atij mirësitë më të mëdha.

Dhe Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: *“Ne vërtet të dhamë ty shumë të mira, prandaj ti falu dhe ther kurban për hir të Zotit tënd! E, s’ka dyshim se urrejtësi yt është farësosur.”*⁴⁶

Dëshmojmë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut; Ai është Një, nuk ka shok. Ai urdhëron për të mira dhe ndalon nga e keqja. I Lavdëruar është Ai, dhe përmendja e Allahut është më e madhja. Çdo lavd dhe madhështi i takon Atij, i Cili ekziston pa pasur nevojë për asgjë.

Dhe dëshmojmë se Muhammedi, paqja qoftë mbi të, është robi dhe i dërguari i Tij, zotëria i njerëzisë, paralajmëruesi i popullit, për të cilin Hëna u nda në dysh. Salatet qofshin mbi zotërinë dhe të dërguarin tonë Muhammedin, paqja qoftë mbi të, mbi çdo sy që sheh dhe mbi çdo vesh

⁴⁵ *Kur’ani fisnik-Përkthim i kuptimeve të tij në gjuhën shqipe*, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, Medine, 1434 h., f. 20.

⁴⁶ Po aty, f. 1268.

që dëgjon, mbi familjen e tij, shokët e tij, fëmijët e tij, gratë e tij të pastra dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin atë.

Mevlana Suzi e kuptoi se jeta e kësaj bote, ashtu si edhe koha, është e kalueshme, ndërsa jeta në botën tjetër është e përhershme. Prandaj, për hir të Allahut të Madhërishëm dhe në kërkim të kënaqësisë së Tij, ai shprehet kështu: *“Padishahu i kohës, Sulltan Selimi, për shkak të mirësisë dhe zemërgjerësisë së tij, ia ka dhuruar Mevlana Suziut sipërfaqen në Grazhdanik brenda këtyre kufijve: në anën lindore dy lisa të mëdhenj dhe livadhi i Kemalit; në anën jugore, fshatrat Lika dhe Vlashna; në anën perëndimore, fshatrat Gorica dhe Nashec; ndërsa në anën veriore, rruga kryesore që vjen nga qyteti dhe shkon në fshatin Tupec.”*

Nga 10 pjesët e të ardhurave të gjithmbarshme, 250 akçe ia jep çdo vit sipahisë (kalorësisë) së tij.

Pas kësaj, Mevlana Suziu nga kjo dhuratë që i është dhënë për vakëf i lë:

Prodhimin që vjen nga livadhi dhe ara e fermës, të gjitha gjallesat që gjenden aty, si dhe gjithë prodhimin që vjen prej tyre; mulliri me katër gurë, i cili ndodhet mbi lumin që vjen nga qyteti; si edhe dy livadhet e mëdha, përmes të cilave kalon një përroskë.

Vajzës së tij, Aishes, ia lë vakëf livadhin që ndodhet në anën jugore, si dhe shtëpitë që gjenden brenda fermës në anën perëndimore, të cilat kufizohen me anën veriore nga rruga kryesore që vjen nga qyteti.

Në vazhdim të vakëfnamesë thuhet: *“Brenda qytetit të Pyrzerrinit, në lagjen Iljaz Kuka, ndërtesa që e kam ndërtuar pranë lumit me emrin Bistrica: kjo ndërtesë sipër është mesxhid, ndërsa poshtë është mësonjëtorë. Përderisa jam gjallë, unë do të jem imami, mësuesi dhe myezini. I gjithë prodhimi i përmendur më parë më takon mua. Pas meje, imami dhe mualimi (mësuesi) do të jenë një person i vetëm, si dhe myezini dhe mësonjëtorja do të menaxhohen me këto të ardhura. Këta dy persona do të jenë poseduesit e tre pjesëve të vakëfit.*

Livadhin e përmendur duhet ta mbikëqyrin imami dhe myezini dhe, nëse ka nevojë për ndonjë riparim, ai të bëhet duke përdorur të ardhurat e përgjithshme të saj. Të gjitha nevojat e tjera të kryhen duke përdorur

po këto të ardhura. Kushtëzot që banuesit e lagjes, me lejen e kadiut, për hir të Zotit, ta mbikëqyrin vakëfin.

Livadhi në Grazhdanik i takon vajzës sime, Aishes, përderisa ajo është gjallë, ndërsa pas saj, ashtu siç është përcaktuar më sipër, i takon imamit dhe myezinit.

Kurse disa libra të vlefshëm, të cilët gjenden në bibliotekën e Mevlana Suziut, i lë vakëf me këto kushte: dy vëllime të 'Tefsir-i Shejh', dy vëllime 'Hidaje', një vëllim 'Mesnevi' dhe dy vëllime 'Kimja-i Saadet'. Përderisa jam gjallë, unë do të jem pronar i tyre (dorëshkrimeve), ndërsa pas vdekjes sime për to do të kujdeset imami i xhamisë sime. Imami le t'ua japë ato (dorëshkrimet) në huazim dijetarëve dhe atyre që janë në gjendje të përfitojnë prej tyre, të cilët do të lexojnë lutje (salavate) për shpirtin tim.'".

Muaji Rebiul-ahir i vitit nëntëqindenëntëmbëdhjetë

Dëshmitarët prezentë janë:

- Tabbak Hussam
- Tabbak Nasuh
- Kemâl Beg Jahshi
- Tavi Mustafa
- Ali Çelebi, El xhyndi
- Pir Ahmed Beg
- Kemâl Beg, El xhyndi
- Mevlana Nehari
- Myhyrdârzade Mustafa Çelebi
- Ibrahim Halife, El myezzin
- Iliyaz Halife, El imâm
- Ali Çelebi - Myezzin Suzi
- Iliyaz Çelebi Groshzade
- Piri Halife, El imam
- Çelebi Efendi, myderriz zade
- Abbaz Beg, Elxhyndi
- Bekri Çelebi, El myezzin, ibni Mahmud Halife
- Elhaxh Yakup
- Elhaxh Iliyaz

- Hasan Çavush
- Mustafa Bin...
- El haxh Ramadan, El dibag

2.1. Xhamia

Xhamia e Suziut gjendet në lagjen Tabakhane të Prizrenit, e cila ka qenë e njohur me përpunimin e lëkurave,⁴⁷ e që si zeje u zhvillua buzë lumit, për shkak se përpunimi i lëkurave ishte i lidhur ngushtë me ujin; më pas, në të njëjtën rrethinë u formuan edhe shumë objekte banimi, si dhe objekte ekonomike.⁴⁸



Figure 1: Pamja e jashtme e xhamisë së Suziut

⁴⁷ Mr. Marjan Prenkaj, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX*, Instituti i historisë, Prishtinë, 1998, f. 56.

⁴⁸ Prof. Dr. Esat Haskuka, *Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve*, Shtypshkronja “Kosova”, Prizren, 2003, f. 221.

Dihet se kjo rrethinë ishte e banuar në kohën kur Suziu ndërtoi xhaminë e tij. Mbishkrimi i xhamisë, edhe pse ka ekzistuar, nuk është ruajtur deri më sot; prandaj nuk kemi një informatë të saktë lidhur me vitin e ndërtimit të saj. Megjithatë, supozohet se Suziu e ka ndërtuar xhaminë e tij pasi u kthye në Prizren në vitin 1510. Fillimisht ajo ishte ndërtuar si mesxhid, gjë që vërtetohet edhe nga dokumenti me numër AMKT DV 188/44, i cili gjendet në Arkivin Osman të Kryeministrit të Turqisë, ku thuhet se kjo xhami ka qenë mesxhid edhe në vitin 1277 h./1857 m.⁴⁹, ndërsa më vonë i është shtuar edhe minarja, nga ana e një personi që quhej Ymer begu, në vitin 1861, dhe që nga atëherë e ka marrë formën e xhamisë.⁵⁰

Suziu e ka ndërtuar xhaminë e tij në anën e majtë të Lumbardhit të Prizrenit. Xhamia është e ndërtuar në formë katrore me përmasa 8.60 x 8.60 m, me mure 100 cm të trasha, e mbuluar me dy kulme: i pari katërstrehësh, ndërsa tjetri tristrehësh. Kubeja brenda xhamisë është tetëkëndëshe, e punuar në dru, dhe mbulohet nga çatia me tjegulla.⁵¹ Deri në vitin 1978, para renovimit të saj, çatia ishte e mbuluar me gurë të shumtë.⁵²

Xhamia nga brenda është e ngjyrosur me ngjyrë të bardhë, ndërsa pjesa e poshtme është e lyer me ngjyrë krem. Ajo ka gjithsej 14 dritare, dhe mbi mihrab ndodhet një dritare e rrumbullakët. Shtatë dritaret e poshtme janë drejtkëndëshe, ndërsa mbi to gjenden gjashtë dritare të tjera, po ashtu drejtkëndëshe, të cilat mbi vete kanë edhe nga një gjysmëhark.

Çatia njëkatëshe e xhamisë ka një thellësi prej 4,15 metrash, është e mbështetur mbi 10 shtylla druri dhe ka një tavan të rrafshët, gjithashtu prej druri. Në anën e majtë gjendet një mihrab i hapur në mur, ndërsa në

⁴⁹ “*Suzi (Sozi) camii*”, Prizrenli Suzi’nin 500.yili (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000, f. 113.

⁵⁰ Raif Vırmiça, *Kosova’da osmanlı mimari eserleri*, T.C.Kultur bakanlığı osmanlı eserleri, TÜRK TARİH KURUMU BASIMEVİ, Ankara, 1999, f. 45-47.

⁵¹ Raif Vırmiça, *Suzi ve vakıf eserleri*, TAN Yayınları, Priştine, 1998, f. 49.

⁵² Mr. H. Altıparmak – A.S. Recepoğlu, “*Suzi (Sozi) Camii*”, Suzi Çelebi/Araştırma İnceleme, Bay yayınları, Prizren, 1998, f. 208.

anën e djathtë një dritare e mbyllur. Edhe kjo pjesë është e ngjyrosur me ngjyrë të bardhë.

Xhamia ka edhe një oborr të madh, pjesa e përparme e të cilit është e rrethuar me shufra hekuri, ndërsa hyrja në oborr bëhet nga ana e djathtë e xhamisë. Oborri përmban rreth 30 varre, disa prej të cilave kanë mbi-shkrime e disa jo. Në mesin e tyre ndodhen edhe varret e Suziut dhe të vëllait të tij Nehariut, të cilat, ndryshe nga varret e tjera, janë të rrethuara me mure.⁵³

Xhamia është ende në funksion edhe sot, falë renovimeve të shumta që janë bërë ndër vite. Sigurisht që ajo nuk ka pasur gjithmonë pamjen që ka sot, gjë që u bë e dukshme pas renovimit të vitit 1993. Megjithëse dikur nuk ishte aq e zbukuruar, ajo përfaqësonte artin e shekullit XVI dhe konsiderohej si një nga arkitekturat më të vjetra në Prizren. Në muret e saj kishin qenë të varura shkrime kuranore në forma rrumbullake dhe katrore, ndërsa tavani ishte prej druri, me një dizajn të veçantë dhe i ngjyrosur me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë.⁵⁴

Në xhami sot falen të pesë kohët e namazit, ndërsa ligjëratat mbahen në gjuhën shqipe. Imamët që kanë shërbyer në këtë xhami dhe janë mbajtur mend nga xhemati për kontributin e tyre janë: Shykry Efendiu, Hafëz Fet’hi Mydyti, Hafëz Kemal Kajseri dhe Nusret Hafëzi, duke mos harruar se edhe vetë Suziu, në kohën e tij, ka qenë imam i kësaj xhamie. Gjatë kohës së Hafëz Kemal Kajseriut (deri në vitin 1970), namazet janë falur me hatme dhe ligjëratat janë mbajtur në gjuhën turke. Xhamia, së bashku me çardakun, ka një kapacitet prej rreth 200 personash. Renovimi i fundit i saj është bërë në vitin 2005, ku ndër të tjera është ndërtuar edhe abdesthanja.⁵⁵

⁵³ Mr. Hamit Altıparmak, “*Mevlana Suzi Zerrini camii mezartaş kitabeleri*”, Suzi Çelebi/Araştırma İnceleme, Bay yayınları, Prizren, 1998, f. 217.

⁵⁴ Raif Viriçiça, *Prizren Camileri*, TBD Yayınları, Prizren, 1996, f. 48-49.

⁵⁵ Raif Viriçiça, *Camiler kenti Prizren*, Bashkësia islame e republikës së Kosovës & Kosova türk araştırmacılar derneği, Prizren, 2016, f. 249.

2.2. Mektebi

Arsimimi dhe edukimi i popullsisë myslimane në vendet ku ata banojnë ka qenë njëra nga preokupimet kryesore të njerëzve të vetëdijshëm për rëndësinë e dijes.

Kjo nevojë, në fillimet e saj, u shfaq nëpër xhamitë e ndërtuara në këto vende, të cilat ofronin arsimim për myslimanët. Megjithatë, kjo praktikë kishte disa probleme, pasi zhurma e nxënësve gjatë mësimit dhe pyetjet e shumta të bëra me zë të lartë përbënin pengesë për ata që mundoheshin t'i përkustoheshin adhurimit të Zotit. Si pasojë, prishej qetësia dhe besimtarët që falnin namazin shqetësoheshin.⁵⁶

Dëshira për realizimin e kësaj nevoje për dije çoi në ndërtimin e vendeve të posaçme për mësim-nxënie. Këto vende u ngritën pranë xhamive dhe u quajtën *kuttabe* ose *mektebe* (nga fjala *ketebe* – shkroi, shkruan), ndërsa te ne kanë kuptimin e shkollës fillore. Më pas, u hapën edhe shkollat e mesme dhe të larta, të cilat quheshin *medrese*.⁵⁷



Figure 2: Pamja e sotme e mektebit të Suziut

⁵⁶ Prof. Assoc. Dr. Jani Sota, “Institucionet fetare islame dhe roli i tyre në zhvillimin e jetës arsimore, kulturore dhe fetare-shpirtërore të shqiptarët”, *Edukata Islame-revistë shkencore kulturore islame*, nr. 106, Prishtinë, 2014, f. 67.

⁵⁷ Jashar Rexhepagiq, “Faltore, institucione dhe qendrat islame në Kosovë(xhami, teqe, kutubhane, vakëfe)”, *Edukata islame- revistë shkencore kulturore islame*, nr. 65, Prishtinë, 2001, f. 80.

Në Ballkan, institucionet e para mësimdhënëse në formë të shkollave të mesme dhe të larta ishin *medreseja e sulltan Muratit II në Shkup (1438)* dhe *medreseja e Is'hak Beut*, po ashtu në Shkup, e cila kishte famë të madhe dhe ishte ndër më të njohurat në Rumeli (u ndërtua më 1445).⁵⁸

Këtë traditë osmane të ndërtimit të mektebeve afër xhamisë e realizon edhe Suziu, i cili pranë xhamisë së tij ndërtoi një mekteb.

“Në tërë periudhën osmane, Prizreni ishte qendra më e rëndësishme kulturore-arsimore e Kosovës dhe hynte në radhën e pikave qendrore më të rëndësishme të Gadishullit Ballkanik.”⁵⁹

Ndërsa dokumenti më i vjetër që dëshmon për ekzistimin e një mësonjëtorjeje në Kosovë është vakëfnameja e Suziut, e legalizuar në vitin 1513. Nga kjo vakëfname mund të konkludohet se i pari që ndërmori një hap të tillë për arsimimin e rrethit ku jetonte në Kosovë ka qenë Suziu.⁶⁰

Ky mekteb ishte ndërtuar në dy kate me sipërfaqe prej 80 m², ku dihet se në katin e dytë ka banuar vetë Suziu, ndërsa kati i parë është përdorur si mekteb. Kati i dytë ishte i dalë 1 metër përpara katit të parë dhe mbështetej mbi katër shtylla prej druri. Ndërtesa ishte e ngjyrosur me ngjyrë të bardhë dhe kishte një kulm katërstrehësh të mbuluar me tjegulla të rru-mbullakëta.⁶¹

Këto shkolla në qendër të vëmendjes së tyre kanë pasur mësimin e shkrim-leximit të Kuranit, si dhe mësimin e tij përmendsh, si dhe zakonisht mësimi është zhvilluar në gjuhën osmane.⁶²

⁵⁸ Dr. Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë (1830-1912)*, Instituti Albano-logjik, Prishtinë, 2019, f. 55.

⁵⁹ Prof. Dr. Esat Haskuka, *Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve*, Shtypshkronja “Kosova”, Prizren, 2003, f. 181.

⁶⁰ Suzan D. Canhasi, “*Osmanlı hakimiyeti dönemi 'nde Mitroviça 'da türkçe eğitim*”, Türk dil ve edebiyat bölümü-Prishtine Üniversitesi, Prishtine, 2014
<http://79.123.169.199/ojs/index.php/Kefdergi/article/view/360>.

⁶¹ Osman Baymak, “*Suzi Çelebinin daha iki hayratı...*”, Suzi Çelebi (araştırma-inceleme), BAY yayınları, Prizren, 1998, f. 214.

⁶² Hasan Kaleshi, “*Prizreni qendër kulturore gjatë periudhës turke*”, Hikmet- Revishtë shkencore, nr.10, Prishtinë, 2015, f. 11.

Mirëmbajtja e këtyre institucioneve mundësohej përmes vakëfeve që sillnin të ardhura të sigurta dhe të vazhdueshme.⁶³

2.3. Biblioteka

“Se sa i zhvilluar është një popull, tregon mënyra se si e vlerëson librin dhe, krahas tij, edhe bibliotekën. ...Historia e bibliotekave është, në fakt, edhe historia e vetë njerëzimit, pasi ato krijojnë mundësinë për një lidhje të drejtpërdrejtë fizike me të kaluarën...”⁶⁴

Përgjatë sundimit të Perandorisë Osmane, xhamitë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e librave me vlerë shkencore, si dhe në lejimin e përdorimit të tyre nga dashamirësit e dijes. Këto libra zakonisht mbaheshin në xhami, në dollapë të quajtur **hizane**, ose ndërtohej ndonjë ndërtesë pranë xhamisë që shërbente si bibliotekë.⁶⁵

Biblioteka e parë në trojet ballkanike ka qenë biblioteka e Gazi Is'hak-beut, e cila gjendej pranë medresesë së tij në Shkup.⁶⁶ Biblioteka të tjera në Ballkan gjejmë edhe përreth Shkupit, atë të Is'hak Çelebiut në Manastir, pastaj atë të Husrev beut në Sarajevë⁶⁷, kurse në afërsi të Prizrenit, në Bresanë të Opojës, atë të Mehmet Kukli-begut, të vitit 1538, si dhe të Mehmet Pashës, e cila daton që nga viti 1573⁶⁸. Mirëpo, para bibliotekave të Kukli-begut dhe Mehmet Pashës në Prizren, duke u bazuar në dokumentet historike, mund të themi se biblioteka e Suziut është më e

⁶³ Prof. Dr. Esat Haskuka, *Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve*, Shtypshkronja "Kosova", Prizren, 2003, f. 182.

⁶⁴ Mr.Sahadete Sadikaj-Kukaj, *Gjendja e bibliotekave në rajonin e Prizrenit*, Biblioteka Ndërkomunale Prizren, Prizren, 2011, f. 9.

⁶⁵ Ahmet Okutan, *Camiler ve din Görevlileri*, Türkiye diyanet vakfı, Tekirdağ, 2008, f. 48.

⁶⁶ Prof. assoc.dr.Jani Sota, Po aty, f. 75.

⁶⁷ Fevzi Karamuço, *"Prizrenli Suzi Çelebi kütüphanesi"*, Suzi Çelebi/Araştırma İnceleme, Bay yayınları, Prizren, 1998 f. 211.

⁶⁸ Sadik Mehmeti, *"Në shenjë të 500-vjetorit të themelimit të bibliotekës së parë në Kosovë"* http://ardhmeriaonline.com/artikull/article/kosova-dhe-biblioteka-500-vjecare/#.VndQb_krLIU.

vjetra në Prizren, madje edhe në Kosovë. Ajo, ashtu si të gjitha vakëfet e tjera që ka lënë Suziu, është legalizuar në vitin 1513.⁶⁹

Biblioteka e Suziut ka një rëndësi të veçantë, ngase është biblioteka e parë në rajon, e cila, përveç mësimit fetar, ka pasur rol të rëndësishëm në aspektin edukativo-arsimor të popullsisë së vendit, si dhe për personat e interesuar për dije.⁷⁰

Dihet se kjo bibliotekë ishte shumë e pasur me shumëllojshmëri librash, ku pjesa më e madhe e tyre, mbi 80%, ishin në gjuhën arabe, ngase ato ishin librat bazë për mësimin e nxënësve, por kishte edhe libra në gjuhën perse dhe osmane.⁷¹

Kjo bibliotekë e parë orientale në Kosovë përmbante libra të fushave të ndryshme⁷², ndërsa shumica e tyre kishin të bëjnë me traditën islame si dhe të drejtën e sheriatit.⁷³

Pasi është ndërtuar mektebi, Suziu ka sjellë në mektebin e tij libra të ndryshëm, të cilat i përmend në fund të vakëfnamesë së tij, përkthimin e së cilës e dhamë më herët, ku ai i përmend titujt: dy vëllime të **Tefsir-i Shejh**, dy vëllime të veprës **Hidaje**, një vëllim të veprës **Shiratul Islam**, një vëllim të veprës **Teskiretul Evlija**, katër vëllime të veprës **Mesnevi** dhe dy vëllime të veprës **Kimjai Saadet**. Lejen për përdorimin e këtyre librave, si dhe librave të tjerë në bibliotekë, ai e kushtëzon kështu: *“Derisa unë të jem gjallë, unë do të jam pronar i tyre(dorëshkrimeve), ndërsa pas vdekjes sime për to do të kujdeset imami i xhamisë time. Imami le t’ua japë ato(dorëshkrimet) në huazim dijetarëve dhe atyre që janë në gjendje të kenë dobi prej tyre, të cilët do të lexojnë lutje (salavate) për shpirtin tim”*

⁶⁹ Dr. Sadik Mehmeti, Shkollat dhe arsimi në Kosovë (1830-1912), Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, f. 185.

⁷⁰ Mr.Sahadete Sadikaj-Kukaj, po aty, f. 134.

⁷¹ Fevzi Karamuço, po aty, f. 213.

⁷² Salajdin Krasniqi, “Prizreni udhëtim në kohë”, Prizren, 2002, f. 26.

⁷³ Prof. Dr. Esat Haskuka, po aty, f. 193.

GJENDJA E VAKËFEVE TË SUZIUT

Si çdo monument historik që ka nevojë për kujdes dhe mbikëqyrje, që mos të jetë viktimë e viteve të kaluara, edhe vakëfet e Suziut kanë pasur nevojë për të njëjtën kujdesje dhe mirëmbajtje. Në këtë kapitull do të flasim në lidhje me gjendjen e vakëfeve të Suziut në ditët e sotme.

3.1. Gjendja

Prej të gjitha vakëfeve që i ka lënë Suziu, vetëm xhamia është ajo që ka shpëtuar nga vrazhdësia e viteve të kaluara. Dhe kjo, sigurisht, nuk është rastësi, ngase ajo ka mbetur e gjallë falë renovimeve dhe mbikëqyrjes përgjatë viteve të ndryshme.

Xhamia nuk e ka pamjen e njëjtë sikurse e ka pasur më herët. Në humbjen e karakteristikave të saj, si dhe ndryshimin e pamjes së saj të mëhershme, kanë ndikuar renovimet e ndryshme të bëra brenda dhe jashtë xhamisë, ku janë përdorur materiale që e kanë mbuluar pamjen e dikurshme dhe kështu xhamia ka marrë një formë tërësisht të re.⁷⁴

Arti i shekullit XVI, të cilin e paraqiste xhamia, tashmë nuk ekziston. Oborri i saj është tej mase i lënë pas dore, pa asnjë mbikëqyrje. Gjatë vizitës që i bëra xhamisë, depërtimi përmes varreve ishte i vështirë për shkak të barit dhe shkurreve të rritura tej mase, të cilat, po ashtu, nuk i japin pamje të bukur xhamisë.

Kjo xhami, së bashku me oborrin e saj, tani është pronë e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Ndërsa mektebi tani është njëkatësh dhe më nuk e ka funksionin e mektebit, por është i banuar nga një familje prizrenase, e cila e shfrytëzon si shtëpi të saj. Në bisedën që pata me sekretarin e Bashkësisë Islame të Prizrenit, ai tha se familja refuzon të largohet nga shtëpia, e cila, në esencë, ishte vakëf i lënë nga Suziu.

Ndërsa biblioteka ka pasur fatin më të hidhur. Një pjesë e librave është shpërndarë gjatë Luftës së Parë Botërore, kurse pjesa më e madhe

⁷⁴ Raif Vırmiça, *Kosova'da osmanlı mimari eserleri*, T.C.Kultur bakanlığı osmanlı eserleri, Türk Tarih Kurumu Basımevi, Ankara, 1999, f. 46.

gjatë Luftës së Dytë Botërore, në vende të ndryshme të botës. Disa libra janë huazuar me qëllim kthimi, por nuk janë kthyer më, një pjesë janë vjedhur, ndërsa disa janë shitur. Të njëjtin fat, sikurse edhe librat e tjerë, e ka pasur edhe “Gazâvatnâme”-ja e Suziut.⁷⁵ Duke pasur parasysh që në Prizren kemi biblioteka të ruajtura që nga periudha osmane, siç është biblioteka e Medresesë së Gazi Mehmet Pashës, me 2000 libra e 200 dorëshkrime të gjuhëve të ndryshme orientale⁷⁶, biblioteka e Suziut nuk e kishte pasur fatin e tillë, ngase nuk kemi asnjë libër të mbetur nga ajo pasuri e tij, përveç Vakëfnamesë së tij, e të cilën e shkroi ai vetë.

Në periudhën e Perandorisë Osmane ishte traditë që personat e shquar dhe me famë të varroseshin në oborret e xhamive. Këtë e shohim edhe në xhaminë e Suziut, ku gjenden shumë varre të personave të ndryshëm dhe të periudhave të ndryshme. Ky oborr ende gjendet mbrapa xhamisë, por është tejte i lënë pas dore; bari i rritur dhe shkurret nuk i japin një pamje të bukur, duke treguar se nuk janë prekur prej kohësh. Edhe katër muret që e mbështjellin varrin e Suziut dhe të vëllait të tij, Nehariut, janë tejte të dëmtuara dhe kanë nevojë ose për riparim, ose për ndërtim të ri.

Epitafët e të dy varreve janë dëmtuar shumë dhe janë bërë të palexueshme, ndoshta vetëm ndonjë shkronjë e shkrimit aty-këtu mund të lexohet.



Figure 3: Tyrbeja dhe varri i Suziut dhe i vëllait të tij, Nehariut

⁷⁵ Raif Virmiça, *Suzi ve vakıf eserleri*, TAN Yayınları, Priştine, 1998, f. 66.

⁷⁶ Mr. Sahadete Sadikaj-Kukaj, po aty, f. 134.

3.2. Sfidat

Koha e kaluar dhe ndryshimet e shumta në rajon, qofshin ato politike, ekonomike apo shoqërore, kanë qenë njëra nga sfidat kryesore për këto objekte me rëndësi historike. Meqenëse sot nuk e kemi në prezencë asnjërën prej vakëfeve që Suziu na i ka lënë në mbikëqyrje (përfshirë bën vetëm xhamia), mund të themi se sfidat përgjatë këtyre shekujve kanë qenë të shumta.

Në rastin e Suziut, me gjithë kushtet që ai i ka lënë dhe trashëgiminë që ia ka besuar vakëfeve të tij, duket se trashëgimtarët e kësaj pasurie nuk i kanë dhënë rëndësinë e duhur ose nuk janë përkujdesur siç duhet.

Edhe pse luftërat e ndryshme të ndodhura në rajon apo më gjerë nuk kanë ndikuar në rrënimin e këtyre vakëfeve, mbetet që sfida kryesore e tyre ka qenë papërgjegjësia në mbikëqyrjen e tyre. Si pasojë, sot këto vakëfe mund t'i shohim, por tashmë ato kanë ndërruar pronësi dhe janë bërë prona private.

Gjatë periudhës osmane, shumica e dokumenteve janë ruajtur nëpër arkivat e përgjegjësve osmanë, ndërsa pjesa më e madhe e këtij dokumentacioni u shkatërrua në kohën kur austriakët depërtuan në Prizren, kohën kur filloi lufta austro-osmane (1689, 1716, 1718).⁷⁷ Mund të ketë qenë që në këtë periudhë të kenë humbur edhe librat e bibliotekës së Suziut, si dhe të vidhej edhe “Gazâvatnâme”-ja e tij.

Në dy luftërat botërore janë bërë shkatërime të qëllimshme të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare⁷⁸, ndërsa xhamia e Suziut i shpëtoi kësaj.

3.3. Perspektiva

Edhe pse këto vakëfe janë historikisht të vjetra dhe me rëndësi të veçantë, duke marrë parasysh periudhën e ndërtimit të tyre, mund të themi se ato sot nuk kanë shumë perspektivë zhvillimi. Vendndodhja e xhamisë së Suziut, e cila është disi larg qendrës së qytetit, e ka bërë atë më pak të dukshme dhe pak të njohur për gjeneratat e reja.

⁷⁷ Po aty, f. 116.

⁷⁸ Po aty, f. 249.

Rëndësia e Suziut dhe e vakëfeve të tij për prizrenasit dhe për kosovarët në përgjithësi është e padiskutueshme, por kjo njohje duhet të promovohet, të debatohet dhe të mësohet. Është e domosdoshme që ky personalitet historik, ashtu si edhe të tjerë me vlerë kombëtare, të jetë më i pranishëm në literaturën shqipe dhe në programet arsimore.

Fatkeqësisht, burimet kryesore që kanë shkruar për Suziun dhe kanë ndihmuar në njohjen e personalitetit të tij janë kryesisht të huaja. Historia shqiptare e përfshirë në tekstet shkollore, si në shkollat fillore ashtu edhe në të mesmet, nuk jep njohuri të mjaftueshme për personalitete që kanë kontribuar në shoqërinë e tyre. Për pasojë, gjeneratat e reja kanë njohuri të kufizuara për historinë e vendit të tyre dhe për figurat që ndihmuan në zhvillimin dhe përparimin e tij.

PËRFUNDIMI

Me gjithë vështirësinë e hulumtimit të një periudhe të vjetër e të paqartë për kohën e tashme, ishte me rëndësi të tregoheshin, aq sa dihen, kontributet e Suziut në sferën shoqërore dhe fetare.

Personalitete të këtilla, sikurse Suziu, si dhe trashëgimia e tyre, duhet të kenë mbikëqyrje dhe përkujdesje maksimale, që ato të jenë shembull për çdo të ri që jeton në këto troje.

Përgjatë hulumtimit të jetës së Suziut jam munduar që çdo burim, prej të cilit kam marrë informatë, ta shënoj në fusnotë, në mënyrë që punimi të jetë sa më i saktë dhe sa më korrekt.

Nuk mund të themi se fjalët që i thamë janë përfundimtare dhe se nuk ka mbetur asgjë tjetër për t'u shtuar; hulumtimi më i hollësishëm i mbetet studiuesve të ardhshëm, të cilët do të ndriçojnë edhe më shumë personalitetin e Suziut dhe trashëgiminë që ai na la.

Është e udhës, mendojmë, që të organizohen sesione dhe konferenca shkencore për Suziun dhe veprën e tij.

Emrin e tij, me shumë nder, duhet ta mbajë ndonjë shkollë ose edhe biblioteka e qytetit të Prizrenit, sepse ky ishte personi i parë që Prizrenit i dha një shkollë dhe një bibliotekë. Dhe jo vetëm kaq: Suziu ishte edhe mësuesi dhe bibliotekisti i parë.

Një personalitet kaq i shquar, një vakëflënës dhe bamirës i madh, poet, historian, mësues e bibliotekist, që kishte edhe dy vëllezër të tjerë, po ashtu poetë të shquar, sigurisht që meriton dhe duhet të ketë vendin e tij në historinë tonë kombëtare.

Burimet dhe literatura:

- Kurani fisnik-Përkthim i kuptimeve të tij në gjuhën shqipe, përktheu dhe komentoi: H.Sherif Ahmeti, Medine, 1434 h.
- Ahmeti, Abib, *Theranda-Prizreni ndër shekuj*, Orient, Prizren, 1996.
- Ahmeti, Bajrush, *Perandoria Osmane dhe përhapja e Islamit në trojet shqiptare dhe në viset fqinje*, Prishtinë, 1997.
- Frashëri, Sami, *Personalitetet shqiptare në Kâmus Al-a'lâm*, Logos-A, Shkup, 2002.
- Haskuka, Prof. Dr. Esat, *Analizat e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve*, Shtypshkronja "Kosova", Prizren, 2003.
- Ibrahim, Nexhat, *Suzi Prizrenasi*, Grafo-art d.o.o. Sarajevo, Prizren, 1990.
- Kaleshi, Hasan, *Kontributi i shqiptarëve në diturinë islame*, Logos-A, Shkup, 2013.
- Kazıcı, Prof. Dr. Ziya, *Islâm medeniyeti ve müesseseleri tarihi*, Marmara Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, İstanbul, 2006.
- Krasniqi, Salajdin, *Prizreni udhëtim nëpër kohë*, Shtypshkronja SIPRINT, Prizren, 2002.
- Levend, Agâh Sirri, *Gazavat-nameler ve Mihaloğlu Ali bey'in gazavat-namesi*, Turk tarih kurumu, Ankara, 2000.
- Maksudoğlu, Prof. Dr. Mehmet, *Historia osmane dhe institucionet*, ALSAR, Tiranë, 2013. Mehmeti, Dr. Sadik. *Shkollat dhe arsimit në Kosovë (1830-1912)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, f. 55.
- Okutan, Ahmet, *Camiler ve din Görevlileri*, Türkiye diyanet vakfı yayın matbaacılık ve ticaret işletmesi, Tekirdağ, 2008.
- Osi, Dr. Maliq, *Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor*, Shoqata numizmatike shqiptare Demastion, Prizren, 2001.

- Prenkaj, Mr. Marjan, *Prizreni dhe rrethina në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX*, Instituti i historisë, Prishtinë, 1998.
- Virmiça, Raif, *Camiler kenti Prizren*, Bashkësia islame e republikës së Kosovës & Kosova türk araştırmacılar derneği, Prizren, 2016, f. 249.
- Virmiça, Raif, *Kosova'da osmanlı mimari eserleri I*, TÜRK TARİHK KURUMU BASIMEVİ, Ankara, 1999.
- Virmiça, Raif, *Suzi ve vakıf eserleri*, TAN Yayınları, Priştine, 1998.
- Virmiça, Raif, *Prizren camileri*, Türk demokratik birliği yayınları, Prizren, 1996.
- Sadikaj-Kukaj, Mr.Sahadete, *Gjendja e bibliotekave në rajonin e Prizrenit*, Biblioteka Ndërkomunale Prizren, Prizren, 2011.

Punimet shkencore dhe revistat

- “Edukata Islame”-revistë shkencore kulturore islame, nr.106, Prishtinë, 2014
- “Edukata Islame”-revistë shkencore kulturore islame, nr.65, Prishtinë, 2001
- “Hikmet”-revistë shkencore, nr.10, Instituti për shkencat humane “Ibni Sina”, Prishtinë, 2015
- “Sûzi Çelebi” (araştırma-inceleme), BAY yayınları, Prizren, 1998
- “Prizrenli Suzi'nin 500.yili” (Bildiriler, bilgiler, belgeler), Kosova türk yazarlar derneği, Prizren, 2000

Literatura nga internet

- Kürşat Şamil Şahin, “Gazavâtnâmelerde edebi savaş tasvirleri”
- <http://dergipark.ulakbim.gov.tr/tubar/article/viewFile/5000123193/5000117090>
- Sadik Mehmeti, “Në shenjë të 500-vjetorit të themelimit të bibliotekës së parë në Kosovë”http://ardhmeriaonline.com/artikull/article/kosova-dhe-biblioteka-500-vjecare/#.VndQb_krLIU
- Suzan D. Canhasi, “Osmanlı hakimiyeti dönemi'nde Mitroviça'da türkçe eğitim”, Türk dil ve edebiyat bölümü-Priştine Üniversitesi, Priştine, 2014 <http://79.123.169.199/ojs/index.php/Kefdergi/article/view/360>

Semra VASIJA-TËRHOLLI

SUZI ÇELEBI FROM PRIZREN AND HIS WAQFS

Abstract

This paper discusses one of the earliest scholars, poets, and historians of Prizren during the Ottoman period, Suzi Çelebi, who is considered one of the most influential figures of his time. He is best known for his poem *Gazavatname-i Mihaloğlu*, which describes the Ottoman conquest of the Balkans in the 15th century and the battles and glory of one of its military commanders, Ali Bey Mihaloğlu. This work is considered one of the most notable achievements in Ottoman literature of that century. In addition to its historical value, this work exemplifies a model of epic writing, characterised by strong artistic and linguistic elements, reflecting the literary tastes of the time.

The paper places particular emphasis on the waqfs left by this distinguished benefactor in Prizren and on his waqf deed legalized in 1513, which testifies to his contribution to the social and cultural development of the city.

Keywords: *Suzi Çelebi, Prizren, Ottoman period, waqf, waqf deed.*

Dr. Sc. Zilha MASTALIQ-KOSHUTA*

FUSHATË SNAJPERI NË SARAJEVË GJATË PERIUDHËS SË RRETHIMIT 1992-1995

Abstrakt

Në fillim të prillit të vitit 1992, hapësira e Sarajevës u nda dhunshëm. Njësitë e Korpusit të 4-të të Distriktit të 2-të ushtarak të Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë (UPJ), forcat e armatosura që kishin mbështetur dhe ishin rreshtuar pranë Partisë Demokratike Serbe (PDS), si dhe shumë vullnetarë vendas, mercenarë dhe luftëtarë të huaj, morën pozicione strategjike në Sarajevë dhe përreth saj. Armiqësitë e hapura filluan pasi Bosnja dhe Hercegovina u njoh si shtet i pavarur ndërkombëtarisht. Më pas, Sarajeva u bllokua dhe u vendos nën rrethim për gati katër vjet. Pas tërheqjes së pjesshme të Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë nga Bosnja dhe Hercegovina, Distrikti i 2-të ushtarak i saj u transformua në pjesë të Ushtrisë së Republikës Serbe të Bosnjës dhe Hercegovinës (URS RBeH), e që nga gushti i vitit 1992 mori emrin Ushtria e Republikës Serbe (URS). Me këtë transformim, Korpusi i 4-të u shndërrua në Korpusin e Sarajevës dhe Romanisë (KSR).

Gjatë periudhës së rrethimit katërvjeçar të Sarajevës, u zhvillua një “fushatë e koordinuar, sistematike dhe afatgjatë e granatimeve dhe snajperimeve” kundër banorëve të saj, me qëllim që të “vrite-

* Dr. Sc. Zilha Mastaliq Koshuta, është bashkëpunëtore e lartë shkencore në Institutin për kërkimin e krimeve kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare. Universiteti i Sarajevës.

shin, gjymtoheshin, plagoseshin dhe terrorizoheshin popullsia civile e Sarajevës”. Përveç sulmeve të artilerisë në qytet, që përbënin mënyrën më të përhapur të vrasjes së banorëve, një tjetër metodë ishin edhe sulmet me snajperë. Pa energji elektrike, ujë, gaz dhe nevoja të tjera ekzistenciale, banorët luftonin çdo ditë për mbijetesë. Nga pozicionet e pushtuara, u krye një fushatë e snajperimit dhe granatimeve kundër popullsisë civile të Sarajevës, e cila nuk ishte e sigurt askund. Masakrat dhe vrasjet, plagosjet, terrori i vazhdueshëm dhe lëndimet psikologjike ishin pjesë e krimeve që u kryen ndaj banorëve të Sarajevës.

Në pjesën e parë të punimit paraqitet kuptimi i fushatës së snajperit, me një përshkrim të vendeve dhe zonave të qytetit nga ku kryhej më shpesh kjo fushatë. Një element shumë i rëndësishëm është edhe prezantimi i llojeve të armëve që përdorëshin nga snajperët. Pjesa e dytë e punimit trajton organizimin e trajnimit të snajperistëve, duke përfshirë vendndodhjet ku janë zhvilluar këto trajnimet dhe mënyrën e realizimit të tyre. Përveç burimeve të shumta parësore, jepen të dhëna për kërkesat dhe dorëzimin e armëve dhe municioneve snajper Korpusit të Sarajevës dhe Romnisë të URS-së. Dokumenti përmban gjithashtu informacione mbi identitetin e snajperistëve, si dhe mbi mercenarët dhe vullnetarët e paguar nga vende të tjera.

Në shembujt e viktimave të fushatës së snajperit, kryesisht në rastet e vrasjes së fëmijëve, bëhet e qartë se qëllimi i armikut ka qenë vrasja e civilëve me dashje, drejtpërdrejt dhe qëllimisht. Në këtë pjesë, viktimat e mitura të fushatës së snajperit paraqiten sipas rendit kronologjik. Pjesa e fundit e punimit i kushtohet ndjekjes penale ose mosndjekjes penale të atyre që janë përgjegjës për këto krime para gjykatave vendore dhe ndërkombëtare.

Fjalët çelës: *Bosnja dhe Hercegovina, Sarajeva, rrethimi, 1992-1995, fushatë snajperi, sulme me snajper, snajperistët, trajnime, armatimi, fëmijët, vrasje të qëllimshme, (mos)ndjekje penale, ICTY, URS.*

HYRJE

Fushatë snajperi

Fushata e snajperit kundër civilëve në Sarajevë ka qenë objekt diskutimi para Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), në kuadër të proceseve gjyqësore që lidhen me këtë qytet. Një numër ekspertësh janë konsultuar dhe kanë dhënë përkufizime më të sakta të termit “fushatë snajperi”, në kontekstin e rasteve ekzistuese të pranuar nga ICTY-ja, të cilat do të përdoren edhe në këtë punim. Sipas një raporti të oficerit të këmbësorisë John Hamill, vëzhgues ushtarak i OKB-së, termi *fushatë snajperi* është përdorur në mënyrë josistematike gjatë luftës në ish-Jugosllavi dhe zakonisht i referohet qëllimit ndaj civilëve me një sërë armësh gjysmë automatike ose automatike (p.sh. mitralozë). Termi rrjedh nga fakti se burimi i zjarrit zakonisht është aq i fshehur sa bëhet e vështirë të përcaktohet. Në terminologjinë ushtarake, një fushatë snajperi ndërmerret për qëllime të veçanta, duke përdorur ndonjëherë edhe armë speciale të destinuara vetëm për operacione të tilla. Një snajperist, në kuptimin ushtarak, është dikush që qëllon dhe vret individë nga një distancë e gjatë. Hamill e ka mbështetur përkufizimin e “fushatës së snajperit” në një raport të titulluar *Armët në ish-Jugosllavi*, të shkruar nga oficeri i ushtrisë kanadeze Tetsuo Ani.¹

Në fakt ishte një gjuajtje e drejtpërdrejtë e njerëzve, nga një distancë më e madhe nga çdo lloj arme këmbësorie, si pushkë ose mitralozë, nga një vend i fshehur ose pjesërisht i fshehur.² Një përkufizim i zakonshëm i termit “fushatë snajperi” përfshin të shtënat e drejtpërdrejta ndaj një personi ose objekti, e i cili nuk përfshin domosdoshmërisht një pushkë speciale.³ Fushatat e snajperit për të cilat akuzoheshin të akuzuarit nuk u

¹ ICTY, Lënda IT-98-29-T, Prokurori v. Stanislav Galliq, *Aktgjykimi*, 2003, paragrafi 183, 63.

² Po aty, par. 182, par. 184, 62-63.

³ Oxford English Dictionary (botimi i dytë, 1991) e përcakton termin *to snipe* si “të qëllosh ose të hapësh zjarr mbi (njerëzit etj.) me të shtëna të vetme, zakonisht nga një mbulesë dhe nga një distancë më e madhe”. Collins Shorter Dictionary and

kufizuan vetëm në incidentet e kryera me pushkë speciale snajperi, të pajisura me objektivin optike.⁴ Eksperti i ICTY-së, Patrick van der Weijden, theksoi se termi **snajperist** i referohet një gjuajtësi të fshehur që qëllon mbi këdo që i shfaqet në objektiv, përfshirë gratë dhe fëmijët. Ai gjithashtu bëri një dallim midis “snajperistit të zakonshëm” dhe “snajperistit profesionist”, duke sqaruar se ky i fundit është i trajnuar më mirë në një numër aftësish të specializuara (si kamuflazhi), se ai posedon pajisje më cilësore dhe më të shumta, dhe se zakonisht vepron në një ekip të përbërë nga një gjuajtës dhe një vëzhgues. Ndërkaq, një snajperist i zakonshëm vepron i vetëm, nuk disponon pajisje të shumta dhe ka kaluar një trajnim shumë më të kufizuar.⁵

Snajperistët janë të aftë në “zbulimin, vëzhgimin, fshehtësinë dhe neutralizimin e objektivave ose të pajisjeve kryesore të armikut”. Ata ishin shigjetarë të trajnuar mirë, me aftësi të shkëlqyera luftarake, të aftë për të zënë një pozicion dhe për ta braktisur atë pa u vënë re. Objektivat e tyre konsiderohen me rëndësi të veçantë. Ata u angazhuan për të përdorur aftësitë e tyre në gjuajtje precize dhe përvojën në terren për të hyrë dhe për të dalë nga pozicionet pa u zbuluar. Pajisja bazë e një snajperisti përfshinte një pushkë precize me objektiv optik, ndërsa një snajperist është një gjuajtës shumë i specializuar dhe i trajnuar në mënyrë të avancuar.⁶ Sipas Weijdenit, në zonat e populluara, rrezja e veprimit ishte e kufizuar në një mesatare prej 75 metrash, ndërsa gjuajtja nga distanca më të gjata ishte e mundur vetëm nga pozicione dominuese me pamje nga lart-po-

Thesaurus (1995) jep këtë përkufizim: “të qëllosh mbi armikun nga mbulesa”. Ndërsa në Webster's New Universal Unabridged Dictionary (1996) thuhet: “të qëllosh mbi personat kur u jepet mundësia për ta bërë këtë nga ndonjë pozicion i mbrojtur ose i largët”. Më shumë në: *Po aty*, f. 312.

⁴ Po aty, par. 183, 62.

⁵ ICTY, Nr. 0606-3278-0606-3345-BCDT, *Incidentet e fushatës së snajperit në Sarajevë 1994-1994*, autor J. van der Weijden, Raporti mbi lëndën kundër Dragomir Millosheviqit, 2; ICTY, Lënda IT-95-5/18, Prokurori v. Radovan Karaxhiq, *Aktgjykimi*, 2016, paragrafi 3618, 1381.

⁶ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 109, 38.

shtë. Snajperistët mund të përdornin një gamë të gjerë armësh, duke zgjedhur armë të kalibrit më të madh për të realizuar gjuajtje në distanca më të gjata.⁷

Në fushatën e snajperëve, Korpusi i Sarajevës dhe Romanisë (SRK) përdori pushkë të pajisura me objektiv optik ose me mundësi montimi të tij. Më së shpeshti u përdorën pushkët e tipit Zastava M76, si dhe M84. Po ashtu u përdor edhe pushka e tipit “Dragunov”, që në variantin jugosllav njihej si M91.⁸

Mbrojtja e të akuzuarit në procedurën kundër Stanislav Galiqit para ICTY-së kundërshtoi pretendimet e mësipërme, duke e përcaktuar fushatën e snajperëve si zjarr nga “pushkë speciale me objektivë optike” dhe duke pohuar se Korpusi i Sarajevës dhe Romanisë (KSR) nuk kishte në dispozicion pushkë të tilla.⁹ Disa dëshmitarë për mbrojtjen e të pandehurit në çështjen kundër Dragomir Millosheviqit, deklaruan gjithashtu se KSR nuk kishte snajperistë dhe snajperë.¹⁰

Dihet se snajperistët përdornin municione të ndaluara nga konventat ndërkombëtare, si p.sh. municionet shpërthyes (plumba dumtum), në sulmet e tyre kundër civilëve në Sarajevë. Gjuajtja e civilëve me municione të tilla shkaktonte vuajtje të mëdha për viktimat, pasi këto municione shpërthenin në momentin e goditjes dhe provokonin lëndime të rënda. Forcat e URS-së i përdorën këto municione për shkak se një plumb i vetëm mund të shkaktonte dëme ndaj shumë personave, pa lënë vrimë daljeje, duke e bërë kështu të pamundur përdorimin e metodave të zakonshme

⁷ Po aty, par. 110, 38-39.

⁸ Po aty, f. 285, 27.

⁹ ICTY, Lënda IT-98-29-T, Prokurori v. S. Galliq, *Aktgjykimi*, 2003, paragrafi 182, 62.

¹⁰ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 69, 24.

për përcaktimin e drejtimit të qëllimit, si futja e tytës nëpër vrima.¹¹ Ka disa raste që konfirmojnë se forcat e URS-së i përdorën këto municione.¹²

Sulme me snajper

Përveç sulmeve të artilerisë, të cilat përbënin mënyrën më të zakonshme të vrasjes së banorëve të Sarajevës, metoda e dytë më e zakonshme ishte vrasja me snajper. Përveç qytetarëve të rritur, viktimat ishin edhe fëmijët, të cilët vriteshin në të gjitha rrethanat e mundshme: gjatë lojës, në bodrum, në dhomën e tyre, duke fjetur, në oborr, në krahët e nënës ose të babait, duke vrapsuar nëpër rrugë, të fshehur në kalime dhe situata të ngjashme. Ata nuk ishin të sigurt askund. Fëmijët shënjestroheshin kryesisht në zona vitale të trupit, plagët e të cilave çonin në vdekje ose lëndime të rënda. Shumë shpesh ata goditeshin në zemër, kokë ose mushkëri, gjë që dëshmon qartë qëllimin e snajperistit. Snajperistët janë vrasës të padukshëm, të cilët nuk bëjnë dallim nëse viktimat është fëmijë, grua apo i moshuar. Qëllimi i snajperistit ishte i qartë – çdo e shtënë synonte të vriste ose të plagoste rëndë personin e shënjestruar.

Në shumë vende në Sarajevë, veçanërisht në pjesë të rrugës kryesore të qytetit, e cila përfshin edhe hotelin “Holiday Inn” në Marindvor, kishte tabela me mbishkrim “Kujdes snajper”, që ishte një tregues i qartë i sulmeve intensive në zonë.¹³ Jeremy Hermer, një vëzhgues ushtarak i OKB-së, deklaroi se rruga kryesore, e cila shtrihej paralelisht me lumin Miljacka nga qyteti i vjetër në drejtim të perëndimit, njihej si “Rruga e Snajperëve”.¹⁴ Shpeshherë ndodhte që personi i vrarë të mbetej i shtrirë për disa ditë, nga frika se dikush do të tentonte ta largonte dhe do të bëhej shënje-

¹¹ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, 94, 95, paragrafi 284.

¹² Po aty, par. 345, 346; ICTY, Lënda IT-98-29-T, Prokurori v. S. Galliq, *Aktgjykimi*, 2003, 113, paragrafi 300, 302.

¹³ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 911.

¹⁴ ICTY, Lënda IT-98-29-T, Prokurori v. S. Galliq, *Aktgjykimi*, 2003, paragrafi 229, 81.

stër e sulmeve të reja. Sulmet kryheshin kryesisht gjatë ditës, kur sulmuesit mund të shihnin qartë se bëhej fjalë për civilë. Pavarësisht se banorët e Sarajevës përpiqeshin ta përshtatnin jetën e tyre me këto sulme – duke jetuar natën, duke u fshehur gjatë ditës, duke mbyllur shkollat, duke lëvizur vetëm kur ishte e domosdoshme, duke vendosur kontejnerë si mbrojtje – ata ende nuk ishin të sigurt dhe vazhdimisht vriteshin e plagoseshin. Transportuesit e blinduar të personelit shpeshherë shërbenin si një mburojë e lëvizshme pas së cilës njerëzit përpiqeshin të lëviznin, për t’u fshehur nga të shtënat e snajperëve.¹⁵

Fotografi John Ashton mbërriti në Sarajevë në korrik të vitit 1992. Ai dëshmoi për përvojat e tij në Sarajevë, përfshirë edhe fushatën e snajperëve, në gjyqet para ICTY-së. Ashton deklaroi se kishte parë personalisht snajperë që qëllonin mbi njerëzit. Sipas tij, ata “hapën zjarr nga Grbavica dhe qëlluan drejt qytetit, midis ndërtesave, në afërsi të universitetit, pranë hotelit **Holiday Inn** dhe afër muzeut.”¹⁶ Ushtarët e KSR-së në Grbavicë, i thanë atij se ata e kishin vijën e tyre të frontit atje, dhe se qëllonin mbi njerëzit që i kalonin rrugët nga atje.¹⁷

Gazetari norvegjez Morten Hvaal, inspektori i kriminalistikës në Qendrën e Shërbimit të Sigurisë (QSHS) Sarajevë-Mirsad Kuçanin, si dhe dëshmitarë të tjerë që dhanë dëshmi të ngjashme, raportuan dhe dëshmuuan edhe para ICTY-së.¹⁸ Kirurgu Millan Mandilloviq, nga Spitali Shtetëror në Sarajevë, tha se numri i pacientëve civilë të shtruar në spitalin shtetëror ishte të paktën katër herë më i lartë se numri i ushtarëve të pranuar.¹⁹

Anëtarët e Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR) bombarduan zonat ku dihej se strehoheshin civilët, si pjesë e fushatës së snajperëve.

¹⁵ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 44, 14-15.

¹⁶ ICTY, Lënda IT-98-29-/ , Prokurori v. S. Galli, *Aktgjykimi*, 2003, paragrafi 228, 80-81.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty, par. 215, 76.

¹⁹ Po aty, par. 216, 77.

Roy Thomas, vëzhguesi i lartë ushtarak i UNPROFOR-it në Sektorin e Sarajevës, deklaroi se “boshnjakët përdorën rrugë të fshehura për të shmangur Rrugën e snajperëve, por ato rrugë u sulmuan me artileri, që ishte një tregues i qartë se ata po i sulmonin pikërisht ata”. Ai theksoi se kjo praktikë shpjegon pse numri i viktimave ishte i lartë, duke pasur parasysh edhe numrin relativisht të vogël të projekteve të lëshuara.²⁰ Fuad Shehbajraktareviqi, nga Sarajeva, tha se kishte ndërtesa si mbrojtje përmes rrugës së Titos, ndërsa drejt Marindvorit ishte e hapur, dhe për këtë arsye ishte më e rrezikshme për shkak të të shtënave nga Grbavica.²¹ Jacques Kolp, oficeri ndërlidhës i UNPROFOR-it me URBeH, nga marsi i vitit 1993 deri në nëntor të vitit 1994 dëshmoi se ishte e njohur si temë se si zjarri i snajperit u hap nga zona e Grbavicës “nga ndërtesat në anën tjetër të lumit”.²² David Fraser, përfaqësues i UNPROFOR, tregoi se nuk kishte pozicione ushtarake në Sarajevë, në zonën e “Rrugës së snajperëve”, por kaluan nëpër rrugë vetëm civilë, e të cilët ishin objektivi kryesor i të shtënave:

Pashë [...] njerëz që përpiqeshin të kalonin urat, lumin në qendër të Sarajevës, sidomos në Sarajevën e Re. Vëzhgova se si ata ndalonin dhe u fshehën pas një peme ose muri, pastaj dilnin jashtë dhe vraponin, e pas kësaj ishin ndjekur nga të shtënat. Vëzhgova kryqëzimin kryesor pranë ndërtesës Energoinvest, një nga kryqëzimet më të rrezikshme në të gjithë Sarajevën, ku vazhdimisht vepronin snajperët. Ishte një zonë e gjerë dhe hapur përballë kthinës së vendbanimeve të Hrasnos dhe Grbavicës, ku kryqëzoheshin këto vendbanime dhe ishte e qartë se kishte një pozicion snajperi nga i cili hapej zjarr në atë zonë në baza ditore.²³

Gazetari Aernout Van Lynden konfirmoi gjithashtu se një pjesë e madhe e rrugës së quajtur “Rruga e snajperëve”, si dhe Sheshi Marindvor

²⁰ Po aty, f. 448, 79.

²¹ “Ndërsa po kalon nëpër rrugën e Titos, ke mbrojtjen e ndërtesave, sapo të shkosh në Marindvor, ka mbaruar, Grbavica, qëllon një snajper, vret gjithçka të gjallë”. Po aty, par. 229, 81.

²² Po aty, par. 228, 80.

²³ Po aty, 230, 82.

dhe kryqëzimi pranë Presidencës së Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, ishin të ekspozuara ndaj zjarrit të snajperëve nga rrokaqiejt në Grbavicë. Në fund të shtatorit të vitit 1992, Van Lynden vizitoi ndërtesat e banimit në Grbavica, me lejen e Presidencës së Republikës Serbe. Ai pa edhe pozicione snajperësh në vijën e parë. U dërgua në dhoma në disa ndërtesa ku ishin vendosur lloje të ndryshme pozicionesh qitjeje, duke përfshirë dhoma të errëta me pushkë snajper pranë thasëve me rërë, pas vrimave të dritareve. Ai përshkroi pushkët me tyta të gjata dhe objektiva teleskopike, të cilat i njohu si pushkë snajper. Në dysheme kishte gëzhoja plumbash bosh. Ushtarët, të veshur me uniforma të UPJ-së, përdornin voki-toki për të komunikuar me shokët në pozicione dhe pika vëzhgimi. Ai theksoi se ishte e qartë se kjo ishte një veprim i mirëkoordinuar.²⁴ Akuza të ngjashme u konfirmuan nga gazetari norvegjez Morten Hvaal, i cili mbulonte përleshjet në Sarajevë nga shtatori i vitit 1992 deri në gusht të vitit 1994. Me leje, ai vizitoi katër rrokaqiejt në Grbavicë, ku pa pozicione snajperësh dhe lloje të ndryshme armësh, përfshirë mitralozin M84, i njohur më mirë si “mbjellësi i vdekjes”.²⁵ John Ashton u çua vazhdimisht nga anëtarët e KSR-së në pozicione, në vijën e parë të frontit, në ndërtesat e banimit në Grbavicë. Përveç pozicioneve të snajperave, edhe në ambiente kishte “mijëra e mijëra gëzhoja...”.²⁶

Përveç Grbavicës, kishte edhe pozicione të tjera nga të cilat banorët e Sarajevës ishin në shënjestër: Varrezat Çifute, Shkëmbi me Majë, Shkëmbi “Baba” në shpatin verior të malit Trebeviq, Kodra e Arrës në Polinat (nga ku më shpesh shënjestroheshin banorët e Kobile Gllavës), kisha ortodokse në Dobrinja IV (e cila ishte në ndërtim e sipër dhe rreth së cilës kishte skela), Shkolla e të Verbërve në Nexhariqi, në Vrace, mbi Kodrës së Trashë, nga kthesa në rrugën Llukavicë-Pale mbi Skenderija²⁷, si dhe pozicione të tjera që ishin nën kontrollin e KSR-së. Pas riintegritit të Sara-

²⁴ Po aty, par. 238, 86.

²⁵ Po aty, par. 229, par. 239, 81, 86.

²⁶ Po aty, par. 240, 87.

²⁷ Po aty, par. 510-585, 210-235; ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 908, 300-301.

jevës, në prill të vitit 1996, punonjësit e MPB-së, të Qendrës së Shërbimit të Sigurisë, gjetën dhe dokumentuan ekzistencën e një numri të madh pozicionesh mitralozësh dhe snajperësh drejt Muzeut Kombëtar, Shkollës Teknike, Hotel Holiday Inn, Muzeut të Revolucionit (sot Muzeu Historik), Bulevardi Boris Kidriq (sot Rruga Franc Lehar), urës “Vëllazëri-Bashki” etj.²⁸ Nga procesverbali i hetimeve të kryera në prill të vitit 1996, rezulton se foletë e snajperistëve ishin të vendosura në katet e fundit, në papafingo me mundësi aksesu në çati ose në katet më të ulëta, dhe se këto ishin pjesët më të mbrojtura të ndërtesave.²⁹



Harta: Sarajeva nën rrethim, e rrethuar nga forcat KSR e URS, sipas hartës së URS-së.³⁰

Snajperistët ishin më aktivë gjatë motit të mirë, kur qytetarët dilnin jashtë. Ata shënjestronin vendet ku mbledheshin civilët, qëllonin njerëz në tregje, në kopshte, para shtëpive, në tramvaje, por edhe në radhë për

²⁸ Edin Omerçiq, *Sarajevska “Aleja snajpera”*, 18.11.2022, www.historiografija.ba.

²⁹ Po aty.

³⁰ ICTY, harta e punës së selisë së URS-së, nga Lënda kundër Dragomir Millosheviqit.

ujë dhe ushqim. Gjithashtu, qëllonin në kontejnerë me ujë që njerëzit mbanin. Si pasojë, banorët detyroheshin të shkonin për ujë natën vonë ose shumë herët në mëngjes, për të shmangur zjarret e snajperistëve.³¹ Dëshmitarja Rialda Musaefendiq deklaroi se dy shoferë të një kamioni buke u vranë. Ajo gjithashtu vuri re plumba në bukë, pasi anëtarët e KSR-së qëlluan në një kamion që transportonte bukë. Banorët vepronin shumë shpejt kur vozisnin ose kalonin rrugët, për të shmangur të shtënat nga snajperistët.³²

Për shkak të ndikimit psikologjik që kjo kishte mbi popullatën, tramvajet dhe njerëzit që udhëtonin me to ishin një objektiv i preferuar i snajperistëve në Sarajevë. Njerëzit vëzhgonin me kujdes se çfarë po ndodhte me tramvajet: nëse ato lëviznin, situata konsiderohej relativisht e mirë, ndërsa nëse nuk lëviznin, kjo nënkuptonte se gjendja ishte e vështirë dhe i gjithë qyteti pushtohej nga frika.³³ Të shtënat mbi tramvaje ushtronin një ndikim të madh psikologjik në qytet. Duke qenë se tramvajet shpesh bëheshin objekt i zjarrit të snajperëve, ndërmarrja GRAS ndërmori masa për të mbrojtur shoferët, duke instaluar pllaka çeliku, pas të cilave ata qëndronin gjatë vozitjes. Tramvajet përbënin objektiva të lehta, veçanërisht përgjatë “Rrugës së Snajperëve”, në zonën midis Muzeut Kombëtar dhe hotelit **Holiday Inn**, ku shinat formonin një kthesë në formë “S”. Ato ishin gjithashtu tepër të ekspozuara ndaj sulmeve pranë kazermës “Marshall Tito”, në Pofaliqe dhe në afërsi të hotelit “**Bristol**”.³⁴ Përveç të rriturve, fëmijët³⁵ ishin shumë shpesh shënjestër e sulmeve ndaj tramvajeve.

³¹ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 208, 72.

³² Po aty, par. 209, 72.

³³ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 214, 73.

³⁴ Po aty, par. 215, 217, 73-74.

³⁵ Ka disa dokumente që e konfirmojnë këtë, njëri prej tyre: ICTY, RBiH, MPB, CSB, Sarajevë, nr. 19/05-1, 15.12.1994, *Shënim zyrtar për plagosjen dhe vdekjen në tramvaj*. Atë ditë, disa persona u plagosën në tramvaj, ndërsa Kemal Tanović iu nënshtrua plagëve të marra. Të shtënat me snajper erdhën nga Grbavica.

Një nga shembujt ndodhi më 8 tetor 1994, kur dy tramvaje u shënjestruan, duke vrarë dhe plagosur disa persona. Fëmijët që zbritën nga tramvaji në afërsi të Fakultetit Filozofik dhe godinës së Këshillit Ekzekutiv u bënë gjithashtu shënjestër e snajperëve, rast në të cilin u plagosën katër fëmijë të moshës 12 deri në 14 vjeç. Ata u qëlluan nga ndërtesa “Metalka” në Grbavicë.³⁶ Një nga djemtë që u qëllua nga një snajper atë ditë ishte Amir Goro, i cili ishte vetëm 14 vjeç. Pas plagosjes, ai u dërgua në Francë, ku iu nënshtrua disa operacioneve të ndërlikuara. Megjithatë, pasojat e plagës ishin tepër të rënda dhe, si rezultat, Amir Goro ndërroi jetë në moshën 28-vjeçare, më 29 gusht 2019.³⁷ Përveç qëllimeve të civilëve në tramvaj, civilët në autobusë, edhe mjete të tjera transporti ishin gjithashtu në shënjestër.

Mbrojtja e Millosheviqit dhe Galiqit para ICTY-së pretendoi se UR-BeH kishte hapur zjarr snajperi ndaj civilëve boshnjakë. Megjithatë, këto pretendime u hodhën poshtë. Gjenerali Smith deklaroi se **“askush nuk ka paraqitur ndonjëherë ndonjë provë që diçka e tillë ka ndodhur”**.³⁸ Millorad Katiq ishte dëshmitari që mbrojti Millosheviqin dhe Galliçin, duke deklaruar se “snajperët e UBeH” ndodheshin në “Ndërtesën e Kuqe” dhe se ata po qëllonin ndaj tramvajve që lëviznin përgjatë rrugës “Dragua nga Bosnja”. Megjithatë, pasi iu prezantua një seri pamjesh të asaj pjese të qytetit, Katiq pranoi se “Ndërtesa e Kuqe” nuk mund të shihej nga rruga “Dragua nga Bosnja”, nga ku tramvajet qëlloheshin më shpesh nga snajperët.³⁹

³⁶ ICTY, Aktgjykimi nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 262, 82.

³⁷ SniperAlley.photo, Inçizimi i plagosjes, <https://twitter.com/sniperalleyphot/status/1432013471323983879>; Barbara Demick, *Young victim is on the mend in Paris*. Për këtë rast, si dhe raste të tjera të snajperit, shihni dokumentarët e realizuar nga TV Slovenia: "Krvavi turizem" (<https://365.rtvsllo.si/arhiv/tednik/174900301>) dhe "Sarajevo, 1425 Days of Horror" (<https://365.rtvsllo.si/arhiv/mednarodna-obzorja/174948918>).

³⁸ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, par. 243, 83.

³⁹ Po aty, par. 242, 83.

Rrethimi i Sarajevës, vrasja e civilëve, veçanërisht e fëmijëve, dhe krimet kundër tyre përbëjnë ndër krimet më të rënda kundër njerëzimit. Në përputhje me detyrimet e vendosura nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe me aktet e tjera ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e civilëve në konflikte të armatosura, personat nën moshën 18 vjeç kanë statusin e personave të mbrojtur posaçërisht. Normat themelore të së drejtës ndërkombëtare nuk u respektuan nga Ushtria e Republikës Serbe (URS), duke shkelur normat ligjore të detyrueshme, të zhvilluara ndër shekuj, dhe më e rëndësishmja midis tyre – mbrojtja e civilëve, përkatësisht mbrojtja e fëmijëve.⁴⁰

Trajnimet dhe kërkesa për armë dhe municione për fushatë snajperi

Komanda e Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR) të Ushtrisë së Republikës Serbe (URS) organizoi trajnime të veçanta për snajperistët, të cilat zhvilloheshin kryesisht në kazermat e Jahorinës dhe Romanisë. Në një dokument të titulluar “Urdhri për ndarjen dhe dërgimin e instruktorëve të snajperistëve në stërvitje në kazermën e Jahorinës”, datuar më 19 janar 1995, shihet se Dragomir Millosheviq lëshoi urdhra për stërvitjen e snajperistëve. E njëjta gjë rezulton edhe nga urdhri i datës 29 janar 1995.⁴¹

Në zonën e Shkëmit të Kuq, në fshatin Zhdrijelo në Romanijë, u organizua trajnimi i vullnetarëve dhe i ushtarëve në trajtimin e armëve. Në

⁴⁰ Këto norma ligjore të së drejtës ndërkombëtare humanitare bazohen “në vlerat që janë themelore për çdo qenie njerëzore – integritetin e individit, në të drejtën për jetë dhe të drejtën për t’u mbrojtur nga frika, dhimbja dhe dhuna. Prandaj, sit ë tilla vlejné për të gjithë, pavarësisht nga dallimet në kombësi, shtetësi ose fe.” *Konventa e Gjenevës në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte e 12 gushtit 1949*; ICTY, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2007, 4.

⁴¹ ICTY, f. Nr. 20/04-20, *Urdhër për Shkëputjen dhe Dërgimin e Instruktorëve të Snajperëve në Trajnim në Kazermën Jahorina, 19 janar 1995*; ICTY, *Urdhri i Komandantit të KSR-së për Trajnimin e Njësive të KSR-së i 29 janarit 1995*.

fillim të marsit 1992, në trajnim ishin rreth 100 persona, “si me uniformë, ashtu edhe me rroba civile”, përfshirë edhe një numër serbësh nga Sarajeva. Trajnimi zgjati rreth njëzet ditë dhe përfshiu fillimisht stërvitje për çmontimin dhe montimin e armëve, si dhe për mbushjen e municioneve, më pas përdorimin e snajperëve etj. Pas disa ditësh, pjesëmarrësit kryen xhirime të drejtpërdrejta në thasë të mbushura me kashtë, në një distancë prej 150 deri në 200 metra. Trajnimi përfshinte gjithashtu praktikimin e përdorimit të thikës, palosjen dhe shpalosjen e tendave, e të tjera. Pas përfundimit të trajnimit, të gjithë pjesëmarrësit u ndanë në katër grupe dhe u dërguan në shtëpi, me marrëveshjen që do të thirrreshin përsëri në rast nevojë. Pas dhjetë ditësh, ata u ftuan me telefon për t’u paraqitur në grupet e tyre dhe për t’u rikthyer në Romani për trajnime shtesë, të cilat zgjatën edhe shtatë ditë të tjera. Në përmbyllje të stërvitjes, ushtarët rreshtoheshin, iu afroheshin flamurit serb me kamuflazh dhe thoshin: “Betohem Zotit dhe mbretit se do t’i shërbej me besnikëri popullit serb, pa u penduar për jetën tonë.”⁴²

Më shumë dokumente të KSR URS-së dëshmojnë për mbajtjen e kurseve dhe trajnimeve të snajperistëve. Përmbajtja e këtyre kurseve ishte e strukturuar në tri tema kryesore: tema e parë trajtonte *Pushkën snajper*, tema e dytë përqendrohej te *Gjuajtja*, ndërsa tema e tretë kishte të bënte me *Veprimet e një snajperisti*, (përfshirë koordinimin dhe veprimet e një çifti ose grupi snajperësh në kushte luftarake).⁴³ Në një nga dokumentet e nënshkruara nga Millosheviqi theksohet se trajnimi i instruktorëve të snajperistëve do të zhvillohej më 23 janar 1995 në zonën e kazermës Jahorina dhe do të zgjaste tetë ditë. Në këtë dokument, kapiteni Zoran Terziq, togeri Vllajko Bozhiq dhe major Stevan Velloviq janë renditur si personat përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e kursit “Mbrotjtja Ko-

⁴² Smail Çekiq, *Agresija na RBiH: planiranje, priprema, izvođenje*, Instituti për Kërkimin e Krimeve kundër Njerëzimit dhe së Drejtës Ndërkombëtare, Sarajevë, 2004, libri 2, 831-834.

⁴³ AIIZ, inv. nr. 7-85, Përmbajtja e temave të kursit të snajperit.

mbëtare”, duke u përcaktuar përkatësisht si komandant i kursit dhe instruktorë trajnues.⁴⁴

Ka një numër dokumentesh përkatëse nga të cilat shihet se sa ishte kërkesa për pushkë snajperi dhe municione.

Në fillim të vitit 1992, por edhe më herët, u bënë kërkesa në të cilat kërkoheshin armë, përfshirë pushkë snajperi. Një i tillë i drejtohej Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të RSFJ-së, komandantëve të Qarqeve Ushtarake II dhe IV.⁴⁵ Në fillim të shkurtit të vitit 1992, pushkë snajperi, objektive nate dhe mjete të tjera speciale u sollën nga Pançeva.⁴⁶ Në prag dhe pas barrikadave të marsit, në Sarajevë, në zonën e lagjes së Sarajevës Pofaliqi, mbi 300 pushkë automatike dhe gjysmautamatike, përfshirë pushkë snajperi dhe armë të tjera, u shpërndanë për popullatën serbe atje.⁴⁷ Ka shumë dokumente që tregojnë ndarjen e armëve, përfshirë pushkët snajper.⁴⁸ Në Raportet e vitit 1992, kërkesa për municione snajperi mund të monitorohet dhe në një kërkesë të nënkolonelit Radisllav Krstiq, të datës 13 gusht, drejtuar Komandës së KSR-së, ku thuhej se, për shkak të “aktiviteteve në shkallë të gjerë të njërive tona që janë duke u zhvilluar”, pra, u kërkuan “shumë urgjentisht”, 5,000 plumba snajper⁴⁹. Disa ditë më vonë, më 17 gusht, u kërkuan edhe 10,000 plumba të tjerë snajperi.⁵⁰ Dy ditë më vonë, më 19 gusht, komandanti

⁴⁴ Komanda e KSR-së, faqe 20/04-20, 19.01.1995, *Ndarja dhe dërgim snajperësh për stërvitje në Kazermën Jahorina, Urdhër*, nënshkruar nga Dragomir Millosheviq.

⁴⁵ Çekiq, *Agresija...*, libri 1, 556.

⁴⁶ Po aty, 587.

⁴⁷ Po aty, 593.

⁴⁸ Disa nga mjekët e Spitalit Ushtarak në Sarajevë morën pushkë snajper. Mbi identitetet dhe më shumë detaje në: Po aty, 623.

⁴⁹ Komandant i Brigadës së 2-të Ushtarake Sokolac, str. pov. nr. 45/2-92, 13.08.1992, *Kërkesë për rimbushje të municioneve në komandat e KSR-së*, e firmosur nga nënkolonel Radisllav Krstiq.

⁵⁰ Në të njëjtën letër thuhej edhe kërkesa për 300.000 fishekë të tipit 7.62 mm, 150.000 të tipit 7.9 mm, 80.000 fishekë panciri të djegshëm, 60.000 fishekë për mitralozin M56 etj. Komanda e Dytë e Romanisë mtbr Sokolac, f. pov. nr. 667/4-

Millorad Lolloviq kërkoi edhe 300 copë plumba snajperi për 2/2 e rtmb Pale dhe KSR,⁵¹ dhe më 22 gusht, komandanti, nënkoloneli Velko Stojanoviç, kërkoi edhe 1,224 plumba snajperi.⁵² Në të njëjtën ditë, u dërgua një kërkesë për nevojat e Brigadës Rajllovac, duke kërkuar pesë arka me plumba snajperi, gjegjësisht 4,500 copë, dhe 900 plumba të tjerë snajper për nevojat e Brigadës së Koshevës.⁵³ Më 4 nëntor 1992, zëvendëskomandanti i Komandës KSR URS-së, kolonel Dragan Marçetiç, urdhëroi të gjitha njësitë e Korpusit të vlerësonin mundësitë e vendosjes së snajperëve në zonat e tyre të përgjegjësisë, në pozicionet e duhura të snajperave, dhe se ata duhej të identifikoheshin.⁵⁴ Ishte e nevojshme duhej të përcaktonin numrin e pikave të snajperave, si dhe të vendosej numri i kërkuar i snajperistëve. Njësitë më pas do të deklarënin nevojën për snajperistë, pushkë snajperi, pajisje dhe pajisje synimi.⁵⁵ Kërkesa vazhdoi me të njëjtin intensitet deri në fund të luftës.

Në një letër të dërguar nga KSR - Pozita e Komandës Ndhimëse (PKN), të datës 30 mars 1995, u kërkuan armë këmbësorie, duke përfshirë pesë pushkë snajperi.⁵⁶ Në një letër të datës 19 prill 1995, u kërkuan pesë pushkë të tjera snajperi M-76, kalibri 7.62, me kërkesë të konsiderueshme për armë të tjera këmbësorie.⁵⁷ Më 1 maj 1995, Shtabi i Për-

92, 17.08.1992, *Kërkesë për rimbushje të municioneve në komandën e KSR-së*, e nënshkruar nga nënkolonel Radislav Krstiq.

⁵¹ 2/2. rtmb Pale, f. pov. nr.01/98-1, 19.08.1992, *Kërkesa e MTS nga magazina Kogan*.

⁵² Komanda e Parë sar. nr., f. pov. nr. 1-409, 22.08.1992, *Raporti Luftarak i Komandës së KSR-së*, nënshkruar nga Velko Stojanoviç.

⁵³ Komanda e Grupit Operacional të Ushtrisë Serbe "Vogoshqa", f. pov. nr. 153, 22.08.1993, *Kërkesë për lëshimin e municioneve dhe MES-it në Komandën e KSR-së*.

⁵⁴ Edin Omerçiq, *Sarajevë "Aleja snajpera"*, 18.11.2022, www.historiografija.ba.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Komanda e Parë e smbr f. pov. nr. 1-159/1, 30.3.1995, *Copa të KSR-së, Letër nga Major Çedo Pajiç mbi sasinë e TMS-së*.

⁵⁷ Komanda KSR-PKM, pov. nr. 16/7-4-1/3, 19.04.1995, *Kërkesë për TMS*, nënshkruar nga kolonel Aleksa Krsmanoviç.

gjithshëm i URS-së i dërgoi një letër Ministrisë së Mbrojtjes së RS-së, Institutit Teknik dhe të Riparimit (ITR), Haxhiqi, si dhe Komandës së KSR-së, se 20 pushkë snajperi ishin miratuar.⁵⁸ Në kërkesën e Dragomir Millosheviqit, të datës 15 prill 1995, 9,000 plumba snajperi u kërkuar “urgjentisht” për drejtimin e Trnovskit, për 1. Smbr dhe 2 SLpbr URS-së.⁵⁹ Më 3 maj, komandanti Millosheviq kërkoj 2,700 municione snajperësh për nevojat e Brigadës së Këmbësorisë Ilixha⁶⁰, dhe më pas, më 24 maj, për shkak të “operacioneve intensive në unazën e brendshme të fushës së betejës së Sarajevës”, komanda të tjera kërkuar 5,400 municione snajperësh.⁶¹ Më 16 qershor, Komanda e KSR-së informoi Komandën SRK-PKM, Komandën 3. Spbr dhe Komandantit Millosheviq se komanda do të jetë 27. Bazës së Sfondit (PoB) që vepronte në kuadër të 3. Spbr URS-së, ndër të tjerash, i ishin vënë në dispozicion 5,400 fishekë snajperi,⁶² ndërsa 1. Smbr URS e kishte për detyrë dorëzimin e 900 copë fishekëve në Llukavicë. Në të njëjtën ditë, komandanti Çedomir Slladoje kërkoj edhe 9,000 municione snajperi për operacionet intensive luftarake që po zhvilloheshin.⁶³

⁵⁸ Shtabi i Përgjithshëm i URS-së, Sektori për Sfondë, Departamenti Teknik, pov. nr. 10/3/4/2-4-217, 1 maj 1995, *Shkresë*, e nënshkruar nga kolonel Gjuro Dakiq.

⁵⁹ Komanda e KSR-së, f. pov. br. 20/13-2-134, 15.04.1995, *Kërkesë për dorëzimin e MTS-së*.

⁶⁰ Komanda e KSR-së, f. pov. nr. 20/13-2-156, 3.5.1995, *Kërkesa e MTS-së*.

⁶¹ Komanda e KSR-së, f. pov. nr. 20/13-2-202, 24.05.1995, *Kërkesa për MTS*, nënshkruar nga Dragomir Millosheviq.

⁶² Komanda KSR-së, f. pov. br. 20/13-2-271, 16.6.1995, shumë urgjente, *Njoftim për shtimin e MTS 3. Smbr*, nënshkruar nga nënkoloneli Milivoj Solar; Ekziston gjithashtu një dokument që 1,800 copë municione snajper u dorëzuan një ditë më parë për Komandën e 3-të të Këmbësorisë. Spbr në: Komanda e KSR-së, str. pov. nr. 20/13-2-263, 15.6.1995, shumë urgjent, *Njoftim për shtimin e MTS 3. Smbr*, nënshkruar nga nënkoloneli Milivoj Solar;

⁶³ Komanda KSR, f. pov. nr 20/13-2-268, 16.6.1995, shumë urgjente, *kërkesa MTS për njësi në pjesët jugperëndimore dhe veriperëndimore të fushëbetesës së Sarajevës*; Në të njëjtën ditë, Sladoje kërkoj 38,500 litra karburant naftë për nevojat e KSR dhe 12,400 litra për Igmanška pbr nga Republika Federale e Jugosllavisë.

Në një kërkesë të datës 27 korrik 1995, Millosheviqi kërkoi urgjentisht 9,000 fishekë të tjerë snajperësh për njësitë në pjesën jugperëndimore të fushëbetejës së Sarajevës.⁶⁴ Në një letër të datës 24 gusht 1995, Ndhimës Komandanti i Prapavijës, toger Milovan Gjurgjiq, i kërkoi Komandës së KSR-së dhe nënkolonelit Solar furnizimin me 900 fishekë snajperësh (kalibri 7.9 mm M76).⁶⁵ Si përgjigje, të nesërmen sasia e kërkuar e plumbave u miratua, dhe dërgesa dha informacion për të pranuar.⁶⁶ Sasitë e kërkuara të municioneve përbënin vetëm një pjesë të vogël të nevojave dhe paraqisnin mungesat në normën e caktuar të racionimit të municioneve për brigadën. Në një telegram të datës 23 gusht 1995, Ndhimës Komandanti i Prapavijës, koloneli Aleks Krsmanoviq, informoi njësitë e KSR-së se TRZ Çaçak do të kryente riparimin “sa më shpejt të jetë e mundur” të të gjitha pushkëve gjysmë automatike të snajperit me defekt (kalibri 7.9 mm M76).⁶⁷ Në një nga raportet e vitit 1992 u tregua konsumi i një sasive të konsiderueshme municionesh, ku u deklarua edhe konsumi i 40 fishekëve snajperësh për atë ditë.⁶⁸ Sipas Pasqyrës vjetore të sasisë së municioneve dhe MES të shpenzuara, do të japim një shembull për vitin 1995, ku nga 1 janari, e deri më 31 dhjetor 1995, tregohet konsumi i municioneve snajperësh sipas muajit, duke treguar një konsum total prej 29,248 fishekësh. Nga ky rishikim, është shumë e qartë se shumica e fi-

Komanda e KSR-së, f. pov. nr. 20/13-2-256, 16.6.1995, shumë urgjente, *Kërkesa për karburant dizel nga RFJ*;

⁶⁴ Komada KSR, f. pov. nr. 20/13-2-383, 27.7.1995, *Kërkesë për dorëzim të MTS*.

⁶⁵ Komanda 1. e Ilixhës pbr, pov. nr. 3-3029-1, Ilixhë, 24.08.1995, Komanda e KSR-së na Persononalitet të ppuk. *Solar, Kërkesa*.

⁶⁶ Komanda e Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë, pov. nr. 20/13-2-462, 25.08.1995, në Brigadën Ilixa të PKM KSR, nënshkruar nga nënkolonel Solak Milivoj.

⁶⁷ Komanda KSR-PKM, pov.ner. 16/7-4-325, 23.08.1995, *Telegram i kolonelit Aleks Krsmanoviq për riparimin e pushkëve snajper*.

⁶⁸ Komanda e Brigadës së 2-të të Sarajevës, tt.569, 18.07.1992, *Raporti i Rregullt Luftarak drejtuar Komandës së SRK-së*, i nënshkruar nga Shefi i Shtabit Millan Maljkoviq.

shekëve snajperësh u përdorën në muajin maj.⁶⁹ Nga një numër dokumentesh përkatëse, është e mundur të identifikohen personat që kanë shërbyer si snajperistë në Sarajevë gjatë periudhës 1992-1995. Menjëherë pas fillimit të luftës, me formimin e një njësie të MPB-së së komunës serbe të Stari Gradit, u krijua një departament snajperësh. Në këtë departament kishte disa anëtarë (identitetet e të cilëve janë të njohura për autorin).⁷⁰ Njëri prej anëtarëve të këtij departamenti qëndroi aty vetëm për një kohë të shkurtër, pasi tregoi rezultate të dobëta në të shtënat gjatë operacioneve në zonën e Crepolskos, në verën e vitit 1992. Anëtarët e këtij departamenti zakonisht kryenin edhe detyra të tjera policore dhe përdornin snajperët kryesisht për misione skautimi. Armatimi i tyre përfshinte snajperë ushtarakë të prodhuar nga “Flamuri i Kuq”; në fillim, ata kishin mitralozë M53, ndërsa më vonë u pajisën edhe me mitralozë M84. Gjatë periudhës prill-maj 1992, trajnimi për snajperistët u zhvillua në Crepolskë, me disa persona të ngarkuar posaçërisht për organizimin e tij. Në maj të vitit 1992, Korpusi i Sarajevës (KSR) planifikoi një operacion për shkatërrimin e vendbanimit të Falletiqit dhe dëbimin e popullsisë aty. Sipas këtij plani, synohej që çdo ditë të qëllohej në zonën e populluar për të shkakuar frikë dhe për t’i detyruar civilët të largoheshin. Snajperistët u angazhuan në këto veprime në baza ditore, duke përdorur pushkën M84. Në këto operacione morën pjesë më së shumti çetat nga Zeçija Gllava, Vuçija Lluca dhe Gornji Biosku.⁷¹ Në një numër dokumentesh të tjera evidentojnë identitetet e personave që morën pjesë në fushatën e snajperistëve kundër banorëve të Sarajevës. Ndër snajperistët e njohur që vepruan nga pozicioni i famshëm i “Rrokaqiejve të Bardhë” në rrugën Vëllazërim-Ba-

⁶⁹ Komanda e KSR-së, *Aneksi 2, Nr. 0529-2760, Rishikimi i municioneve të shpenzuara dhe MES-it nga 01.01.1995, deri më 31.12.1995.*

⁷⁰ Identitetet janë të njohura për autorin dhe dokumentet rreth tyre janë në Arkivin e Institutit për Kërkimin e Krimeve kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare të Universitetit të Sarajevës.

⁷¹ AIIZ, inv. nr. 7-82, RBiH, Armata e RBiH, Komanda e Divizionit të 12-të, Qendra e Sigurisë, nr. 04/01,5-220-1, Sarajevë, 28.2.1996, Fushata e snajperit gjatë agresionit kundër RBiH.

shkim gjatë gjithë periudhës së luftës janë: D.A. dhe vëllai i tij D.A., si dhe një grua me inicialet N.V. Nga godina e Qendrës Tregtare në Grbavicë vepruan M.K., M.T. dhe një person i njohur me nofkën Mikelis. Po ashtu, A.P. ishte aktiv në lokacionin e VZ “Shqiponja” në Rajllovac, ndërsa nga zona e Ilixhës u përmend një grua që ishte punonjëse në VZ “Shqiponja”, e identifikuar si G.Sh.⁷² Një person me nofkën Llubarda operonte nga lokaliteti në Nexhariq, ndërsa B.B., komandanti i Togës së Ndërhryjes, vepronte në lokacionet e Nexhariqit dhe Ilixhës. Dokumentet përmbajnë gjithashtu emra të tjerë të snajperistëve. N.P., komandanti i snajperistëve, ishte përgjegjës për raportimin në brigadë mbi performancën e snajperistëve gjatë ditës. Sipas të dhënave në dispozicion, ky i emëruar më vonë u trajtua në repartin psikiatrik në Sokocë.⁷³

Mercenarët nga Republika Federale e Jugosllavisë, Rusia, Rumania dhe Greqia u angazhuan gjithashtu si snajperistë. Këta mercenarë ishin të pranishëm në zonat e Trebeviqit dhe Grbavicës dhe vepronin kryesisht si snajperistë, por shumë shpesh merrnin pjesë edhe në veprimtari zbulimi pak para sulmeve, si dhe në vetë sulmet. Ata nuk ishin të njohur për popullsinë serbe të Grbavicës dhe banonin në shtëpitë e boshnjakëve të dëbuar me forcë. Kishin të veshura uniforma kamuflazhi me dizajn specifik të ushtrisë ruse dhe ishin kryesisht të armatosur me pushkë snajperi gjysmë automatike të pajisura me aparatura IC. Ata shpesh vepronin nga ndërtesa “Metalka”, Qendra Tregtare dhe rrokaqiejt në rrugën Leninoa, si dhe nga Varrezat Çifute, Ozrenska dhe Ohridska. Ushqimin e konsumonin në një restorant ushtarak, i cili ndodhej në katin e parë të shkollës fillore “Brane Shurbat”.⁷⁴ Në një rast, një duzinë anëtarësh të një shoqate qitjeje mbërritën në zonën e Grbavicës, të cilët paguheshin jashtëzakonisht shumë për “punën e tyre të përgjakshme”, në varësi të performancës së tyre.⁷⁵

⁷² Po aty, 2-3.

⁷³ Po aty, 3.

⁷⁴ AIIZ, inv. nr. 7-416, Komanda e Korpusit të 1-rë, f. pov. nr. 11/61-953, 10.12.1993, Angazhimi i mercenarëve të huaj në fushën e betejës së BH.

⁷⁵ Çekiq, Agresija..., libri 2, 931; Oslobodenje, 16 mars 1993.

Ekziston gjithashtu një narrativë në diskursin publik që flet për pjesëmarrjen e vullnetarëve nga vendet evropiane, veçanërisht nga Italia, për ardhjen vullnetare të “turistëve të pasur” në Bosnje dhe Hercegovinë dhe për pagesën e shërbimeve për të vrarë civilë në kryeqytet. Për këtë çështje është inçizuar edhe një dokumentar i titulluar **“Sarajevo Safari”**, i cili trajton pjesëmarrjen e tyre.⁷⁶ Në këtë punim ne nuk do të merremi me këtë segment, sepse ka nevojë për një kërkim shkencor, për të cilin më pas është e nevojshme të shkruhet një punim i veçantë.

Viktimat e mitura të fushatës së snajperit

Në periudhën midis viteve 1992 dhe 1995, fëmijët e Sarajevës vriteshin dhe plagoseshin pothuajse çdo ditë nga fushata snajperiste. Në këtë kapitull do të paraqesim, në rend kronologjik, një përmbledhje të shkurtër të 63 fëmijëve të vrarë nga snajperët. Shembujt e vrasjeve të fëmijëve kanë për qëllim të tregojnë se ata ishin viktimat të qëllimshme në një fushatë snajperësh dhe se janë vrarë në një mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Në vitin 1992, 24 fëmijë u vranë. Një nga viktimat ishte vajza Mellisa Osmanković, e cila u vra nga një snajper më 26 maj 1992 në hollin e një ndërtese në rrugën Hasan Brkić, në komunën “Qendra”. Plumbi e goditi në shpatull dhe ajo vdiq në spitalin e Koshevës. Mellisa ishte nëntë vjeçare.⁷⁷ Vajza katërmëdhjetë vjeçare, Sellma Sollak, u vra më 30 maj, në banesën e saj në rrugën e Revolucionit të Tetorit, në komunën e “Novi

⁷⁶ Dokumentari u shfaq në <https://www.youtube.com/watch?v=nk2yz0xQaGo>. Një raport për filmin u shfaq edhe në mediat italiane, në televizionin RAI: <https://www.rainews.it/tgr/rubriche/estovest/video/2022/10/TGR-Estovest-del-02102022-c5337603-6e46-4efe-80f9-4baeaa9e08f5.html>.

⁷⁷ Arkivi i Institutit për Kërkimin e Krimeve kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare (AIIZ), inv. nr. 7-663, Fëmijët e vrarë të Sarajevës (UDS), *Dosije s usmjerenim orjentacionim intervjuem i dokumentima za Melisu Osmanković (Dosije za Melisu Osmanković)*; Zilha Mastaliq Koshuta, “Ubijena djeca Sarajeva u opsadi”, Pjesa VI, 616, në: Smail Çekić et al, *Zločini nad djecom Sarajeva u opsadi*, Instituti për Kërkimin e Krimeve, 2010; Zilha Mastaliq, *Zločini nad djecom Sarajeva u vrijeme opsade 1992-1995*, 2012, Dorëshkrimi i tezës së magistraturës, 46.

Gradit”. Sellma hyri në dhomë për të marrë një pulovër dhe për të zbritur në strehë, për shkak të granatimeve. Plumbi e goditi në zemër.⁷⁸ Disa ditë më vonë, më 6 qershor 1992, Xhevad Sijamiq u vra në rrugën Sallko Llagumxhija, në komunën e “Novi Gradit”, pasi u largua nga streha dhe shkoi në shtëpi. Një plumb snajperi e goditi atë në stomak. Ai ishte 16 vjeçar.⁷⁹ Vajza, Adisa Ramiq, ishte 14 vjeçare kur u vra më 5 korrik, në rrugën “Dragua nga Bosnja”, në komunën “Novo Sarajevo”. Një plumb snajperi e goditi atë në qafë.⁸⁰ Të nesërmen, më 6 korrik, Kemal Lligata u vra në rrugën Humska, në komunën “Novo Sarajevo”. Ai ishte para shtëpisë së tij, kur një plumb snajperi e goditi në sy. Ai ishte 13 vjeçar.⁸¹ Arijana Deliq u godit nga një plumb, më 14 korrik, në një banesë në rrugën “Prvomajska”, në komunën e “Novi Gradit”. Ajo u qëllua në kokë. Ajo vdiq gjatë rrugës për në spital.⁸² Faruk Katica u vra më 21 korrik 1992, në fshatin Koshevsko II, në komunën “Centar”. Ai ishte 17 vjeçar.⁸³ Në gusht u vra një djalë i ri, Amar Vuk. Ai ishte tetë vjeçar. Ai u qëllua në kokë nga një snajper, më 19 gusht, teksa po flinte në dhomën e tij, në rrugën Palevska, në komunën e “Novi Gradit”.⁸⁴ Në fund të muajit, më 28 gusht, u vra edhe Sellma Bjellak. Ajo ishte nëntë vjeçare. Teksa po luante me motrën dhe shokët e saj në një rrugë poshtë qytetit, në Komunën e “Stari Gradit”, një plumb snajper e goditi në qafë.⁸⁵ Djali, Muamer Smajloviq, u vra më 3 shtator, kur u godit nga një snajper në rrugë në komunën “Novo Sarajevo”, gjatë kthimit të tij nga ambulanca. Ai ishte nëntë vjeçar.⁸⁶ Më 10 shtator 1974 u vra edhe Lubisha Pokrajaq.⁸⁷ Po atë ditë u vra

⁷⁸ AIIZ, inv. nr. 7-1471, UDS, *Dosije za Selmu Solak*; “Ubijena djeca Sarajeva...”, Pjesa VI, 685, në: Çekiq et al., *Zločini...*; Mastaliq, *Zločini nad djecom...*, 45.

⁷⁹ AIIZ, inv. nr. 7-743, *Dosije za Dževada Sijamića*; Po aty, 675; Po aty, 45.

⁸⁰ AIIZ, inv. nr. 7-665, *Dosije za Adisu Ramić*; Po aty, 648; Po aty, 47.

⁸¹ AIIZ, inv. nr. 7-1414, *Dosije za Kemala Ligatu*; Po aty, 547; Po aty.

⁸² AIIZ, inv. nr. 7-579, *Dosije za Arijanu Delić*; Po aty, 373; Po aty, 48.

⁸³ AIIZ, inv. nr. 7-1394, *Dosije za Faruka Katicu*; Po aty, 506; Po aty, 47.

⁸⁴ AIIZ, inv. nr. 7-642, *Dosije za Amara Vuka*; Po aty, 764; Po aty, 49.

⁸⁵ AIIZ, inv. nr. 7-1306, *Dosije za Selmu Bjelak*; Po aty, 314; Po aty.

⁸⁶ AIIZ, inv. nr. 7-664, *Dosije za Muamera Smajlovića*; Po aty, 684; Po aty.

edhe Amir Shorllija, i cili ishte 18 vjeçar.⁸⁸ Një djalë tre vjeçar, Mirnes Shahbazoviq, po luante në oborr kur u godit nga një plumb snajperi, në rrugën Tuzllanska, në komunën e “Novi Gradit”, më 16 shtator.⁸⁹

Nëse analizojmë vetëm të dhënat për muajin shtator 1992, përveç qytetarëve të mitur të Sarajevës, katër prej tyre, një numër i madh qytetarësh të rritur u vranë – mbi 20 persona – dhe 63 të tjerë u plagosën. Këto shifra tregojnë qartë përmasat e tragjedisë dhe sa qytetarë humbnin jetën çdo ditë gjatë rrethimit.⁹⁰

Sedina Tozo u vra më 7 tetor në Marindvor, në komunën e “Qendrës”.⁹¹ Në të njëjtën ditë, Nexhad Haxhiq, i cili në atë kohë ishte 11 vjeçar, u qëllua në oborrrin e rrugës Humska, në komunën “Novo Sarajevo”. Ai vdiq të nesërmen, nga plagët e rënda që kishte marrë.⁹² Më 9 tetor, Vahidin Sijamiq (16) u qëllua gjithashtu, kur po vraponte përtej rrugës, gjatë rrugës për në shtëpi. Një snajper e qëllloi në kokë. Vdekja ndodhi të ne-

⁸⁷ ICTY, Nr. 00970276, *Snajpersko djelovanje u Sarajevu*, 2, dokumentet e përdorura në lëndën kundër Stanisllav Galliq; Certifikata e vdekjes së UMC-së në emër të Ljubo Pokrajac; Fragmente nga lista e personave të vdekur të dorëzuar në morgun e UMC-së më 10 dhe 11 shtator 1992, me emrat e Safet Zhiliq dhe Lubisha Pokrajac; Fletët statistikore për rastin e vdekjes në emër të Pokrajacit, Ljubo dhe Zhiliq, Safet.

⁸⁸ ICTY, Nr. 00970276, *Snajpersko djelovanje u Sarajevu*, 2, dokumentet e përdorura në çështjen kundër S. Galliq; Fragment nga lista e personave të vdekur të sjellë në morgun e UMC-së më 11 shtator 1992, në të cilin gjenden emrat e Boraçiq Bido dhe Shorllija Amir; Fragment nga gazeta Oslobodenje e datës 12.09.1992 - certifikatat e vdekjes; Në këtë ditë, katër qytetarë të Sarajevës u vranë dhe u plagosën. Po aty, 1-2.

⁸⁹ AIIZ, inv. nr. 7-1483, *Dosije za Mirnesa Šahbazovića*; “Ubijena djeca Sarajeva...”, Pjesa VI, 704, në: Çekiq et al., *Krimet...*; Mastaliq, *Zločini nad djecom...*, 67.

⁹⁰ Për më shumë detaje mbi identitetin e viktimave, shih: ICTY, Nr. 00970276, *Snajpersko djelovanje u Sarajevu*, 1-13, dokumentet e përdorura në lëndën kundër S. Galliq.

⁹¹ AIIZ, inv. nr. 7-1506, *Dosije za Sedinu Tozo*; “Ubijena djeca Sarajeva...”, 750.

⁹² AIIZ, inv. nr. 7-1355, *Dosije za Nedžada Hadžića*; Po aty, 424; Mastaliq, *Zločini nad djecom...*, 68.

sërmen.⁹³ Mellisa Vitezhiq u vra më 16 tetor, në rrugën Hakija Turajlliq, në komunën e “Novi Gradit”. Ajo ishte 12 vjeçare. Ajo u qëllua në kokë.⁹⁴ Edis Babiq u qëllua në stomak nga një snajper më 19 tetor, teksa po kalonte rrugën në zonën e Kodrës së Brijeshqit, në komunën e “Novi Gradit”. Ai ishte nëntë vjeçar.⁹⁵ Dejan Stevanoviq u vra nga një snajper, më 27 tetor, në bodrumin e një pallati në “Vojničko Polje”, në komunën e “Novi Gradit”. Ai ishte 10 vjeçar.⁹⁶ Të nesërmen, më 28 tetor, Ellvir Bakareviq (17 vjeçar) u vra në vendbanimin Bistrik, në komunën e “Stari Gradit”.⁹⁷

Në nëntor dhe dhjetor, vazhduan të shtënat ndaj fëmijëve nga snajperët. Djali, Emir Subashiq, u vra më 3 nëntor, ndërsa po luante me vëllain e tij më të vogël para një ndërtese banimi në rrugën Branko Shipka, në komunën “Novo Sarajevo”. Ai u qëllua në pjesën e pasme të kokës dhe u vra në moshën dhjetëvjeçare.⁹⁸ Në fund të nëntorit, më 26 nëntor, Kadrija Sadiki u vra pranë një tregu në vendbanimin Otoka, në komunën e “Novi Gradit”. Ai ishte 17 vjeçar.⁹⁹ Samir Hajdareviq u vra më 3 dhjetor, në rrugën e 21 Majit, në komunën e “Novi Gradit”. Ai ishte 17 vjeçar.¹⁰⁰ Djali Nedim Pekmezoviq, u vra më 21 dhjetor në rrugën Isak Samokovlia, në komunën e “Novi Gradit”. Ndërsa luante me miqtë, ai u godit nga një plumb snajperi.¹⁰¹ Shtatë ditë më vonë, më 28 dhjetor, Nexhad Subashiq u vra para një ndërtese në rrugën Tetovska, në komunën e “Novi Gradit”. Ai u qëllua në kockë temporale.¹⁰²

⁹³ AIIZ, inv. nr. 7-1468, *Dosije za Vahidina Sijamića*; Po aty, 676; Po aty, 69.

⁹⁴ AIIZ, inv. nr. 7-619, *Dosije za Melisu Viteškić*; Po aty, 759-760; Po aty.

⁹⁵ AIIZ, inv. nr. 7-641, *Dosije za Edisa Babića*; Po aty, 288; Po aty.

⁹⁶ AIIZ, inv. nr. 7-1473, *Dosije za Dejana Stevanovića*; Po aty, 690; Po aty.

⁹⁷ AIIZ, inv. nr. 7-1295, *Dosije za Elvira Bakarevića*; Po aty, 293; Po aty.

⁹⁸ AIIZ, inv. nr. 7-1476, *Dosije za Emira Subašića*; Po aty, 694; Po aty.

⁹⁹ AIIZ, inv. nr. 7-808, *Dosije za Kadriju Sadikija*; Po aty, 661; Po aty, 70.

¹⁰⁰ AIIZ, inv. nr. 7-1358, *Dosije za Samira Hajdarevića*; Po aty, 431; Po aty, 82.

¹⁰¹ AIIZ, inv. nr. 7-736, *Dosije za Nedima Pekmezovića*; Po aty, 626; Po aty, 71.

¹⁰² AIIZ, inv. nr. 7-1478, *Dosije za Nedžada Subašića*; Po aty, 696; Po aty.

Viti 1993 ishte viti më intensiv për sa i përket vrasjeve të snajperistëve. Atë vit u vranë 27 fëmijë. Emir Nuhanoviq u qëllua nga një snajper më 14 janar 1993, kur ishte rrugës për të marrë ujë në rrugën e spitalit në Dobrinje, në komunën e “Novi Gradit”. Ai ishte 14 vjeçar.¹⁰³ Ndërsa po përpiquej t’i ndihmonte djalit të plagosur, Sead Llagumxhija u vra nga një snajper më 13 shkurt, në rrugën Antun Branko Shimiq, në komunën “Novo Sarajevo”.¹⁰⁴ Vajza, Rijalda Mujezin, u vra më 2 mars, në rrugë, teksa ishte me nënën dhe shoqen e saj, në rrugën e Roginës, në “Stari Grad”. Snajperi e goditi Rijaldën në ijë dhe mushkëri, dhe pasi nëna mori vajzën në krahë, snajperi qëlloi gjithashtu nënën dhe e plagosi. Rijalda ishte 13 vjeçare.¹⁰⁵ Sejo Kilempiq u vra më 7 mars, në pistën e aeroportit të Sarajevës. Ai u qëllua në kokë dhe stomak.¹⁰⁶ Alma Hasanbegoviq u vra më 22 mars, kur luante në rrugën Haxhijamkova, në komunën e “Stari Gradit”. Ajo u qëllua në stomak. Ajo ishte 13 vjeçare.¹⁰⁷ Altijana Hajdareviciq u vra më 23 mars në rrugën e Titos, në Komunën “Centar”. Ajo u godit në kokë nga një plumb snajper derisa ishte në dhomën e saj.¹⁰⁸ Sanella Pecikoza u vra më 29 mars, në rrugën midis Mojmillos dhe Dobrinjas. Ajo ishte 14 vjeçare.¹⁰⁹ Senan Dediç u vra më 7 prill në rrugën Drinska, në komunën “Novo Sarajevo”. Ai ishte 16 vjeçar.¹¹⁰

Pas miratimit të Rezolutës 824, e cila shpallte Sarajevën “zonë të sigurt” të OKB-së më 6 maj 1993, vrasja e qytetarëve të Sarajevës vazhdoi me një intensitet të barabartë ose edhe më të madh. Shpallja e qytetit si “i sigurt” nuk do të thoshte asgjë dhe vrasjet e fëmijëve nga snajperët nuk u ndalën.

¹⁰³ AIIZ, inv. nr. 7-1467, *Dosije za Emira Nuhanovića*; Po aty, 608; Po aty, 72.

¹⁰⁴ AIIZ, inv. nr. 7-1413, *Dosije za Seada Lagumdžiju*; Po aty, 543; Po aty, 73.

¹⁰⁵ AIIZ, inv. nr. 7-701, *Dosije za Rijaldu Mujezin*; Po aty, 582; Po aty, 74.

¹⁰⁶ AIIZ, inv. nr. 7-748, *Dosije za Seju Klempića*; Po aty, 511; Po aty.

¹⁰⁷ AIIZ, inv. nr. 7-720, *Dosije za Almu Hasanbegović*; Po aty, 511; Po aty.

¹⁰⁸ AIIZ, inv. nr. 7-623, *Dosije za Altijanu Hajdarević*; Po aty, 430; Po aty, 75.

¹⁰⁹ AIIZ, inv. nr. 7-1442, *Dosije za Sanelu Pecikozu*; Po aty, 624; Po aty.

¹¹⁰ AIIZ, inv. nr. 7-633, *Dosije za Senana Dedića*; Po aty, 368; Po aty.

Sedin Ivazoviq u vra më 20 maj 1993, përderisa luante me miqtë në sheshin Josip Mazhar Shoshe, në komunën e “Novi Gradit”. Ai u qëllua në kockë temporale. Ai ishte 17 vjeçar.¹¹¹

Ifeta Lliçina u vra më 29 maj në oborrrin e një shtëpie në rrugën Orlovačka, në komunën “Novo Sarajevo”. Ajo u qëllua përderisa ishte jashtë me nënën e saj. Plumbi e goditi në zemër. Ifeta ishte 5 vjeçare.¹¹² Ajdin Sipoviq u vra në korridorin e shtëpisë së tij, më 23 qershor, në Sedrenik, në komunën e “Stari Gradit”. Ai ishte 15 muajsh. Nëna e tij gjithashtu u plagos nga i njëjti plumb.¹¹³ Vedad Botiq u qëllua më 14 korrik 1993, në rrugën e Srebrenicës, në komunën “Novo Sarajevo”. Ai iu nënshtrua plagëve të tij në spital. Ai ishte 14 vjeçar.¹¹⁴ Dyvjeçarja Ellma Jakupoviq u vra në një banesë, më 21 korrik, në rrugën Jukiçeva në komunën “Centar”. Ajo hyri në dhomën e saj për të marrë lodrën e saj të preferuar kur u godit në kokë.¹¹⁵ Edis Muratoviq u qëllua më 24 korrik, në shtëpinë e tij, në rrugën 21 maj, në komunën e “Novi Gradit”. Ai ishte më pak se 3 vjeçar.¹¹⁶ Nellmira Kukuljac u vra më 30 korrik, në rezervuarin e Mojmillos, në komunën e “Novi Gradit”. Ajo u qëllua në kokë. Ajo ishte 17 vjeçare.¹¹⁷ Xhevad Hasanoviq u vra nga një snajper më 2 gusht teksa po luante në rrugën Butmirska, në komunën “Ilixha”. Ai ishte më pak se 12 vjeçar.¹¹⁸ Pesëvjeçarja Ellvedina Çolliq u vra më 8 gusht në një shtëpi në Kobila Glava, në komunën e “Vogoshqës”. Nëna e Ellvedinës u vra më 29 shtator 1992 në një bombardim.¹¹⁹ Sada Pohara (17-18) u vra më 30

¹¹¹ AIIZ, inv. nr. 7-1381, *Dosije za Sedina Ivazovića*; Po aty, 479; Po aty, 77.

¹¹² AIIZ, inv. nr. 7-669, *Dosije za Ifeta Ličinu*; Po aty, 546; Po aty.

¹¹³ AIIZ, inv. nr. 7-622, *Dosije za Ajdina Sipovića*; Po aty, 678; Po aty.

¹¹⁴ AIIZ, inv. nr. 7-695, *Dosije za Vedada Botića*; Po aty, 325; Po aty, 79.

¹¹⁵ AIIZ, inv. nr. 7-589, *Dosije za Elmu Jakupović*; Po aty, 483; Po aty.

¹¹⁶ AIIZ, inv. nr. 7-659, *Dosije za Edisa Muratovića*; Po aty, 594; Po aty.

¹¹⁷ AIIZ, inv. nr. 7-1408, *Dosije za Nelmiru Kukuljac*; Po aty, 532; Po aty, 80.

¹¹⁸ AIIZ, inv. nr. 7-1535, *Dosja për Dževad Hasanović*; “Ubijena djeca...”, 439.

¹¹⁹ AIIZ, inv. nr. 7-575, *Dosije za Elvedinu Čolić*; Po aty, 350; Mastaliq, *Zločini nad djecom...*, 79.

gusht në Dobrinjë, në rrugën Kasim Prohiq.¹²⁰ Ellvir Mullaosmanoviq u vra nga një plumb më 1 shtator. Ai ishte jashtë strehës kur u qëllua. Ai ishte 15 vjeçar.¹²¹ Irhad Begiq u qëllua në kokë, në rrugën pas Hridit, në komunën “Stari Grad” më 8 shtator. Ai vdiq në spital. Ai ishte 12 vjeçar.¹²²

Njëvjeçarja Irina Qishiq u godit nga një plumb snajperi më 12 tetor, në rrugën Husref Rexhiq, në komunën “Centar”. Irina ka lindur në Beograd, dhe erdhi në Sarajevë me nënën e saj, në prill 1993, për të qenë me babanë e saj.¹²³ Adnan Kasapoviq u vra më 24 tetor në rrugën Adija Mullabegoviq, në zonën e “Vojničko Pole”, komuna “Novi Grad”. Ai po qëndronte në një kalim që ishte i mbuluar me batanije. Era fryu dhe largoi batanijen, dhe një plumb snajper e goditi në zemër. Ai ishte 15 vjeçar.¹²⁴ Vrasja e djalit Adnan ishte një nga rastet e shqyrtuara gjatë gjyqit kundër Dragomir Millosheviqit, nën komandën e të cilit ndodhi kjo vrasje. Dhoma e Gjykatës arriti në përfundimin se djali u qëllua nga një snajper i KSR-së, nga pozicioni pranë Shtëpisë së të Verbërve në Nexhariq, në një zonë ku nuk zhvilloheshin aksione ushtarake. Gjykata vërtetoi se djali ishte i veshur me rroba civile, bashkë me shokët e tij, dhe se snajperi e kishte pamjen e qartë të tij kur qëllloi.¹²⁵

Adnan Hoxhiq u vra më 31 tetor, pranë kryqëzimit Stup, në komunën e “Novi Gradit”. Ai shkoi të merrte dru për nënën e tij, për dimër. Ai ishte 15 vjeçar. Babai i tij u vra në luftë, dhe nëna e tij u plagos dy herë.¹²⁶

¹²⁰ Deklarata u bë nga Izet Shkul, mik i familjes Pohara, në: Djeca Dobrinje, žrtve rata, Gaudeamus, Gimnazija Dobrinja, 49, në: Mastaliq, *Zločini...*, 79.

¹²¹ AIIZ, inv. nr. 7-625, *Dosja për Dosije za Elvira Mulaosmanovića*; “Ubijena djeca...”, 591.

¹²² AIIZ, inv. nr. 7-611, *Dosije za Irhada Begića*; Po aty, 304; Mastaliq, *Zločini...*, 79.

¹²³ “Ubijena djeca...”, 362; Mastaliq, *Zločini...*, 81.

¹²⁴ AIIZ, inv. nr. 7-1393, *Dosije za Adnana Kasapovića*; Po aty, 505; Po aty, 81.

¹²⁵ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2009, paragrafi 203, 204, 77.

¹²⁶ AIIZ, inv. nr. 7-1366, *Dosije za Adnana Hodžića*; „Ubistva djece...”, 445; Mastaliq, *Zločini...*, 81.

Amir Kerlla u vra më 3 nëntor në Brusulje, në komunën e “Stari Gradit”. Ai u qëllua në kokë. Ai ishte 12 vjeçar.¹²⁷

Jasenka Mashiq u plagos nga një snajper më 14 nëntor, teksa ndodhej në një rrugë të komunës së “Novi Gradit”. Plumbi e goditi në qafë. Pas gjashtë ditësh nga plagosja, ajo ndërroi jetë. Jasenka ishte vetëm 15 vjeçare.¹²⁸ Izudin Biço u vra më 23 dhjetor, në rrugën Nedim Fillipoviq, në komunën e “Novi Gradit”. Ai po shkonte drejt shtëpisë së tezes së tij, kur një snajper e goditi në qafë. Izudini ishte vetëm 14 vjeçar.¹²⁹ Sanel Turcalo u vra më 28 dhjetor, në një apartament në rrugën Zharko Zgonjanin. Ai u qëllua në kokë. Ai ishte 15 vjeçar.¹³⁰

Në vitin 1994, 10 fëmijë u vranë nga një snajper. Mirza Sadoviq u qëllua më 16 janar 1994, në rrugën Pastrma, në komunën e “Stari Gradit”. Tri ditë më vonë ai iu nënshtrua plagëve të marra. Një plumb snajperi e goditi atë në kokë. Ai ishte 9 vjeçar.¹³¹ Djaloshi Nermin Kubur u vra më 2 shkurt 1994, në kopshtin e një shtëpie në Sedrenik, të komunës së “Stari Gradit”. Ai ishte 12 vjeçar.¹³² Mirella Pllociq u vra më 11 gusht, në rrugën Hasan Kikiq, në komunën “Centar”. Ajo po luante para ndërtesës me miqtë e saj, kur plumbi i një snajperi e goditi në kokë.¹³³ Adella Kustura u vra më 30 gusht 1994, në një tramvaj pranë Shkollës së Mesme të Inxhinierisë Mekanike, në komunën “Centar”. Ishte 16 vjeç.¹³⁴

Adnan Popovac u vra më 2 shtator 1994, pranë Bunicas në Hrasnicë. Ai u qëllua në sy, nga një plumb snajperi gjatë armëpushimit, kur doli për të blerë ëmbëlsira.¹³⁵ Sahir Kapo u vra më 17 shtator 1994, në rrugën Jovan Zharko Vesellinov, në komunën “Novi Grad”. Ai u qëllua në një ka-

¹²⁷ AIIZ, inv. nr. 7-630, *Dosije za Amira Kerlu*; Po aty, 510; Po aty.

¹²⁸ AIIZ, inv. nr. 7-1418, *Dosije za Jasenku Mašić*; Po aty, 561; Po aty.

¹²⁹ AIIZ, inv. nr. 7-644, *Dosije za Izudina Biču*; Po aty, 311; Po aty, 83.

¹³⁰ AIIZ, inv. nr. 7-1504, *Dosije za Sanela Turčala*; Po aty, 745; Po aty.

¹³¹ AIIZ, inv. nr. 7-609, *Dosije za Mirzu Sadovića*; Po aty, 664; Po aty.

¹³² AIIZ, inv. nr. 7-1404, *Dosije za Nermina Kuburu*; Po aty, 526; Po aty.

¹³³ AIIZ, inv. nr. 7-629, *Dosije za Mirelu Pločić*; Po aty, 634; Po aty, 88.

¹³⁴ AIIZ, inv. nr. 7-1412, *Dosije za Adela Kusturu*; Po aty, 540; Po aty, 90.

¹³⁵ AIIZ, inv. nr. 7-766, *Dosije za Adnana Popovca*; Po aty, 638.

lim të mbuluar me batanije. Sahiri ishte më pak se 13 vjeçar.¹³⁶ Adnan Çamxhija u vra më 2 tetor 1994, në rrugën Jahorinska, në Hrasnicë, komuna “Illixha”. Ai po kthehej nga stërvitja, kur u godit nga një plumb snajperi. Adnani ishte 16 vjeçar.¹³⁷

Nermina Omeroviq u vra më 8 nëntor 1994, në një apartament në rrugën Kosta Herman, në komunën “Centar”, nga një plumb snajperi në kokë. Në dritaren e dhomës që shikonte drejt Grbavicës, në vend të xhamit ishte vendosur një dërrasë kompensate, pranë së cilës kishte një hapje përmes së cilës kalonte plumbi. Snajperi qëllloi nga një dritare në katin e 7-të të godinës “Metalka” në Grbavicë. Nermina kishte hyrë në dhomë për të ndezur televizorin, në mënyrë që familja të dëgjonte lajmet, kur plumbi e goditi. Nëna dhe tezza e saj e çuan në Qendrën Klinike të Sarajevës, ku iu nënshtrua plagëve të marra.¹³⁸

Djaloshi shtatëvjeçar, Nermin Divoviq, u vra më 17 nëntor 1994, gjatë armëpushimit. Ai u godit nga një plumb snajperi, i cili fillimisht plagosi nënën dhe më pas vrau djalin e saj. Nermini iu nënshtrua plagëve gjatë rrugës për në spital. Snajperi qëllloi nga ndërtesa “Metalka”. Plumbi kaloi nëpër barkun e nënës, doli nga ana e majtë e trupit të saj dhe e goditi Nerminin në kokë.¹³⁹ Lejla Bajramoviq u qëllua më 8 dhjetor, në rrugën Boris Kidriq, në komunën “Centar”, nga një plumb snajperi teksa fliste në telefon, në korridor. Ajo u qëllua në sy dhe vdiq në spitalin e Koshevës. Lejla ishte 17 vjeçare.¹⁴⁰

Në vitin 1995, dy fëmijë u vranë nga snajperi. Mirza Kovaçeviq u vra më 31 mars, në rrugën Ramiq Banja, komuna “Stari Grad”. Ai ishte 16

¹³⁶ AIIZ, inv. nr. 7-1387, *Dosije za Sahira Kapu*; Po aty, 496; Mastaliq, “Zločini...”, 89.

¹³⁷ AIIZ, inv. nr. 7-1529, *Dosije za Adnana Čamdžiju*; Po aty, 342; Po aty.

¹³⁸ AIIZ, inv. nr. 7-566, *Dosije za Nerminu Omerović*; Krimet, 612; Po aty; Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra për Shërbime të Sigurisë, Sarajevë, Nr. 19/05-2, 12.11.1994, *Raporti Zyrtar*.

¹³⁹ AIIZ, inv. nr. 7-744, *Dosije za Nermina Divovića*; Po aty, 380; Po aty, 89; D. Millosheviq, 2007, f. 325-341.

¹⁴⁰ AIIZ, inv. nr. 7-697, *Dosije za Lejlu Bajramović*; Po aty, 290; Po aty, 89.

vjeçar.¹⁴¹ Damir Dodik u vra më 25 qershor 1995, në Qendrën Shëndetësore, në rrugën Vrazova, në komunën “Centar”. Ai ishte duke lëvizur me biçikletë kur një plumb snajper e goditi në zemër. Ai ishte 17 vjeçar.¹⁴²

Midis prillit 1992 dhe dhjetorit 1995, të paktën 63 fëmijë u vranë nga fushata e snajperëve. Numri më i madh i viktimave ishte në komunën “Novi Grad” – 22 fëmijë, e ndjekur nga komunat “Centar”, “Stari Grad” dhe “Novo Sarajevo”. Viti më i përgjakshëm ishte 1993, kur u vranë 27 fëmijë; pas tij viti 1992 me 24, viti 1994 me 10 dhe viti 1995 me 2 fëmijë. Duke i parë vrasjet sipas periudhave të komandës së gjeneralëve të KSR-së, rezulton se numri më i madh i fëmijëve u vra gjatë komandës së Stanisllav Galliçit – 41, i ndjekur nga Tomisllav Shipçiqi me 12 dhe Dragomir Millosheviqi me 10 fëmijë. Nga shembujt e mësipërm, shihet qartë se fëmijët goditeshin kryesisht në pjesën e zemrës, kokës ose mushkërive, çka tregon qëllimin e qartë të snajperëve. Fëmijët ishin viktimat e qëllimshme, të shënjestruara, të vrara në mënyrë sistematike dhe të planifikuar. Ata vriteshin duke luajtur, në bodrume, të fshehur në kalime, në krahët e nënave dhe të afërmeve, duke fjetur, duke ngasur biçikletën dhe në vende të tjera.

(Mos)ndjekja penale e krimeve të kryera

Në periudhën nga prilli deri në mes të majit 1992, kreu i Korpusit të 4-të të Distriktit të 2-të Ushtarak të Ushtrisë Popullore Jugosllave (UPJ), i njohur gjithashtu si Korpusi i Sarajevës, ishte komandanti Vojislav Gjurgevac. Nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi data e saktë kur Gjurgjevac mbajti këtë pozicion, por ekzistojnë informacione që tregojnë se ishte midis 12 dhe 20 majit 1992, kur ai u pasua në këtë detyrë nga koloneli Tomisllav Shipçiq. Më 2 maj 1992, në ditën e sulmit të përgjithshëm në Sarajevë, Gjurgjevac arrestoi Presidentin e Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Alija Izetbegovićin, në aeroportin e Sarajevës, pas kthimit të tij nga negociatat e mbajtura në Lisbonë në atë kohë. Gjatë

¹⁴¹ AIIZ, inv. nr. 7-660, *Dosije za Mirzu Kovačevića*; Po aty, 521; Po aty, 90.

¹⁴² AIIZ, inv. nr. 7-1336, *Dosije za Damira Dodika*; Po aty, 382; Po aty, 91.

periudhës kur komandonte Korpusin e Sarajevës, u regjistruan vrasjet e të miturve të parë në qytet. Në total, gjatë kohës së tij si komandant, nëntë fëmijë u vranë, shumica prej tyre nga granatimet.¹⁴³ Askush nuk është dënuar për vrasjet e këtyre fëmijëve. Gjurgjevac vdiq në vitin 2004 në Lubjanë. Ai ishte në krye të korpusit gjatë periudhës kur njësitë e Ushtrisë Popullore Jugosllave (UPJ) po merrnin pozicione strategjike në dhe përrëth Sarajevës, duke rigjeneruar dhe duke vendosur forcat e tyre. Oficerët e lartë të UPJ-së caktuan vende për vendosjen e armëve të artillerisë, ndër-tuan strehimore dhe organizuan një sistem zjarri “në mënyrë që në çdo kohë, ditë e natë, të mund të mbulonin të gjitha objektet jetike në qytet me zjarr snajperësh dhe artilerie, si dhe të mobilizonin dhe trajnonin personel besnik”.¹⁴⁴ Këto fushata u udhëhoqën nga Gjurgjevci, me një grup oficerësh të UPJ-së.¹⁴⁵ Pas miratimit të Rezolutës 752 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 15 maj 1992, e cila kërkonte që të gjitha ndërhyrjet e Ushtrisë Popullore Jugosllave (UPJ) në Bosnje dhe Hercegovinë të ndaleshin dhe që njësitë ose të tërhiqeshin, ose të vireshin nën kontrollin e Qeverisë së Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, ose të transformeshin dhe çarmatosen, në një përpjekje për të demonstruar respekt të dukshëm për këto vendime, Republika e Serbisë gjeti një zgjidhje në këtë drejtim. Ajo i caktoi të gjithë boshnjakët nga UPJ që shërbenin në vende të tjera në Bosnje dhe Hercegovinë, ndërsa mori vendim për të tërhequr anëtarët e UPJ-së që nuk ishin me origjinë nga Bosnja dhe Hercegovina.

¹⁴³ Nga prilli, deri në mes të majit 1992, u vranë fëmijët Aida Zeliq, Nadir Skikiq, foshnja Belma Qutuk, Midhat Zorniq, dhe në fillim të majit u vranë Amer Klico, Aida Kuçuk, Armin Qosiq, Nina Dedoviq, Zuhra Lingo. Zilha Mastaliq Košuta, “Umro Tomislav Šipčić, general koji je ubijao sarajevsku djecu, spalio Vijećnicu i tvrdio da Muslimani bacaju Srbe lavovima”, https://stav.ba/vijest/umro-tomislav-sipeic-general-koji-je-ubijao-sarajevsku-djecu-spalio-vijecnicu-i-tvrdio-da-muslimani-bacaju-srbe-lavovima/11399?fbclid=IwAR1xV1o_j_Plvc3Db141gthn0nvLp9skt7qB2hh1lZlrKXC3dEIA959_K0 (Më shumë detaje për këta fëmijë në: Mastaliq Koshuta, “Ubijena djeca Sarajeva”, Pjesa VI, 261-853, në: Çekiq et al, *Zločini nad djecom Sarajeva u opsadi*.

¹⁴⁴ Çekiq, *Agresija...*, libri 1, 740.

¹⁴⁵ Po aty.

Kjo, me sa duket, synonte të përmbushte kërkesat ndërkombëtare, ndërsa në të njëjtën kohë një forcë e madhe e armatosur serbe, e komanduar nga oficerë të ish-UPJ-së, do të mbetej në Bosnje dhe Hercegovinë. Kështu, kjo ushtri e re trashëgoi oficerë dhe personel nga UPJ-ja, si dhe sasi të konsiderueshme armësh dhe pajisjesh. Më 12 maj, Kuvendi i vetëshpallur i Republikës Serbe të Bosnjës dhe Hercegovinës mori një vendim zyrtar në Banja Llukë për formimin e Armatës së Republikës Serbe të Bosnjës dhe Hercegovinës, që do të fillonte nga gushti i vitit 1992. Kështu u formua Ushtria e Republikës Serbe (URS).¹⁴⁶ Korpusi i Katërt i Distriktit të 2-të Ushtarak u bë kështu Korpusi i Sarajevës dhe i Romanisë i Forcave të Armatosura të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Në periudhën midis 12 dhe 20 majit 1992, Gjurgjevcin e pasoi koloneli Tomislav Shipçiq. Ishte një periudhë transformimi në Korpusin e Sarajevës dhe Romanisë, i cili në ato ditë drejtohej nga Tomislav Shipçiq. Shipçiq, nënkolonel i Ushtrisë Popullore Jugosllave (JNA) dhe nga maji 1992 një gjeneral i KSR-së të Ushtrisë Republikane Federale të Bosnjës dhe Hercegovinës (URF RBeH), lëshoi urdhra që rezultuan në kryerjen e krimeve kundër banorëve të Sarajevës, përfshirë fëmijët. Ai qëndroi në këtë pozicion deri më 10 shtator 1992, kur komandën e mori Stanislav Galij.

Të paktën 147 fëmijë u vranë në Sarajevë midis prillit dhe 10 shtatorit 1992, shumica e tyre nga granatimet dhe fushata snajperi. Fëmijët u vranë në mënyra të ndryshme dhe ndaj tyre u kryen format më të rënda të krimeve. Deri më sot, përgjegjësit për këto krime nuk janë ndjekur penalisht. Përveç shtabit komandues, nuk janë dënuar për krime as anëtarët e kuadrove të ulëta ushtarake, të cilët janë gjithashtu përgjegjës për krimet. Megjithatë, Instituti për Kërkimin e Krimeve kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare i Universitetit të Sarajevës, në bashkëpunim me Shoqatën e Prindërve të Fëmijëve të Vranë të Sarajevës 92-95, paraqiti një kallëzim penal kundër Tomislav Shipçiq në Prokurorinë e Bosnjës

¹⁴⁶ Zilha Mastaliq Koshuta, Vahid Alaxhuz, Elvedin Mulagiq, *Hadžići tokom agresije na Republiku Bosnu i Hercegovinu*, Komuna e Haxhiqi, Instituti për Kërkime të Krimin i Universitetit të Sarajevës, Haxhiqi-Sarajevë, 2022, 26.

dhe Hercegovinës më 31 janar 2011. Vite më vonë, Zyra e Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës nuk ndërmori asnjë veprim. Më 5 prill 2022, një letër iu dërgua Institutit nga Zyra e Prokurorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, e nënshkruar nga prokurorja Vesna Illiq, duke kërkuar përsëri të njëjtin dokumentacion që ishte dërguar në vitin 2011. Me kërkesë të ICTY-së, e cila dorëzoi dokumentacionin në Prokurorinë për rastin Ship-çiq dhe deklaroi se çështja ishte urgjente, Prokuroria nuk reagoi. Në korrik të vitit 2022, Tomislav Shipçiq vdiq në Vrbas, Serbi, në moshën 83-vjeçare. Askush nuk është mbajtur përgjegjës për vdekjen e këtyre fëmijëve, përfshirë 12 fëmijë që u vranë nga snajperët. Vrasja e fëmijëve vazhdoi gjatë periudhës kur Stanisllav Galliq ishte komandant i Korpusi të Sarajevës dhe Romanisë (KSR), nga 11 shtatori 1992 deri më 10 gusht 1994. Gjatë kësaj kohe, forcat që ai drejtonte dhe komandonte kryenin një fushatë snajperësh dhe granatimi të drejtuar kundër popullsisë civile të Sarajevës. Në këtë periudhë u kryen krime të shumta, ku ndër viktimat përfshiheshin edhe fëmijët.

Në përcaktimin e përgjegjësisë penale të Stanisllav Galliqit, një oficer me rang të lartë në Ushtrinë Jugosllave dhe komandant i Korpusi të Sarajevës dhe Romanisë (KSR) të Ushtrisë së Republikës Serbe (URS), Tribunali i ICTY-së përcaktoi se ishte mëse e qartë që gjenerali Galliq ishte përgjegjës për gjuajtjen e drejtpërdrejtë dhe pa dallim ndaj civilëve dhe popullatës civile në Sarajevë. Ai mban përgjegjësi për fushatën e rrethimit, granatimeve dhe fushatave snajperiste kundër popullsisë civile të Sarajevës, të cilat rezultuan, ndër të tjera, në një numër të madh vdekjesh dhe plagësh në të gjitha kategoritë e moshave. Bëhej fjalë për “një qëllim të qëllimshëm për të kryer akte dhune kundër civilëve”.¹⁴⁷ Qëllimi kryesor i fushatës së snajperimeve dhe i granatimeve në Sarajevë ishte terrorizimi i popullsisë civile.¹⁴⁸ Galliq lëshoi urdhra me shkrim dhe me gojë për bombardime dhe sulme snajperi të përhapura e sistematike kund-

¹⁴⁷ ICTY, Lënda nr. IT-98-29-T, Prokurori v. S. Galliq, *Aktgjykimi dhe opinioni*, 2003, para. 727, 745-752.

¹⁴⁸ ICTY, Lënda nr. IT-98-29-A, Prokurori v. S. Galliq, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2006.

ër popullsisë civile, të cilat u përcollën në nivelet më të ulëta të hierarkisë komanduese. Kjo ishte një fushatë e qëllimshme sulmesh ndaj civilëve.¹⁴⁹ Galliq gjithashtu kishte kontroll edhe mbi fushatën e snajperit dhe të artilerisë.¹⁵⁰ Viktimat që u vranë nga snajperët ishin viktima të qëllimshme, dhe snajperët zgjodhën qëllimisht objektivat. Sulmet me snajper ndaj civilëve të Sarajevës ishin sulme të paramenduara, dhe jo goditje aksidentale.¹⁵¹ Nëse kërkesat ushtarake serbe nuk do të plotësoheshin, u lëshuan urdhra për të vazhduar ose intensifikuar zjarrin e snajperëve.¹⁵² Gjuajtjet janë bërë nga pozitat e KSR URS-së.¹⁵³ Galliq kishte autorizim për t'i ndëshkuar individët që kryenin krime ose shkelnin disiplinën ushtarake, por ai nuk e bëri këtë.¹⁵⁴ Konsumi i municioneve, i cili tejkalonte nevojat e operacioneve të rregullta ushtarake, ishte vetëm një nga faktorët e shumtë që treguan se Galliq dinte për aktivitetet e ndëshkueshme të njësisë së tij.¹⁵⁵ Në vendimin e shkallës së dytë kundër Galliqit, Dhoma e Apelit e Gjykatës së Hagës hodhi poshtë apelimet e tij dhe e dënoi me burgim të përjetshëm për krime terrori kundër civilëve, vrasje dhe akte çnjerëzore.¹⁵⁶

Strategjia e vazhdimit të fushatave të snajperëve dhe granatimeve ndaj civilëve vazhdoi gjatë periudhës së komandës së Dragomir Millosheviqit, nga 10 gushti 1994 deri më 10 tetor 1995. Anëtarët e Korpusi të Sarajevës dhe Romanisë (KSR), nën komandën e Millosheviqit, janë përgjegjës për fushatat e snajperëve dhe granatimeve të vazhdueshme ndaj banorëve të Sarajevës, të cilat shkaktuan vdekjen dhe plagosjen e rëndë të

¹⁴⁹ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29-A, Prokurori v. S. Galliq, *Aktgjyrimi i Shkallës së Dytë*, 2006, paragrafi 237, 239, 102-103.

¹⁵⁰ Po aty, par. 367-371, 160-161.

¹⁵¹ Po aty, par. 279, 117.

¹⁵² Po aty, par. 237, 103.

¹⁵³ Po aty, par. 259, 117.

¹⁵⁴ Po aty, par. 381, 165.

¹⁵⁵ Po aty, par. 380, 164.

¹⁵⁶ Po aty, par. 402, 173; ICTY, Prokurori v. S. Galliq, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2007, 1.

shumë civilëve. Gjatë gjithë periudhës së rrethimit, popullsia u ekspozua ndaj kushteve të vështira që shkaktuan frikë dhe pasiguri, duke lënë plagë të thella dhe të pashlyeshme psikologjike.¹⁵⁷ Banorët e Sarajevës nuk ishin askund të sigurt, dhe civilët mund të plagoseshin ose të vriteshin kudo dhe në çdo kohë.¹⁵⁸ Pasi u gjuajt predha e parë, KSR ndaloi, por më pas qëlloi përsëri granatën, me qëllim të terrorizonte popullsinë civile, sepse “ata kurrë nuk mund të ishin të sigurt se kur do të ndalonin granatimet”.¹⁵⁹ Forcat e KSR-së synonin të shkaktonin vuajtje të rënda fizike ose psikologjike, ose të kryenin një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor të viktimave. Ata e dinin mirë se fushatat e tyre do të sillnin këto vuajtje dhe do të përbënin një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor.¹⁶⁰ Këto forca i sulmuan qëllimisht civilët dhe objektet civile në masë, dhe për këto arsye asnjë civil askund nuk ishte i sigurt.¹⁶¹ Sulmet ishin të përhapura (që do të thotë se shkalla e sulmit dhe numri i personave që i nënshtroheshin

¹⁵⁷ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2009, paragrafi 4, 2.

¹⁵⁸ Po aty, par. 116, 43.

¹⁵⁹ Shënjestrimi i qëllimshëm i civilëve me armë precize, duke përdorur një numër të madh granatash, përbën akt terrorizimi. Duke marrë parasysh faktin se këto mjete, veçanërisht minahedhësit, përdoren nga operatorë shumë të trajnuar, qëllimi ishte qartësisht terrorizimi. Korpusi i Sarajevës dhe ai i Romanisë mban përgjegjësi për granatimin e civilëve dhe zonave civile, “veçanërisht duke pasur parasysh provat në lidhje me saktësinë e minahedhësve dhe aftësinë e operatorëve të minahedhësve nga radhët e KSR-së, gjuajtjen e predhave të shumta ndaj qytetit, ashpërsinë e plagosjeve dhe numrin e njerëzve të vrarë si rezultat i veprimeve të minahedhësve”. Nëse qëllimi i dikujt është t’i shkaktojë terror popullatës civile, ai do të vrasë civilë, do të ndërpresë furnizimin me ushqim dhe ujë, do të shkatërrojë shërbimin shëndetësor duke bombarduar spitalet dhe ambulancat, do të sulmojë civilët qëllimisht dhe tinëzisht dhe do të përdorë çdo mjet të mundshëm për të krijuar një ndjenjë pafuqie dhe cenueshmërie. ICTY, Prokurori kundër D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 971.

¹⁶⁰ Po aty, par. 938.

¹⁶¹ ICTY, Prokurori v. S. Galliq, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2007, 3.

ishin të mëdha) dhe sistematike, që nënkupton natyrën e organizuar të akteve të dhunës dhe probabilitetin shumë të ulët që ato të ishin rastësore.¹⁶²

Një shembull i përdorimit të snajperit, i cili u përmend në rastin e Millosheviqit, ishte sulmi në tramvaj më 27 shkurt 1995, kur civilët u qëlluan. Pretendimet e Millosheviqit se tramvaji ishte objektiv ushtarak që përdorej për transportimin e anëtarëve të URBeH-së rezultuan të paqëndrueshme.¹⁶³

Dragan Simiq dëshmoi se, në periudhën nga fundi i dhjetorit 1994 deri në maj 1995, Millosheviqi ka qëndruar kryesisht në Grbavicë dhe Nexhariq. Gjatë kësaj kohe, në këto zona pati shumë incidente me snajper. Millosheviqi, si komandant i KSR-së, vizitonte rregullisht njësitë e KSR-së aty dhe ishte në dijeni të krimeve të kryera.¹⁶⁴ Gjenerali i brigadës Fraser deklaroi në dëshminë e tij se, “në lidhje me incidentet e snajperit në qytetin e Sarajevës, qëllimi i komandantit ishte në veprim”. Ai dëshmoi se kishte një fushatë snajperi në pjesë të ndryshme të Sarajevës, përgjatë “Rrugës së snajperëve”, rreth aeroportit dhe rreth zonës së “Shkëmbit të Majtë”, të gjitha këto zona nën kontrollin e brigadave të ndryshme të KSR-së. Prania e fushatës së snajperëve në këto pjesë dëshmonte ekzistencën e “qëllimit të komandantit të lartë”.¹⁶⁵

¹⁶² Korpusi i Sarajevës dhe ai i Romanisë është mbajtur përgjegjës për granatimin e civilëve dhe zonave civile, “veçanërisht duke pasur parasysh provat në lidhje me saktësinë e minahedhësve dhe aftësinë e operatorëve të minahedhësve nga radhët e KSR-së, gjuajtjen e predhëve të shumta ndaj qytetit, ashpërsinë e plagosjeve dhe numrin e njerëzve të vrarë si rezultat i veprimeve të minahedhësve”. ICTY, **Prokurori kundër D. Millosheviqit**, Aktgjykimi, 2007, paragrafët 41, 913 dhe 925.

¹⁶³ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2009, paragrafi 128, 47.

¹⁶⁴ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, par. 845, 281.

¹⁶⁵ Po aty, par. 853, 284.

Milloshëviqi dha urdhra në lidhje me trajnimin, pajisjen dhe vendosjen e snajperëve, dhe gjithashtu urdhëroi gjuajtjen e civilëve.¹⁶⁶ Fushatat e snajperit u zhvilluan gjatë një periudhe të gjatë kohore në pjesë të ndryshme të Sarajevës, të cilat ishin nën kontrollin e brigadave të ndryshme të KSR-së. Kjo tregon se Millosheviqi koordinoi, planifikoi dhe urdhëroi shumicën e fushatave të snajperit të përmendura në Aktakuzë.¹⁶⁷ Megjithatë ai ishte *de jure* dhe *de facto* epror ndaj anëtarëve të KSR-së, përfshirë edhe snajperistët, dhe ushtronte kontroll efektiv mbi ta, ai nuk bëri asgjë për t'i parandaluar krimet.¹⁶⁸ Në periudhën nga 6 gushti deri më 10 shtator 1995, ai u zëvendësua nga shefi i Shtabit, Çedomir Slladoje, i cili, me urdhër të Millosheviqit, vazhdoi fushatën e snajperëve dhe granatimeve.¹⁶⁹ Dhoma e Apelit e lroi Millosheviqin për dy krime, granatimin e ndërtesës së "Bitas", më 22 gusht, dhe tregun "Markalla", më 28 gusht 1995.¹⁷⁰

Në lëndën kundër Millosheviqit, në një nga kapitujt e Aktgjykimit përmenden disa raste të fushatës së snajperit në Grbavicë, në pjesën e kontrolluar nga URS-ja, të cilat u kryen nga pjesëtarët e URBeH-së. Një nga këto raste ndodhi më 11 mars 1995, kur u raportua se një vajzë u vra dhe një tjetër u plagos në rrugën Rava Janković në Grbavicë. Prokuroria e ICTY-së konstatoi se autorët ishin ndëshkuar për këtë vepër.¹⁷¹

U shkel një marrëveshje për ndërprerjen e fushatës së snajperit, si ajo e 14 gushtit 1994 midis Vahid Karaveliqit dhe Dragomir Millosheviqit. Për më tepër, shkelje pati edhe në marrëveshje të tjera të ngjashme, si Marrëveshja për ndërprerjen e plotë të armiqësive më 23 dhjetor 1994. Mosrespektimi i këtyre marrëveshjeve konfirmon se, pas miratimit të

¹⁶⁶ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2009, paragrafi 262, 102-103.

¹⁶⁷ Po aty, paragrafi 274, 278, 103, 109.

¹⁶⁸ Po aty, par. 280, par. 282, 109-112.

¹⁶⁹ Po aty, par. 285, 112.

¹⁷⁰ Po aty, par. 294, 115.

¹⁷¹ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, 259, par. 773.

Rezolutës nr. 824 më 6 maj 1993, me të cilën Sarajeva dhe rrethinat e saj u shpallën zonë e sigurt e Kombeve të Bashkuara dhe u kërkuar që të kurseshin nga “sulmet e armatosura dhe aktet e tjera armiqësore”, sulmet vijuan pa ndërprerje,¹⁷² dhe shkatërrimi i Sarajevës, po edhe vrasja e popullsisë së saj, vazhduan në mënyrën më brutale dhe monstruoze. Në fund të luftës, më 1 tetor 1995, Millosheviqi lëshoi një urdhër për të gjitha njësitë e KSR-së, duke urdhëruar sipas Shtabit të Përgjithshëm të URS-së që të ndërpriten të gjitha operacionet në qytetin e Sarajevës, me qëllim pezullimin e mëtejshëm të fushatave të snajperit kundër qytetit. Ai ndaloi “të gjitha fushatat e snajperit kundër qytetit të Sarajevës” dhe urdhëroi që ky ndalim t’i komunikohet deri te ushtari i fundit nga të gjithë komandantët dhe komandantët e njësive.¹⁷³

Në periudhën midis prillit 1992 dhe nëntorit 1995, një grup udhëheqësish politikë dhe ushtarakë serbë morën pjesë në një Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale, e cila përfshinte edhe një fushatë snajperësh.¹⁷⁴ Qëllimi kryesor ishte kontrolli mbi Sarajevën, të cilin ata u përpoqën ta arrinin, ndër të tjera, përmes sulmeve të vazhdueshme, granatimeve dhe fushatave snajperi. Njësitë e snajperëve brenda KSR-së, si dhe snajperët individualë, ishin nën kontrollin e Komandës së KSR-së dhe, në fund të fundit, të Shtabit të Përgjithshëm të URS-së.¹⁷⁵ Kishte një plan të përbashkët që vinte nga udhëheqja politike dhe ushtarake e serbëve të Bosnjës. Ky plan përfshinte vrasje, terror dhe sulme të paligjshme ndaj civilëve. Ratko Mlladiq, Stanisllav Galliq, Dragomir Millosheviq, Momçillo Krajishnik, Nikolla Kolleviq, Radovan Karaxhiq dhe Biljana Pllavshiq formuan një grup që vepronte në përputhje me këtë plan dhe kishin qëllimin

¹⁷² Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Bosnjën dhe Hercegovinën: nga Rezoluta 713 e 25.09.91 deri te Rezoluta 1004 e 12.07.95, *Rezoluta 824*, Qendra e Shtypit e URBeH, Sarajevë, 1995, 72-74.

¹⁷³ ICTY, *Aktgjykimi* nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviqit, *Aktgjykimi*, 2007, paragrafi 840, 280.

¹⁷⁴ ICTY Lënda nr. IT-95-5/18, Prokurori v. Radovan Karaxhiq, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2016, 1.

¹⁷⁵ Po aty, 8.

e përbashkët për të kryer krime si pjesë të tij. Karaxhiç dha një kontribut të rëndësishëm në këtë plan, duke mbështetur Ratko Mlladiqin në strategjinë e tij ndaj Sarajevës si kreu i strukturave politike, ushtarake dhe qeveritare. Strategjia përfshinte intensifikimin e fushatës së snajperëve dhe granatimeve, si dhe zgjidhjen ushtarake të situatës në qytet. Si Komandant Suprem i Ushtrisë së Republikës Serbe (URS), ai lëshoi ose miratoi direktiva ushtarake në lidhje me Sarajevën, duke zgjatur kështu rrethimin dhe duke lejuar që fushata e snajperëve dhe granatimeve të vazhdonte për një kohë të pacaktuar. Ai kishte kontroll de jure mbi Korpusin e Sarajevës dhe Romanisë (KSR) dhe URS-në, mori pjesë në çështjet ushtarake në lidhje me Sarajevën dhe dha urdhra të shumtë në nivel strategjik dhe operacional. Në disa raste, ai promovoi dhe shpërbleu Mlladiqin, Galliçin dhe Millosheviqin, pavarësisht se ata po sulmonin popullsinë civile.¹⁷⁶ Megjithëse ai ishte vazhdimisht i informuar për sulmet e KSR-së ndaj civilëve, ai mohoi përgjegjësinë e KSR-së dhe fajësoi në vend të kësaj Ushtrinë e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës (URBeH). Nuk u bë asnjë përpjekje për ndjekjen penale të ushtarëve të KSR-së që shënjestronin civilët. Ai gjithashtu paralajmëroi se do të intensifikonte fushatën e snajperëve dhe granatimeve nëse donte të detyronte udhëheqjen legjitime boshnjake të pranonte marrëveshjet e paqes të diktuar prej tij. Këto sulme i përdori si një mjet presioni ndaj udhëheqjes së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe komunitetit ndërkombëtar, me qëllim arritjen e objektivave politike. Prandaj, kontributi i tij në Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale, si dhe i të tjerëve, ishte i pamatshëm, sepse pa mbështetjen e tyre, sulmet ndaj civilëve nuk do të ishin kryer.¹⁷⁷ Ai u dënua me burgim të përjetshëm.

Ratko Mlladiq, si pjesë e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale (NPK) për Sarajevën, mori pjesë në themelimin e Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR) dhe mori vendime lidhur me personelin në këtë korpus. Ai komandoi njësi në operacione të ndryshme, përhapte propagandë kundër boshnjakëve dhe kroatëve, urdhëroi kufizimin e ndihmës humanitare për Sarajevën, dhe megjithëse kishte kontroll efektiv mbi autorët e krimeve,

¹⁷⁶ Po aty.

¹⁷⁷ Po aty, 8-9.

nuk parandaloi asnjë krim dhe nuk ndëshkoi asnjë prej tyre. Mlladiq urdhëroi ndërprerjen e furnizimit me ujë dhe energji elektrike për Sarajevën, duke i detyruar banorët të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe t'i nënshtroheshin sulmeve me snajper dhe të tjera. Ai kishte ndërmend të niste dhe të kryente një fushatë snajperësh dhe granatimi kundër civilëve në Sarajevë, me qëllim kryerjen e terrorit, sulmeve të paligjshme dhe vrasjeve të civilëve.¹⁷⁸ Ai u dënua me burgim të përjetshëm.

Momçillo Krajishnik, Biljana Pllavshiq dhe Nikolla Kolleviq ishin gjithashtu pjesë e UZP-së për Sarajevën. Krajishnik u dënua me 20 vjet burg,¹⁷⁹ Pllavshiq me 11 vjet burg¹⁸⁰ dhe Nikolla Kolleviq kreu vetëvrasje në vitin 1997, në Pallet.

Së bashku me forcat ushtarake dhe policore të Ushtrisë së Republikës Serbe (URS) dhe Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), këta persona kryen një fushatë të koordinuar, sistematike dhe afatgjatë granatimesh dhe snajperimesh në Sarajevë, me qëllim vrasjen, gjymtimin, plagosjen dhe terrorizimin e popullsisë civile të këtij qyteti.¹⁸¹ Për kryerjen e këtyre krimeve u përdorën në mënyrë masive: a) armë artilerie; b) armë snajperi; c) armë kimike të ndaluara nga e drejta ndërkombëtare humanitare (si bomba ajrore të modifikuara, predha artilerie me fosfor, etj.); d) armë kundërajrore; e) tanke dhe njësi të blinduara për kryerjen e operacioneve, si dhe armë të tjera. Me bombardime dhe sulme me snajper, autorët “sy-

¹⁷⁸ ICTY, Lënda nr. IT-09-92, Prokurori v. Ratko Mlladiq, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2017, 11.

¹⁷⁹ ICTY, Lënda nr. IT-00-39, Prokurori v. Momçillo Krajishnik, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 7.

¹⁸⁰ Biljana Pllavshiq u përmend nga ICTY-ja si rrethana lehtësuese një deklaram konfirmues fajësie, me pendim, dorëzim vullnetar në Gjykatë, sjellje të pasluftës dhe moshën. ICTY-ja, Lënda nr. IT-00-39&40/1, Prokurori v. Biljana Pllavshiq, *Përmbledhje e Aktgjykimit*, 2003, 3-5.

¹⁸¹ ICTY, Prokurori v. Stanislav Gallic, IT-98-29-A, Aktgjykimi, 5.12.2003, par. 310. ICTY, Prokurori v. Dragomir Millosheviq, IT-98-29/1-T, Dhoma e Gjykimit, *Aktgjykimi*, 12.12.2007, paragrafi 12.12.2007. 971; ICTY, Prokurori v. Dragomir Millosheviq, IT-98-29/1-A, Dhoma e Apelit, *Aktgjykimi*, 12.12.2009, paragrafi 12.12.2009, paragrafi i Apelit. 38.

nonin të shkaktonin vuajtje të rënda fizike ose mendore, ose të kryenin një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor të viktimave, ose ishin të vetëdijshëm se veprimet e tyre kishin të ngjarë të shkaktonin vuajtje të rënda fizike ose mendore, ose se ato do të përbënin një sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor”.¹⁸² Vrasja e civilëve, veçanërisht e fëmijëve, si dhe krimet kundër tyre vazhduan edhe gjatë rrethimit katërvjeçar të qytetit.

Përfundim

Formacionet e armatosura të Republikës Federale të Jugosllavisë (UUPJ dhe UJ), njësitë ushtarake të Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR) dhe korpuset e tjera të Ushtrisë së Republikës Serbe (URS), së bashku me shumë vullnetarë vendas, mercenarë dhe luftëtarë të huaj, u vendosën në pjesët e pushtuara të Sarajevës dhe ndërmorën sulme kundër qytetit me qëllim pushtimin, ndarjen dhe shkatërrimin e Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës si shtet. Objektivi kryesor ishte marrja nën kontroll e Sarajevës, synim të cilin ata u përpoqën ta arrijnë përmes sulmeve të vazhdueshme, granatimeve intensive dhe fushatave të snajperizmit.

Në periudhën midis prillit 1992 dhe nëntorit 1995, një grup udhëheqësish politikë dhe ushtarakë serbë mori pjesë në një Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale, e cila përfshinte edhe një fushatë snajperësh. Njësitë e snajperëve brenda Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR), si dhe snajperët individualë, ishin nën kontrollin e Komandës së KSR-së dhe, përfundimisht, të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Republikës Serbe (URS). Stanislav Galiq dhe Dragomir Millosheviq u dënuan nga ICTY për drejtimin e një fushate granatimi dhe snajperësh me qëllim përhapjen e terrorit ndaj qytetarëve të Sarajevës. Megjithatë, në kuadër të prokurorive të deritanishme para gjykatave ndërkombëtare dhe vendore, nuk është ngritur asnjë aktakuzë kundër autorëve të drejtpërdrejtë – snajperëve që

¹⁸² ICTY, Prokurori v. Dragomir Millosheviq, 2007, paragrafi 938; ICTY, Prokurori v. Dragomir Millosheviq, 2009, par. 108-110.

qëlluan mbi fëmijët dhe qytetarët e Sarajevës, gjë që paraqet një fakt tejet shkatërrues.

Komanda e Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR) e Ushtrisë së Republikës Serbe (URS) organizoi trajnime të rregullta speciale për snajperistët, të cilat zhvilloheshin kryesisht në zonat e Romanisë dhe Jahorinës. Pas përfundimit të trajnimit, ushtarët iu afruan flamurit serb të kamufluar dhe dhanë një betim solem: **“I betohem Zotit dhe mbretit se do t’i shërbej me besnikëri popullit serb, pa u penduar për jetët tona.”** Përveç trupave vendore, mercenarë nga Republika Federale e Jugosllavisë, Rusia, Rumania dhe Greqia u angazhuan gjithashtu si snajperistë. Për realizimin e operacioneve snajperiste, u sollën sasi të konsiderueshme armësh dhe municionesh snajper, një pjesë e madhe e të cilave u siguria nga RFJ.

Pozicionet nga të cilat snajperët ishin më aktivë kundër banorëve të Sarajevës përfshinin: Grbavicën, varrezat hebraike, Shkëmbin me Majë, shkëmbin “Baba” në shpatin verior të malit Trebeviq, Kodrën e Arrës në Pollinat (nga ku shpesh shënjestroheshin banorët e Kobile Gllavës), kishën ortodokse në Dobrinja IV (e cila ishte ende në ndërtim dhe e rrethuar me skela), Shkollën e të Verbërve në Nexhariq, zonën e Vracës, mbi Kodrën e Trashë, kthesën në rrugën Llukavicë-Palle mbi Skenderija, si dhe pozicione të tjera që kontrolloheshin nga Korpusi i Sarajevës dhe Romanisë (KSR).

Gjatë periudhës prill 1992 – dhjetor 1995, të paktën 63 fëmijë u vranë nga fushata e snajperëve. Këta fëmijë ishin viktimë të qëllimshme dhe të drejtpërdrejta të sulmeve snajperiste.

BURIMET DHE LITERATURA:**Burimet:**

Fondet e përdorura nga:

Arkivat e Institutit për Kërkime të Krimeve Kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare të Universitetit të Sarajevës (AIKK).

Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Arkivat e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY)

Dokumentet e Komandës së Korpusit të Sarajevës dhe Romanisë (KSR)

Dokumentet e Shtabit Kryesor të URS-së.

Dokumentet e Brigadës së Parë të Sarajevës të URS-së.

Dokumentet e Grupit Operativ të Ushtrisë Serbe Vogoshqa.

Dokumentet 1. të pbr. URS-së të Illixhës.

Dokumentet e Komandës së Brigadës së Dytë të Sarajevës.

Dokumentet e Korpusit të Parë të URBeH.

Aktgjykimet e ICTY -së (Lënda IT-98-29-T, Prokurori v. Stanislav Galliq; Lënda IT-95-5/18, Prokurori v. Radovan Karaxhiq; Aktgjykimi Nr. IT-98-29/1-A, Prokurori v. D. Millosheviq; Lënda Nr. IT-09-92, Prokurori v. Ratko Mlladiq; Lënda Nr. IT-00-39, Prokurori v. Momçillo Krajishnik; Lënda Nr. IT-00-39&40/1, Prokurori v. Biljana Pllavshiq).

Fondet e Kombeve të Bashkuara (OKB-së).

Dosje me intervista orientuese dhe dokumente për fëmijët e vrarë të Sarajevës.

Dorëshkrime private.

Periodikë:

Oslobodenje

Stav

Web:

SniperAlley.photo, Inçizimi i plagosjes,

<https://twitter.com/sniperalleyphot/status/1432013471323983879>;

Barbara Demick, *Young victim is on the mend in Paris*.

“Turizmi i përgjakur” <https://365.rtvsllo.si/arhiv/technik/174900301>

“Sarajevo, 1425 Days of Horror” <https://365.rtvsllo.si/arhiv/mednarodna-obzorja/174948918>).

<https://www.youtube.com/watch?v=nk2yz0xQaGo> film Sarajevo safari
https://stav.ba/vijest/umro-tomislav-sipcic-general-koji-je-ubijao-sarajevsku-djecu-spalio-vijecnicu-i-tvrдио-da-muslimani-bacaju-srbelavovima/11399?fbclid=IwAR1xV1o_j_Plvc3Db141gthn0nvLp9skt7qB2hh1lZlrKXC3dE1A959_K0

Literaturë

Smail Çekiq, *Agresija na RBiH: planiranje, priprema, izvođenje*, Instituti për Kërkimin e Krimeve Kundër Njerëzimit dhe së Drejtës Ndërkombëtare, Sarajevë, 2004.

Smail Çekiq, Muhamed Shestanoviq, Merisa Karoviq, Zilha Mastaliq Koshuta, *Zločini nad djecom Sarajeva u opsadi*, Instituti për Kërkimin e Krimeve kundër Njerëzimit dhe të Drejtës Ndërkombëtare, Universiteti i Sarajevës, Sarajevë, 2010.

Zilha Mastaliq, *Zločini nad djecom Sarajeva u vrijeme opsade 1992-1995*, 2012, Dorëshkrimi i tezës së magjistraturës.

Zilha Mastaliq Koshuta, Vahid Allaxhuz, Elvedin Mulagiq, *Hadžići tokom agresije na Republiku Bosnu i Hercegovinu*, Komuna e Haxhiqit, Instituti për Kërkime të Krimit të Universitetit të Sarajevës, Haxhiqi-Sarajevë, 2022.

Edin Omerçiq, *Sarajevska „Aleja snajpera”*, 18.11.2022, www.historiografija.ba

Muhamed Shestanoviq, *Zločin nad psihičkim integritetom djece*, Instituti për Kërkimin e Krimit, Universiteti i Sarajevës, Sarajevë, 2000.

Karta e Kombeve të Bashkuara e vitit 1945.

Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Bosnjën dhe Hercegovinën: nga Rezoluta 713 e 25.09.91 deri te Rezoluta 1004 e 12.07.95, Qendra e Shtypit e URBeH, Sarajevë, 1995.

Konventa e Gjenevës në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte e 12 gushtit 1949.

Nga boshnjakishtja, përktheu e përshtati:

Dr. Azmir Jusufi

Dr. Sc. Zilha MASTALIQ - KOSHUTA

THE SNIPER CAMPAIGN IN SARAJEVO DURING THE SIEGE 1992–1995

Abstract

Dr. Sc. Zilha Mastaliq Koshuta is a senior scientific associate at the Institute for Research of Crimes Against Humanity and International Law. University of Sarajevo.

At the beginning of April 1992, the territory of Sarajevo was violently divided. Units of the 4th Corps of the 2nd Military District of the Yugoslav People's Army (JNA), the armed forces that supported and aligned themselves with the Serbian Democratic Party (SDS), as well as many local volunteers, mercenaries, and foreign fighters, took strategic positions in and around Sarajevo. Open hostilities began after Bosnia and Herzegovina was internationally recognized as an independent state. Thereafter, Sarajevo was put under siege for nearly four years. Following the partial withdrawal of the Yugoslav People's Army from Bosnia and Herzegovina, its 2nd Military District became part of the Army of the Republika Srpska of Bosnia and Herzegovina (VRS BiH). In August 1992 its name was changed into the Army of the Republika Srpska (VRS). Through this transformation, the 4th Corps became the Sarajevo - Romanija Corps (SRK).

During the four-year siege of Sarajevo, a “coordinated, systematic, and long-term campaign of shelling and sniping” was carried out against its residents, with the aim of “killing, maiming, wounding, and terrorizing the civilian population of Sarajevo.” Besides the artillery attacks on the city, which were the most common method to kill its residents, another method was to snipe them. Without electricity, water, gas, and other existential necessities, residents struggled for survival on a daily basis. From the positions captured

by the Serbian forces, a campaign of sniping and shelling was carried out against Sarajevo's civilian population, who could not find any safety anywhere. Massacres and killings, continuous terror and psychological trauma were part of the crimes committed against the residents of Sarajevo.

The first part of the paper examines the nature of the sniper campaign, describing the places from where it was carried out. A very important element is the presentation of the types of weapons used. The second part of the paper addresses the organization of sniper trainings, including the locations where these trainings took place and the manner of their implementation. In addition to numerous primary sources, data are provided on requests for and deliveries of sniper weapons and ammunition to the Sarajevo and Romanija Corps of the VRS. The document also contains information on the identity of snipers, as well as mercenaries and paid volunteers from other countries.

Through examples of victims of the sniper campaign, mainly in cases of child killings, it becomes clear that the enemy's objective was the deliberate, direct, and intentional killing of civilians. In this section, the child victims of the sniper campaign are presented in chronological order. The final part of the paper is dedicated to the prosecution, or lack of it, of those responsible for these crimes before domestic and international courts.

Keywords: *Bosnia and Herzegovina, Sarajevo, siege, 1992–1995, sniper campaign, sniper attacks, snipers, training, weaponry, children, deliberate killings, failure to prosecute, ICTY, VRS.*

Myderriz Sabit efendi ZAIMI

NJË HUMBJE E DHIMBSHME PËR BOTËN ISLAME*

-Myderriz Haxhi Selim efendi Jashari-Drejta (1887-1951)-

Myderrizi i kasabasë së Vuçitërnës, Haxhi Selim efendiu, për dyzet vjet me radhë prorre u shqua si një alim shumë i ditur dhe personalitet udhërrëfyes dhe intelektual i kasabasë sonë. Ai është i biri i mualimit dhe personalitetit të madh, Hasan Tahsinut. Gjyshi i tij, Jashar efendiu, bënte pjesë në shtresën e lartë, fisnike, të besueshme dhe të mirë të qytetit të Vuçitërnës. Jashar efendiu, për njëzet vjet me radhë ka qenë myteveli (administrator) i vakëfit, dhe i cili, në fund, me dëshirën dhe vullnetin e tij, e bëri pranimdorëzimin e plotë të vakëfit dhe të të ardhurave të tij tek administratorët pasues, duke mos ndaluar për vete qoftë edhe një akçe të vetme. Gjithashtu, edhe babai i Jashar efendiut, Mahmut efendiu, ka qenë njeri fisnik, i dalë nga ky oxhak i madh, i cili i përkiste parisë së vendit. Mahmut efendiu ka ndërruar jetë në Mekën e Ndershme. Në bazë të kësaj që thamë, shohim se haxhi shejh Selim efendiu është një personalitet me vlera, i cili i takon zinxhirit të mirë të paraardhësve të tij, dhe i cili nga prejardhja e tij shquhej dhe ishte “një pasues i mirë pas të mirëve”.

* Këtë shkrim autori myderrizi i Vushtrrisë, Sabit efendi Zaimi, ia kushton hoxhës, intelektualit, poetit dhe myderrizit tjetër të Vushtrrisë, Selim efendi Jasharit – Drejtës, me rastin e kalimit të këtij të fundit në botën e amshueshme. Ky shkrim është botuar në gjuhën osmane në revistën sarajevase “Glasnik”, më 1951. Pas më së shtatë dekadash e gjysmë, me pak shkurtime, botohet i shqipëruar në revistën “Edukata islame”, në shenjë mirënjohje e përkujtimi për këta dy myderrizë të shquar të vendit tonë. (Shënim i ynë).






Selim "Sami" efendi

Myderrizi i haxhi shejh Selim efendiut ishte haxhi Abdylkadër efendi Dagestani. Rrugëtimin e tij të mësimëve, haxhi shejh Selim efendi, e nisi duke ndjekur e vazhduar fillimisht rrugën dhe përvojën e të parëve të tij, baballarëve dhe gjyshërve të tij, dhe më pastaj edhe duke ndjekur profesionalizmin dhe misionin e myderrizëve të tij. Me ligjëratat, këshillat dhe shërbimin e tij për banorët myslimanë deri më tani, ai ka falë shumë dinjitet, besnikëri, zgjuars, dëshirë e vullnet të madh. Kështu që, në kasabanë e tij, në sajë të shpërndarjes së vlerave,

llogaritet si një burim i pasur dhe i përhershëm, një personalitet që i ka dhënë jetë e frymëzim këtij vendi, dhe i cili do të mbetet një pikë referençe për të gjitha kohët. Sot nuk paramendohet të ketë një person mysliman mbi moshën njëzetvjeçare, e mos të ketë shkuar të mësonte e të përfitonte te një figurë e tillë e me një bagazh kaq të pasur, si dhe mos të ketë përfutuar nga mësimet apo mos të ketë qenë pjesë e mexhliseve të cilat i organizonte haxhi Selim efendi. Ai vetë ka qenë i laureuar me diplomë të ixhazetit, ka qenë ixhazetli, dhe gjithashtu ai u ka dhënë ixhazet edhe një gjenerate të tërë të studentëve, të cilët në fund i ka pajisur edhe me diploma.

Profesionalizmi dhe puna e tij kanë qenë të kompletuara përgjithësisht. Ai ka qenë një pikë mbështetëse që e ka përmbyshur çdokënd. Për vendin tonë dhe Bashkësinë Islame ai ka qenë një shtyllë e fortë, dhe i cili do të mbetet gjithmonë një njeri i majave, i respektit dhe një person i përlulur ndaj diturisë dhe vlerave të saj. Myslimanët gjithmonë i ftonte në bashkim dhe pajtim mes vete.



Përveç njohurive të gjuhës dhe shkencave arabe, ai zotëronte gjithashtu edhe gjuhën perse, ndërsa shquhej si njohës i denjë i gjuhës dhe i letërsisë turke, si shkrimtar i përkryer dhe poet i dalluar në këto gjuhë. Njëkohësisht, ai ishte edhe një ekspert i kompletuar i shkencës së faraizit (drejtës së trashëgimisë). Edhe guri dhe dheu i kasabasë sonë ndiejnë kënaqësi me të! Sepse, në kasabanë tonë, vetëm ai mund të ishte burri që përfaqësonte personalitetin shpirtëror të fesë. Shkurt, ai ishte një myderriz shumë i kompletuar, po aq i përgatitur sa edhe bashkëkohor. Ai gjithashtu pati fatin të përmbushte edhe kushtin e pestë të fesë islame, përkatësisht ta vizitonte Shtëpinë e Shenjtë të Zotit, Qaben. Këtë vizitë ai nuk e kreu vetëm me praninë e tij fizike, por edhe kontribuoi atje me diturinë e tij. Gjatë qëndrimit në haxh, e shoqëruan edhe paria e lartë e Mekës, të cilët Selim efendiun e cilësuan dhe përkufizuan me fjalët: “Ka ardhur një erudit nga vendet e Kosovës”. Vlerat e tij të shumta, qofshin shpirtërore apo diturore, me të cilat ne krenohemi gjithnjë e më shumë, janë të dëshmuara në rreshtat e botuar në shtypin saudit.

Mirëpo, ç’të bëjmë?! A mos, vallë, ka ndonjë njeri që do të mund t’i ikën vdekjes, kësaj ndodhie dhe këtij caktimi të Zotit?! Lidhur me këtë, Allahu, xh.sh., thotë:

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٌ

“Çdo gjë që është në të (në Tokë) do të hduket.” (Rrahman, 26)

Me gjithë këto madhështi e vlera, në këtë botë kalimtare çdo gjë është e përkufizuar; gjithçka në këtë botë një ditë do të përfundojë, dhe gjithsesi do të shkojë në botën tjetër, sepse ky është ligj hyjnor. Kështu, dalëngadalë, duke lënë pas vete gjithmonë dhe kudo madhështinë dhe praninë e tij, si një shpirt i lartë e i pastër, në heshtje dhe i vetmuar, u largua nga kjo botë edhe haxhi Selim efendi.

Haxhi Selim efendi u largua nga kjo botë në sabahun e xhumasë së dytë të muajit safer, në ora 1 e 30¹. Ai u largua nga kjo botë, nga kjo shtë-

¹ Sipas kësaj dhe kronogramit që e jep në fund të këtij punimi Sabit efendi, kuptohet se Selim efendi Jashari-Drejta ka vdekur në sabahun e ditës së xhuma të 9 nëntorit të vitit 1951 (përkatësisht në sabahun e xhumasë së dytë të muajit safer të vitit 1371 hixhrij).

pi e përkohshme, duke i mbyllur sytë dhe duke e shqiptuar ajetin e dobishëm kuranor:

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ

“Na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!” (*Ali Imran, 173*)

Kështu, duke u radhitur ndër robërit më të mirë dhe më të devotshëm, më saktë, duke e futur veten në mesin e më punëdrejtëve (‘âlâji il-lijjî-nëve), Haxhi Sami efendiu u shpërngul te Zoti i tij i Madhëruar.

Një humbje e një njeriu të tillë, me kaq vlere, është një nga humbjet më të mëdha, mirëpo kur e dimë se haxhi Selim efendiu u largua nga kjo botë duke e fituar një botë shpirtërore shumë herë më të shenjtë se kjo, mua personalisht ky fakt më mban të fortë, më ngushëllon dhe më bën të ndiej se ai nuk ka vdekur, por ende rron dhe është i gjallë mes nesh(...).

Shejh Sadi Shirazi e ka një thënie:

“دولت جاوید یافت هرکی نکونان کز عقبش ذکر (خیر) زنده کند نامرا”

“Ai që jeton me emër të mirë, ka për të pasur një shtrirje të pafund.” Sepse nami i mirë që lë pas e bën atë të jetë prore i përmendur për të mirë dhe e bën atë të jetë i pavdekshëm...

Jam i bindur se Haxhi Selim efendiu, në ditën kur do ta marrë myzhden prej Zotit të tij, do të jetë personi i përshkruar sipas fjalëve të Sadi Shirazit. Ah, sa lumturi dhe sa gëzim për të!

Epo, vdekja e almit/dijetarit, me të vërtetë se është vdekje e botës!

“Datën e vdekjes së tij e tha Sabiti, i cili atë do ta pasojë

*Myderriz Shejh Samiu, te Zoti i Vërtetë u shpërngul, thuani jahu!”*²

Marrë nga: “Glasnik”, nr. 10-12, Sarajevë 1951, f. 403-405.

Shqipëroi nga gjuha osmane:

Hatixhe Ahmed

² Në këtë dyvargësh, autori i këtij punimi përkujtimor, Sabit efendi Zaimi, sipas llogaritjes “ebxhed”, na e jep edhe vitin e vdekjes së myderrizit dhe shejhut të tij, Haxhi Selim efendiut, e që është viti 1951. (Shënim i ynë).

Enes KARIQ*

AJETET E KURANIT NË MONUMENTIN MBIVARROR TË JOSEPH VON HAMMER-PURGSTALL-IT

Në vendin Klosterneuburg (më saktësisht në Klosterneuburg-Weidling), rreth pesëmbëdhjetë kilometra në veri të Vjenës, ndodhet një varrezë e bukur - nëse një njeri i ndjeshëm mund ta quajë “të bukur” një varrezë. Në këtë varrezë ia vlen të shkosh vetëm nëse je i gatshëm të qëndrosh katër apo pesë orë duke ecur nëpër shtigjet midis dhjetëra, ndoshta qindra varresh, dhe vetëm nëse e njeh, të paktën në vija të trasha, historinë e Vjenës dhe të Perandorisë Austro-Hungareze.

Pikërisht këtu, në Klosterneuburg-Weidling, gjenden varret e disa të ndje-



Joseph von Hammer-Purgstall

* Dr. Enes Kariq (1958 -) teolog dhe shkrimtar i njohur boshnjak, i specializuar në historinë dhe metodologjinë e interpretimit të Kuranit. Profesor universitar dhe akademik. Përkthyes i Kuranit në gjuhën boshnjake. Autor i shumë veprave dhe i studimeve shkencore dhe letrare në gjuhë të ndryshme. Disa prej tyre janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe. (Shënim yni).

rëve të shquar, për të cilët mund të thuhet se jeta tokësore ka qenë mjaft bujare. Në këtë parcelë të figurave të njohura ndodhet edhe varri i dijetarit të madh, orientalistit, politikanit, poliglotit, dragomanit dhe historianit të shquar – Joseph von Hammer-Purgstall-it (Jozef fon Hamer-Purgstall).

Në këtë ese do të themi vetëm disa fjalë, në mënyrë përkujtuese, për të ndjerin Hammer, për varrin e tij të hijshëm, si dhe për arsyet e mundshme pse mbi këto nishane të çmueshme gjenden ajete kuranore dhe shprehje e vargje të tjera islame.

Diplomati në Stamboll

Austriaku Joseph von Hammer-Purgstall lindi në Graz, më 1774. Pas përfundimit të shkollës fillore, i ati, Joseph Johann von Hammer, e dërgoi për të studiuar në Vjenë, në disa prej shkollave më të mira që kishte kryeqyteti në atë kohë. I ri dhe ambicioz, Hammer-i i përfundoi studimet me sukses të jashtëzakonshëm dhe, më 1796, hyri në shërbimin diplomatik; ndërsa më 1799 u caktua me detyrë në ambasadën austriake në Stamboll.

Kohën në Stamboll (kur shpesh udhëtonte nëpër vendet e Levantit) e shfrytëzoi për t’u specializuar në mënyrë të thellë në turqishten osmane, në arabisht dhe në persisht. Gjatë qëndrimeve në Levant dhe në Lindjen e Afërt, Hammer-i bashkëpunoi ngushtë me komandantin britanik të marinës, William Sidney Smith. Ky bashkëpunim, natyrisht, ishte i diktuar nga interesa politike dhe drejtohej kundër politikës pushtuese franceze të asaj kohe. (Ishin vitet kur Napoloni kishte nisur ekspeditat e tij ushtarake, madje edhe kundër Rusisë). Pa dyshim, Hammer-i, me veprimtarinë e tij, kontribuoi në zbatimin e politikës së Austrisë dhe, pjesërisht, të Britanisë ndaj Perandorisë Osmane, dhe, nëse jo ndryshe, të paktën si përkthyes i shkëlqyer (dragoman).

Kjo u pa edhe kur, më 1807, ai u kthye në Evropë, në Vjenë. Në vitin 1809, Klemens von Metternich-i (1773–1859) filloi ngjitjen e tij në hierarkinë e pushtetit, dhe Hammer-i, poliglotti i ditur, u bë bashkëpunëtor dhe këshilltar i tij i besuar. Kështu thonë disa burime. Ndërkaq, sipas disa të tjerave, thuhet se Metternich-i, si një shtetar absolutist, “e kufizoi” Hammer-in duke e mbajtur, sipas nevojës, vetëm si përkthyes dhe këshilltar. Nëse kjo i pengoi ambiciet më të mëdha të Hammer-it, apo nëse Metter-

nich-i i ofroi më pak nga sa priste, kjo mbetet një çështje për t'u hulumtuar.

Krahas detyrave të tij si përkthyes “oborrtar”, Joseph von Hammer-Purgstall-i u mor edhe me shkencë, me disiplinat orientalistike, si dhe me përkthime nga tri gjuhët kryesore orientale: arabishtja, turqishtja osmane dhe persishtja. Në vitin 1835, atij iu dha edhe një fat shtesë në këtë botë: ai trashëgoi pronën e konteshës Purgstall dhe fitoi titullin baron (Freiherr), duke ia shtuar kështu mbiemrit të tij edhe emrin Purgstall. Hammer-i botoi një sërë veprash, duke u bërë praktikisht themelues ose forcues i disa disiplinave në studimet orientalistike në Austri dhe në Gjermani (Prusi). Kur në Vjenë u themelua Akademia e Shkencave, më 1847, Hammer-i u zgjodh kryetar i saj i parë, një ngjarje që, siç pretendohet, nuk mund të kishte ndodhur pa mbështetjen e Klemens von Metternich-it. Hammer-i ndërroi jetë në Vjenë, në vitin 1856, në kulmin e karrierës së tij shkencore.

Kur bëhet fjalë për kontributin në themelimin dhe zhvillimin e orientalistikës, Hammer-i krahasohet me Silvestre de Sacy-në (1758–1838) në Francë, si dhe me Sir William Jones-in (1746–1794) dhe Edward William Lane-n (1801–1876) në Angli dhe Britani të Madhe.

Vepra kryesore e Hammer-it është “*Geschichte des osmanischen Reiches*” (*Historia e Perandorisë Osmane*), në disa vëllime, botimi i parë i së cilës u bë gjatë periudhës 1827–1835¹. Përveç kësaj, Hammer-i botoi studime historike mbi Hordhinë e Artë, mbi asasinët, Hanatin e Krimesë, Stambollin, Bosforin etj.

Ai shkroi vepra ose punime në fushën e turqishtes osmane, arabishtes, persishtes... poezisë dhe letërsisë. Ai përktheu veprat e Gazaliut, Zamah-shariut, Mutanabbiut, Salabiut, Hamaviut, Hafizit, Saadiut, Evlija Çelebiut... Ai gjithashtu përktheu në gjermanishte në formë poetike pjesë të Kuranit. Ai gjithashtu në mënyrë ambicioze përktheu në frëngjisht dhe në gjermanisht edhe “Një mijë e një net” dhe kërkoi me këmbëngulje dorë-

¹ Kjo vepër, në një version të shkurtuar, është përkthyer (në gjuhën serbokroate) nga i ndjeri Nerkez Smailagiq (“Historija Turskog/Osmanskog carstva”, prijevod: Nerkez Smailagić, Zagreb, 1979). (Shënim i autorit).

shkrime të ndryshme të kësaj vepre në të gjithë Lindjen e Mesme etj. Ai pati bashkëpunime të shumta me një numër të madh të poetëve, shkrimtarëve dhe filozofëve evropianë. Falë punës së Hammer-it në përkthimin e “Divanit” të Hafizit në gjermanisht, erdhi edhe rezultati i bukur: Johann Wolfgang von Goethe (1749-1832) shkroi “West-Östliche Divan” (Divani Perëndimor-Lindor), botimi i parë i të cilit u shfaq në Shtutgart në vitin 1819².

Bukuria e varrit të Joseph von Hammer-Purgstall-it

Varri i Hammer-it është jashtëzakonisht i bukur (nëse për dikë të ndjeshëm nuk është tepër guxim të thuhet se një varr mund të jetë i bukur!). Në çdo detaj vërehet se vendpushimi i tij i fundit është konceptuar më herët nga vetë banori i ardhshëm – nga vetë Hammer-i. Gjithashtu, duke marrë parasysh të gjitha gdhendjet dhe gravurat që e zbukurojnë nga të gjitha anët, ky varr përbën një rrëfim të fuqishëm mbi thelbin e jetës njerëzore. Është sikur vetë Hammer-i të kishte dashur që vizitorët e varrit të tij të meditonin pikërisht mbi faktin se edhe ata, një ditë, do të dalin para Zotit të tyre të dashur dhe së pari do të shtrihen në varr, për t’i mbuluar dhe tretur dheu i zi.

Siç shihet qartë nga të gjitha fotografitë e varrit, Hammer-i ka përgatitur mbishkrimet e varrit në rreth dhjetë gjuhë të ndryshme. Dhe, siç thotë Robert Irwin, profesor i gjuhës arabe në Universitetin e Kembrixhit, Hammer-i zotëronte dhe përdorte në mënyrë të shkëlqyer në veprimtarinë e tij diplomatike, politike, shkencore dhe akademike pikërisht këto dhjetë gjuhë (*mastered ten languages*).

² Joseph von Hammer-Purgstall-i, përmes veprave të tij historike dhe orientalistike, ka dhënë një kontribut të vyer në njohjen dhe studimin e historisë dhe kulturës shqiptare. Ai jo vetëm që ka dokumentuar rolin e shqiptarëve në Perandorinë Osmane, por edhe ka ndriçuar, plotësuar e saktësuar të dhënat për këto personalitete, si, fjala vjen, poetët Mesihi Prishtina, Jahja Bej Dukagjini, Suzi Prizreni, Koçi Beu nga Korça dhe një numër të tërë të pashallarëve të kohës. Studimet e tij sot janë një burim me rëndësi për historinë e shqiptarëve dhe rolin e elitës shqiptare në periudhën osmane. (Shënim i yni).



*Mbishkrimet
në gjuhën osmane dhe perse*

Në vetë nishanet e varrit, mbi katër faqet e tyre, mbizotërojnë mbishkrimet në arabisht, turqish-ten osmane dhe persisht. Midis tyre, mbishkrimeve në arabisht, pra citimeve nga Kurani, u është dhënë një përparësi mbizotëruese. Në faqen e jashtme të nishanit të kokës, në arabisht shkruhet: *“Ai (Zoti) është i Gjalli dhe i Përjetshmi! (Këtu prehet) ky i ndjeri-merhumi, që është i falur dhe që ka nevojë për mëshirën e Zotit të tij, të Atij që fal dhe që i mbulon mëkatet. (Këtu prehet) përkthyesi nga tri gjuhë, Jusufi, i biri i Hammerit, për shpirtin e tij qoftë një kujtim i bukur!”*

Po ashtu, në nishanin e këmbëve, në faqen e jashtme, në arabisht qëndron e shkruar:

“Ai (Zoti) është i Përjetshmi. Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Ne i përkasim Zotit dhe tek Ai do të kthehemi. Të gjithë njerëzit do të vdesin. Çdo pushtet një ditë do të marrë fund. Jeta nuk është e përhershme, përveç për Atë që nuk vdes kurrë (d.m.th. vetëm Zoti është i përjetshëm)!”

Siç shihet qartë, emrat e Zotit *El Hajj* (i Gjalli, i Përjetshmi) dhe *El Bākī* (i Mbeturi, i Përhershmi) mbizotërojnë në nishanet e varrit të Hammer-it. Kjo është, në thelb, një traditë osmane myslimane e stolisjes së gurëve të varrit (nishaneve), të cilën Hammer-i pati rastin ta mësonte dhe ta shihte gjatë shërbimit të tij diplomatik në Stamboll dhe në mbarë Levantin.

Pas përmendjes së emrit të Zotit *El Bākī*, pasojnë citime nga Kurani: i pari nga surja *Ali Imran* (3:185) dhe i dyti nga surja *El-Bekare* (2:156). Më tej, vijnë thënie që paralajmërojnë për përkohshmërinë e jetës dhe

shkurtësinë e pushtetit njerëzor – të dyja në variante që lidhen me hadithet e pejgamberit Muhamed, a.s.



Mbishkrimi në gjuhën arabe

flisnin rrjedhshëm, lexonin, diskutonin, shkruanin dhe përkthenin nga arabishtja, turqishtja osmane dhe persishtja.

Po ashtu, edhe emri “Joseph” mbi varrin e Hammer-it, në gjuhën arabe, është shkruar qartë si “Jūsuf”.

Me të vërtetë është interesante që Hammer-i ka zgjedhur që mesazhet kryesore në varrin e tij të jenë të shkruara në gjuhën arabe, pikërisht në faqet më të dukshme dhe të jashtme të “nishanit të kokës (së varrit)” dhe “nishanit të këmbëve”.³

Gjithashtu, Hammer-i ka pasur një interes të veçantë për të theksuar, po ashtu në gjuhën arabe, se ai ishte “përkthyes nga tri gjuhë” (*muterxhimu l-alsinati s-salāsah*). Kjo është një sintagmë e veçantë, me të cilën, në traditën e qytetërimit islam, nderoheshin dijetarët, filozofët dhe juristët që

³ Termat “nishani i kokës” dhe “nishani i këmbëve” i përdor rahmetliu Mehmed Mujzinović në veprën e tij trevëllimshme “Islamska epigrafika Bosne i Hercegovine” (*Epigrafia islame e Bosnjës dhe Hercegovinës*). Shih botimin “Sarajevo - Publishing“, Sarajevë, 1998! (Shënim i autorit)

Vendi ku jeton njeriu dhe ku duhet të marrë mësim

Mirëpo, Hammer-i nuk e la pas dore as turqishten osmane dhe as gjuhën perse në nishanet e tij. Në faqet e brendshme të nishanit të kokës dhe atij të këmbëve gjenden vargje dhe thënie të shkruara me kaligrafi mbresëlënëse. Në njërën anë të nishanit të varrit, Hammer-i ka zgjedhur këtë varg në persisht nga **Gjylistani** i Saadiut:

*“Eh! Sa herë që në bahçe mbinte një fidan,
Shkoja ta shihja, dhe shpirti më gëzohej.
Miku im, eja tek unë në pranverë,
Kur nga pluhuri im të dalë një fidan i ri.”*

Më poshtë vjen edhe një distik në turqishten osmane, që në një përkthim të lirë thotë:

*“Për hir të kopshtit, bilbili erdhi në këtë botë,
Pastaj, si flutur, prej tij fluturoi larg.”*

Të marrësh mësim nga vetë pamja e varrit dhe nga mesazhet e thënieve të gdhendura në nishanet e tij ishte dëshira e të famshmit Hammer. Pikërisht varrezat dhe varri, ai “mezari” i heshtur, janë vendi ku duhet të pranosh të vërtetën e pashmangshme: bota është e përkohshme, jeta është e shkurtër, qëndrimi i njeriut është i brishtë; jeta ngjan me një fidan që mbin nga toka pjellore, pastaj përkulet i dobët ndaj erës... Më tej, jeta është si një ndalesë e shkurtër e bilbilit në kopsht; dhe ashtu si bilbili që fluturon prej tij si flutur, edhe njeriu largohet nga kjo botë (edhe pse, natyrisht, kjo nuk na pëlqen!).

Në një tjetër faqe të brendshme të gurit të varrit janë gdhendur vargjet në persisht të Saadi Shirazit:

*“Gjithë botën prore e kam shëtitur,
Ditët i kam kaluar me njerëz nga më të ndryshmit,
Në çdo qoshe kam kërkuar kënaqësi,
Dhe nga çdo lëmë kam mbledhur nga një kalli.”*

Me këto vargje, Hammer-i, përmes fjalëve të Saadiut, kujtoi jetën e tij të pasur dhe të mbushur me përvoja: një jetë mes shumë njerëzve, plot kënaqësi, ku përjetoi shumë të mira dhe mblodhi kallinj të pjekur e të be-

gatë... Por, sidoqoftë, vjen çasti kur duhet të vdesësh, të largohesh, të thuash – një ditë, në fund të gjithçkaje, – “lamtumirë, e dashur jetë!”.

Prandaj, Hammer-i vendosi që nën këto vargje të Saadiut të shtojë edhe një distik në turqishten osmane:

*“Ziyaretten murad ancak du‘adır.
Bugün bana ise yarın sanadır.”*

E, që do të thotë:

*“Qëllimi i vizitës këtu është vetëm lutja.
Sot ajo drejtohet për mua, nesër do të jetë për ty”.*

Me këtë që thamë, ende nuk kemi përshkruar gjithçka që gjendet mbi varrin e Hammer-it. Le të përmendim shkurt se ky varr nderon edhe poetin spanjoll Pedro Calderón de la Barca (vdekur më 1681), vargjet e të cilit, në spanjisht, janë gdhendur në njërën anë të varrit të Hammer-it. Po ashtu, edhe poeti francez François de Malherbe (vdekur më 1628) është nderuar me disa vargje të tij të gdhendura në këtë varr.

Në fund, të themi edhe ne lutjen tonë: *Zoti i Dashur ta shpjerë Joseph von Hammer-Purgstall-in në Xhenetin e bukur, në parajsën e begatë, ku ka shumë libra dhe biblioteka!*⁴

Përgatiti:
S. Mehmeti

⁴ Autori i kësaj eseje përkujtimore ende nuk është bërë “ai që i di ato tri gjuhë” (arabisht, osmanisht dhe persisht). Për këtë arsye, falënderon Prof. Dr. Kerima Filan dhe z. Nermin Hodžić për ndihmën në shpjegimin e kuptimit të vargjeve dhe thëniet në persisht dhe turqishten osmane. Autori falënderon gjithashtu z. Sidik Spahić për ndihmën në përzgjedhjen e literaturës gjermane mbi Joseph von Hammer-Purgstall-in dhe përkthimet gjermane të këtyre thëniet dhe vargjeve. Punimi i plotë, që do të trajtojë të gjitha mbishkrimet, thëniet dhe vargjet – përfshirë ato në latinisht, frëngjisht, greqisht, spanjisht – të cilat gjenden gjithashtu mbi varrin e Hammer-it, do të botohet së shpejti. (*Shënim i autorit*).

IV. TEMA E NUMRIT

(30-vjet nga gjenocidi serb në Srebrenicë)

Naim ef. TËRNAVA

(Myfti i Kosovës)

KUJTESA E GJALLË DHE DËSHMIA E SHKRUAR: SREBRENICA NË NDËRGJEGJEN TONË

1. Srebrenica ndërgjegjja jonë

Sot, në përvjetorin e 30-të të gjenocidit të kryer në Srebrenicë nga forcat serbe, jemi mbledhur jo vetëm për të kujtuar, por edhe për të dëshmuar se kujtesa nuk vdes dhe e vërteta nuk heshtet.

Ky përvjetor i dhimbshëm shënohet me një kontribut modest, në nderim të të gjitha viktimave, përmes botimit në gjuhën shqipe të librit **“Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”**, të autorit dhe të mbijetuarit të këtij gjenocidi, imam Mevludin Hrnjiq¹. Promovimi i këtij



¹ Punimet në vazhdim, në këtë rubrikë, janë pjesë e aktivitetit me rastin e promovimit të librit: Mevludin Hrnjiq, **Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës – Kronologji e kujtesës**, Prishtinë, botuar nga “Dituria Islame”, 2025, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, më 8 qershor 2025, në Prishtinë.

botimi realizohet sot, në këtë aktivitet të veçantë, si homazh për viktimat dhe si shprehje e kujdesit, kujtesës dhe përgjegjësisë morale ndaj historisë sonë.

Ngjarjet e korrikut të vitit 1995 në Srebrenicë nuk janë një tragjedi e izoluar, por një akt i qëllimshëm gjenocidi, i orkestruar me synimin për zhdukjen e boshnjakëve, vetëm pse i përkisnin një besimi dhe etnie tjetër. Mbi 8.000 burra dhe djem u masakruan, shumë gra u përdhunuan dhe mijëra familje u shpërngulën, nën sytë e botës dhe përballë institucioneve që kishin për detyrë mbrojtjen.

Gjenocidi në Srebrenicë, 30 vjet më parë, u krye në një zonë të shpallur të mbrojtur nga OKB-ja, duke përfaqësuar jo vetëm dështimin e komunitetit ndërkombëtar, por edhe një plagë të përbashkët të njerëzimit. Ideologjia e shfarosjes qëndronte pas kësaj tragjedie dhe u përhap më pas edhe ndaj popullit shqiptar në Kosovë, i cili përjetoi masakra, dëbime masive dhe përpjekje për shfarosje në vitet në vijim.

Populli boshnjak, ashtu si ai shqiptar, tregoi qëndresë me dinjitet, duke mbrojtur jo vetëm jetën, por edhe identitetin, besimin dhe të drejtën për ekzistencë. Kjo qëndresë dhe kjo e vërtetë vazhdojnë të ruhen përmes kujtimeve dhe dëshmive të mbijetuarve.

Është me rëndësi të veçantë përmendja e botimit në shqip të librit **“Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”**, nga Mevludin Hrnjiq, një prej të mbijetuarve të asaj tragjedie, i cili përmes fjalës së shkruar u ka dhënë zë atyre që nuk mundën të flasin.

Ky libër nuk do të ekzistonte pa guximin, motivimin dhe vendosmërinë e autorit, imam Mevludin Hrnjiq, i cili përjetoi në mënyrë të drejtpërdrejtë sfidën jetësore gjatë rrethimit të Srebrenicës dhe sulmit brutal të forcave serbe, si dhe në rrugën e tij drejt territoreve të lira. Ai ndau me botën përvojën e tij personale dhe kolektive, duke sjellë vuajtjet, rrëfimet, humbjet dhe rezistencën e një imami që nuk braktisi besimtarët në momentet më të rënda. Ky është një akt i lartë shërbimi ndaj së vërtetës, drejtësisë dhe brezave që vijnë.

Libri që po promovojmë sot, botuar nga Shtëpia Botuese **“Dituria Islame”**, përfaqëson më shumë se një dëshmi; ai është thirrje për ndërgjegjësim, burim edukimi për brezat e rinj dhe urë lidhëse mes kujtesës

dhe së ardhmes. Për lexuesin shqiptar, kjo vepër hedh dritë mbi njërën prej plagëve më të rënda të historisë së popullit boshnjak dhe përmes saj nxit nevojën për ruajtjen aktive të kujtesës historike, përballë mohimit dhe harresës që shpesh vjen me kalimin e kohës. Ajo na fton gjithashtu të reflektojmë mbi përvojat e ngjashme të popullit tonë, duke forcuar solidaritetin dhe ndërgjegjësimin ndaj së vërtetës dhe drejtësisë.

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përmes Drejtorisë për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, ka ndërmarrë dhe do të mbështesë edhe në të ardhmen projekte të tilla që dëshmojnë të vërtetën e hidhur të së kaluarës sonë të afërt – jo për hakmarrje apo urrejtje, por për vendosjen e drejtësisë dhe për parandalimin e tragjediave të ngjashme në të ardhmen.

Në këtë frymë, kujtojmë fjalën e Kuranit Famëlartë:

“Mos mendoni se ata që janë vrarë në rrugën e Allahut janë të vdekur. Jo! Ata janë të gjallë te Zoti i tyre dhe furnizohen.” (Kuran, Ali Imran, 169).

Dhe urtësinë popullore që thotë: *“E kaluara kur harrohet, rrezikon të përsëritet.”*

Meqenëse për librin do të flasim më kompetencë – referuesit e çmuar që vijnë nga bota akademike dhe kanë njohuri të thella në këtë fushë – unë do të doja që t’i them dy fjalë për autorin e këtij libri, për të mbijetuarin e masakrës së Srebrenicës, për atë që mbijetoi për të na rrëfyer për kasaphanën serbe në Srebrenicë, për imamin e nderuar Mevludin Hrnjiq.

2. Imami Mevludin Hrnjiq – mbijetesa e dëshmitarit

Imami Mevludin Hrnjiq është një simbol i qëndresës dhe i besimit të palëkundur në Zotin e Madhërishëm, një dëshmitar i gjallë i gjenocidit në Srebrenicë të Bosnjës, një ngjarje tragjike që ndodhi në korrik të vitit 1995, kur forcat serbe vranë mbi 8.300 burra dhe të rinj myslimanë boshnjakë. Ai është një shembull i forcës shpirtërore dhe qëndrueshmërisë në kohë të vështira. Imami Mevludin Hrnjiq është figurë e njohur dhe e respektuar në komunitetin mysliman të Bosnjës.

Për rolin e tij si njëri ndër dëshmitarët e paktë të mbijetuar të gjenocidit të Srebrenicës, por edhe për vuajtjet e tij, më së miri flet libri **“Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”**, ku, në mënyrë të jashtëzakonshme,

mes ndjenjash të përziera dhimbjeje dhe shprese, paraqet rrugëtimin e tij të vështirë drejt shpëtimit. Në këtë sprovë të rëndë, ai kaloi një periudhë të gjatë dhe të vështirë, duke udhëtuar përmes maleve dhe fshatrave të shkatërruara nga serbët për të shpëtuar jetën e tij dhe për të mbetur dëshmi e gjallë që do t'i rrëfejë ato momente tmerri që përjetuan vëllezërit dhe motrat e tij.

Udhëtimi i imam Mevludinit, që zgjati 80 ditë, nëpërmjet tmerresh dhe kushteve jashtëzakonisht të vështira, në male dhe fshatra të shkatërruara, kishte një synim të vetëm: të mos dorëzohej para dorës gjakatare dhe të shpëtonte jetën e tij. Në këtë udhëtim shpëtimi, ai dëshmoi për besimin e palëkundur në Zotin e Madhërishëm, duke mbijetuar tmerret nga forcat armike serbe dhe duke e përballuar këtë tragjedi. Pa këtë besim, pa këtë mbështetje, imami ynë nuk do t'ia dilte mbanë.

Imami Mevludin, pa dyshim dhe në vazhdimësi, e kishte bazuar shpresën te udhëzimet kuranore. Këto udhëzime, të cilat ua kishte shpjeguar dhe komentuar xhematit në xhaminë e tij në Srebrenicë, edhe para luftës, por edhe gjatë saj, tash do t'i praktikonte vetë në kushte tejet të vështira. Nisur nga parimi se besimtari, pavarësisht në çfarë gjendjeje bie, nuk guxon të humbë shpresën te ndihma e Zotit xh.sh., ai, gjatë 80 ditëve të strehimit dhe udhëtimit nëpër male e fusha, për të mos rënë në duart e armikut serb, e mbështeti shpresën te mësimet e Islamit, të cilat pikërisht theksojnë rëndësinë e durimit dhe të besimit.

Kurani na mëson: ***“O ju që besoni! Kërkoni ndihmë me durim dhe namaz, se Allahu është me ata që janë të durueshëm”*** (El-Bekare, 153). Imam Mevludini, nëpërmjet librit të tij të kujtimeve, bëhet një dëshmi e gjallë e besimit të palëkundur në Allahun dhe e forcës shpirtërore që ofron Islami. Ai, edhe në këto situata të vështira, ndoqi mësimet e Islamit për të përballuar sfidat dhe për të mbijetuar, duke treguar se besimi dhe durimi janë çelësat për të kapërcyer çdo vështirësi.

Edhe momentin tjetër të dhimbshëm, kur imami arriti në shtëpinë e tij të shkatërruar në Kamenicë, ai e kujton si një përballje me realitetin e hidhur të humbjes së familjes dhe të jetës së dikurshme. Ky moment vë në pah forcën e tij shpirtërore dhe besimin që e udhëhoqi përmes këtyre ngjarjeve të vështira.

Disa muaj para se të ndodhte gjenocidi në Srebrenicë, konkretisht në mars të vitit 1995, serbët e rrethuan qytetin, nën urdhrat e udhëheqësit të tyre, Radovan Karaxhiq. Qyteti u la pa ushqime për disa muaj, duke ushtruar presion mbi luftëtarët boshnjakë që të largoheshin, derisa forcat serbe arritën të hynin dhe ta merrnin kontrollin e qytetit në korrik 1995. Ndonëse, formalisht, Srebrenica ishte një zonë e mbrojtur dhe e garantuar nga forcat e Kombeve të Bashkuara, në të vërtetë ajo u la në pamëshirën e forcave serbe.

Ratko Mlladiq, shefi i Shtabit të Ushtrisë Serbe të Bosnjës, gjatë hyrjes në Srebrenicë, u shfaq para mediave duke u premtuar banorëve boshnjakë siguri dhe mbrojtje, madje duke thënë se do të lejoheshin të largoheshin të sigurt. Por më 11 korrik 1995, pasi mediat u larguan, filluan përgatitjet për shfarosjen masive. Fillimisht burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët. Burrat dhe të rinjtë u dërguan në vendet e ekzekutimit, ndërsa gratë në kampe, ku përjetuan përdhunime dhe tmerre të tjera.

Kur Mlladiqi u sigurua se kishte ardhur momenti i pritur, iu drejtua ushtarëve dhe paramilitarëve të tij duke thënë: “Vëllezërit e mi serbë, shfrytëzoheni këtë mundësi të artë, sepse nuk do të ripërsëritet më kurrë kjo mundësi.” Gjenocidi filloi që atë natë. Dëgjoheshin krisma armësh, britma të shumta, ndërsa për katër net rresht u masakruan myslimanët boshnjakë të zënë nga forcat serbe. Ky ishte gjenocidi më i madh pas Holokaustit të Luftës së Dytë Botërore, ku u masakruan mbi 8.300 burra e të rinj myslimanë boshnjakë.

Shumë herë është thënë se, për të parandaluar ngjarje të tilla të tmerrshme, si masakrat e shumta të kryera në Bosnjë gjatë luftës së viteve 1992-1995, me theks të veçantë gjenocidin në Srebrenicë, por edhe masakrat e kryera në Kosovë gjatë luftës së viteve 1998-1999 nga i njëjti armik - ushtria, policia dhe paramilitarët serbë - duhet patjetër të shohim me ndershmëri të kaluarën dhe të pranojmë me kokë të ftohtë se këto krime, masakra, maltretime, djegie e rrënime kanë ndodhur. Roli ynë, pas këtyre veprave çnjerëzore kundër popujve të pafajshëm, është që të punojmë për t’i parandaluar, që të mos përsëriten asnjëherë më.

Përndryshe, dështimet e shoqërive apo të mekanizmave ndërkombëtare për t’i parandaluar këto masakra e krime do të konsiderohen dështim

për mbrojtjen e viktimave të pafajshme dhe do të mbesin njolla të pashlyeshme në ndërgjegjen e njerëzimit.

Në përfundim themi se historia e imam Mevludin Hrnjiqit është një shembull i shkëlqyer i forcës shpirtërore dhe i besimit të palëkundur në Zotin e Madhërishëm. Ai tregoi se, edhe në momentet më të errëta e të pamundura për mendjen njerëzore, besimi në Zotin xh.sh. dhe ndjekja e mësimave të Islamit e udhëzuan drejt shpëtimit dhe paqes. Ndaj, nga libri i imamet Mevludin Hrnjiq **“Dëshmitari i gjenocidit të Srebrenicës”** mësojmë se rikujtimi i gjenocideve, masakrave dhe krimeve të kryera është parim thelbësor, sepse rikujtimi është një akt respekti ndaj atyre që humbën jetën apo që vuajtën padrejtësisht nga dora e armikut barbar. Nisur nga ky parim, ata meritojnë të mos harrohen kurrë. Sado e dhimbshme të jetë historia, ajo duhet t’u mësohet gjeneratave të reja me qëllim që të mos përsëritet.

Njohja e shkaqeve të krimeve të së kaluarës, si në shoqërinë shqiptare, ashtu edhe në atë boshnjake, ndihmon shoqërinë të kuptojë pasojat të urrejtjes, diskriminimit dhe jotolerancës. Rikujtimi dhe dokumentimi i krimeve u shërben brezave të rinj si bazë për kërkim përgjegjësie dhe ndëshkim të fajtorëve edhe në përmasa ndërkombëtare. Duhet vazhdimisht të kemi parasysh se popujt që harrojnë historinë e tyre rrezikojnë të humbin identitetin, që është vlerë esenciale që i dallon nga të tjerët. Rikujtimi i vuajtjeve është pjesë e kujtesës kolektive dhe rezistencës kombëtare, por është edhe një akt kundër harresës dhe manipulimit të historisë. Vetëm duke e pranuar të kaluarën dhe duke reflektuar mbi të ardhmen, shoqëritë mund të pajtohen dhe të ndërtojnë një të ardhme më të drejtë dhe më të sigurt për të gjithë.

3. Zëri ynë i përbashkët për drejtësi

Dhe në fund themi se me këtë aktivitet, dëshirojmë t’i bashkëngjitemi zërit të botës demokratike që kërkon drejtësi, të vërtetë dhe kujtesë për atë që ka ndodhur në Srebrenicë. I bashkohemi përpjekjeve të shteteve, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që kanë mbështetur pa mëdyshje njohjen dhe cilësimin e kësaj masakre me emrin që meriton – gjenocid.

Po ashtu, ky aktivitet duhet kuptuar si një mesazh dhe si një kontribut për paqe, mirëkuptim dhe bashkëjetesë. Ne besojmë thellë se Zoti i ka krijuar njerëzit të jetojnë në paqe e harmoni – jo në konflikte, urrejtje apo dhunë.

Të gjithë jemi thirrur të ndërtojmë ura, jo mure. Të mbjellim shpresë, jo frikë.

Dhe të flasim për të vërtetën, jo ta fshehim atë.

Srebrenica nuk është më vetëm një emër në hartë – ajo është plagë. Plagë e hapur në ndërgjegjen njerëzore, plagë që flet dhe që s’duhet të mbyllet pa drejtësi.

Zoti i mëshiroftë viktimat e Srebrenicës.

“Fatiha” për viktimat e gjenocidit në Srebrenicë!

Albin KURTI

(Kryeministër i Kosovës)

SRBERENICA - MË SHUMË SE MASAKËR ISHTE PËRPJEKJE PËR TË ZHDUKUR NJË POPULL

Të nderuar zyrtarë të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës,

Të nderuara zonja dhe zotëri,

Motra dhe vëllezër, miq të kujtesës dhe të drejtësisë,

Sot, në zemër të Prishtinës, ne po e kujtojmë një plagë të hapur të Evropës, po dëshmojmë se kujtesa është akt rezistence dhe se fjala e shkruar është betim për të mos harruar.

Libri “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”, i autorit dhe i të mbijetuarit Mevludin Hrnjiq, që sapo ka dalë nga shtypi dhe po sillet këtu para nesh, më shumë se një rrëfim personal, është gur kujtese me një plagë që ende kullon.

Është zëri i një njeriu që mbijetoi për të treguar, për të kujtuar ata të cilët nuk mundin dhe sot ai zë po flet edhe në gjuhën shqipe, që kujtimi të marr zemër edhe në vendin tonë.

Zotëri Hrnjiq, pranoni mirënjohjen tonë më të thellë për kurajën tuaj për shkruar këtë libër për të sjellë zërin e Srebrenicës deri këtu pranë nesh.

Mirë se vini në Kosovë, një vend që e kupton dhe e ndjen dhimbjen tuaj si të veten sepse në heshtjen pas një gjenocidi çdo fjalë që tregon të vërtetën është dritë e cila ndriçon kujtesën tonë kolektive.

Këtë muaj bëhen tridhjetë vjet nga korriku i vitit 1995 kur mbi tokën e Srebrenicës ra nata më e zezë e njerëzimit.

Nën komandën e Ratko Mlladiqit, forcat serbe vranë tetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy burra dhe djem boshnjak.

Më shumë se masakër ishte përpjekje për të zhdukur një popull, një kulturë, një frymë.

Ishte gjenocid, dhe gjenocidin e Srebrënisë është krim që i përket gjithë njerëzimit dhimbje që nuk njih kufij dhe përgjegjësi që nuk mund të harrohet.

Në Kosovë çdo korrik e kujtojmë Srebrenicën si plagë që flet edhe për ne, sepse sikur boshnjakët edhe shqiptarët e Kosovës përjetuan në të njëjtën dekadë egërsinë e mizorinë e të njëjtit regjim të njëjtën përpjekje përfshirjeje, të njëjtin krim që merr emrin më të rëndë që një historia, pra gjenocid.

Pata fatin ta vizitoj Srebrenicën për herë të parë në vitin 2016. Rrëfimet që dëgjova nga nënat e mbetura pa bijë, nga gratë e mbetura pa burra ishin si britma, të cilat shpojnë heshtjen e botës dhe s'mund të harrohen.

Kur u bëra Kryeministër i Kosovës, e sollën këtë kujtim edhe në institucione, duke e njohur vuajtjet e popullit boshnjak në vitin 2021.

Kuvendi i Republikës sonë miratoi një rezolutë që e dënon gjenocidin Srebrënisë, ndërkaq vitin e kaluar, në mbledhjen e 212 të Qeverisë së Kosovës e shpallëm njëmbëdhjetë korrikun Ditë memoriale në përkujtim të gjenocidit të Srebrenicës.

Vit pas viti përpigemi ta mbajmë gjallë kujtimin jo vetëm si një detyrë politike, por si një borxh njerëzor, sepse adresa e këtij krimi nuk mund të ndalet në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Fillet e tij çojnë në Beograd në zemrën e një politike shtetërore që mbolli urrejtje dhe vdekje Radovan Karaxhiq dhe Ratko Mlladiq ishin vetëm duart që e zbatuan planin, por mendja dhe fryma e këtij krimi vinin nga më lart.

Dënimet e tyre janë dëshmi se drejtësia vonon, por nuk humbet.

Çdo dëshmitar si zotëri Hrnjiq, çdo libër si ky që kemi sot në dorë është dëshmi që duhet respektuar dhe afirmuar, sepse kujtimi është rruga drejt drejtësisë dhe drejtësia është rruga drejt paqes së vërtetë

Ju falënderoj të gjithëve që keni kontribuar që ky zë të flasë edhe në gjuhën shqipe, dhe ju falënderoj që jeni këtu për të dëgjuar, për të kujtuar dhe për të besuar se e vërteta sado e vonuar, gjithmonë ka forcën të flasë dhe të thërrasë!

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe vëmendjen!

Ramadan SHKODRA

SREBRENICA - DËSHMI E KTHYER NË AMANET

Srebrenica - është emërvendi që i flet botës për njërën prej tragjediave më të mëdha njerëzore në fund të shekullit XX. Është zëri i 8372 burrave dhe djemve myslimanë boshnjakë të vrarë mizorisht nga forcat serbe në korrik të vitit 1995. Është vendi i shehidëve, të cilët u vranë vetëm sepse i përkisnin një etnie tjetër dhe një besimi tjetër nga ai i xhelatit. Aty u synua të zhdukej një popull për shkak të identitetit dhe të fesë së tij. Në Srebrenicë ndodhi gjenocidi, i cili u faktua, me të drejtë vetëm një vit më parë, edhe nëpërmjet konstatimit të tij nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Sot, tridhjetë vjet më pas, “Srebrenica është..., të shkosh në Potoçari; të heshtësh, të shikosh bardhësinë e nishaneve dhe ta lësh heshtjen që të ta shpjegojë leksionin nga historia, për të cilin të gjithë zhurmshëm po flasin.”- shprehet në kujtimet e tij, imami Mevludin Hrnjiqi.

Po, vallë, kush është Mevludin Hrnjiqi?

Është autori i librit që gjendet përpara jush “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës – Kronologji e kujtesës kushtuar gjenocidit në Srebrenicë”. Është ai që, bashkë me të tjerët, ishte aty – në qendër të tragjedisë, mu në mesin e kasaphanës. Është ai që nuk shkroi me laps të ftohtë, por me zemrën që ende mban plagët e së kaluarës. Është ai që foli thjesht, por në mënyrë tronditëse. Është ai që nuk pranoi të heshtë. Është rrëfimtari i dëshmisë bindëse, të vërtetën e së cilës xhelatët nuk mund ta fshehin dot. Është ai që brezave të rinj ua dokumenton dhe ua kujton që kurrë të mos harrojnë se ç’u bënë të parëve fqinjët e tyre.

Imami Mevludin Hrnjiqi nuk është historian, as kronist, as jurist, as gazetar. Ai nuk e shkroi si profesionist i fjalës apo i analizës, por si dëshmitar i mbijetuar, i ndershëm dhe i guximshëm. Ai nuk shkroi me stilin e një akademiku, por me forcën e kujtesës së gjallë, me dhimbjen që buron nga shpirti, me zemrën e plagosur të një njeriu që e pa me sy shfarosjen e popullit të tij.

Prandaj libri “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës – Kronologji e kujtesës kushtuar gjenocidit në Srebrenicë”, i imam Mevludin Hrnjiqit, nuk është vetëm një vepër letrare a një dëshmi historike. Ai është një britmë që vjen nga thellësia e shpirtit të një të mbijetuari; është një amanet i dhimbjes dhe i qëndresës që nuk bën të harrohet. Nuk është as vetëm autobiografi, por është një testament i dhimbjes dhe i besës, një ftesë për reflektim dhe veprim moral; është një akt nderimi dhe një kampanë që bie për drejtësi dhe kujtesë njëkohësisht.

Me një fjalë, Imami Mevludin Hrnjiq e ka shkruar këtë libër për të çliruar ndërgjegjen, për të mos e mbajtur brenda vetes peshën e asaj që ka parë dhe përjetuar. Dhe, më shumë se kaq, e ka shkruar për t’i dëshmuar botës, me dinjitet e qartësi, mizoritë që i janë bërë popullit boshnjak në Srebrenicë.

I lindur dhe i rritur në rajonin e Srebrenicës, i mbijetuar i gjenocidit të vitit 1995 dhe dëshmitar i gjallë i asaj tragjedie, Imam Mevludin Hrnjiqi, një ndër figurat më të respektuara të komunitetit mysliman boshnjak sot, mori, pra, mbi vete barrën morale për ta ruajtur kujtesën dhe për ta dokumentuar të vërtetën si një zë i të gjithë atyre që nuk jetojnë më për të rrëfyer. Qëndrimi i tij i palëkundur dhe gatishmëria për ta ndarë dhimbjen me të tjerët prandaj e bëjnë këtë libër jo vetëm të rëndësishëm, por edhe të pazëvendësueshëm në arkivin e kujtesës historike të popullit boshnjak dhe më gjerë. Në një format të këtillë, ky libër është zëri i ndërprerë i klithmave të mijëra të vrarëve, që u artikuluan në dakikun e fundit të jetës së tyre, është amaneti për ta thënë të vërtetën për ta, atë të vërtetë që do të kujtohet si njëra ndër ngjarjet më ngjethëse në historinë e mizorive çnjerëzore, e mbi të gjitha është dhembje e bashkëndjenjë me nënat dhe me familjet boshnjake. Duke e njohur këtë të vërtetë të dhimbshme, bota e qytetëruar u bashkua në shënimin e saj, ndonëse edhe sot vijojnë zërat që

e relativizojnë dhe madje edhe e mohojnë gjenocidin e bërë në Srebrenicë. Edhe ata do të mund të mësonin nga dëshmia e autorit Hrnjiq.

Libri është ndërtuar mbi një strukturë kronologjike që ndjek jetën personale të autorit, të ndërthurur me historinë e përgjakshme të Bosnjës. Ai ndahet në kapituj që trajtojnë jetën para luftës, përvojën gjatë agresionit serb dhe gjenocidin në Srebrenicë, rrugën e mbijetesës nëpër male dhe jetën pas luftës si imam e edukator. Çdo kapitull bart peshën e një kohe të caktuar – që nga fëmijëria e qetë në një familje fshatare myslimane deri te ferri i Srebrenicës dhe rruga e dhimbjes përmes humbjes së babait dhe tre vëllezërve... Libri është një dokumentim i gjallë dhe i thellë i traumës kolektive dhe një testament i qëndresës shpirtërore, që i tejkalon kufijtë e Bosnjës dhe popullit boshnjak dhe që jehon fuqishëm, sidomos edhe ndër ata që pësuan ngjashëm dhe u përballën me të njëjtin xhelat.

Botimi i këtij libri në gjuhën shqipe prandaj është një ngjarje e veçantë dhe me domethënie të thellë. Për herë të parë lexuesi shqiptar ka mundësi që ta lexojë këtë rrëfim të gjallë e të drejtpërdrejtë nga një imam boshnjak, i cili, nëpërmjet përjetimeve të tij personale, flet për tragjedinë e një populli të tërë. Është një ngjarje e veçantë edhe sepse mes asaj që ndodhi në Bosnjë dhe asaj që Serbia tentoi të realizonte në Kosovë ka shumë ngjashmëri. Në të dyja rastet dhuna dhe gjenocidi u përdorën si mjet për spastrimin etnik, për zhdukjen e identitetit. Armiku ishte dhe mbetet i përbashkët – një ideologji e urrejtjes që ka prodhuar vetëm gjak dhe tragjedi në Ballkan.

Ky botim është fryt i një bashkëpunimi të çmuar mes Bashkësisë Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, si një shenjë solidariteti, vëllazërie dhe përgjegjësie për ta ruajtur të vërtetën dhe për ta ndarë atë me të gjithë ata që besojnë në drejtësi dhe në të vërtetën.

Shtëpia botuese “Dituria Islame” nga Prishtina e pati për nder që me shumë përkushtim ta realizonte botimin e këtij libri në gjuhën shqipe, sidomos pas bisedave të gjata e plot emocione e dhimbje që patëm vitin e kaluar me Imam Hrnjiqin gjatë qëndrimit të tij në Prizren dhe Prishtinë (tetor 2024), me rastin e ekspozitës “Bota kujton Srebrenicën - Svet pam-

ti Srebrenicu” kushtuar gjenocidit të Srebrenicës, të cilin e falënderojmë vëllazërisht.

Libri “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës – Kronologji e kujtesës kushtuar gjenocidit në Srebrenicë” i Imam Mevludin Hrnjiqit, që po elk në dritë edhe në në gjuhën shqipe, le të jetë e le të shërbejë si jehonë e zërit që nuk do të shuhet kurrë; si një thirrje për të mos harruar, por për të mësuar; si kujtesë jo për të urreyer, por për të qëndruar të bashkuar përballë padrejtësisë dhe krimit. Le të jetë një homazh për viktimat – për jetët e pafajshme të shuara në Srebrenicë, për nënat që kërkojnë bijtë e tyre edhe sot, për ata që mbijetuan me plagë të pashërueshme. Le të shërbejë gjithashtu si thirrje për të shkruar dhe për të ruajtur të vërtetën, por edhe si një shembull që duhet ndjekur edhe nga të mbijetuarit tanë në Kosovë, të cilët përjetuan po ashtu terrorin dhe mizoritë e forcave serbe në vitet 90 të shekullit të kaluar, sepse dëshmia është një akt drejtësie, është mënyra më njerëzore për të mos lejuar që krimi të mbulohet nga pluhuri i harresës.

Historia, që të mos përsëritet, nuk duhet të harrohet!

Dr. Hysen MATOSHI

KUJTESA SI AMANET PËR SREBRENICËN

Srebrenica, nga një vendbanim i vogël në Bosnjën Lindore, më 1995, u kthye në fjalën më të pranishme në mediet dhe në debatet botërore diplomatike. Shpallja e saj një zonë e mbrojtur e Kombeve të Bashkuara dhe nën kontrollin e forcave ndërkombëtare më 1993 ishte një uverturë në ngjarjen më të pazakonshme dhe më tronditëse për vetëdijen e emancipuar të njerëzimit, e cila pasoi në korrikun e vitit 1995. Zona e mbrojtur dhe e demilitarizuar, në të cilën ishin strehuar dhe kishin gjetur shpëtimin dhjetra mija boshnjakë të dëbuar nga vatrat e tyre shekullore (që ishin pushtuar prej forcave ushtarake serbe) ishte vënë nën kujdesin e forcave ndërkombëtare të UNPROFORIT, si garantuese të jetës së civilëve, ndonëse ata jetonin në kushte pothuajse çnjerëzore, pa pasur strehim të përshtatshëm, ushqime të mjaftueshme, kujdes shëndetësor, liri qarkullimi, jetë normale familjare e shoqërore etj. Kjo zonë e mbrojtur e Kombeve të Bashkuara, më parë se me një zonë të sigurt, shëmbëllente me një geto, në të cilën po i shtynte ditët e jetës së pasigurt një popullatë e destinuar për shfarosjen e saj përfundimtare, kjo zonë shëmbëllente me një kamp të madh përqendrimi në të cilin të internuarit, si në një paradhomë tmerri, dita-ditës, po prisnin ekzekutimin e tyre.

Vërtet si mund të shpjegohet fakti që forcave serbe iu lejua spastrimi i vendbanimeve etnike boshnjake të pjesëve lindore të vendit, duke e përqendruar në dy qytete të vogla krejt popullsinë e dëbuar dhe, pas dy vitesh, pasi që vendbanimet e tyre ishin shkretëruar dhe rrafshuar me tokë, tani po i dorëzonin në pamëshirën e një politike e ideologjie vrastare që synonte realizimin e projektit të shfarosjes përfundimtare. Pasi serbët ua kishin rrëmbyer pronat dhe çdo gjë që kishin pasur, kësaj popullate mund

t'ia merrnin vetëm edhe një gjë që u kishte mbetur: jetën e saj. Synimet për ta shtrirë Serbinë në pjesën më të madhe të Bosnjë e Hercegovinës prodhuan fatkeqësi të tilla që tronditën botën, që u shndërruan në simbolin e të keqes trishtuese të emërtuar si gjenocid, vrasje deri në shfarosje të një kombi të pambrojtur. Indiferenca e paparë në raport me të ndodhurat tragjike që përjetuan 8372 boshnjakë, të cilët u vranë sistematikisht nga forcat serbe, e bën këtë tragjedi edhe më të rëndë. Ishin përmasat e paimagjinueshme të këtij gjenocidi që nxitën reagimin e institucioneve dhe personaliteteve të botës, ndonëse faktorët determinues politikë të botës e njohën rezultatin e këtij gjenocidi, duke ia kaluar kreaturës dejtonjane, të njohur si Republika Serbska, qytetin të cilin forcat ushtarake serbe e lanë në gjak. Bota nuk njeh një shembull të dytë të kësaj të shpërblimit të veprimeve gjenocidiale. Gjenocidi vërtet u dënua nga Gjykata ndërkombëtare, por rezultati i tij u pranua dhe sot është plotësisht funksional si një vrasje e dytë e viktimave.

Ndonëse të mbijetuarit e ferrit të Srebrenicës janë të paktë, përjetimet e tyre kanë marrë formën e një monumenti të gjallë evokues e shkrimor, janë shndërruar në një zë që thërret gjithandej planetit, gjithandej kohëve, duke pohuar të vërtetën e dhimbshme. Ndër këto përjetime të formatuara në trajtë shkrimore është edhe libri i Mevludin Hrnjiqit, i titulluar “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”. Para se ta lexoja librin, e pata dëgjuar një rrëfim të përmbledhur të autorit, i cili ishte bërë si pjesë e ekspozitës “Bota kujton Srebrenicën”, që u mbajt më 24 tetor 2024, në Prishtinë, në organizim të Bashkësisë Islame të Kosovës. Aty kuptuam se rrëfimi i plotë i hoxhë Mevludinit ishte botuar në boshnjakisht. Duke e pasur kaq afër Srebrenicën, madje edhe duke pasur të freskëta kujtimet mbi Srebrenicat e kontekstit tonë hapësinor, ishte e udhës që lexuesi shqiptar, veçmas ai i Kosovës, ta kishte në dorë këtë libër të përkthyer në gjuhën shqipe. Drejtori i Kulturës i Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Ramadan Shkodra, mori nismën e qëlluar të botimit të këtij libri. Lexuesi ynë tani ka një dëshmi autentike, që para vetes i vjen në një format përjetimi të pazakonshëm, gati edhe të pabesueshëm, marrë parasysht tmerret e pafundme që autori i kaloi në rrugën drejt shpëtimit dhe lirisë së dëshiruar. Rëndësinë këtij botimi ia shtojnë edhe fjalët paravajtëse të drejtorit të

kulturës dhe sidomos vështirimi domethënës i Myftiut të Republikës së Kosovës, Efendi Naim Tërnavës.

Rruga 80-ditëshe e imanit Mevludin Hrnjiq nga Srebrenica deri në Kalesi ngjan me një rrugëtim nëpër rrathët danteskë të ferrit, nëpër të cilët përjeton vuajtjet, dhimbjen, tmerrin, frikën, pasigurinë, urinë, të ftohtit, nëpër të cilët tmerri që e përjeton vjen në një spirale të përshkallëzuar të tronditjeve shpirtërore... Mirëpo autori këtu nuk del thjesht dhe vetëm si përjetuesi i tyre, ai është gjithashtu edhe mbijetuesi i të gjitha këtyre sfidave me të cilat u përball, është edhe dëshmitari fjala e të cilit shpalos një pjesë të së vërtetës tragjike. Ndonëse jeta e tij ecën nëpër teshun e shpatës, nëpër rreziqe të panumërta që janë përshkruar deri në detaje, Mevludin Hrnjiqi ka pasur një shpresë të madhe se pas shumë vështirësish do të dalë i gjallë në tokën e lirë, ndërsa këtë shpresë e ushqen dhe e forcon besimi i përhershëm në Krijuesin e Madhërishtëm. Ai është njeri, i cili me bindje të patundur e ka dorëzuar jetën e tij në dorën e Allahut, ndaj nuk pranon që të dorëzohet te pamëshira e dushmanëve, të cilët i kishin mbështjellë thirrjet e tyre për dorëzim me premtimin mashtrues të faljes. Të gjithë ata që autori i kishte pranë vetes dhe që kishin vendosur, në një moment të vështirë të mbijetesës, të dorëzoheshin te forcat serbe, me shpresën e faljes, do të përfundonin të vrarë, të ekzekutuar mizorisht, sikundër edhe është dëshmuar nga disa xhirime monstruoze që i kanë bërë vetë forcat serbe. Ka mjaft prej tyre që nuk u janë gjetur eshtrat edhe sot e asaj dite, ose që janë gjetur pjesë të tyre në varreza të ndryshme, gjë që flet se ata u vranë më shumë se një herë, pra mund të thuhet se duke ua zhdukur e zhvendosur disa herë kufomat ata u vranë e u rivranë edhe për së vdekuri!

Libri është strukturuar në disa tërësi që përfshijnë periudha dhe zhvillime që rrëfihen në një linjë kronologjike, si kujtesë e largët dhe e afërt. Marrë parasysh që poenta e këtij libri është periudha 80-ditore e rrugëtimit nga Srebrenica deri në liri (Kalesi), më duket sikur pjesa e parë, që është një autobiografi e autorit, është prezantuar më gjatë dhe më detajisht nga sa ishte e nevojshme në këtë kontekst. Ngjashëm ka marrë vëmendje të theksuar edhe periudha e fillimit të luftës në Bosnjë dhe rezistenca e popullatës boshnjake ndaj mësymjeve të ushtrisë serbe, qoftë në forma-

tet e asokohshme të organizimit të APJ-së, qoftë në formacionet ushtarako-policore të serbëve të Bosnjës që këtu përshkruhen me emërtimin e përbashkët si formacione çetnike, pastaj luftimet heroike të mbrojtësve, por edhe pësimet në trevën e lindjes, në rrethinat e Kamenicës, vrasjet e krimet e shumta makabre gjatë realizimit të të cilave nga formacionet serbe përdorëshin armë artilerike e deri edhe aeroplanë lufte mbi popullatën e paarmatosur civile, jeta e vështirë e në skamje, mjerimi dhe mungesa e perspektivës etj. Në një trajtë evokimi personal të gjitha këto të ndodhura janë përshkruar me një vërtetësi të jashtëzakonshme. Boshnjakët e trevës së autorit sulmohen nga të gjitha anët dhe nga të gjitha armët. Marrë parasysh afërsinë e territorit të Serbisë një pjesë e armëve artilerike e tankeve të forcave serbe godasin edhe nga ana tjetër e Drinës. Kudo nëpër këto zhvillime spikat edhe bota emocionale e autorit, i cili bashkëndjen me vuajtjet dhe pësimet masive të bashkëkombësve, të cilave me vështirësi u bëjnë ballë ushtarët boshnjakë të paarmatosur mirë, të përballur me mungesa të shumta të ushqimeve, veshmbathjes, strehimit etj. Në të gjitha këto zhvillime imam Mevludinin e shohim të jetë përkrah mbrojtësve të fshatrave boshnjake, pa i lënë anash as detyrimet e tij të vazhdueshme si prijës fetar, sikundër edhe interesimin për familjarët e tij. Në të gjitha këto dromca kujtimesh sillen një numër i madh personash me të cilët kishte pasur të bënte gjatë këtyre zhvillimeve dramatike. Veçmas evidenton në këtë kapitull rëniet e luftëtarëve boshnjakë, por edhe pësimet e popullatës vendëse nga veprimet gjakatare të forcave ushtarake serbe. Pas një rezistence të gjatë, si pasojë e raportit të pabarabartë në pajise luftarake dhe gjëra të nevojshme për jetë, rezistenca boshnjake në rrethinat e Kamenicës natyrshëm vjen duke rënë, ndërsa popullsia e saj orientohet drejt Srebrenicës, ku vendosen edhe vetë Mevludini dhe familja e tij.

Jeta dyvjeçare në Srebrenicë, si pjesë e biografisë së përgjithshme të autorit, me të drejtë, nuk ka marrë ndonjë vëmendje të madhe në këtë libër, kryesisht për shkak të rëndësisë së fazës pasuese, përkatësisht të atyre veprimeve, pas rënies së zonës së sigurisë, e që me të drejtë janë karakterizuar si gjenocidiale. Kjo pjesë e librit e përbën boshtin e interesimit të autorit, mbase edhe të lexuesit. Faktografia e përmbledhur në shifra të vrarësh, të dëbuarish, të keqtrajtuarish të ndryshëm, nuk e pre-

zanton të vërtetën e plotë pa e dëgjuar përjetimin, pa e dëgjuar dëshminë autentike të autorit-protagonist në këto të ndodhura, i cili shpalos dimensionin njerëzor e shpirtëror të kësaj tragjedie, të këtij rrugëtimi të cilin nuk e patën fatin që ta përfundonin mijëra boshnjakë, mes tyre edhe tre vëllezërit dhe babai i Mevludinit.

Nga ky libër kuptojmë se rruga për në liri, për secilin banor të asokohshëm të Srebrenicës, kalonte nëpër xhehenemin e kësaj bote. Forcat serbe, pasi e kishin pushtuar Srebrenicën, kishin filluar gjahun për eliminimin e të gjithë meshkujve, pavarësisht nëse ishin pjesë e forcave boshnjake, apo qytetarë të rëndomtë. Faktet dhe kujtesa e autorit thonë se të gjithë ata që përfunduan në duart e serbëve u ekzekutuan. Madje, një pjesë e tyre u mashtrua nga forcat serbe, duke ua premtuar faljen dhe shkëmbimin menjëherë pas dorëzimit. Një pjesë tjetër e burrave boshnjakë ranë në prita të organizuara përgjatë rrugëve të mundshme të tërheqjes drejt territoreve të lira, pastaj u përdorën edhe helme ushtarake me qëllim të çorientimit psikik të të arratisurve, pati boshnjakë që pësuan edhe nga pasojat e urisë, të ftohtit, pasojat e frikës, kushteve çnjerëzore të mbijetesës, por edhe që u vetëvranë për të mos u dorëzuar të gjallë të ndërgjegjshëm se çetnikët nuk respektonin asnjë kod lufte dhe asnjë normë morale në raport me robërit e kapur etj. Situatat që i përshkruan Hrnjiqui, në pjesën dërrmuese të të cilave ishte pjesëmarrës i drejtpërdrejtë, janë të pamagjinueshme. Krime gjithandej, ekzekutime, vrasje në prita, vrasje të çetnikëve të infiltruar në grupet e boshnjakëve të përndjekur, pasiguri totale, frikë dhe uri e tmerrshme, mungesë e gjërave elementare për jetë, tërheqje e vazhdueshme në majat e maleve dhe kodrave përreth, strehim në gërmadha, në rrënoja të djegura, në shpella e nën qiell të hapur etj. Kudo të vrarë të pavarrosur, kudo rrënime, kudo rreziqe dhe granatime nga të gjitha anët. Hrnjiqui dhe një pakicë e atyre që mbijetuan nuk e kishin asnjë mbështetje, përveç besimit dhe mbështetjes në Allahun, dhe këtë ai e thekson disa herë gjatë rrëfimit të tij, sidomos në rastet kur zbulimi nga forcat serbe ishte pothuajse i sigurt, si ndërhyrje hyjnore ndodhte mrekullia. Ndonëse është përballur me të gjitha këto vështirësi, sikundër u tha më lart, të vetmin mbështetës e kishte në besimin e paluhatshëm në Krijuesin, fjalën e Tij, të cilën e kishte shoqëruese të përhershme në këtë

sprovë të vështirë. Kurani ishte shpresa e tij me të cilën ëndërronte lirinë dhe takimin me prindërit e me familjen. Rreziqet me vështirësitë me të cilat përballej nuk kishin ndikuar që të harronte misonin e njeriut në këtë jetë dhe aq më pak raportin e tij me Krijuesin. Ndonëse në rrethana të pamundshme ai si imam i përmbush obligimet fetare të namazit, ruan lidhjen e pashkëputshme dhe e bazon fatin e tij te caktimi i Allahut të cilin e falënderon pafundësisht. Kjo është, do të thosha, formula e shpëtimit të tij.

Marrë parasysh se e vërteta për gjenocidin e Srebrenicës jo një herë u mohua, autori ynë, nëpërmjet këtij libri dhe veprimtarive të tjera, i ka vënë vetes detyrën e rëndë të dokumentimit të saj, duke e kuptuar atë si një amanet për familjarët e të vrarëve dhe si një dëshmi për të vërtetën e plotë, por, sikundër e thotë edhe vetë, Srebrenicën gjithashtu duhet kuptuar edhe si “një paralajmërim për brezat që do të vijnë”.

Mevludin Hrnjiki, me rrëfimin e tij, është shndërruar në zërin e atyre që nuk janë, e ka ndihmuar ndërgjegjen njerëzore që të mos bjerë në lajthitje dhe në mohimin e njërës ndër trajtat më të vrazhda të gjenocidit në kohën e sotme; e ka ndihmuar të vërtetën, e cila do të jetë e rëndësishme për ta kuptuar drejt historinë dhe për ta projektuar ardhmërinë prospektive e paqësore; fundja kjo e vërtetë do të jetë e rëndësishme për secilin boshnjak që do të kujtojë rrugën e përgjakshme të lindjes së shtetit të tyre dhe rrjedhimisht shpresojmë se nuk mund të lejohet asnjë recidiv i këtij akti monstrum. Nga kjo vepër është e pritshme të mësojnë edhe vetë serbët, në emër të të cilëve, e të frymëzuar nga ideologjia hegjemone panserbe, janë bërë shumë krime, madje jo vetëm në Srebrenicë dhe jo vetëm në dekadën e fundit të shek. XX. Kundërshtimi serb i përcaktimit të 11 Korrikut si Ditë e Kujtimit e Gjenocidit nëpërmjet angazhimit të të gjithë mekanizmave institucionalë e diplomatikë është një tregues se shoqëria serbe ende është larg të kuptuarit real të pasojave që mbolli ideologjia hegjemoniste serbe mbi popujt e tjerë të Ballkanit. Përpjekjet për të realizuar dominim me çdo kusht dhe në dëm të hapësirave etnike të të tjerëve u bënë shkak i tragjeditive të mëdha dhe edhe i përplasjeve deri në përmasa globale. Srebrenica ishte finalja e gjakderdhjes që, nga kjo mendësi, u shkaktua edhe në shumë pjesë të tjera të Jugosllavisë federale. Modeli i

shpërbërjes së civilizuar të shtetit federal jugosllav me marrëveshje në disa shtete kombëtare nga kjo ideologji vrastare u provua të zëvendësohej me modelin e zhbërjes së kombeve të tëra, në rend të parë të boshnjakëve dhe të shqiptarëve, me qëllim që të realizohej ideja e një mbikombi në Ballkan.

Ndaj, them se kjo vepër është një testament i hapur, një thirrje për t'u përballur me të vërtetën e hidhur e të dhimbshme, një mësim i madh për njerëzimin që asnjëherë të mos e lejojë më riciklimin e tragjedisë së Srebrenicës, që formatet e gjenocidit të marrin fund një herë e përgjithmonë.

Respekt e vlerësim meritore për autorin Mevludin Hrnjiq, falënderim për botuesin, organizatorët dhe pjesëmarrësit e këtij evenimenti krejt të veçantë dhe sidomos nderim për të gjithë ata që ranë në rrugën e gjatë e të vështirë të kërkimit të lirisë.

Prof. Dr. Sylë UKSHINI*

KUJTESA SI REZISTENCË: RRËFIMI I IMAM HRNJIQIT PËR SREBRENICËN

Mevldin Hrnjiq: Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës-Kronologji e kujtesës. Prishtinë, Botoi “Dituria islame”, 2025.

“Srebrenica është, biro, të shkosh në Potoçari: të heshtësh, të shikosh bardhësinë e nishaneve dhe ta lësh heshtjen që ta shpjegojë leksionin nga historia, për të cilin të gjithë zhurmshëm po flasin.” (Autori)

Srebrenica dhe fundi i pacifizmit evropian

Përfundimi i Luftës së Ftohtë solli shpresën për paqe dhe demokraci në Evropën Lindore, por në Juglindje, në ish-Jugosllavi, nisi një valë e re lufrash të përgjakshme. Kulmi i këtyre konflikteve arriti në korrik 1995 me masakrën e Srebrenicës, ku forcat serbe të Bosnjës, të udhëhequra nga Ratko Mladiq, vranë mbi 8,000 burra dhe djem boshnjakë në një zonë të shpallur “të sigurt” nga OKB-ja.

Ky krim, më i madhi në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore, tronditi opinionin publik ndërkombëtar dhe përfaqësoi një dështim katastrofik të bashkësisë ndërkombëtare dhe të politikës pacifiste të OKB-së. Masakra në këtë qytet të vogël, që deri atëherë ishte thuhetse e panjohur për shumicën e botës, ndryshoi gjithçka në verën e vitit 1995.

* Autori është profesor në Universitetin “Kadri Zeka”- Gjilan.

Siç shkruan diplomati amerikan James Pardew në librin *Paqebërësit: Lidërshipi amerikan dhe fundi i gjenocidit në Ballkan*, dëshmitë tronditëse për ekzekutimet, fushat e vrasjeve dhe varrezat masive shkaktuan një indinjatë të thellë në opinionin ndërkombëtar, duke nxjerrë në pah dështimin e rëndë të OKB-së për të ndaluar këtë mizori ndaj civilëve boshnjakë.

Ndërsa, ish-ministri i Jashtëm gjerman Joschka Fischer rrëfen se kjo ngjarje ndryshoi bindjet e tij pacifiste, duke theksuar nevojën për ndërhyrje ndërkombëtare për të parandaluar krimet kundër njerëzimit. “Lajmi për këtë masakër më tronditi thellë,” shkruan në ditarin e tij ish-ministri Fischer, duke shtuar: “Nuk mund t’i shmangesha më faktit se në Bosnjë – dhe, me këtë, në Evropën e vitit 1995 – po cenohej vetë thelbi i parimeve më elementare të një shoqërie njerëzore.”

Masakra e Srebrenicës nuk ishte një akt i izoluar, por pjesë e një strategjie të menduar mirë nga udhëheqja serbe, për të krijuar një “Serbi të Madhe”, e frymëzuar nga ideologjia e shprehur në Memorandumin famëkeq të Akademisë Serbe të Shkencave, më 1986. Ky dokument, i përpiluar nga figura të larta akademike dhe politike, legjitimonte nacionalizmin serb dhe mohonte shtetësinë e Bosnjës dhe të Kosovës.

Krimi në Srebrenicë u paraqit nga propaganda serbe si një hakmarrje për të kaluarën osmane, duke përdorur narrativën viktimë-kryesore për të justifikuar spastrimin etnik. Kjo ideologji, e shfaqur qysh në fund të viteve ’80 dhe e përkrahur nga partia e Millosheviqit, çoi në luftë në Kroaci, Bosnjë dhe më pas në Kosovë.

Dëshmitë, dokumentet dhe përgjimet e Tribunalit të Hagës zbulojnë një plan të qëllimshëm për ndarjen e Bosnjës dhe zhdukjen e boshnjakëve nga territoret e pretenduara nga serbët. Srebrenica, nga një qytet i panjohur, u bë simbol i dështimit ndërkombëtar dhe i një gjenocidi të dokumentuar, që edhe sot na detyron të reflektojmë mbi rrezikun e nacionalizmit ekstrem dhe përgjegjësinë për të mbrojtur të drejtat themelore të njeriut.

Etja, uria dhe rraskapitja në marshimin drejt shpresës nëpër “rrugën e vdekjes”

“Masat e njerëzve janë në rrugë dhe rrugica. Qarkullojnë informacione se komandanti Rupert Smith ka mbërritur në komandën e UNPROFOR-it, se sulmet dhe përparimet e çetnikëve do të ndalen, se Srebrenica do të mbijetojë. Dikur, rreth mesditës, të gjitha shpresat u shuan, sepse çetnikët nga të gjitha pozicionet përreth qytetit filluan granatimet, të shtënat dhe përparimin e mëtejshëm, derisa më në fund pushtuan enklavën e Srebrenicës”, - shkruan imami Mevludin Hrnjiq në librin e tij rrëfimtari për ditët e tmerrit të 11 korrikut 1995, kur forcat serbe do të kryenin gjenocidin e parë në Evropë pas vitit 1945.

Ishte dita kur dhjetëra mijëra njerëz në Srebrenicë prisnin me ankth ndërhyrjen e NATO-s për të ndaluar avancimin e forcave serbe drejt kësaj qyteze në lindje të Bosnjës. Për këtë arsye, trupat e OKB-së të stacionuara aty ruanin një farë optimizmi. Por avionët e NATO-s nuk u shfaqën kurrë në qiell. Kjo ishte dita, siç thotë Hrnjiq, kur nisi dënimi me vdekje i Srebrenicës. Librat e tillë, si ky i imam Mevludin Hrnjiq, që burojnë nga përvoja personale e mbijetesës në kohë lufte, nuk janë vetëm dëshmi historike; ata janë edhe akt akuze kundër krimeve të heshtura e të mohuara, dhe një përpjekje për të ruajtur kujtesën kolektive nga harresa. Në këtë kategori hyn edhe kronika e imam Mevludin Hrnjiqit, një dëshmi rrëqethëse e përmasave të gjenocidit serb në Srebrenicë, por edhe një reflektim i thellë mbi besimin, qëndresën dhe humanitetin në kohë të errëta.

Ky libër nuk është vetëm një rrëfim i vuajtjes individuale, por një pasqyrë e dhunës sistematike ndaj një populli të tërë – dhunë që ngjason në mënyrë dramatike me atë që kanë përjetuar shqiptarët e Kosovës gjatë viteve 1998-1999. Përmes përshkrimeve të tij autentike, Hrnjiqi na fton të ballafaqohemi me një kapitull të dhimbshëm të historisë së fashizmit ballkanik, i cili, për fat të keq, vazhdon të mbetet si doktrinë e padënuar, madje vazhdon të interpretohet si heroizëm nga projektuesit e këtij krimi të paprecedentë që nga Holokausti.

Rasti i Srebrenicës është i vetmi krim masiv në Evropën e pas Luftës së Dytë Botërore, i cili është cilësuar edhe juridikisht si gjenocid. Megjithatë, Serbia ia doli që në GJND të mos shpallej përgjegjëse për kryerjen

e gjenocidit. Këtë e arriti falë një marrëveshjeje që ish-prokurorja e Tribunalit të Hagës, Carla Del Ponte, bëri me Beogradin në maj 2003, kur, pa miratimin e Tribunalit të Hagës, pranoi kërkesën e Beogradit për të mbrojtur pjesë të dokumenteve të Këshillit Suprem të Mbrojtjes. Kjo bëri që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND), në vendimin e saj të vitit 2007, ndonëse pranoi se në Bosnjë ishte kryer gjenocid, ta përjashtonte Serbinë nga përgjegjësia.

Kësaj radhe kujtimi i Srebrenicës është më i dukshëm, sepse është 30 vjetori i këtij gjenocidi, dhe sot po e promovojmë librin e imamit Mevludin, dëshmitarit të drejtpërdrejtë nga Srebrenica.

Imami boshnjak Mevludin Hrnjiq ka shkruar një kronikë rrëqethëse për periudhën e luftës në Bosnjë e Hercegovinë – një rrëfim autobiografik që dokumenton mbijetesën e tij gjatë gjenocidit serb në Srebrenicë, një nga ngjarjet më të rënda që ka përjetuar Evropa Juglindore pas Holokaustit. E ndërtuar mbi përvojën personale, dëshmia e Hrnjiqit ndjek jetën e tij që nga formimi si imam e deri te përkushtimi i pandërprerë ndaj fesë, humanizmit dhe dinjitetit njerëzor, edhe në kushtet më çnjerëzore.

Narrativa e tij nuk është vetëm një rrëfim personal, por edhe një dëshmi historike që ndriçon natyrën sistematike të dhunës dhe synimin për shfarosje etnike. Shumë nga ngjarjet, toponimet dhe përjetimet që Hrnjiqi përshkruan krijojnë paralele të qarta me realitetin e Kosovës gjatë viteve 1998–1999. Në të dyja rastet, boshnjakët dhe shqiptarët u përballën me të njëjtin agresor shtetëror dhe me një strategji të ngjashme: zhbërjen e pranisë së tyre etnike dhe kulturore nga territoret që regjimi serb synonte t'i aneksonte apo t'i serbizonte.

Ky libër përfshin një mori ngjarjesh që përshkojnë rrugëtimin e imam Mevludinit, i cili, me autenticitet të thellë, na ofron një tablo të egërsisë së formacioneve shtetërore dhe paramilitare serbe, të atyre që kishin për qëllim zhdukjen sistematike të çdo gjëje që ishte *boshnjake dhe myslimane* në territorin e Bosnjës dhe të Hercegovinës.

Veçanërisht prekëse është përshkrimi i periudhës 80-ditore të mbijetesës, gjatë së cilës Hrnjiqi kalon nëpër “rrugën e vdekjes” për të arritur

në territorin e lirë, të kontrolluar nga forcat boshnjake. Ai përjeton të njëjtin fat si mijëra burra dhe djem që u nisën nga Srebrenica përmes maleve dhe pyjeve të Kamenicës e Pobugjës – në një marshim që për shumëkënd përfundoi në varreza masive. Në këtë udhëtim dramatik, dy Kuranë që mbante me vete u bënë dëshmitarët e heshtur të gjenocidit, por edhe të shpëtimit të tij.

Duke lexuar librin e imam Mevludin Hrnjiqit, mendja më shkon te Elie Wiesel – hebreu që mbijetoi Holokaustin dhe autori i veprës tronditëse *Nata* – si dhe te Eliott Behar, ish-prokurori kanadez në Tribunalin e Hagës dhe autor i librit *Tell It to the World*. Të tre, secili në mënyrën e vet, e kanë shndërruar përvojën e dhimbjes dhe përballjes me gjenocidin në një akt kujtese dhe ndërgjegjësimi universal.

Elie Wiesel, shkrimtar dhe laureat i Çmimit Nobel për Paqe, përfaqëson një nga zërat më të fuqishëm të shekullit XX në dëshmimin e tmerrave të Holokaustit. Në një intervistë për *New York Times* më 1997, ai shprehet:

“Unë i nxis çdo të mbijetuar që takoj. Fillimisht, kjo ishte shumë e vështirë për shumë prej tyre, por tani po shkruajnë. Nuk mund ta imagjinojnë sa shumë janë.”

Kjo thirrje, për të mos e lënë heshtjen të mbizotërojë, i jep kuptim edhe dëshmisë së Hrnjiqit – një dëshmi e guximshme që thyen murin e mohimit.

Ngjashmëritë mes Elie Wiesel-it dhe imam Mevludin Hrnjiqit janë të dukshme dhe domethënëse: të dy kanë shkruar dëshmi personale për krime kundër njerëzimit, duke përshkruar humbjen tragjike të familjarëve, tronditjen e besimit dhe përpjekjen për mbijetesë përballë një dhune sistematike. Librat e tyre nuk janë thjesht rrëfime individuale; ata përfaqësojnë akte të fuqishme të kujtesës kolektive dhe të ndërgjegjësimit moral, që synojnë edukimin e brezave të ardhshëm për të mos lejuar kurrë më përsëritjen e mizorive të tilla.

Për më tepër, rrëfimi i imam Mevludin Hrnjiqit është më i drejtpërdrejtë, dokumentues dhe konkret, pa stilizime dhe ekzagjerime - një dëshmi personale e cila nuk ka për qëllim të meditojë mbi të keqen në mënyrë abstrakte, por ta ekspozojë atë përmes fakteve, përjetimeve dhe përshkri-

meve të jetuara. Kjo e bën librin e tij një akt të domosdoshëm jo vetëm për kujtesë, por edhe për drejtësi.

Hrnjiq përshkruan me detaje rrëqethëse ekzekutimin brutal të pjesëtarëve të komunitetit të tij dhe të familjarëve më të afërt, duke shpalosur jo vetëm tragjedinë personale, por edhe dimensionin kolektiv të gjenocidit. Përmes dëshmisë së tij, ai dokumenton mënyrën se si të mbijetuarit përballuan pasojat fizike dhe shpirtërore të kësaj tragjedie, të projektuar dhe zbatuar me qëllim nga elita politike, fetare dhe ushtarake serbe. Rrëfimi i tij është i ndërtuar me një gjuhë të thjeshtë dhe të ndjerë, çka e bën librin më të afërt, më prekës dhe më të qasshëm për lexuesin.

Përtej rrëfimit personal, Hrnjiq thekson rëndësinë e ruajtjes së kujtesës kolektive dhe të domosdoshmërisë për drejtësi. Ai na ndihmon të kuptojmë përmasat e të keqes që mund të shkaktojë urrejtja, intoleranca dhe ideologjitë hegjemoniste, si ajo e ndërtuar rreth mitit të “Serbisë së Madhe”. Ky libër, pra, nuk është vetëm një dëshmi e mbijetesës, por edhe një akt moral kundër harresës dhe mohimit.

Në këtë kontekst, kujtohet mendimi i Elie Wiesel-it, i cili e konsideronte harresën si një formë të dytë të vdekjes për viktimat. Për të, kujtesa ishte një akt drejtësie dhe nderimi: *“Harresa është forma më e thellë e mohimit.”* Nëse bota harron, nëse shoqëritë mbyllin sytë para së kaluarës, atëherë vuajtjet e miliona njerëzve do të kenë qenë të kota. Pikërisht për këtë arsye, dëshmia e Hrnjiqit është një kontribut i çmuar jo vetëm në dokumentimin e gjenocidit, por edhe në ndërtimin e një kulture të përgjegjësisë dhe reflektimit.

Kjo maksimë kundër harresës gjen shprehjen e saj më të fortë në veprën e imam Mevludin Hrnjiqit, i cili që në faqet e para të librit shkruan:

“I bllokuar nga një e kaluar e dhimbshme, përballë një të tashmeje të vrazhdë dhe në pritje të një të ardhmeje të pasigurt, gjeta forcën dhe vullnetin për ta shkruar rrëfimin tim të jetës.”

Rrëfimi i tij jetësor është i ndarë në tri pjesë kryesore:

1. Periudha e paraluftës, ku pasqyrohet fëmijëria dhe rinia;
2. Periudha e luftës, që përqendrohet në jetën në Srebrenicë dhe në udhëtimin dramatik për t'i shpëtuar gjenocidit;
3. Periudha e pasluftës, e cila shënon jetesën në Sniježnica, vendli-
ndja e tij e dytë dhe njëkohësisht simbol i mbijetesës dhe i rigja-
llërimit.

Veprat e këtij lloji, si kjo e imam Mevludinit, janë thelbësore për disa arsye kryesore:

- Ato sjellin një perspektivë njerëzore dhe të sinqertë mbi ngjarjet historike;
- Ndihmojnë në ruajtjen e kujtesës kolektive për viktimat e gjenocidit;
- Edukojnë brezat e ardhshëm mbi pasojat shkatërruese të urrejtjes, dhunës dhe ideologjive etnonacionaliste.

Sigurisht, në disa pjesë rrëfimi i imam Mevludin Hrnjiqit është emocionalisht i rëndë dhe i vështirë për t'u lexuar, por kjo është pjesë e natyrshme e dëshmisë për një tragjedi me përmasa kaq të mëdha. Srebrenica është më shumë se një vend për të – ajo është fati i tij, makthi dhe trauma që e shoqëron gjithmonë. Është klithma e jetës së tij, por edhe gëzimi i papërshkrueshëm i lirisë, i mbijetesës dhe i takimit me të dashurit.

Një pyetje që ai i bën shpesh vetes është: *“Si mbijetova gjithë këtë? Si ia dola?”* Forca që e mbajti gjallë në këto momente ekstreme ishte besimi i patundur në Zot, dëshira për të jetuar, frika nga vdekja dhe intuita për të mos i besuar premtimeve të armiqve. Edhe kur shpresa për mbijetesë dukej e shuar plotësisht – sidomos pasi mësoi për ekzekutimin e babait dhe tre vëllezërve të tij nga forcat serbe – Hrnjiqi nuk e humbi as arsyen, as ndjenjën e humanizmit.

Kjo qëndrueshmëri morale, përballë dhimbjes së jashtëzakonshme, e dallon thellësisht nga një pjesë e madhe e klerikëve ortodoksë serbë, të cilët jo vetëm që nuk e kundërshtuan spastrimin etnik dhe gjenocidin në Bosnjë dhe Kosovë, por shpesh u vunë në ballë të justifikimit, nxitjes dhe

legjitimitit të këtyre krimeve kundër njerëzimit. Madje humbi kriterin moral të vlerësimit të krimit bashkë me ndjenjën e viktimës. Nga kjo është e njohur thënia e kryepriut Milan Gjuriq, njërit prej themeluesve të Partisë Radikale Serbe: “Shteti serb është gjithkund ku janë varrezat serbe.” Pra, kulti i viktimës u bë pjesë e pandashme e mentalitetit serb dhe zuri vendin kyç në psiken kombëtare serbe, prandaj, siç thoshte historia-nia Latinka Perović, “ne serbët mbyllim sytë para krimeve që i kemi bërë, siç është krimi i Srebrenicës.” Sipas kësaj mendësie, në Serbi ende nuk pranohen krimet serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, pra krimet mbi boshnjakët dhe shqiptarët gjatë luftës së viteve të fundit të nëntëdhjetave.

Siç pohon edhe Millorad Tomaniq, në librin *Kisha Serbe në Luftë*, një nga mbështetjet më të mëdha për regjimin e Slobodan Millosheviqit erdhi pikërisht nga kleri i Kishës Ortodokse Serbe. Madje edhe, sot elita politike dhe kleri i Kishës Ortodokse Serbe, pra edhe më tej, e akuzojnë Slobodan Millosheviqin jo për faktin se i nisi luftërat në Bosnjë, Kroaci dhe në Kosovë, por sepse i humbi ato.

Prandaj, studiuesja holandeze Nevenka Tromp ka të drejtë kur pohon se, edhe pse Millosheviqi “zbriti nga treni”, domethënë se projekti i “Serbisë së Madhe” nuk është ndalur. Në vend të retorikës së hapur për zgjerim territorial, elitat politike sot flasin për “rregullim kufijsh”. Kjo përbën një formë të re të njëjtë qëllim. Ky fakt dëshmon se ajo që ndodhi tri dekada më parë mund të përsëritet sërish.

Prandaj, në këtë 30-vjetor të masakrës së Srebrenicës, libra si ai i imam Mevludin Hrnjiqit janë të domosdoshëm dhe shërbejnë si manuale të kujtesës kolektive për të parandaluar përsëritjen e një të keqeje të tillë, të paprecedentë në Evropë që nga koha e nazizmit të Adolf Hitlerit.

Në librin e tij, imam Mevludin Hrnjiq përshkruan me detaje rrënqethëse mënyrën se si njësitë paraushtarake serbe, si “Tigrat e Arkanit”, përhapnin terror të organizuar për të detyruar myslimanët të braktisnin shtëpitë dhe tokat e tyre. Ky terror nuk ishte thjesht spontan, por pjesë e një strategjie të mirëkoordinuar, e cila gëzonte mbështetjen dhe pjesëmarrjen aktive të Ushtrisë Popullore të Jugosllavisë (JNA) në operacionet e spastrimit etnik.

Një nga episodet më të forta që autori sjell është momenti kur, gjatë kthimit nga një vizitë te një xhematli në Karakaj, ai përballet me kërcënime me thikë nga ushtarë serbë, të cilët i bënin gjeste prerjeje të fytit - një shenjë simbolike dhe tronditëse e dhunës së paralajmëruar. Ky rast nuk përbën një incident të izoluar, por përfaqëson thelbin e bashkëpunimit kriminal mes institucioneve ushtarake shtetërore dhe grupeve paramilitare – një bashkëpunim që bëri të mundur realizimin e gjenocidit në terren.

Një nga momentet që paralajmëroi hapjen e luftës ishte 6 prilli, kur në qytetin e Zvornikut ndodhën ngjarje të trishta dhe shqetësuese: serbët lokalë vendosën barrikada në Fushën e Vidakovës dhe në Meterizëm. Ky ishte i ashtuquajti “revolucion i drunjte” – një strategji e njohur tashmë nga konteksti i Kosovës, ku grupe serbe lokale, të përkrahura nga Beogradi, inskenonin bllokada për të krijuar kaos institucional dhe për të luajtur rolin e viktimës. Kjo skemë propagandistike shpesh paraprinte sulmet e organizuara.

Edhe pse njeri i fesë, ai i beson luftës së armatosur dhe gjithnjë e përmend me respekt rezistencën e luftëtarëve boshnjakë myslimanë. Ai pranon se boshnjakët ishin të dobët në aspektin e armatimit, por thotë: “Ne jemi gati të luftojmë dhe të përballemi me armikun.”.

Pas rënies së Kamenicës, imam Mevludini, së bashku me familjen dhe banorët e tjerë, arrin në Srebrenicë, e cila në atë kohë do të shpallej zonë e mbrojtur e OKB-së.

Pasi qyteti u shpall zonë e mbrojtur, filloi demilitarizimi i forcave boshnjake myslimane, ndërsa jashtë tij u vendosën pika vëzhgimi të OKB-së. Megjithatë, sipas autorit, situata vetëm përkeqësohej – ndihmat humanitare shpesh pengoheshin nga çetnikët serbë, ndërsa brenda qytetit mbizotëronte frika dhe pasiguria, sidomos kur disa komandantë të njërive boshnjake, përfshirë legjendarin Naser Oriq, u larguan nga Srebrenica. Për këtë të fundit, Mevludin shpreh konsideratë dhe respekt të thellë.

Në fillim të korrikut, njësitë çetnike serbe filluan rrethimin e qytetit – një sinjal i qartë për katastrofën që po afrohej. Komandanti Rupert Smith dhe trupat e UNPROFOR-it, megjithëse të pranishëm, nuk ndërморën asnjë veprim për të ndaluar sulmet, duke lënë qytetarët në një gjendje të pa-fuqishme. Shpresa e tyre po shuhej dita-ditës.

Në ditarin e tij, imam Mevludini përshkruan momentet më të dhimbshme të ballafaqimit të popullatës civile me agresorin. Ai kujton me dhimbje fjalët e babait të tij, i cili, në një përpjekje për të mbrojtur familjen, i përgatiti një çantë shpine me pak bukë, disa konserva, lëng pluhuri dhe disa fletë duhani, duke i thënë: *“Hajde, fëmijë, shpëtoni veten, me mua le të bëhet si të bëhet.”*

Kjo ishte hera e fundit që Mevludini pa babanë e tij - një kujtim i përjetshëm i tragjedisë personale dhe kolektive që po ndodhte.

Ishte 11 korriku – dita kur nisi dënimi me vdekje i Srebrenicës. Imam Mevludini, pasi takohet për herë të fundit me nënën e tij, nis rrugëtimin me kolonën e luftëtarëve si pjesëtar i çetës së katërt të Brigadës 284. *“Në kodrën mbi fshatin Joshgeve po pushojmë, kthehem dhe shikoj Srebrenicën. Sytë më mbushen me lot – nga trishtimi dhe pafuqia, duke parë se çfarë po ndodhte me ne”,* - shkruan ai.

Kështu nis udhëtimi i tij tetëdhjetëditor drejt Kalesijës, përmes pyjeve, kodrave, rrugicave dhe linjave çetnike - një rrugë e mbushur me frikë, vuajtje dhe përpjekje për mbijetesë. Përmes rrëfimit të tij, lexuesi përjeton makthin dhe torturën që shoqëroi çdo hap të këtij marshimi, me plot episode të frikshme dhe dramatike.

Në një nga episodet më të dhimbshme, imam Mevludini përshkruan përdorimin e armëve kimike nga çetnikët, të cilët helmuan edhe burimet e ujit për të goditur kolonat e civilëve.

“Efekti i helmeve të betejës, halucinacionet, mungesa e gjumit, rrasëkapitja, uria dhe paniku lanë gjurmë të thella. Shumë u dorëzuan. Disa me shpresën e kotë se do të liroheshin apo shkëmbeheshin, të tjerë, në dëshpërim, bënë vetëvrasje. Të plagosurit bënë të njëjtën gjë, sepse askush nuk mund t'i ndihmonte.”

Një nga përjetimet më prekëse është takimi me nënën pas shpëtimit: *“Ishte një përjetim për të cilin kisha ëndërruar gjatë gjithë kohës. Pas takimit me nënën time, ndjeva një forcë të madhe dhe qetësi. Ajo gjithmonë më ka dhënë vetëbesim të ri.”* Ndërsa, për babanë dhe vëllezërit e vrarë ai thotë: *“Shpesh i takoj vetëm në ëndërr, sikur të ishin gjallë. Dhe kjo bëhet gjithnjë e më e rëndë çdo vit që kalon.”*

Ky fragment përfaqëson një moment të thellë emocional dhe narrativ në rrëfimin autobiografik të imam Mevludin Hrnjiqit, duke nxjerrë në pah dimensionin personal dhe kolektiv të traumës pas gjenocidit në Srebrenicë. *“Shtëpia ishte shkatërruar dhe djegur. U ula në prag dhe qava nga thellësia e shpirtit”*, - shkruan imam Mevludini. Kthimi në vendlindje pas dy vjetësh e gjysmë, përballja me shkatërrimin fizik të shtëpisë dhe shpërrthimi i dhimbjes përmes lotëve artikulojnë në mënyrë prekëse përmasat e humbjes dhe zhveshjen e të mbijetuarit nga çdo përkufizim i normalitetit.

Episodi me bashkëkombësin Rexho, i cili i dorëzon rrëfyesit të brendshmet e një foshnjeje si amanet për bashkëshorten e tij, bart një ngarkesë simbolike të jashtëzakonshme: është dëshmia e fundit e jetës dhe dashurisë brenda një konteksti të shfarosjes sistematike. Ky gjest i thjeshtë, por thellësisht human, shndërrohet në një thirrje etike për ruajtjen e kujtesës, përballjen me dhimbjen dhe mbajtjen e nderit të viktimave përmes aktit të dëshmisë.

Për imam Mevludin Hrnjiqin, dokumentimi i tragjedisë boshnjake dhe, veçanërisht, i gjenocidit në Srebrenicë nuk është thjesht një kujtim personal, por një thirrje universale për të mos harruar dhe për të mos falur krimet që ndodhën në atë qytet. Ashtu si për autorin ishte detyrim moral dhe historik të dokumentojë gjenocidin, për ne të gjithë është përgjegjësi e përbashkët të ruajmë kujtesën për këtë ngjarje që ndryshoi rrjedhën e historisë së Ballkanit dhe që shërbeu si paralajmërim për botën, në mënyrë që në Kosovë të mos ndodhte një “Bosnjë e dytë”. Përvoja tragjike e gjenocidit në Srebrenicë, në korrik të vitit 1995, shërbeu si një pikë ktheje në ndërgjegjësimin e elitave politike perëndimore për nevojën e ndërhyrjes së hershme dhe vendimtare në rastet e krizave humanitare dhe të dhunës masive. Kjo traumë kolektive ndikoi në formësimin e gatishmërisë për të vepruar me më shumë vendosmëri në rastin e Kosovës katër vite më vonë, përmes një ndërhyrjeje ushtarake që synonte ndalimin e spastrimit etnik dhe ndëshkimin e makinerisë shtetërore serbe të dhunës.

Megjithatë, edhe sot, në qarqet e majta radikale në Perëndim dëgjo-hen zëra kritikë ndaj kësaj ndërhyrjeje, të cilët, të udhëhequr nga bindje të thella antiamerikane dhe nga një diskurs i ashtuquajtur “anti-imperia-

list”, e konsiderojnë ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë si të paligjshme, për shkak të mungesës së një autorizimi eksplisit nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, veçanërisht për shkak të kundërshtimit rus. Këto qëndrime shpesh shoqërohen me minimizim apo mohueshmëri të krimeve të kryera nga forcat serbe ndaj popullatës shqiptare të Kosovës.

Për më tepër, disa nga këto zëra jo vetëm kundërshtojnë legjitimitetin e ndërhyrjes dhe pavarësinë e Kosovës, por shkojnë deri në mohimin e ngjarjeve të dokumentuara si masakra e Reçakut dhe shumë mizori të tjera, duke i paraqitur ato si konstruksione propagandistike apo shpifje të qëllimshme. Një qëndrim i tillë, përveçse bie ndesh me të dhënat e Tribunalit të Hagës dhe raportet e organizatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, rrezikon të legjitimojë qasjet revizioniste dhe të dëmtojë përpjekjet për drejtësi dhe pajtim në rajon.

Në këtë kontekst, miratimi i Rezolutës për Srebrenicën nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2024, e cila e shpall 11 korrikun si “Ditën Ndërkombëtare të Reflektimit dhe Përkujtimit të Gjenocidit të vitit 1995 në Srebrenicë”, përfaqëson një akt të rëndësishëm të njohjes ndërkombëtare të së vërtetës historike dhe një hap domethënës drejt drejtësisë tranzicionale. Kjo rezolutë jo vetëm konsolidon narrativën e bazuar në fakte për krimet e kryera, por gjithashtu hap një shteg të ri për reflektim kritik dhe ballafaqim të shoqërive me të kaluarën e tyre të dhunshme.

Në këtë linjë, edhe Kosova, një vend që vetë ka qenë viktimë e spastrimit etnik dhe dhunës shtetërore të drejtuar nga e njëjta ideologji nacionaliste serbe, ka përgjegjësinë morale dhe historike të përkujtojë këtë ditë me dinjitet dhe me simbole të qëndrueshme. Një akt i tillë mund të jetë vendosja e një memoriali përkujtimor që mban numrin 8,372, që përfaqëson numrin e boshnjakëve të vrarë në Srebrenicë, si një kujtesë publike e përhershme për gjeneratat e reja dhe një deklaratë e qartë e solidaritetit me viktimat e gjenocidit.

Përfundim:

Libri *Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës* i imam Mevludin Hrnjiqit përfaqëson një dëshmi të rrallë dhe të pazëvendësueshme për një nga krimet më të rënda kundër njerëzimit që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. I shkruar nga perspektiva e një dëshmitari të drejtpërdrejtë, ky tekst kapërcen kufijtë e rrëfimit personal për t'u shndërruar në një dokument të rëndësishëm historik dhe moral, i cili ndriçon përmasat e dhunës sistematike dhe të urrejtjes etnike të ushqyer nga ideologjia e Serbisë së Madhe.

Kjo ideologji, me rrënjë të thella në Memorandumin famëkeq të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (1986), i cili është i krahasueshëm me platformën e Klubit Kulturor Serb të vitit 1939, vazhdon të ndikojë diskursin politik dhe shoqëror serb, përkundër faktit se asnjëherë nuk është dënuar seriozisht nga vetë Serbia apo nga komuniteti ndërkombëtar. Siç ka vërejtur me të drejtë shkrimtari Ismail Kadare, “Bombat e NATO-s ndëshkuan Serbinë më 1999, por jo doktrinën serbomadhe.”

Në këtë kontekst, libri i Hrnjiqit nuk është vetëm një akt kujtese, por edhe një thirrje e fuqishme për drejtësi, përgjegjësi dhe reflektim historik. Ai sfidon amnezitë kolektive dhe mohimet e qëllimshme, duke riafirmuar domosdoshmërinë për një ballafaqim të ndershëm me të kaluarën si parakusht për ndërtimin e paqes së qëndrueshme në Ballkan.

Me një ndershmëri të thellë, një sens të fortë etiko-historik dhe një guxim të veçantë moral, imam Mevludin Hrnjiqi i jep zë një prej tragjeditë më të mëdha të kohës sonë. Ky zë duhet jo vetëm të dëgjohet, por të ruhet, të studiohet dhe të përcillet brez pas brezi, si pjesë përbërëse e kujtesës sonë kolektive dhe si garanci për mosripërsëritjen e së keqes.

Durim ABDULLAHU¹

SREBRENICA KA NDODHUR, PRANDAJ MUND TË NDODHË SËRISH!

Në prill të vitit 1986, plot 41 vjet pasi kishte dalë i gjallë nga kampi i Aushvicit, kimisti italian me origjinë hebreje Primo Levi, e botoi librin e tij të fundit “Të mbyturit dhe të shpëtuarit”. Mes reflektimeve nga përvoja e tij në lagerët nazistë, në përfundim, te faqet përmbyllëse të këtij libri të mbramë të tij, Levi shkruan: “Ka ndodhur, prandaj mund të ndodhë sërish; ky është thelbi i gjithë asaj që duhet thënë. Mund të ndodhë, dhe kudo”.

Primo Levi po i shkruante këto fjalë pas katër dekadash dëshmi dhe përballje me trashëgiminë e Holokaustit, reflektime dhe kujtime të shkruara veçanërisht te librat e tij “A është vallë njëri?” dhe “Armëpushimi”. Tek i pari, ai e kishte shpjeguar përvojën e tij njëmbëdhjetë mujore në kampin e Aushvicit në Poloni, më të njohurin e kampeve naziste të përqendrimit dhe të punës, ku ai e përjetoi edhe çlirimin e kampit nga trupat ruse, më 27 janar 1945. Ndërkaq, te romani tjetër, “Armëpushimi”, Levi e rrëfen udhëtimin e tij të gjatë rreth dy vjet derisa u kthye nga Polonia në Itali.

Nëse Primo Levi nuk do të ishte vetëvrarë më 11 prill 1987, një vit pasi paralajmëroi që “mund të ndodhë, dhe kudo”, si dhe nëse do të jetonte të paktën edhe tetë vjet, deri më 1995, ai do të ishte bërë dëshmitar i gjenocidit në Srebrenicë, gjenocidit të dytë në Evropë pas Holokaustit. Në mes të korrikut 1995, forcat serbe të komanduara ushtarakisht nga

¹ Autori është historian, ligjërues në Universitetin e Prishtinës.

Ratko Mladiq dhe politikisht nga Radovan Karagjiq, me urdhra dhe mbështetje prej Beogradit të Slllobodan Millosheviqit, i vranë të paktën 8372 boshnjakë në Srebrenicë. E tëra kjo ndodhi në praninë e trupave paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, misioni i të cilëve doli të ishte një dështim spektakolar për parandalimin e masakrës së kryer nga serbët në Srebrenicë.

Pas vetëm pesë dekada thirrjesh të përsëritura “Kurrë më”, shprehjes së artikuluar nga të mbijetuarit e Getos së Vrashavës, Evropa dhe bota pa të përsëritej një gjenocid, i pari pas shfarosjeve masive të Luftës së Dytë Botërore. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, serbët lokalë dhe shteti i Serbisë, kryen gjenocid para syve të forcave ndërkombëtare, teksa refugjatët boshnjakë të izoluar në kampe po prisnin mes lutjesh për bombardime nga NATO-ja. Ndërkohë, një tjetër gjenocid do ta pasonte atë të Srebrenicës, vetëm pesë vite më vonë, më 1999, kur ushtria dhe policia e Serbisë kryen qindra masakra të orkestruara në përpjekjen e tyre për ta spastruar etnikisht Kosovën nga shqiptarët vendas, përmes një mori operacionesh gjenocidale që kishin nisur të zbatoheshin rreth 10 vite më herët. Një fushatë bombardimesh mbi Jugosllavi nga trupat e vendeve të NATO-s që zgjati 78 ditë, e ndërprente gjenocidin dhe spastrimin etnik të plotë të Kosovës, duke sjellë çlirimin e saj nga Serbia në qershor të vitit 1999. Ajo që kishte ndodhur në Bosnje – Srebrenica – nuk mund të lejohej në Kosovë; por ajo që nuk kishte ndodhur në Bosnje – ndërhyrja ushtarake e NATO-s në shkallë të gjerë – u aplikua në Kosovë.

Lufta në Bosnjë dhe veçanërisht gjenocidi në Srebrenicë, e rikthyen peshën morale të mosveprimit ndaj gjenocidit në politikën evropiane dhe amerikane. Mësimet e nxjerra nga Lufta e Dytë Botërore dhe të mësuara sërishmi nga gjenocidi në Srebrenicë, sollën fushatën e bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi në pranverën e vitit 1999, me qëllim të ndaljes së gjenocidit që Serbia po kryente mbi shqiptarët në Kosovë. Ishte pikërisht rreziku i gjenocidit në Kosovë, ai që e shtyri një të mbijetuar tjetër hebre nga Aushvici, Eli Wiesel, që duke e justifikuar fushatën e NATO-s mbi Jugosllavi, të tërhiqte vëmendjen për rreziqet e indiferencës, si rreziqe të ardhura nga mosveprimi kundër padrejtësisë dhe vuajtjeve njerëzore.

Këto ditë që janë bërë 30 vite nga gjenocidi në Srebrenicë, në Prishtinë u publikua në libri “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”, i shkruar nga Mevludin Hrnjiq, një boshnjak i mbijetuar i Srebrenicës. Duke qenë imam, lidhje e autorit të këtij libri me Kosovën, është ndërmjetësuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, e rrjedhimisht, libri i tij është botuar nga shtëpia botuese Dituria Islame, nën kujdesin e Myftiut Naim Tërnavë. I përkthyer në shqip nga Amir Jusufi dhe i redaktuar nga Ramadan Shkodra, dëshmia e shkruar e Imam Mevludin Hrnjiqit, ka një vëllim prej 246 faqesh të shtrira në pesë kapituj: Ajo që parapriu; Në luftë në territorin tonë; Srebrenica – strehim dhe destinacion përfundimtar; Ditët e lirisë; Kur e kujtoj Srebrenicën.

Në kapitullin e parë, Hrnjiq e ka rrëfyer fëmijërinë e tij, shkollimin dhe jetën derisa është maturuar për t’u thirru në shërbim ushtarak. Tek i dyti, ai përshkruan rrethanat dhe zhvillimet që çuan deri te lufta e Bosnjës, por duke mos e kaluar kontekstin e regjionit ku ai jetonte. Kapitulli i tretë është pjesa qendrore e librit, ku Imam Mevludini tregon luftimet mes çetnikëve serbë dhe luftëtarëve boshnjakë, mes të cilëve ishte mobilizuar edhe ai. Duke e ndjekur kronologjinë e ngjarjeve, në mbi 100 faqet e këtij kapitulli, Mevludin Hrnjiq i ka gjuhësuar dhe tekstualizuar kujtimet e tij nga ngjarjet që kulmuan me gjenocidin në Srebrenicë, plot 27 vite më pas, meqë libri në boshnjakisht është botuar së pari më 2022, në Tuzëll. Te kapitulli i katërt i librit të tij prej dëshmitari, Hrnjiq rrëfëhet se si filloi ta rindëronte jetën pas luftës dhe se si besimi i tij si mysliman ishte boshti rreth të cilit e ringriti jetën prej të mbijetuari. Në fund, tek i pesti kapitull, ai reflekton mbi përjetimet e tij nga koha e luftës, duke iu rikthyer kujtimeve për Srebrenicën, mes pyetjesh që ai ia parashtron vetes për këtë fat të tij.

Mevludin Hrnjiq është dëshmitari i përkryer i një prej ngjarjeve më të trishtueshme në historinë moderne të Evropës. Me rastin e promovimit të librit të tij në Fakultetin e Studimeve Islame, ai ishte në Kosovë, i ftuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, por më parë, Mevludin Hrnjiq i kishte refuzuar dy ftesa të tjera për të ardhur në Kosovë.

Më 16 qershor 1991, Mevludin Hrnjiq ishte ftuar që të paraqitej në Prishtinë, në kazermën ushtarake “Mareshal Tito” për të kryer shërbimin

obligativ ushtarak në Armatën Popullore të Jugosllavisë. Atë kohë, ai besoi se ia hodhi kësaj ftese të paktën për një vit, pasi arriti ta korruptonte një zyrtar për ta shtyrë këtë ftesë, por pak muaj më pas, Mevludin Hrnjiqit iu përsërit ftesa, me kërkesën që më 19 shtator 1991, të paraqitej në kazermën “Karaulla” në Gjakovë. Ai refuzoi të shkonte sërish dhe u bind se kishte vepruar drejt kur pikërisht ato ditë, një shok i shkollës dhe fqinj i tij, Avdo Memiq, u kthye nga ushtria dhe i tregoi Mevludinit se si mezi ishte arratisur nga kazerma “Lora” në Split.

Por çfarë kishte ndodhur aty? Në fund të shtatorit 1991, forcat ushtarake kroate e kishin sulmuar kazermën “Lora” në Split, por ushtarët rekrutë jugosllavë kishin rezistuar me sukses. Duke dashur t’i përgëzonte ata ushtarë për rezistencën që kishin bërë ndaj kroatëve, atje shkoi një kolonel 49 vjeçar, Ratko Mlladiq. Kur u afrua t’i falënderonte për dore ushtarët e rreshtuar në radhë, Ratko Mlladiq u xhindos dhe u nervozua kur rekrutët e parë iu prezantuan me emrat dhe origjinën e tyre: ata ishin shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia. Përse nuk më keni treguar që keni kaq shumë bërlllok në këtë kazermë? – i ishte drejtuar Mlladiqi komandantit të kazermës, duke i lënë në gjysmë mes kërcënimesh falënderimet e tij.

Ky ushtarak, i cili dikur kishte shërbyer edhe në kazermën “Mareshal Tito” të Prishtinës, pasi do të gradohej gjeneral, do t’u printe forcave serbe në ekzekutimet masive gjatë gjenocidit në Srebrenicë. Dhe aty, mes atyre që luftuan e rezistuan dhe që patën fatin të shpëtonin të gjallë, ishte edhe një klerik i ri mysliman: 25 vjeçari Imam Mevludin Hrnjiq. Me dy kopje të Kuranit me vete, njëri në arabisht dhe tjetri në boshnjakisht, ai arriti t’u shpëtonte jo vetëm plumbave të ushtarëve të Mlladiqit, por arriti që ta shpëtonte edhe besimin e tij në Zotin, si një besimtar dhe klerik i bindur, përkundër përjetimeve të tmerrshme dhe situatave ekstreme nëpër të cilat kaloi.

Në librin e tij “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”, Mevludin Hrnjiq, sipas një tradite letrare të kategorizueshme mes veprave të Primo Levit, rrëfen gjithë udhëtimin e tij jetësor, nga fëmijëria dhe shkollimi te shërbimet e para si klerik; pastaj nga fillimi i luftës në Bosnjë deri te mesi i korrikut të vitit 1995, kur mes 8372 boshnjakëve të vrarë, ishin edhe

babai i tij Mehmedi dhe tre vëllezërit Ademi, Salko dhe Ibrahim. Ky libër, rrëfen për një udhëtim që si nëpër tehun e thikës kalon duke u anuar herë kah vdekja, dhe herë kah jeta.

Botimi i librit “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës”, mund të jetë një lidhje e mirë tekstuale e publikut lexues shqiptar, për ta kuptuar më qartë se lufta në Kosovë nuk ishte thjesht një luftë më vete dhe e izoluar në kuadrat e vjetër të konflikteve mes shqiptarëve dhe serbëve, por se lufta në Kosovë e viteve 1997 – 1999, ishte kapitulli i mbramë i luftërave të shkaktuara nga Serbia në Jugosllavi.

“Ka ndodhur, prandaj mund të ndodhë sërish; ky është thelbi i gjithë asaj që duhet thënë. Mund të ndodhë, dhe kudo” – kishte shkruar Levi. Pikërisht për këtë mësim historie, libri i “Dëshmitar i gjenocidit të Srebrenicës” i autorit boshnjak Mevludin Hrnjiq, duhet lexuar me gjithë sfo-ndin historik të ngjarjeve të kohës. Sepse dëshmitarët e mbijetuar të gjenocidit, janë të mbijetuar të vetë njerëzimit, për sa kohë që gjenocidet, si përpjekje për shkatërrimin e komuniteteve të veçanta njerëzore, janë goditje në vetë njerëzimin. Duke besuar te humanizmi, si shpresë te njeriu që angazhohet ta ruajë njeriun si njeri!

V. REFLEKSIONE

Muharrem B. GASHI

KËNGË POPULLORE ME ELEMENTE FETARE

Kënga popullore me elemente dhe rite fetare, si namazi, agjërimi, haxhi, Ramazani, Bajrami, zekati etj., thuajse lindi së bashku me popullin. Kënga është thesar shumë i çmuar i jetës shpirtërore të popullit. Prodhimi poetik i popullit është arkiv, visar i dijes së tij, i fakteve historike dhe i shprehjes së zemrës së tij. Është pasqyrë e shpirtit të tij në gëzime e pikëllime. Populli, shekuj me radhë, jetoi me këngën e vet. Me të mbijetoi e lulëzoi, duke dhënë krijime më të begatshme artistike.

Balada popullore shqiptare ka shtrirje të gjerë gjithëkombëtare dhe ka origjinë të lashtë. Ajo reflekton etapa të ndryshme të zhvillimit historik e shoqëror dhe përmban gërshetime kulturore në suaza ballkanike e më gjerë. Kultura dhe arti popullor shqiptar, që nga lashtësia, janë prekur nga ndikimet e rrymave të ndryshme, të Lindjes dhe të Perëndimit.

Balada ka pasur pikësynim të depërtojë në psikologjinë e individit, ta provojë qëndrimin e tij në çastet dhe vizionet dramatike e tragjike të jetës. Në thelbin e kuptimit filozofik të baladës, pothuajse vazhdimisht, është e pranishme jeta dhe vdekja, si probleme të mëdha ekzistenciale, morale e sociale të individit. Realizimi artistik i baladës bëhet në pranimin e konfliktit të shkallëzuar: synim – ndalesë – përfundim tragjik.

Këngët kreshnike shqiptare përmbajnë në vete një varg elementesh origjinale shqiptare, të cilat elemente ndikuan në ekzistimin e gjatë dhe në kultivimin e tyre, të kodifikuara në bazë të parimeve, si respekti ndaj prindërve, fëmijëve, vëllezërve, motrave dhe më të vjetërve, dajave e nipave, miqve e dashamirëve. Karakteristikë të kënga kreshnike është se për çdo herë kënga fillon me hyrje: “*Ou lum për Ty për të lumin Zot, shy-*

qyr, jemi shiptar mysliman, hak pe dimë Zotin taman, s' jemi kanë po Zoti na ka dhanë, pa nafakë ishalla s'na ka lanë".etj.

Këngët popullore historike janë historia e popullit shqiptar. Feja është elementi kryesor për të frymëzuar, për të trimëruar, për të mobilizuar, si dhe për ta ngritur popullin në luftë kundër armikut.

Shembujt tregojnë se si Mehmet Ali Pashë Kavalla, prijës i Egjiptit, më 13 maj të vitit 1805, nga autoritetet turke shikohej me rezervë, vetëm pse ishte me origjinë shqiptare. Pikërisht për këtë Kapedan Pasha përgatiti një ushtri të përbërë prej 2500 vetave, për ta rrëzuar Mehmet Ali Pashën nga posti i prijësit të Egjiptit. Megjithatë, më 17 korrik 1805, kur konfrontohen dy ushtritë, turqit për rrëzimin e Mehmet Aliut dhe shqiptarët në mbrojtje të tij, kënga na tregon se si ndodhi ngjarja:

*...disa toskë, e disa gegë,
shkuen u myllen n'at Bullak,
kush të don me iman me dekë,
do t'lufton me turko-shak.*

Po, njashtu edhe lufta turko-greke, e vitit 1821, kur sulltani e ftoi Mehmet Aliun që ta ndihmojë në shtypjen e revoltës greke në More dhe Kretë të Greqisë, Mehmet Aliu e dërgoi të birin Ibrahim Pashën, i cili i priu një ushtrie prej 17 mijë vetave, duke e shpartalluar rezistencën greke. Për këtë ngjarje rrëfen kjo këngë:

*Zot çka doket, deti e fusha zi,
Tek po vinë shumë asçer xhynli.¹
Shumë asçer, xhynli janë ty'ardhë
Me kallqina², me kapuçë t'bardhë
U dalin para ketër pashallarë
Shyqyr Zotit, nau nisë luftë e marë.
Luftë e martë, na u ka nisë shydet,*

¹ Xhynli, (tur.) vullnetar, me vetë dëshirë.

² Kallqin-i, na, veshje prej zhguni, për burra, prej zogu të këmbës e deri mbi gjunj.

*Gja n'dynjatë, shiptarin s'e pret,
 Dur Junan,³ shiptari po i thet,
 Dur Junan, o, i biri i Junanit,
 Ky do t'jen taborri i Gilanit.
 Nal Junan, o, i biri i kralicës,
 Ky do t'jen taborri i Senicës.
 Nal Junan, o i biri i shkinës,
 Birinxhi taborri i Prishtinës.
 Nal Junan, o, i biri i çifutit
 Ky do t'jen taborri pej Shkupit,*

*Nal Junan, o, i biri i derrit,
 Ky do t'jen taborri i Perzerenit,
 Nal Junan, ti bre dilinxhi,⁴
 Prap asçer janë tuj ardhë xhynli.
 Dhe kështu shqiptarët të ushëhequr nga Ibrahim Pasha,
 shpartalluan rezistencën greke, tani vazhdon, kënga:
 Musliman qi bjen shahadet,
 për me hipë n'atë minare t'shkretë,
 me thirrë zanin Muhamet,
 qi so **thirrë rrafsh qe shtatumdhetë vjetë.***

Po ashtu, e ngjashme ishte edhe rezistenca kundër copëtimit të trojeve shqiptare, dorëzimi i Ulqinit te ushtria malazeze, nga ana e Haxhi Der-vish Pashës, Marshall i ushtrisë turke, më 26, nëntor 1880. Ngjarje që e pasqyron kënga: **Me bismele Allah n'selamet**, e që vazhdon me vargjet: *shiptaria u çue n'kamë, kush të don me iman me dekë, n'Karadak⁵ t'bahet bejan.* Ja vargjet e këngës!

³ Junan-i, grek, grekau.

⁴ Dilinxhi-a, tur., njeri i pa ftyrë, i poshtër.

⁵ Karadak-u, (tur.), Mali i Zi.

*T'ejten prama, n'dy sahati,
 Haxhi Pasha.⁶ e hoq nizamin,
 Shkodra e madhe qilloj gati,
 Ja muer kaurrit, istikamin.
 Istikami ty u godutë,
 Asqeria vinë ty u avitë,
Zoti i madh ja u past falë imanin
Për at'dhe tanë janë ra shehid
 Tuk se mrrini Haxhi Pasha,
 Emuer miletin me hexhele,
 Çare s'kemi pa e lëshue Ulqinin,
 E kemi Stamollin muhasere.*

Pra, folklori, si art i fjalës që pasqyroi realitetin jetësor e historik të popullit tonë gjatë periudhave të ndryshme, pati rënie e ngritje, varësisht nga rrethanat e ndryshme kulturore, shoqërore e politike.

Shumë ngjarje dhe personalitete të ndryshme, në disa raste, nuk u pasqyruan në mënyrë të drejtpërdrejtë, por tërthorazi, në mënyrë figurative, me anë të mjeteve stilistike, siç janë: alegoria, kriptologjia, enigmatika, perifraza, metafora, madje edhe përmes meseleve e bejteve. Për shembull:

*Muhabetin ta bajmë bashk,
 As kush mos me na ditë,
 Mos t'na dalin fjala jashtë,
 Se ka i bejt dona me qitë.*

Këto këngë, që këndonin për trimat e heronjtë me mesazhet patriotike që përmbanin, i frymëzonin ata, ua kultivonin dhe ua shtonin me të madhe dashurinë ndaj atdheut dhe ndaj fesë, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër i demaskonin fuqishëm tradhtinë dhe lakminë si vese të këqija, jo njerëzore dhe jo kombëtare.

⁶ Haxhi Dervish Pasha, Komandant i ushtrisë turke.

*Juve u plaçin szhtë e ballit,
Mos i hani paret e Kralit,
Zanat t'zi mos na i leni djalit!
Shiptar veti, kush i thet,
Ai s'e shet venin e vetë.*

Kështu që, në çdo zhanër të këngëve popullore vërehet se është i pranishëm elementi fetar, i cili element e begaton dhe e fuqizon moralin luftarak dhe dashurinë ndaj atdheut.

I. Balada Popullore

*Hasan Aga dhe Çika Patureshë:
O zatet n'çikën Patureshë
Tan tuj lue Çika vjen tuj keshë
Shoqi shoqit ja kan dhanë ka i besë
Kan dhanë besën n'din e iman
Ramazana peng i kan lanë
Dy bajramat i kan lanë dorëzan
Kur të bahem na ka pesumdhet vjetë
Bashk **n'xherdek**⁷ te dy kem me fjetë.*

*M'e pa halla te krushqit po shkon
Letrën n'dorë Imamit ja ka dhanë
Zu Imami letrën p'e kënon
Ja ka nisë krushqve po u kallëzon
Hasan Aga jetë paska dhanë
Nana e vet n'qafë e ka marrë
Tjetërkun ai besën e ka dhanë
Amanet neve na e ka lanë
Me kto dajre krejt ktu çka janë
Bash si nusen dje qysh ja kem marrë*

⁷ Xherdek-u, dhoma e nusërisë, hini rrëndërri në xherdek.

Sod te vorri çashtu do ta çojmë
 Nanës vet ren po i kallëzojnë
 Brimë të madhe nana po banë
 E mjera une n'qafë e paskna marrë
 Te **xhenazja**⁸ hoxha kur po shkon
N'teneshir⁹ Agën pe palon
 Mirë p'e lanë Agën p'e shpërlanë
 Me pamuk sytë po ja qorron
Me qefin¹⁰ po ma përthekon
 Nana e ngrata npër ftyrë i ka ra
 Udha e marë o besnik i ka thanë
 E paske majtë besën qi e ke dhanë
 Edhe Çika vesh e paska marrë
 Shkoj te hoxha rixha po m'i ba
 Pak a bahet xhenazet me nalë
 Po bre motër hoxha i ka thanë
 Qat xhenaze hoxha e ka nalë
 M'e pa çika atëherë çka ban
 Shkoj për ftyre Agës na i ka ra
 Udha e marë Besnik i ka thanë
 Peske majtë besën qi e ke dhanë
 Jo vanesë **tybe**¹¹ s'kam me ba
 Permas teje Agë kam me radhë
 Pra xhenazen xhemati e kanë marrë
 Krushqit në vorr xhenazen p'e çojnë
 Nanës vet Çika na i pasak thanë
 Edhe une jetë due me dhanë
 Amanat nanës ja ka lanë

⁸ Xhenaze, trupi i të vdekurit, ose të vdekurës.

⁹ Teneshir, drrasa ku shtrihet i vdekuri, për t'u pastruar, para se të vorroset.

¹⁰ Qefin-i, (tur.), pëlthurë e bardhë me të cilin, ndër muslimanët, mbështillen të vdekurit para se të varrosen.

¹¹ Tybe-ja, betim, për ta ktyer një punë, ose për të mos e kryer.

Qata krushqi qashtu qysh janë
Edhe mue n'vorr letum çojnë
Hanxhareshë veti na i ka ra
N'at ven çika jetë paska dhanë
*Pra **xhemati**¹² kthye kur janë kanë*
Nana e çikës para u ka dalë
Amanet hoxhë i paska thanë
Edhe Çika jetë na ka dhanë
Bashkë me Agën besën e ka lanë
Amanet neva na e ka lanë
Përskej Agës n'dhe m'e lanë
Shik m'e pa hoxha se çka banë
Hoxhonicën¹³ *po shkon e ka marrë*
N'teneshirë çikën shtri e kanë
Hoxhonica çikën p'e lanë
Udha e marë oj Besnike i ka thanë
E paske majtë besën e dhanë
Përskej Agës n'vorr e kan lanë
Për kitë dynja s'mujten m'u zatetë
I përpjekt Zoti n'xhenet

Kënga Rrushja e Rexhës:

Rrushja e Rexhës p'e çon drekën
Nalnu shoqe t'jau kallëxoj dertin
Ma ka vra Sadria Zekën
I Madhi Zot ai ma vraft veten
Kënga pej zemanit të ezelit:
*Kur ta thërret hoxha Sallen*¹⁴
Dine shokë se unë jam dekë

¹² *Xhemat-i*, turmë njerëzish për ta falur namazin e të vdkurit, ose namazet tjera në xhami.

¹³ *Hoxhonica*, (ar), gasale, femëra e cila e pastron kufomen e femrës.

¹⁴ *Sall-a*, këndim i pikëllueshëm, i muezinit, në minare, lajmëtar, për një të vdekur.

*Ne t'vjena nana t'mi kan hallet
Ajo e din se çka kam hjekë*

*Djalë i ri pa i mushë nizat vjetë
Na i ka krisë zemëra e shkretë
Koka kanë takbir¹⁵ pej Hakut
Me i marrë rrugar për gyrbet*

II. Epika Legjendare

*Ou lum për Ty për të lumin Zot, sjemi kanë,
po Zoti na ka dhanë, pa nafakë ishalla s'na ka lanë.
Mjegull t'madhe Zoti shumë p'e çon
Spedin Muja shokët se ku i ka
Te dy duert n'amin¹⁶ po m'içon
I Madhi Zot ty të kofsha falë
E largon mjegllën kit duman
T'i gjajë shokët e Halilin ku e kam
Po don Zoti bablokun p'e ngon
Ni furtunë t'madhe p'e çon
Pe largon mjehullën at duman
I ka gjet Muja shokët tetanë*

*Krali i Zadranit¹⁷ i zen jesir shokët e Mujës
nëntë vjet i manë në burg:
Dhe i merr në pyetje një nga një,
More Tal Krali i ka thanë
Qe nëntë vjetë mëshelë ju kam lanë
Ka nëntë lëkura n'znan¹⁸ m'i kini lanë
Selamet sod po du meu dhanë*

¹⁵ *Takbir*-i (ar. pers. takdir.) caktim prej Zotit, ajo çka u shkrua me ndodhë.

¹⁶ *Amin*-i, lutje Zotit, Zoti e pranoft, ubaft, si don Zoti.

¹⁷ *Zadrani*, *Zadra*, qytet në Kroaci.

¹⁸ *Znan*-i (tur.) burg, nga fjala zendan.

Çka tu veti lak mos me mi dhanë
 Pra more Tal Krali i kish thanë
 Me t'pas ba une sikur ma ke ba
 Me t'pas thanë n'gojë çka m'ke thanë
 Me m'pas zanë sikur të kam zanë
 Pashë ni Zot ore Tal çka m'kishe ba
 Fort ngushtue Tali koka kanë
 Be ka ba lak mos me i dhanë
 Aje n'veti o Krali i Zadranit
 Me m'pas ba sikur ta kam ba
 Me m'pas thanë n'gojë çka t'kam thanë
 Me t'pas zanë qishtu sikur m'ke zanë
 Moti kryet ty ta kisha marrë.
 Muja e falte namazin kudo që ishte,
 në Bjeshkë, në rrugë apo diku tjetër.

Kënga:

Pra n'bokrrina n'majet ishin dalë
 Vakti i drekës ardhë koka kanë
 Kurr nanazin Muja s'e ka lanë
 Po lypë ujë kërkun sun po gjanë
 O Halil o vlla i ka thanë
Po m'jet dreka sod pa e falë
 Kerkun ujë sun po gjajë
 More bac Halili i mi kish thanë
 Po m'vjen keq ma i moqem kie me kanë
 Pra pej hoxhëve une t'nieshme e kam
Tejemum¹⁹ bac me dhe me marrë
 Ma kabull bac ka me tu ba

¹⁹ *Tejemumi*, (ar.tejemmum). Mënyra dhe mundësia të cilën feja islame përkatësisht, sheriati e lejon që në raste të mungesës së ujit, si parakusht i domosdoshëm që të mund të kryhet namazi, tejemumi duhet të bëhet me dhe të pastër, me zall, ose meterje të tjera.

*Kam harrue o Halil i ka thanë
 Pra do dhe ma t'paçt po ma gjanë
 P'e lypë **Kiblen**²⁰ ai sa mirë p'e gjanë
 O lidh n'namaz drekën e ka falë
 Halili e merr Dylberen e Kralit:
 Shike Imeri oj çikë i ka thanë
 A e kie besen qi e ke dhanë
 Pasha Zotin çika i ka thanë
Muslimane fort moti jam ba
Ramazanat tinez po i ninoj
 Për Halilin çeiz jam tuj ba*

*Fort Halili gëzue koka kanë
 Edhe gjogun djali e kish marrë
Me bismele n'shpinë i ka ra*

*Martesa e Ahmet Bylykbashit
 me Kumrinë e Xhafer Agës:
Ou lum për Ty për të lumën Zot
 Eu ish kanë plak-e Xhafer Aga
 Eu i mjeri i lodhun ish kanë
 Eu evlad Zoti s'i kish falë
 Eu ni t'lutne Zotit po ja banë
Jarabi Allah t'kofshim falë
 Ni evlad mue me ma falë
 Djalë a çikë behana si baj
 Po don Zoti dy çika ja kish falë
 Eu Kumria e madhja ish kanë
 Shumë të mirë Zoti e kish falë
 Zani i sajë e muer krejt dynjanë*

²⁰ *Kibla*, (ar.) drejtimi i obligueshëm, kah i cili myslimani duhet patjetër ta kthejë fytyrë dhe tërë pjesën e përparme të trupit të tij me rastin e faljes së cilitdo prej namazeve.

*Medet plaku ni ditë jetë po nrron
Vet me çika halla metë o kanë
Zot ma vrafsh kralin pej kralisë
E n'atë çikë ai gisht paska vnue
Ja ka çue ni çevre t'praruene
Ja ka çue unazen t'xhevahirit
Edhe ni fjalë krali e paska thanë
S'guxon kush Kumrijen m'e marrë
Dy beglerë te halla po shkojnë
A po ngon oj hallë i kanë thanë
T'kem hi mrena ni çikë me na e dhanë
Njanit duhet përhajr me na e ba
Zgidhe njanin lum Halla i kanë thanë
Hiç inati ne ska me na ardhë
Shike Halla beglerë juka thanë
Cilli t'doni behane s'ju bajë
Ni behane sall çika e ka
Gisht ka vnue krali pej kralisë
E ka pru ni çevre t'prarune
Edhe unazen pej xhevahirit
Edhe ni fjalë mue ma ka thanë
S'guxon kush çikën m'e marrë
Medet qenat t'ligj ishin kanë
Ejvallah lum halla i kanë thanë
Gra t'kralive s'jemi ardhë me marrë
Aksham Zoti kur p'e ban
Fill te halla krali vojtë o kanë
Shumë bajloza me veti i ka marrë
Ju prinë halla n'kullë po i çonë
Nisë e ngrata kafë po ju maronë
Atëherë krali lum halla i ka thanë
Me shkue çikën gati me ma ba
Aman kral halla i ka thanë
Shumë të re çikën e kam*

Po i vjen marre mrena me ardhë
 Rixhanë kralit halla s'poja danë
 Aman kral lum krali i ka thanë
 Une "me qef çikën" ta kam dhanë
 Edhe mue qefin ma maron
 Dy javë vaden me ma lanë
 Une me krushqi kam qef me ta dhanë
Tallbahane²¹ shumë kie me marrë
 Bash si shoqet kam qef me ta dhanë
 Pra batilit n'hatër na i kish fjetë
 Bash qashtu vaden ja ka lanë
 Pra e meçme hallokja ish kanë
 Ish ardhë dita e bajramit
 Medet halla heret çue ish kanë
 Çou Kumri loke i ka thanë
 Mirë pe lanë çikën p'e shpërlanë
 Miër p'e veshë pak ma mirë p'e nrron
 Hec mas nanës loke i ka thanë
 Krrylen n'dorë halla e ka marrë
 Para hoxhës n'xhami po shkon
 Xhamisë deren halla ja ka zanë
 P'e pret hoxhen teri koka ardhë
 Ani halla lum hoxha i kish thanë
 Amanet kitë çikë po ta la
 Qito fjalë xhematit me i thanë
 Me zor krali po don me ma marrë
 Krali gisht n'ta vnue ka
 Nuk guxon kush çikën m'e marrë
 Sod me krushqi krali ka me m'ardhë
 Kështu xhematit t'lutna hoxhë me i thanë
 Jesir çikën ishalla s'kan m'e lanë
 Me të bijen hallashtisë ish kanë

²¹ Tallbuhane, (tur), vegla muzikore, dairet, sazet etj.

N' derë t' xhamisë çikën e ka lanë
 Për shpi udhën halla e ka marrë
 Kah po shkon e ngrata po loton
 P'e pret t' bijen nuse ku po i shkon
 Kuku krali mos po don me marrë
 Ty kajtë halla n' shpi vojtë o kanë
 Pra xhemati kanë zanë janë tuj ardhë
 Besa çikën n' derë ty e qyrrë
 Kryet gërbavt mrena janë tuj hi
 Besa mrena n' xhami hi janë kanë
 Shike hoxha shumë azgan ish kanë
 O xhematë a jini ardhë te tanë
 Po bre hoxhë xhemati i kanë thanë
 Ngoni knena xhematë ju tetanë
 Pra ni çikë n' derë e kini pa
 Bash për sod vaden ja kan da
 Jo për musliman po për ni shka
 Po ni shka, shka i shkinisë
 Gisht ka vnue kraki i kralisë
 Kush del çikën sod m'e marrë
 Sall jesir nër shka mos m'e lanë
 Kitë bajram sod qi jemi ty e falë
 Për mi ta kabull ka me u ba
 Pra n' dy gujt Dizdari çue ish kanë
 A po ngon o hoxhë i ka thanë
 Na jem ardhë bajramin m'e falë
 Gra t' kralive s' jemi ardhë me marrë
 Po don hoxha bajramin m'e falë
 Pra pej Bjeshke ni za koka dalë
 Nal kadale ore hoxhë i ka thanë
 Besa hoxha nalë koka kanë
 Eu xhematë s' koki ardhë tetanë
 S' koka ardhë Ahmet Bylykbashi
 Bash i nipi i Mijës ish kanë
 Si jan kan n' selam i kan dalë

Pra Kumrinë me sy e kish pa
 Ish habitë selam s'ju kish dhashnë
 Aman hoxhë, hoxhës i ka tahnë
 Pra çat lulë kush e ka marrë
 Jo Ahmet kërkush s'e ka marrë
 Ka vnue gisht Krali pej kralisë
 Çikës vaden sod ja ka da
 Ditë bajrami me u martue me shka
 E fesë tonë e ngrata tuj kanë
 Kush del çikën sod m'e marrë
 Sall jesir n'shka mos me lanë
 Si bajramin n'Qabe²² m'e falë
 Pra m'e pa Ahmeti çka banë
 Fill te çika Ahmeti po shkon
 Ma pafsh hajrin Kumri i ka thanë
 Besa hoxha shumë azgin ish kanë
 Para veti te dy po i afron
 Mirë bajramin t'gëzuenin e kanë falë
 Taman **hydben**²³
 hoxha kur p'e knon
 Ni dua Zotit po ja bajnë
 Kitë bajram sod qi mjem ty e falë
 Mi Ahmetin sevapet me kanë
 Sa sevap ky sod ka ba
 Jesir n'shka çikën s'e ka lanë
 Pej Xhamisë dalë kokan kanë
 Me Kumrinë Ahmeti bajram po banë
 Ren zaptitë ngryk e paskan marrë
 Pra dorinë ngat po ja afrojnë

²² Qabe-ja, (ar. Kaba), faltore islame në Mekë, kur falen muslimanët duhet kthyer me fytyrë kah Qabeja.

²³ Hydbe-ja (ar. Hudba), predikim apo fjalimi, të cilin imami i një xhamie apo ndo-një personalitet tjerër fetar e mban me rastin e faljes së xhumasë, Bajramit etj.

Me bismele n'shpinë i ka ra
 Para veti çikën ungj e ka
 Krejt zaptia²⁴ mas po shkojnë tuj knue
 Ky dorinë rrethit tuj e lue
 Shnosh e mirë n'kullë t'veten o shkue
 Pra te kulla Ahmeti po shkon
 Shpejt e ama për para i kish dalë
 Me zapti mirë bajram po banë
 O Ahmet more lum lokja i ka thanë
 Shumë bajrama je shkue me i falë
 Bajram t'gëzueshum kurr kështu s'um ke ardhë
 Mej lum nana oj nanë i kish thanë
 Për kitë çikë kryet pengë e kam lanë
 Kjo e dhanëne n'krali koka kanë
 Hajt Ahmet more budallë mos u ba
 Ni vëlla t'vogël mrapa kie m'e lanë
 Veç ma i mirë se ti ka me u ba
 Aj me zot kullën ty ta banë
 Hajt lum nana Ahmeti i ka thanë
 Hajt shko bukën gati me ma ba
 Tash bajlozat krali do t'mi çonë
 Vinë kojshia për me ba bajram
 Vrajma Zot Dizdari çka ban
 T'mirë ni letër qeni p'e maron
 Mirë zaptive n'dorë ja u paska dhanë
 Mesnet t'madh kralit po mi banë
 Nale darsmen darsëm mos me ba
 Aj Ahmeti Kumrinë ta ka marrë
 Pra me pa zaptia kur po shkojnë
 Pra batilit kur po i kallëzojnë
 Dy bajloza shpejt po m'i shtërngon
 Për me shkue Ahmetit me i thanë

²⁴ Zapti-a (tur.) xhandar i zaptuesve turq; xhandarmëri.

N'fushë te madhe mejdanin m'e da
 Ti Kumrinë me veti m'e marrë
 Edhe une Dylberen due m'e marrë
 Cili t'mujna kryet shoqit me ja marrë
 Këto dy lulat bashkë kemi me i ba
 Pra Ahmetit o bir me m'i thanë
 Sa zapti me veti don me i marrë
 Edhe krali qaq ka me i marrë
 Halla bukën shkoj gati m'e ba
 Taman bukën n'kullë kur p'e çon
 Nja tri softe rrethit ungjës janë kanë
 Mjedis tyne Kumria ujë ty'u dhanë
 Pra bajlozat te dera janë ardhë
 Hajdi mrena halla ju ka thanë
 Pra Ahmetit za po m'i banë
 Nja dy vena t'gatshum me m'i lanë mue
 Dy bajloza krali na i ka çue
 Hajde-hajde nanë i ka kallëzue
 Veni i gaçëm nanë m'ka qillue
 Une kitë kullë k'tu qi e kam marue
 Gjithë ka ven hiç pa u ngushtue
 Pra bajlozat mrena hi jan kanë
 Oj Kumri Ahmeti i ka thanë
 Me mi marrë gjygy m'e legen
 Pra bajlozave dursh me m'u qitë
 Do ti ungji sukur miqtë sparit
 Le t'hanë sillën e bajramit
 Se këta kokan dy djem të ri
 I madhi Zot do t'ju hi n'lakmi
 Kan me u ba dy musliman të ri
 Pra Kumria m'e pa çka po banë
 I kish marrun gjygy m'e legen
 Edhe shkieve dursh u kish qitë
 Edhe n'sofër te dyt ishin ungjës
 Pra sillën e bajramit e kan ngranë

Mirë Ahmeti i paska nerue
Folni birë krali çka u ka çue
Ju nuk kini çare për pa e ngue
Nër ilefe t'ina jeni qillue
O Ahmet i paskan thanë
Shumë selam krali ty t'ka ba
Ti Kumrinë a e ke marrë
Këqyre birë hyzmet ty na ba
Atëherë krali ty të ka thanë
Ti Kumrinë me veti m'e marrë
Pra n'fushë t'mejdanit duhet për me dalë
Edhe krali Dylberen ka m'e marrë
Pra mejdanin ju kini m'e da
Cilli t'muni shoqit kryet me ja marrë
Këto dy lula bashkë kini me i ba
Edhe n'funt Ahmeti i ka thanë
Sa zapti ti po don me i marrë
Edhe krali qaq ne ka me na marrë
Zaptive t'vet Ahmeti sytë ja u lëshon
Kush pej tyne mas Ahmetit i shkon
Paj t'tridheti kryet e kan ungië
As me gojë kurrnja s'ashtë tuj folë
Kafexhia ma i vogëli ish kanë
A po ngoni o birë u kish tahnë
Shkoni kralit m'i bani selam
Na tridhetë zapti kem me kanë
Vetëm zotninë nuk kena m'e lanë
Qysh zotnisë mos me i nimue
Qysh m'e pa zotninë jetë ty nrrue
Për niherë bajlozat jan çue
Shkojshi kralit na i kishin kallëzue
Shik Ahmeti m'e pa çka banë
Aj bre birë zaptive u ka thanë
Shpejt dorinë gati me ma ba
Me tridhetë zapti koka dalë

Hem dorinë gati po ja bajnë
 Aj Ahmeti n'shalë i paska ra
 Pra Kumrisë për krahësh ja ka ngjitë
 Nuk po munet përpara m'e qitë
 Shike halla Ahmet i ka thanë
 Për kit kudër kryet po don m'e lanë
 Ky Ahmeti nanë-loke i ka thanë
 Kur e pruna shumë lavd m'ke pas ba
 Besa veti zor na i paska dhanë
 N'vithe t'dorisë çikën e kish lanë
 Udha e marë halla na u kish thanë
 Besa rrugën ma t'mirë e kanë marrë
 Shike krali m'e pa çka po ban
 Pra Dylberen me veti e ka marrë
 Zaptitë mrapa besa po mi shkojnë
 Ai Dylberës vrançin ja ka dhanë
 Ni sexhade me veti e kish marrë
 Po ma shtron sexhaden n'ledinë
 Ja ka nisë ai me pi raki
 Edhe Ahmeti n'fusha koka dalë
 Pra zaptinë larg i paska lanë
 Pej dorisë n'tokë koka ra
 Ai Kumrisë dorinë ja ka lanë
 Ah m'e panen Ahmeti çka ban
 Paj përskejt kralit po m'i shkon
 O zdravit me kralin o kanë
 Rrudhu pak more batil i ka thanë
 I tha sexhaden une harrue e kam
 Besa krali venin po ja ban
 O Ahmet krali i ka thanë
 Qysh ti gruen Ahmet me ma marrë
 Ou more kral budallë i ka thanë
 Gjithmonë shkiet budallë jini kanë
 Shkau nër turk grue nuk ban me marrë
 Besa turku nër shka po ban

Ai turki shkinën për m'e ba
 Shumë inati kralit na i kish ardhë
 Lej këto fjalë Ahmet i ka thanë
 Na për llafe qitu s'jemi dalë
 Tash mejdanin qysh dona m'e da
 A liftojna sall une e ti
 A liftojna zapti 25 me zapti
 Këqyr Ahmeti o kral i ka thanë
 Po ta kana nusen teme m'e marrë
 Une e ti luftë dom m'e ba
 Kafexhia aty koka kanë
 Kafexhi Ahmeti i ka thanë
 Shko dorinë këta me ma pru
 Edhe Dylberja m'e pa çka po banë
 Vrançin kralit shpejt po ja afronë
 Ky Ahmeti dorinë e kish marrë
 Edhe krali vrançin e kish kapë
 Pra në shala të dytë ju kan ra
 N'shpata e n'myzdrak²⁵ dytë shtërngue janë kanë
 Bash si burrat luftën don m'e ba
 A po ikë more Ahmet a po iku
 I ka Ahmetit thonë na i paska ra
 Kabahatin po thonë e ka ba
 Pra po ikë aj Ahmet Bylykbashi
 Pra pe njek aj krali pej kralisë
 Dej dikur Ahmetin p'e njek
 E dikur myzdrak po ja jepë
 Malimxhi doria m'ish kanë
 Ah për toke paluet po shkon
 Përtej tina myzdraku ish kan ra
 Ai dorinë vetimë p'e dredhon

²⁵ Muzdrak-u, shkop, shtizë, heshtë, me majë shumë të mprehtë, që përdorej gjatë dyluftimit të kreshnikëve.

Besa haz t'madh na i paska dhanë
 Besa ngat kralit po mi shkon
 Me myzdrak Ahmeti kur po sjellë
 Pra n'rruez t'shpinës i gëzuni ja ngjet
 Tej përtej maja po m'ja qet
 Ai Ahmeti m'e pa çka banë
 N'gishta t'kamës çue koka kanë
 Kralit kryet po ja shkurton
 Luftë e madhe nisë ish kanë
 Krejt bajlozat kralit ja shkurton
 Do zapti këtij dam ju kan ba
 Dylberen e Kumrinë i paska marrë
 Ka marrë udhen pej shpie po shkon
 Edhe e ama përpara i ka dalë
 Pra zaptitë ngryk ja paska marrë
 Dhe Kumrinë ngryk p'e përçafon
 Ham Dylberen ngryk p'e shtërngon
 A muj erdhe Ahmet bir i kish thanë
 Si a ma mirë n'kullë ngjitë jan kanë
 Habertores zjarr na i paska dhanë
 Se n'kraina rropllimë-e po shkon
 Nijti Muja edhe shoktë te ranë
 Te Ahmeti n'darsum po shkojnë
 Shumë ni darsum t'mirë po ja u ban
 Për xhedrek koha kur ish ardhë
 Besa hoxha Ahmet i kish thanë
 Me cillën duan sante me ta ba
 Ti lum hoxha Ahmeti i ka thanë
 Me Kumrinë duanë me ma ba
 Për Dylberen ni vëlla une e kam
 Vëllaut Dylberen po due me ja dhanë
 Vëllau i jem kafexhia ish kanë
 Kafexhisë Dylberen ja kish dhanë.

III. Epika Historike

Kënga e Lugut Baranit, viti.1913
Hajmedet për Lug t'Baranit
N'kamë na u çojke Sava i Basanit
Savë Basani n'kamë u çue
N'Baran t'Epër koka shkue
Krejt Baranin e ka rrethue
T'madh e t'vogël i ka tubue
Fill te kisha i paska çue
As fort qeni ju ka ngermue
Bajraktarin ktu ja u due
Bajraktari shpejt koka shkue
Çka more Savë ti qi m'thrret mue
Atëherë Sava i ka kallëzue
Ditë e diell nestra o qillue
M'u pri shqiptarve n'kishë me i çue
Me i ngue popat se çka u thonë juve
M'e prekë kryqin kini m'u kryque
Si mos dishi ju mu kryque
Unë Sava kam me ju mësue
Se kështu krajli më ka urdhmue
Bash pej krajlit urdhnin e kam
Mos t'permenet ma emni shqiptar
Bajraktarit Sava kështu po i thet
Si mos dashi kryqin m'e prekë
Kam mu gri n'shat'e n'shtatdhetë
Kam m'u gri krejt kam m'u coptue
Bajraktari i meçum o qillur
Tri ditë Savë myhlet²⁶ t'i due
Qkep bajraqet m'u kan qillue
Due me dalë me i kërkue
T'aves popullin se çka m'thonë mue

²⁶ Myhlet-i (ar.muhla), -afat, pritje.

Masanej diçka me t'kallëzue
Hazir Alia ni djalë drangur
Pa i folë Savës s'ju durue
Ktheu more Savë qyfar fol me mue
Bajraktarin ma ke munue
Ku ke nie shqiptarët fenë m'e nrrue
Niherë Zotin e kem besue²⁷
Për çdo dotë n'xhami tuj shkue
Ramazanat i kemi ngjinue
Gjithë bajramin e kem festue
S'mun na shtjen kurr fenë m'e nrrue
Pa na gri pa na coptue
Savë Basani ish kanë idhnue
Ushtrisë qeni ju ka ngermue
Disa trima i kanë rrethue
N'kamë e n'dorë i kanë prangue
Jasht Baranit i kanë largue
Po i shtinë vorret me i marue
N'stam të vorreve na i kan çue
Savë Basani iu ka ngermua
O shqiptarë kuku për juve
Kqyrni vorret ku i kini marue
Ma mirë ju bjen ju fenë m'e nrrue
Kapetana kem m'u marue
Koloshinin kini m'e sunue
Rroga t'mira m'u pague
Hazir Alia ni fjalë p'e fletë
Mos u tutni vëllazen p'u thet
Njiher jem le njiher kem me dekë
Tanë do t'bijna shahadet

²⁷ Konvertimi me dhunë i muslimanëve në fenë ortodokëse nga okupatorët serbo-malazez e udhëhequr nga Savë Basani, i njohur edhe si Savë Batarja. Ngjarje e vitit 1913-1914.

Ka ni gisht ta çojmë përtpjetë
Ta bajmë Zotin na isharet
Sod ky Sava po na vret
Tanë po bijkan shahadet
Tanë p'e çojnë ka ni gisht përtpjetë
Pe bajnë Zotin me i sharet
Atëherë Savës inati po i vjen
Ushtrisë urdhnin po ja u jep
Ushtrisë urdhnin ja u ka dhanë
Me i'batore po m'ja u lëshon
Trimet n'vorre rrxue janë kanë
Hazir Alisë goja po i punon
Qit more Savë i tha mos t'kofsha falë
Shahadetin tybe s'un ma nalë
Pa iman hiç s'un u'm çon
A e din shpirtin kush ma ka dhanë
Për së dyti Sava po m'jau lëshon
Tetan trimat qaty jetë po nrrojnë
Tetan trimat po nrrojken jetë
I Madhi Zot i past çuen'xhenet
Kush ta nien ne tu knon rahmet,
Se për din trimat kanë dhanë jatë.

ELIF ALLAH NË KITË DYNJA

Elif Allah, në kitë dynja,
Se pej dekës, kush, pshtim nuk ka.
Pej gjithkujna, kena me u da,
Lumi ai i lumi, pra, men qi ka.
Nuk habitet në, në kitë dynja,
E falë namazin gjith pa ia da,
Ban rahmetë, në fukara.
N'dash me ba, Zoti rahmet,
Pra, ti, çou e ban ibadet,
Ai të gjinet për ahiret.
Për ahiret me banun sermi,

*Vetun nl vorr, na kena me hi,
 Jo me veti, kerkan s'e ki.
 Babë as nanë, as nuk kie vëllazni,
 Dhe përfuni, anve, edhe përmi;
 Kerkah drita, nuk ka me hi.
 Pej këtina terri, kush munet me t'pshtu,
 Veç Zoti i Madh, ni dritë me ta çu.
 Veç ameli i jyt, te ban dritë,
 S'na len ishalla, ne me u merzitë.
 Asi i vetun, more vëlla, mos u ban,
 Mos merr përgoje, hiç kërkan,
 Pse habitesh, more insan?
 Pse çon krye, për me u habitë,
 Masi exheli asht mrapa, tuj, t'pritë,
 Pra, pa dekun, ilaç nuk ka,
 Tanë n'tabut na kena me ra,
 N'dash zinxhin, ndash fukara.
 Hajdi more vëllazen, me i çelun sytë,
 Shahadet, na, me ra natë e ditë;
 Shahadet, bini hiç pa ja da,
 Se ma i mirë imet nuk ka.
 Salavat, bini, hiç pa ja da,
 Ishalla, lutet ai Mustafa.
 Ai te Zoti, pa da ban rigja,
 Mos me na lanë, neve, n'xhehnem me ra.
 Kush don dekës, me i nimue,
 Ai Kur'an duhet, m'e kënuë,
 Çka i kemi senet, kena me i lanë shkret.
 Veç Allahi baft me rahmet.*

ABDESTI

*Lum për Ty për Zotin te lumin
 M'ish kanë Muja me Halilin
 Ni ditë n'kullë heret çue janë kanë
 Sa mirë zjarmin n'kullë e kan dhezë*

Po i marrin ibrig e legen
Mirë avdesin t'paqë e kanë marrë
Mirë me vakt sabahin e kanë falë

SABAHU

Këtu i tërhiqet vërejtja djali i ri, i cili ia kërthet shpinën namazit dhe tregohet mendjemadh rrugës sikur të ishte mbret-padishah, por i thuhet ta len mendjemadhësinë dhe t' kthet namazit:

Kalldermi po m'shkon si shah²⁸
Ma ke qitë qyrkun mejkrah
Aman çun pashë Pereninë
fale bacës nej saba
O i biri i Smjl Hotit qyrkun n'janin krah,
çun pash Perenin fale nej sabah.

Ou lum për Ty, për Zotin te lumin-e
M'ish kanë Muja me Halilin
Ni ditë n'kullë ngjitë ishin kanë
Edhe zjarmin n'kullë e kanë dhezë
Po i marri Ibrig e legen
Mirë avdesin t'paq e kanë marrë
*Mirë **sabahin** me vakt e kanë falë*

DREKA

Pra n'bokrrina Muja ishkan dalë,
*Vakti i **drekës** ardhë koka kanë,*
Kurr namazin Muja s'e ka lanë
Po lyp ujë kerkun s'po gjanë
O Halil vlla i ka thanë
*Po m'jet **dreka** vlla për pa e falë*
Kerkun ujë s'un po gjajë

²⁸ *Shah-u* (pers.) Padishah, mbret.

*More bac Halili i ka thanë
 Po m'vjen keq ma i moqëm kie me kanë
 Pra pej hoxhëve t'nishme une e kanë
Tejemum bac me dhe me marrë
 Ma kabull bac ka me tu ba
 Aiu kam harrue Halil i ka thanë
 Ai do dhe ma t'paqtë e ka marrë
 P'e lypë **Kiblen** sa mirë p'e gjanë
 Edhe nijetin t'mirë e ka ba
 U lidh n'namaza dreken e ka falë.*

IKINDIA

*Diten e shtune mas **Iqinisë**
 Se n'Misir na u nis nizaja²⁹
 Neta nien Mehmet Alia
 Se u rrethie Rexhep Aga*

AKSHAMI

*Shaban Aga ishkan zog sokoli
 Merrnja vesh fjalën qi e foli
 Merrnja vesh në fjalë asht tye thanë
 Due m'u ungj në avdes m'e marrë
Pesë reqate namaz due me i falë
 Fisit vet dul po i çon selam.*

*O i biri i Smajl Hotit qyrkun n'janen anë
 Çun pashë Pereninë **fale nej aksham**.*

²⁹ Nizaja, (tur.), luftë, grindje, konflikt, ushtri etj.

JACIA*Hana lejke në Jaci**Une jam Jollxhi 31³⁰**Apo flet a çka po thue**Dertin po, ma di.***XHUMAJA***Ai Sinani ishkan djalë azgan**Shumë do vjetë kaçak po i banë****Ra n'Dragushë m'e falë xhumanë****Vrajma Zot ni kojshi çka banë**Shkoj Sinanin po ma hjekson**Ren Çaushit po mi kallzon**N'dash Sinanit të gjallë m'e zanë**O ra n'Dragushë m'e falë xhumanë**Isa Beg heret koka çue**Çou Ahmet vlla me u shterngue****Ditë xhumasë n'xhami me shkue*****TERAVIA***Atentat, kundër Nazim Gafurrit:**Ni hafije shkiet e kan pague**Ramazan koka qillue****N'taravi*** Nazmia o kanë*Pej xhamisë n'kafe o dalë**Me do shokë ai llaf po ban**Vrajma Zot çat tradhtar**Ngat dritarës avyt o kanë**Me allti Nazmis po i mshon*

³⁰ Jollxhi, (tur.) udhëtar, kalimtar.

RAMAZANI

*Tridhet ditë janë të ramazanit
Asht myrad i muslimanisë
Vjen e shkon ramazani
seman besen dor ky djali.*

BAJRAMI

*O Azem t'kam pas thanë ty
Me Zhupanin ma bes nuk kie
Tuk e vranë Shakun për ty
E vranë Shakun e Ramadanin
Janë kanë nisë me falë Bajramin*

ZEQATI

*Lejti dielli n'atë buzë t'malit
Po shëndrisin gurtë e kalasë
Gani begu, Gani beg Toptani
Danë zeqatin³¹ fukarasë.*

*Zi edhe i mjeri u rrita jetim
Zemra jeme po rrin pelim
Ej Allahin hak p'e dim
Zemra jeme ma kurr s'di gzim
Lindja e Muhamed Mustafasë:
Zambaku i bardhë kur lulëzoj
Aman more shokë
Me ni rrem e mloj dynjanë³²
kur u çova në mjes t'natës
Aman more shokë
Ngoj bylbylin tuj dhanë vaiz
Kush asht imeti i Muhamedit
T'lumt na more shokë*

³¹ Zekat-i (ar.zakat) “pastërtia”, nderi, lëmosha, e obliguar e paraparë me dispozita të të drejtës islam, vjetore, 2.5%.

³² Me ni rrem e mloj dynjanë, nuri, drita, lindja e Muhamed Mustafas, e shëndriti tërë dynjanë.

VI. RECENSIONE

AUTOBIOGRAFIA SI KONTRIBUT HISTORIOGRAFIK

Anvar El Sadat, Në kërkim të identitetit – rrëfimi i jetës sime (autobiografi), përkthyen Ejup Ramadani dhe Resul Rexhepi, Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, Prishtinë, 2024, f. 479.

Sikundër kanë bërë mjaft personalitete të shquara të përmasës globale, edhe Anvar El Sadati, në një moment të jetës së tij, vendosi të shkruante autobiografinë e tij të bazuar në memorien personale, në të cilën kishte thadruar rrugëtimin e tij tërëjetësor të ndërlidhur ngushtë me faktet historike në një pjesë të rëndësishme të të cilave ai ishte faktor dhe madje-madje edhe kreator i tyre. Periudha e jetës së tij është e ndërlidhur me zhvillime dramatike në Egjiptin modern dhe në rajonin më të gjerë ku shtrihet ai, duke ndikuar jo rrallë edhe në rrjedhat globale të kohës. Pra, nuk është fjala thjesht për një dëshmitar, për dikë që i ka vështruar me vëmendje të ndodhurat e një kohe, veçse kemi të bëjmë me një faktor të rëndësishëm, i cili, me vendimet e tij, në disa aspekte, ka ndikuar në formatin e rrjedhës historike. Historia e tij, në të vërtetë, është një format historie të Egjiptit që nga vitit 1918 e në vijim, sikundër e thotë vetë në fjalën e shkurtër hyrëse.

Memuaret gjithnjë kanë qenë një literaturë që e ka nxitur vëmendjen e lexuesit, por sidomos gjatë shekullit XX ato bëhen një literaturë e pëlqyer së tepërmi, qoftë në aspektin faktografik, gjë që mundëson të kuptuarit e të dhënave dhe fakteve me rëndësi, qoftë në aspektin teknikës dhe të mjeshtërisë së rrëfimit. Marrë parasysh që autobiografitë trajtojnë, në rend të parë, aspekte të jetës personale të autorit është krejtësisht i kuptueshëm per-



ceptimi subjektiv i ngjarjeve të interesit të gjithmbarshëm.

Tejpërtej kësaj autobiografie, të bazuar në kujtime përmbledhëse të një jete me plot zhvillime dramatike, e gjejmë përcaktimin parimor të autorit për t'i lidhur kujtimet e tij me fakte të verifikueshme, për aq sa ka qenë e mundshme, me çka lëndën e tij memuaristike e përafron ndjeshëm me një kontribut të rëndësishëm e të qëndrueshëm historiografik. Anvar El Sadati, në këtë autobiografi, nuk jepet pas aspekteve letrare e imagjinare si fryt i imagjinatës kreative. Subjektivizmi i autorit ngre krye në të shumtën kur bën fjalë për përjetimin personal të situatave konkrete historike nëpër të cilat kaloi ai. Me një fjalë, nuk është jeta personale e tij që ndërhyr në rrjedhat shoqërore, përkundrazi janë zhvillimet e gjithmbarshme ato që e ndikojnë fuqishëm jetën e tij, ndonëse edhe bota e tij e përjetimeve ndikohet prej tyre, sikurse që ndikohen edhe një varg vendimesh që ai, bazuar në përgjegjësitë e shumta dhe gati absolute që i kishte, i merrte në rrethana të krizave e të luftës.

Në të vërtetë, Sadati e pati fatin a fatkeqësinë që të jetonte në rrethana të shndërtimeve rrënjësore historike nëpër të cilat kaloi Egjipti i shekullit XX. Transformimet a revolucionet bartën në vete ngjarje e

përjetime të paharrueshme, e edhe tronditëse, për të dhe për bashkëkohësit e tij. Egjipti nga një mbretëri u shndërrua në një republikë, nga orientimi tradicional lindor prosovjetik e ktheu diplomacinë e tij kah sferat e faktorëve vendimmarrës perëndimorë, nga një luftë me pasoja shkatërrimtare në një paqe të brishtë, por aq të nevojshme për Egjiptin dhe mbarë rajonin, nga një vend eksperimentesh diplomatike të sferës së ndikimit sovjetik në një faktor të rëndësishëm të diplomacisë botërore për kohën etj., kurse në planin personal ai përjetoj transformimet e mëdha nga një fëmijëri e zakonshme në një fshat të humbur për të arritur në metropolin civilizimor të botës, pastaj e shohim se si nga një i burgosur, me kalimin e kohës, kishte zënë poste të rëndësishme përfshirë edhe atë të kryetarit të vendit, nga një oficer puçist në një paqebërës të rangut të Nobelit etj. Pika integruese e përjetimeve personale dhe zhvillimeve të përgjithshme del të jetë Lufta e Tetorit të vitit 1973 me të cilën edhe identifikohet në planin e kronologjisë historike. Ky rrugëtim jetësor i Sadatit, shpeshherë dramatik e me pasoja të mëdha, është shpalosur në një format interesant autobiografik dhe është shpërndarë gjithandej librit me një përqendrim të zhvillimit e interesit të përgjithshëm. Për Sa-

datin jeta e tij nuk ka asnjë domethënie nëse nuk merr parasysh zhvillimet historike në Egjipt, nëse nuk kundrohet në një kontekst më të gjerë të zhvillimeve të kohës, pikërisht sikurse edhe e thekson në këtë fjalë të hyrjes së librit, jeta e tij është e mishëruar në historikun e vendit të tij: “Çdo hap që bëra përgjatë viteve, ishte dhe vazhdon të jetë për hir të Egjiptit, për hir të së vërtetës, të lirisë dhe të paqes”.

Megjithatë, kjo autobiografi, e bazuar në kujtimet e autorit të saj, mbart në vete edhe shumë aspekte personale të cilat kanë të bëjnë me fëmijërinë, ngritjen profesionale, familjen, aktivitetin e tij, burgosjen, arritjet në karrierë, luftën diplomatike, sfidat personale që kishin të bënin me vendimet e përgjithshme etj. Me një fjalë, Sadati njeri i zakonshëm dhe Sadati prijës i një kombi nuk mund të kuptohen pa një ndërlidhje të komponentëve të jetës personale me komponentët e jetës sociale e të zhvillimeve dramatike të historisë së Egjiptit që janë sjellë gjithanshëm në shënimet e tij autobiografike.

Lënda e shkrimeve autobiografike e memuaristike përgjithësisht është përzgjedhje subjektive, ndaj jo rrallë autorët e këtij krahu shkrimesh rrëshqasin në subjektivizëm, si në rastin e materies që sjellin si përmbajtje, ashtu edhe kur bëhet

fjalë për interpretimin e saj. Në rastin tonë ka ndodhur e kundërta, ngase përzgjedhja subjektive dhe interpretimi personal, në masë të ndjeshme, janë objektivizuar nëpërmjet sjelljes së fakteve të verifikueshme dhe të shumanshme, nëpërmjet ndërtimit të rrëfimit autobiografik në kontekstin e zhvillimeve të rëndësishme historike, sikundër ishin lufta egjiptiano-izraelite dhe përpjekjet diplomatike rreth zgjidhjes së saj si krizë permanente. Me një fjalë autori, i vetëdijshëm se e përgjithshmja nuk mund të qëndrojë e plotë brenda të veçantës, nuk e ka vënë historinë e një kohe të vendit të tij dhe të rajonit e më gjerë brenda kornizës së portretit personal. Ky fakt flet për një vetëdije të lartë autoriale që mëton ta objektivizojë, me sa është e mundur, rrëfimin autobiografik, bazuar në parimin sipas të cilit zhvillimet historike nuk ndodhin brenda botës individuale të protagonistit, përkundrazi protagonistit, pavarësisht se i çfarë rëndësie është, vepron brenda tyre, duke u bërë pjesë e tyre. Fundja duke e definuar unitetin ndërmjet jetëshkrimit të tij dhe historisë së Egjiptit, në kuadër të së cilës kishte jetuar, Sadati konsideron se rrëfimi i tij autobiografik “në rend të parë ka të bëjë me rrëfimin e kërkimit të vetes – të vetes sime dhe vetes së Egjiptit – ky trup i vetëm, i cili kishte

shndritur në shpirtin tim që nga fëmijëria ime, kur ishin njësuar vetja ime me vendin tim - tokë e popull”.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e tij si personalitet vendim-marrës i kohës, them me bindje se njohja e plotë e historisë së asoko-hshme të luftërave tragjike izraelito-arabe, por edhe përvijimi i zgjidhjeve paqësore (që nuk u arrit as gjysmë shekulli më vonë), pothuajse duket i pamundshëm pa idetë e shpërfaqura në këtë libër autobiografik. Përfundimi tragjik i Sadatit nuk do të duhej të ishte përfundim i zgjidhjeve që ai ofronte si mundësi reale për të bërë paqen e qëndrueshme dhe aq shumë të nevojshme për popujt, e të cilët, edhe sot e asaj dite, po përjetojnë tmerret e shkatërrimit, madje në një version të papranueshëm të shfarosjes së një kombi të tërë. Koha është të kuptohet thënia lapidare e autorit të kësaj autobiografie, sipas të cilit “nuk ka lumturi për askënd në kurriz të mjerimit të të tjerëve.” Nëse kjo thënie do të ishte pikënisja e një reflektimi të përgjithshëm, pra e një reflektimi të të gjithë faktorëve

rajonale e globale, paqja do të ishte realitet që sot.

Botimi në shqip i autobiografisë “*Në kërkim të identitetit – rrëfimi i jetës sime*” të presidentit egjiptian, Anvar El Sadat, në këtë kohë trazirash globale e luftërash shkatërruese, përbën një risjellje në vëmendje të politikëbërësve dhe të opinionit të gjerë të ideve mbi të cilat mund të ndërtohet një alternativë humane dhe një mirëqenie që do të marrë parasysh të drejtat e të gjithëve. Natyrisht për këtë arritje, që e begaton literaturën autobiografike e memuaristike në gjuhën shqipe dhe i zgjeron horizontet e njohjes së njërës ndër zhvillimet më të rëndësishme historike të gjysmës së dytë të shekullit XX, janë meritore dy përkthyesit tanë, Resul Rexhepi dhe Ejup Ramadani, sikundër që nuk mund të harrohet as kontributi i institucioneve përkatëse të Bashkësisë Islame të Kosovës për mbështetjen dhënë realizimit përfundimtar të këtij botimi.

Hysen Matoshi


“SHQIPËRIA PO DIGJET” DHE “LETRA NGA MËRGIMI” RIKTHEJNË MEHMET AKIFIN TE SHQIPTARËT

**Mehmet Akif Ersoy, Letra nga mërgimi (2023) &
Shqipëria po digjet (2004) përktheu: Abdullah Huruglica,
botoi, Shtëpia botuese: A Publishing.**

Jo të gjithë kanë guxim të shkruajnë. Të shkruash është një akt guximi. Shkrimi, veçanërisht letërsia, është një përpjekje për t'i kthyer në akte veprimi mendimet dhe emocionet, për t'i konkretizuar ato që nuk thuhën lehtë, për t'i sfiduar konvencionet dhe për të lënë një gjurmë në kohë. Ata që shkruajnë nuk janë thjesht kronistë-për-

shkrues të kohës. Shkrimi është ai që i bën të përtejkohshëm-të jetojnë edhe pas vdekjes; të përmenden edhe pas gati një shekull kalimi në botën tjetër, sikundër po bëjmë sot.

Letërsia nuk është vetëm një art i fjalës së bukur, por është edhe një forcë që e sfidon frikën dhe e nxit ndryshimin. Historia ka njohur shumë shkrimtarë që me veprat e tyre



kanë guxuar të prekin tema të ndaluara, ta kritikojnë padrejtësitë dhe të frymëzojnë breza të tërë me mendimin e tyre të lirë e për lirinë. Përmes ligjëritimit të tyre, kredos së pathyer e stoicizmit shembullor, po edhe vargut të fuqishëm poetik, shumë figura janë bërë frymëzim për sa e sa zemra, për sa e sa kohë. Dhe sidomos poezia, që sikurse e vogla ndikon te e madhja, sikurse një person që frymëzon masën, ashtu edhe ajo, mrekullisht, me pak fjalë dhe me formë të fuqishme mund të ngërthejë frymëzimin e një revolucioni, peshën e një epoke.

Një shembull i jashtëzakonshëm i guximit, në jetë dhe në letërsi, është edhe Mehmet Akif Ersoy, një poet që me fjalën e tij nuk kërkoi vetëm pasqyrimin e realitetit, por edhe zgjimin e ndërgjegjes kolektive. Poezia e tij është e mbushur me forcë dhe ndjenjë, ndërsa është e frymëzuar nga ndershmëria, nga atdhedashuria dhe nga përkushtimi ndaj drejtësisë. Në një kohë kur të thuash të vërtetën mund të kishte pasoja të rënda, ai e ngriti zërin pa frikë dhe e përdori poezinë si një armë të shpirtit, pavarësisht pasojave. Po ta lexojmë poezinë e Mehmet Akifit, edhe sot e ndiejmë atë shpirtin e guximshëm dhe revolucionar; atë shpirtin që i rri përballë padrejtësisë deri në vetëmohim. Prandaj edhe sot poezia e tij ka ndi-

kim dhe është e rëndësishme, pasi na edukon me një frymë guximi dhe qëndrese. Për një istikamllëk të pashembullt. Vargjet e tij nuk janë thjesht kujtime të një kohe të kaluar, por janë edhe mesazhe të fuqishme për kohën kur u shkruan dhe për të ardhmen, sepse na mësojnë se të shkruash është një përgjegjësi dhe një sfidë, dhe se fjalët e kanë atë fuqinë t'i lëkundin malet dhe t'i ndriçojnë zemrat.

Në fund të fundit, letërsia është një udhëtim drejt të panjohurës, një përballje me vetveten dhe me shoqërinë. Pra, të shkruash është mos të heshtësh, mos të dorëzohesh përballë errësirës, por të kërkosh dritë në çdo situatë. Të shkruash është të kesh guxim të kërkosh dhe të luftosh për drejtësi, në çdo rrethanë. Pikërisht ky është guximi i vërtetë i letërsisë: të tregosh të vërtetën edhe kur ajo dhemb, të frymëzosh edhe kur shpresa është e zbehtë, dhe të kesh istikam-të qëndrosh besnik dhe i drejtë edhe, siç thotë Mehmet Akifi në poezinë “Dëshmorët e Çanekalasë”, kur *përballë të qëndrojnë shtatë vatrë e dynjasë*¹.

Me rastin e botimit të këtyre veprave të Mehmet Akifit në shqip, “Shqipëria po digjet”, “Letra nga

¹ Mehmet Akif Ersoy, “Shqipëria po digjet”, A Publishing, Prishtinë, 2024, f. 23.

mërgimi”, po edhe “Minberi i Akifit”, është me rëndësi të veçojmë sidomos polidimensionalitetin e tij dhe polisemantikën që reflekton nga teksti letrar i Akifit. Sepse, të pakta janë veprat që kaq thellë përmbledhin frymën e shqetësimit kombëtar, reflektimin filozofik, polivalencën sociale dhe thellësinë shpirtërore, pa harruar edhe dhimbjen e një shpirti të mërguar (siç e kuptojmë nga letrat e tij të shkruara nga Egjipti për pjesën e familjes që kishte mbetur në Turqi).

Mehmet Akifi është i njohur kryesisht për veprën e tij monumentale poetike, “Safahat”, e cila përbën një cikël me shtatë libra, 108 poezi apo 11240 vargje, ku ai paraqet realitetin e shoqërisë osmane në kohë krize, shqetësimet morale dhe fetare, si dhe ndjenjat e një atdhetari të përkushtuar. Poetika e Mehmet Akifit karakterizohet nga një gjuhë e fuqishme, me tendencë për të qenë universale, plot ngarkesë emocionale dhe me retorikë të lartë, që synon jo vetëm pasqyrimin e realitetit, por edhe nxitjen e një reflektimi dhe një angazhimi. Poemat e tij kanë një strukturë narrative të spikatur, ndërsa poeti shpesh përdor edhe një gjuhë të thjeshtë, megjithëse të mbushur me mesazhe të thella etike dhe sociale.

Në përmbledhjen poetike “Shqipëria po digjet” mund të vë-

rejmë se si ndjenja e atdhedashurisë për Shqipërinë është e ndërthurur me dhembjen dhe revoltën për fatin e saj. Akifi e sheh Shqipërinë si një pjesë të pandarë të botës së tij shpirtërore dhe kulturore, dhe vargjet e tij janë të mbushura me një mall të thellë për drejtësinë e munguar për vendlindjen e babait. Në këtë vepër, ai shpreh shqetësimin për degradimin moral dhe politik, krizat e mëdha të fillimshekullit, luftërat në të katër anët dhe padrejtësitë ndaj popullsisë myslimane. Gjithsesi, lapsi i tij i mprehtë ashpër e godet edhe indiferencën dhe neglizhencën ndaj fateve të kombeve të vogla, padrejtësisë ndaj tyre, dhe sidomos kanunin primitiv që po vendosej në botë, se ligjin e bën vetëm i forti. Në tri pjesët e saj, “Këngë për luftën dhe atdheun”, “Poezi shpirtërore”, dhe; “Fragmente poetike”, lexuesi do ta njohë Akifin në tri pjesët kryesore të jetës dhe të aktivitetit të tij intelektual: si frymëzues dhe atdhetar; si fetar dhe besimtar i devotshëm, dhe; si intelektual aktiv. Të njohura janë shumica e poezive të Akifit që lidhen me okazionalitete, sikurse poezitë nga pjesa e parë: “Kënga e luftës”, që buron nga Luftërat Ballkanike; “Zgjohu”, që buron nga Lufta e Parë Botërore; “Marshi i Pavarësisë”, që buron nga Lufta për Pavarësi etj., apo poezitë me të cilat vajtonte fatin e hidhur të popullit

shqiptar, sikurse te poezia “Shqipëria po digjet”, apo “Dëshmorët e Çanaekalasë”. Siç theksohet edhe në parathënie, pjesa e parë e librit është me poezitë më të njohura të Akifit, poezive me motive atdhetare; pjesa e dytë me poezi të motiveve shpirtërore, dhe; pjesa e tretë me poezi të paspecifikuara në temë.

Poezia e Mehmet Akifit, në varg metrikisht të rregullt, kryesisht në *rrubai*-katrenë, dhe kryesisht në 12 ose 16 rrokësh, prerë me cezurë, rregulluar zakonisht në stilin oriental *aruz*, po edhe në *dubejt*-dyvargësh, apo në *musedes*-gjashtëvargësh e *musemen*-tetëvargësh, herë është refleksion narrativ, herë është refleksion didaktik, e herë-herë edhe thumbim i hollë satirik. Në përgjithësi, aspekti figurativ, artistik-letrar dhe leksikor i veprës së Mehmet Akifit janë tiparet më të spikatura të krijimtarisë së tij. Ai përdor metafora të fuqishme dhe simbole për të përçuar ndjenja të thella. Përmes kontrasteve të forta midis dritës dhe errësirës, të mirës dhe të keqes, Akifi arrin të krijojë një atmosferë të mbushur me dramaticitet dhe patos. Personifikimi është një tjetër figurë stilistike që ai përdor me mjeshtëri, ku atdheu apo kombi shfaqen si qenie të gjalla që ndjejnë dhimbje, derdhin lot dhe pësojnë vuajtje. Gjithashtu, ritmi i vargeve të tij shpesh është i gjallë dhe ngac-

mues, duke krijuar një ndjesi urgjence dhe një nevojë për veprim, e që kur lexohet ndihet e gjallë edhe sot, edhe pas një shekulli.

Nga ana tjetër, “Letra nga mërgimi” përfaqëson një anë më personale të poetit. Në këto letra, të shkruara nga Egjipti për familjarët që kishin mbetur matanë detit, kryesisht për vajzën e dhëndrin e vet që ishin në Stamboll, Akifi shfaq mallin, dhimbjen dhe nostalgjinë e një babai të detyruar të jetojë larg familjes dhe atdheut. Edhe pse vetëm letra personale, edhe në to Akifi ruan nivelin intelektual, koncizitetin dhe mprehtësinë, bashkë me stilin i tij letrar, meqë përmes tyre edhe dërgon poezinë e vetme të shkruar prej tij për fëmijë, kushtuar mbesës së tij të dashur, Ferdës, e të cilën do ta gjeni të shqipëruar në faqe 199 të librit. Në këto letra Akifi sikur i lë vend një toni më të përmbajtur dhe më refleksiv, ku shquhet thellësia e mendimit dhe një ndjeshmëri e lartë dhe brenga për fatin e njerëzve të tij të dashur, meqë nëpër letra më shpesh sesa përgjigje, gjejmë pyetje. Kjo vërehet veçmas në letrat ku Akifi shprehet i hidhëruar për mosdhënien e përgjigjeve për pyetjet që i kishte bërë në letrat e mëparshme. Pra, letrat nuk janë thjesht një komunikim familjar, por edhe njëfarë testamenti moral, një medium i kohës ku

Akifi transmeton parimet e veta më të forta mbi dinjitetin, përkushtimin dhe qëndresën përballë vështirësive, e të cilat nuk e lë pa ua përmendur shpesh edhe drejtpërdrejt familjarëve, sidomos vajzës Suadës.

Ndikimi i Mehmet Akifit, edhe në letërsinë shqipe, është i vërejtur, edhe pse jo shumë, për shkak të ndërrimeve politike që ndodhën në Ballkan më vonë. Megjithatë, përkthimi i veprave të tij sjell për lexuesin shqiptarë jo vetëm një figurë të rëndësishme të letërsisë turke dhe islame, por edhe një poet me ndjenja të thella për Shqipërinë, po edhe për të gjitha kombet e vuajtura të kohës së tij. Stilistika e tij, që ndërthur narracionin poetik me filozofinë morale, e bën Akifin një poet okazional, që nuk i shmanget reali-

tetit, mirëpo e përballon atë me guxim, ndershmëri dhe stoicizëm.

Botimi i këtyre veprave në gjuhën shqipe, përkthyer mjeshtërisht prej studiuesit Abdullah Huruglica, ndërsa botuar nga shtëpia botuese A Publishing, është një hap i rëndësishëm për njohjen më të thellë të trashëgimisë letrare të Mehmet Akif Ersoy-it, të një eruditi me gjak shqiptari që shqiptaria nuk e çmoi kurrë aq sa e meritonte. Kjo ngjarje sikur na e lidh hallkën e këputur të zinxhirit kulturor të traditës sonë shqiptare dhe asaj osmane, nëpërmjet një poeti që i përket gjithë botës islame, por që në gjoksin e tij ka pasur një zemër shqiptare.

Besnik Jaha

PËRMBAJTJA

I. EDITORIAL	5
30-VJET NGA GJENOCIDI SERB NË SREBRENICË	7
II. ISLAMISTIKË	11
Mr. Driton ARIFI.....	13
HARRESA SI PENGESË E ZOTËSISË LIGJORE NË TË DREJTËN ISLAME	13
Dr. Sedat ISLAMI	27
PEJGAMBERI ISA, A.S., SIPAS KURANIT, SUNETIT DHE KËSHILLAVE TË PËRCJELLA PREJ TIJ	27
Asist. Prof. Dr. Rexhep SUMA.....	61
STILISTIKA E KURANIT NË PARAQITJEN E HISTORIVE, TË RRËFIMEVE DHE TË TË VËRTETAVE	61
III. KULTURË / TRASHËGIMI	85
Dr. Ferid PIKU.....	87
ABEDIN PASHË DINO, SI KOMENTUES I KURANIT FAMËLARTË SIPAS MËNYRËS SË TEFSIRIT SHOQËROR.....	87
Semra VASIJA-TËRHOLLI.....	109
SUZI ÇELEBIU-PRIZRENASI DHE VAKËFET E TIJ.....	109
Dr. Sc. Zilha MASTALIQ KOSHUTA	141
FUSHATË SNAJPERI NË SARAJEVË GJATË PERIUDHËS SË RRETHIMIT 1992-1995	141
Myderriz Sabit efendi ZAIMI.....	187
NJË HUMBJE E DHIMBSHME PËR BOTËN ISLAME - Myderriz Haxhi Selim efendi Jashari-Drejta (1887-1951)-	187
Enes KARIQ	193
AJETET E KURANIT NË MONUMENTIN MBIVARROR TË JOSEPH VON HAMMER-PURGSTALL-IT	193

IV. TEMA E NUMRIT**(30-vjet nga gjenocidi serb në Srebrenicë) 201**

Naim ef. TËRNAVA 203

KUJTESA E GJALLË DHE DËSHMIA E SHKRUAR:
SREBRENICA NË NDËRGJEGJEN TONË 203

Albin KURTI 211

SRBERENICA - MË SHUMË SE MASAKËR
ISHTE PËRPJEKJE PËR TË ZHDUKUR NJË POPULL.... 211

Ramadan SHKODRA 213

SREBRENICA - DËSHMI E KTHYER NË AMANET 213

Dr. Hysen MATOSHI 217

KUJTESA SI AMANET PËR SREBRENICËN 217

Prof. Dr. Sylë UKSHINI 225

KUJTESA SI REZISTENCË:
RRËFIMI I IMAM HRNJIQIT PËR SREBRENICËN 225

Durim ABDULLAHU 239

SREBRENICA KA NDODHUR, PRANDAJ
MUND TË NDODHË SËRISH! 239**V. REFLEKSIONE 245**

Muharrem B. GASHI 247

KËNGË POPULLORE ME ELEMENTE FETARE 247

VI. RECENSIONE 275

AUTOBIOGRAFIA SI KONTRIBUT HISTORIOGRAFIK.. 277

“SHQIPËRIA PO DIGJET” DHE “LETRA NGA MËRGIMI”
RIKTHEJNË MEHMET AKIFIN TE SHQIPTARËT..... 281

PËRMBAJTJA 287